

Universiteti i Evropës Juglindore
Универзитетот на Југоисточна Европа
South East European University



Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore
Факултет за современи општествени науки
Faculty of Contemporary Social Sciences

STUDIME POSDIPLOMIKE – CIKLI I TRETË

DESERTACION DOKTORATURE

TEZA:

“Ligjërimi nacionalist shqiptar në Kosovë 1945-1999, vazhdimësia e tij në periudhën e pasluftës dhe ndikimi i tij në ligjërimin publik dhe politik”

MENTORI:
Prof. Dr. Ali Pajaziti

KANDIDATI:
Liburn Mustafa

Tetovë, 2020

Deklaratë:

Deklaroj se teza e paraqitur për titull Doktor i Shkencave Politike në UEJL, është punë e imja origjinale. Të gjitha citimet janë sipas standardeve dhe rregullave të përcaktuara në udhëzimet e UEJL-së për citime në teza doktoreshë.

Të drejtat e botimit të tezës së paraqitur i bart vetëm autori i kësaj teze. E njëjta, nuk mund të riprodhohet për çfarëdo qëllimi, pa lejen e autorit.

Liburn Mustafa

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim studimin shkencor të nacionalizmit tek shqiptarët, në veçanti tek shqiptarët e Kosovës. Nevojën e trajtimit të këtij koncepti tek shqiptarët e shtojnë shumë faktorë, ndër ta më të rëndësishmit janë: ai i kujtesës së përbashkët, dallimeve kulturore, niveli i zhvillimit ekonomik e posaçërisht ai i mospërputhjes së kufijve shtetërorë me ata kombëtarë. Shqiptarët pas vitit 1912, përkundër njohjes si komb dhe shtet, gjysma e tyre mbetën jashtë shtetit shqiptar. Në këtë mënyrë, mbeti përgjysmë edhe projekti i nationalistëve shqiptarë për përfshirjen e tërë kombit në një shtet. Kështu, një pjesë e madhe e shqiptarëve të mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë, e posaçërisht ata të ish-Jugosllavisë, projektin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare e konsideronin akoma të pa përfunduar.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është hulumtimi i ligjërimit nationalist shqiptar në Kosovë. Metoda përmes së cilës realizohet ky punim është ajo cilësore. Fillimisht trajtohet lindja, zhvillimi dhe truallizimi i konceptit të nacionalizmit gjatë periudhës së rilindjes kombëtare, ruajtja e koherencës së tij pas pavarësisë së Shqipërisë dhe në veçanti gjatë periudhës së Jugosllavisë së dytë dhe pas saj. Argumentohet se orientimi ligjërimor nationalist në Kosovë është edhe refleksion i orientimeve të tjera ligjërimore siç janë ai i nacionalizmave të tjerë në kuadër të Federatës Jugosllave, si dhe nga ligjërimet e tjera të kohës si ai socialist, komunist, dhe kozmopolitist. Gjithashtu, analizohen arsyet e lëkundjes, ndrydhjes dhe devijimet të idesë së nacionalizmit nga intelektual, politikan dhe lëvizjet politike të kohës. Synimi i mbramë i këtij punimi është që të identifikojë vazhdimësinë dhe ndryshimet në ligjërimin nationalist shqiptar në Kosovë, si dhe reflektimet e këtij ligjërimi në raport me orientimet e tjera ligjërimore.

Fjalët kyçe: Nacionalizmi shqiptar, ligjërimi nationalist, nacionalizmi serb, Rilindja Kombëtare, shteti komb.

Абстракт

Овој научен труд има за цел да има научен пристап за национализмот кај Албанците, особено меѓу косовските Албанци. Потребата за приобање на овој концепт кај Албанците се наметнува од многу фактори, меѓу нив најважни се: оној на колективната меморија, културните разлики, нивото на економски развој со посебен осврт особено на оној од некомпатибилноста на државните и националните граници. Албанците после 1912 година, и покрај тоа што беа признати како нација и држава сепак половина од нив останаа надвор од албанската држава. На овој начин, остана недовршен проектот на албанските националисти за вклучување на целата нација во една држава. И така, голем дел од Албанците оставени надвор од границите на Албанија, особено оние од поранешна Југославија, го сметаа проектот на албанското национално движење сè уште недовршен.

Главната цел на овој труд е истражување на албанскиот националистички дискурс во Косово. Методот преку кој се реализира овој научен труд е квалитативен. Први во трудот се третираат, раѓањето, развојот и територијализацијата на концептот на национализам за време на периодот на национална обнова „ренесанса“, зачувување на нејзината кохерентност по осамостојувањето на Албанија и особено во периодот на втора Југославија. Се тврди дека националистичката дискурсна ориентација на Косово е исто така одраз на другите дискурс-ориентации, како што се оние на другите национализми во рамките на Југословенската федерација, како и на другите дискурси од тоа време, како што се социјалистичкиот, комунистичкиот и космополитскиот. Исто така, анализирани се причините за осцилација та, репресијата и отстапувањата на идејата за национализам од интелектуалните, политичарите и политичките движења на времето. Конечната цел на овој труд е да се идентификуваат континуитетот и промените во албанскиот националистички дискурс на Косово, како и рефлексите на овој дискурс во однос на другите дискурси ориентации.

Клучни зборови: Албански национализам, националистички дискурс, Српски национализам, Национална ренесанса, национална држава.

Abstract

This paper aims the scientific study of nationalism among Albanians, especially among Kosovo Albanians. The need to address this concept among Albanians is pushed by many factors, among them the most important are: that of collective memory, cultural differences, the level of economic development and especially that of the incompatibility of state and national borders. Albanians after 1912, even though were recognized as a nation and a state, half of them remained outside the Albanian state. In this way, the project of the Albanian nationalists for the inclusion of the whole nation in one state remained incomplete. Thus, a large part of the Albanians left outside the borders of Albania, especially those of the former Yugoslavia, considered the project of the Albanian National Movement yet unfinished.

Thus, the main purpose of this paper is to research the Albanian nationalist discourse in Kosovo. The method through which this work is realized is the qualitative one. The dawn, development and organization of the concept of nationalism during the period of national renaissance, the preservation of its coherence after the independence of Albania and especially during the period of the second Yugoslavia and after it, are first treated. It is argued that the nationalist discourse orientation in Kosovo is also a reflection of other discourse orientations such as that of other nationalisms within the Yugoslav Federation, as well as other discourses of the time such as the socialist, communist, and cosmopolitan. Also, the reasons for the oscillation, repression and deviations of the idea of nationalism from the intellectual, politician and political movements of the time are analyzed. The final aim of this paper is to identify the continuity and changes in the Albanian nationalist discourse in Kosovo, as well as the reflections of this discourse in relation to other discourse orientations.

Keywords: Albanian Nationalism, Nationalist Discourse, Serbian Nationalism, National Renaissance, nation-state.

Parathënie

Qëllimi i trajtimit të kësaj teme në këtë hulumtim është burim i shumë arsyeve. Njohja me idenë e nacionalizmit shqiptar nën shpjegimin e teorive shkencore bashkëkohore, është fusha të cilën prej shumë kohësh dëshiroj ta studioj. Synimi im është që çështja e nacionalizmit shqiptar të trajtohet nga një këndvështrim tjetër nga ky i deritanishmi, jo vetëm me qasje nga Republika e Shqipërisë, por edhe nga trevat tjera etnike shqiptare, e posaçërisht nga Kosova. Natyra e hulumtimit, shtrirja e idesë nëpër kohë dhe në periudha të ndryshme historike, sociale e politike kërkon përdorimin e metodave cilësore të studimit. Kjo përfshinë analizën e diskursit të veprave, artikujve, shkrimeve e orientimeve programore të lëvizjeve politike të kohës, për të shpalosur konsistencën dhe oscilimet ideore të ligjëritit nationalist në Kosovë. Hulumtimi nuk mëton version shterues të kësaj teme, por sadopak të kontribuojë në diskutimin mbi nacionalizmin shqiptar, të kaluarën dhe të tashmen, dhe shqyrton mundësinë e nacionalizmit si forcë lëvizëse në ndryshimin e botëkuptimeve politike për të dy shtetet shqiptare në të ardhmen. Natyrisht e tërë kjo detyrë para vetes është e paarritshme pa mbështetjen e familjes, profesorëve, komunitetit intelektual, institucioneve të ndryshme kërkimore dhe shoqërisë në përgjithësi. Andaj, i falënderoj të gjithë që më ndihmuan në këtë arritje të rëndësishme profesionale personale. Fillimisht, falënderoj bashkëshorten time Fisniken për kurajën, besimin, nxitjen dhe ndihmën profesionale që më ka dhënë për ta konkretizuar këtë punim; fëmijët e mi, Erinën dhe Anesën, frymëzueset e mia për të arritur titullin e doktorit të shkencave politike. Falënderoj përzemërsisht prindërit e mi, Mustafën dhe Sherminen, nga të cilët asnjëherë nuk ka munguar mbështetja për edukim dhe arsimim; vëllezërit e mi, Hysenin dhe Latifin për inkurajimin dhe kontributin profesional në këtë rrugëtim.

Falënderoj veçanërisht profesor doktor Ali Pajazitin, njëherit dhe mentorin e kësaj teze, për udhëzimet dhe këshillat e trajtimit të temës nga aspekti shkencor dhe profesional, si dhe për besimin që ai kishte tek unë mbi iniciativën e ndërmarrë. Gjithashtu, falënderoj të gjithë profesorët, intelektualët dhe posaçërisht njohësit e kësaj fushe të studimit për konsultat, sugjerimet, këshillat e pakursyera që ky punim të dalë sa më i kompletuar. Ndërkaq, të gjitha mangësitë që mund të përmbajë kjo tezë, janë përgjegjësi tërësisht e imja, për të cilat diskutimi është i hapur dhe i mirëseardhur.

Përmbajtja

I. Hyrje.....	9
1. <i>Shtrimi i Problemit.....</i>	15
2. <i>Ravijëzim i propozimit të hulumtimit.....</i>	17
3. <i>Metodologjia.....</i>	21
II. Sfondi teorik.....	24
1. <i>Teoritë dhe konceptet.....</i>	24
2. <i>Nocioni i kombit.....</i>	27
2.1 <i>Përkufizimi dhe karakteristikat e një kombi.....</i>	28
2.2 <i>Koncepti i kombi kulturor-etnik.....</i>	29
2.3 <i>Koncepti i kombit politik-qytetar.....</i>	31
3. <i>Teoritë e nacionalizmit.....</i>	33
3.1 <i>Nacionalizmi liberal.....</i>	35
3.2 <i>Nacionalizmi socialist.....</i>	36
3.3 <i>Nacionalizmi antikolonial.....</i>	38
3.4 <i>Nacionalizmi ekspansionist.....</i>	39
3.5 <i>Ideja e nacionalizmit si kohezioni i brendshëm kombëtar.....</i>	39
4. <i>Multikulturalizmi dhe ideja e shtetit multi-etnik.....</i>	41
5. <i>Kozmopolitizmi.....</i>	44
III. Lindja e nacionalizmit shqiptarë.....	49
1. <i>Rilindja Kombëtare.....</i>	50
1.1 <i>Reformat e “Tanzimatit” dhe fillimet e ngritjes së vetëdijes kombëtare shqiptare.....</i>	52
1.2 <i>Planet shoviniste për copëtimin e tokave shqiptare.....</i>	55
1.3 <i>Gjendja ndërkombëtare dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit.....</i>	57
2. <i>Ligjërimi nationalist.....</i>	60
2.1 <i>Kombi në epiqendër të ligjëritimit nga Rilindësit.....</i>	61
2.2 <i>Parimi i nationalist i Rilindasve.....</i>	69
IV. Vazhdimësia e ligjëritimit nationalist shqiptarë në Jugosllavinë e parë.....	72
1. <i>Ligjërimi nationalist shqiptar në Kosovë.....</i>	73
1.1 <i>Hasan Prishtina.....</i>	77
1.2 <i>Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”.....</i>	80
1.3 <i>Lëvizja Nacionalçlirimtare (Lëvizja kaçake).....</i>	83
2.3 <i>Partia Bashkimi (Xhemijeti) dhe përparja parlamentare.....</i>	85
2. <i>Qasja “neutrale” e shtetit shqiptarë ndaj lëvizjeve nacionaliste shqiptare në Kosovë.....</i>	89
3. <i>Ligjërimi politik serb ndaj Kosovës.....</i>	94
V. Ligjërimi nationalist në Kosovë gjatë Jugosllavisë së dytë.....	98
1. <i>Përkufizimi i ligjëritimit nationalist shqiptarë në Kosovë.....</i>	101
1.1 <i>Arsyet e përbrendësimit të konceptit të vendvendosjes në ligjëritimin nationalist.....</i>	107
1.2 <i>Arsyet e përdorimit të eksponentëve “majtiste” tek disa lëvizjeve nacionaliste.....</i>	111

2.	<i>Ligjërimi nacionalist shqiptarë përbrenda Jugosllavisë</i>	114
2.1	Programi politik i Organizata Nacional Demokratike Shqiptare	115
2.2	Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve.....	118
2.3	Demonstratat e 68-tës.....	122
2.4	Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavisë.....	127
2.5	Demonstrata e 81-tës	129
3.	<i>Diferencimi i mendimit nacionalist shqiptarë në Kosovë, nga logjika kombëtare në logjikën e ndarjes territoriale dhe administrative</i>	134
4.	<i>Qasja “indiferente” e shtetit shqiptarë ndaj lëvizjeve nacionaliste në Kosovë</i>	136
5.	<i>Ligjërimi politik jugosllav ndaj çështjes shqiptare në Jugosllavi</i>	140
VI.	Rezistenca paqësore dhe lufta çlirimtare	145
1.	<i>Ligjërimi nacionalist shqiptar, përpjekja për pavarësi dhe shtet ndërtim</i>	146
1.1	Lidhja Demokratike e Kosovës	153
1.2	Ukshin Hoti	157
1.3	Rexhep Qosja	161
1.4	Ushtria Çlirimtare e Kosovës.....	167
2.	<i>Qasja e Shqipërisë ndaj çështjes së Kosovës</i>	170
3.	<i>Ligjërimi jugosllav ndaj çështjes së Kosovës</i>	174
VII.	Ligjërimi politik para dhe pas Pavarësisë së Kosovës	177
1.	<i>Ligjërimi nacionalist shqiptarë dhe ligjërimi kozmopolit</i>	180
2.	<i>Koncepti “multietnik” i shtetit dhe fokusi pan-europian i tij</i>	182
3.	<i>Kosova dhe ideja e shteti si “pronar” i kombit</i>	190
4.	<i>“Bashkimi” i shqiptarëve në Bashkimin Evropian</i>	193
5.	<i>Ligjërimi nacionalist shqiptarë në Kosovën e pas luftës</i>	196
VIII.	Përfundim	203
IX.	Literatura	210

I. Hyrje

Kosova, përveç se është një shtet i ri, ajo përbën nocionin më polisemik¹ të mundshëm në historinë e saj, me theks të veçantë në shek. XX dhe fillimet e XXI. Përtej një objekti me ngarkesa të fuqishme semantike nga popuj të ndryshëm, polisemiteti i saj shtresëzon mbivendosjet e ngjarjeve të ndryshme historike, interpretimet dhe narracionet e këtyre ngjarjeve si dhe lëvizjet ideore, shoqërore e politike. Të gjitha këto janë kryqëzuar dhe pritur në forma dhe trajta të ndryshme duke e shpërfaqur dinamikën dialektike të këtij topos-i, për t'u shndërruar në nyjën gordiane ballkanike. Kosova ka një histori të bujshme, udhëkryq perandorish e identitetesh, interesash demografike, ekonomike dhe politike deri tek një kuti pandoriane ku gërshetohen interesat globale dhe ekuilibrat e tyre përmes aktorëve rajonalë. Narracioni i saj historik, fillon me gjenezën Iliro-Dardane, pushtimet e ndryshme perandorake dhe njëherit me përplasjet mes traditave të ndryshme kulturore dhe shoqërore, e deri tek përplasjet identitare mes identitetit shqiptar dhe atij sllav në njëqindvjeçarin e fundit.² Në shpjegimet kredibile historike Kosova është vendi i ballafaqimit të Perandorisë Osmane të Muratit të I-rë dhe Mbretërisë Serbe të Car Lazarit, është vendi i një ballafaqimi historik të identitetit dhe pronësisë historike midis dy popujve, shqiptarëve dhe serbëve; vend i lashtësisë së kishave ortodokse dhe xhamive myslimane, e mbi të gjitha djep i një Ballkani paqësor dhe stabil. Kosova sot është një vend i pavarur me një sovranitet të cunuar, stabilitet fragjil por me perspektivë të dëshirueshme europiane dhe euroatlantike. Ngaqë historikisht konsiderohet si vendi i përplasjeve epike të popujve, e sidomos të popullit shqiptar dhe serb, Kosova është epiqendra narrative dhe simbolike e dy nacionalizmave të mëdhenj të Ballkanit: nacionalizmit shqiptar dhe nacionalizmit serb.³ Një version nationalist i kësaj përballjeje e gjejmë tek miti i cili na përkuajt kontrastin midis “qytetërimit të shkëlqyer ilirik” dhe “të barbarisë së hordhive sllave”, kurse në një version më modern e gjejmë rolin e Lidhjes së Prizrenit si lëvizje e rezistencës politike dhe ushtarake

¹ Polisemia karakterizohet si fenomen me të cilin një formë e vetme fjalëformuese shoqërohet me dy ose disa kuptime të ndërlidhura. Dallohet nga monosemia, ku një formë fjale shoqërohet me një kuptim të vetëm, dhe homonimia, ku një formë e vetme fjalësh shoqërohet me dy ose disa kuptime të palidhura. Shih: Polysemy, Adam Sennet, Polysemy, Philosophy of Language, Online Publication Date: Aug 2016: <https://www.oxfordhandbooks.com/view/10.1093/oxfordhb/9780199935314.001.0001/oxfordhb-9780199935314-e-32>, 20, 08, 2020.

² Shih: Baruch Kimmerling, Clash of Identities, Columbia University Press, New York, 2008.

³ Shih: Oliver Jeans Schmitt, Kosova histori shkurtër e një treve qendrore Ballkanike, Koha, Prishtin, 2012.

kundër Perandorisë Osmane dhe popujve fqinj në origjinën e së cilës ishte Kosova.⁴ Së fundmi, dëshmitarë të së cilës ishim edhe ne, ishte lufta shqiptaro-serbe në Kosovë (1999), në Luginë të Preshevës (2000) dhe në Maqedoninë e Veriut (2001).

Në këtë disertacion doktore, përmes paraqitjes kronologjike të ngjarjeve politike në trajektoren historike dhe analizën diskurseve të subjekteve individuale dhe politike të kohës, do të përpiqemi që të analizojmë, komentojmë dhe të ndërtojmë diskursin kritik që ka të bëjë me nacionalizmin si një dukuri komplekse, ideore, konceptuale dhe praktike të shqiptarët në përgjithësi, por në veçanti të shqiptarët e Kosovës. Studimi shkencor i nacionalizmit shihet si domosdoshmëri e kohës, ngaqë përbën një ndër forcat më të rëndësishme që ka ndikuar gjatë historisë së botës moderne. Koncepti komb zë një vend qendror në kuptimin e nacionalizmit, apo për të qartësuar edhe më tej ndërvarësinë e dy koncepteve mund të përmendim njërin ndër studiuesit më me autoritet të kësaj fushe si Ernest Gellnerin i cili thotë se “nacionalizmi është ai i cili krijon kombet dhe nuk është e kundërta”, dhe nacionalizmin e përkufizon si “një parim sipas të cilit njësi politike dhe njësi kombëtare duhet të përputhen”.⁵ Pra, mund të themi se koncepti i nacionalizmit nuk varet drejtpërdrejtë nga përcaktimet teorike të konceptit komb, sepse kombi nënkupton një bashkësi shoqërore kurse koncepti nacionalizëm shënon një parim politik.⁶ Pra, mund të themi që në këtë punim do të trajtohet nacionalizmi dhe teoritë e nacionalizmit si parim politik dhe manifestimin e këtij koncepti në ligjërimin politik tek shqiptarët e Kosovës ndër vite. Gjegjesisht, frymën e këtij parimi dhe aspektin shumëdimensional ligjërimit të nacionalizmit tek shqiptarët e Kosovës, frymë me të cilën u udhëhoqën edhe lëvizjet komb/shtet-formuese të Evropës Perëndimore.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është nxjerrja në pah e vazhdimësisë së ligjërimit nacionalist shqiptar në Kosovë në periudhën e Jugosllavisë së dytë si dhe shpërfaqja e këtij mendimi në periudhën e pasluftës në Kosovë (1999). Mirëpo, për të shpalosur vazhdimësinë e ligjërimit nacionalist në këto periudha, fillimisht jemi përpjekur që të hulumtojmë formulimin dhe brumosjen e nacionalizmit shqiptar në retrospektivë. Ky ligjërim u shfaq në shekullin e XIX, nën refleksionin e ngjarjeve të kohës dhe nën ndikimin e ligjërimeve të tjera nacionaliste që

⁴ Muhamedin Kullashi, Përplasja e identiteteve, Dukagjini, Pejë, 2003, f.109

⁵ Ernest Gellner, Kombet dhe Nacionalizmi, Rizoma, p.v.b, p.v.b. f. 27.

⁶ Mbi “parimin politik”, shih më tepër: Ali Pajaziti, Fjalor i Sociologjisë, Logos-A, Shkup, 2009, 500-501; Iain McLean, Fjalor Politik Oxford, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, Tiranë, 2001, 407, 446-447.

shfaqeshin tek popujt e tjerë ballkanas në atë kohë, kështu edhe intelektualët shqiptarë filluan të shkruanin dhe të thërrisnin në emër të “kombit shqiptar”. Në këtë mënyrë vijmë deri tek ndërgjegjësimi i të qenit komb, i cili më pas derivon edhe karakteristikat politike të veta, pra shqiptarët kërkonin të kishin bashkësinë e tyre politike, shtetin e tyre kombëtar, periudhë kjo e ashtuquajtur “Rilindja Kombëtare”. Aktorët e kësaj lëvizjeje për herë të parë artikuloan kombin shqiptar si “bashkësi të përfytyruar”, e cila edhe u bë themel i organizimit politik dhe shoqëror ndër shqiptarë. Rilindja Kombëtare, gjegjësisht plejada e intelektualëve që radhiteshin si pjesë e saj, ishte lëvizja e parë politike që artikuloi fatin e shqiptarëve si bashkësi, gjithashtu dhe vuri themelet e mendimit politik nacionalist shqiptar. Projekti i Rilindjes Kombëtare pati sukses të pjesshëm, shqiptarët u njohën si komb, mirëpo, shteti shqiptar u krijua nga gjysma e popullit dhe atdheut shqiptar, dhe pjesa më e madhe e popullit dhe territoreve të shqiptarëve mbetën jashtë shtetit shqiptar. Kështu, qëllimi i Rilindjes Kombëtare u shpall si i pa përfunduar dhe çështja shqiptare është akoma e hapur dhe kërkon zgjidhje të drejtë. Pra, Rilindja u bë burim i fuqishëm frymëzimi nga intelektualë dhe politikanë shqiptarë jashtë shtetit shqiptar, kësaj vazhdoi dhe përpjekja për çlirimin kombëtar në trojet shqiptare në ish-Jugosllavi. Vazhdimësia e këtij projekti ka qenë motiv kryesor i politikbërjes së shqiptarëve të Kosovës ndër vite, që njëherit është edhe objekti kryesor i këtij hulumtimi.

Periudha nga viti 1912-1945, ku etnia shqiptare jashtë kufijve të shtetit të Shqipërisë, konsiderohet ndër etnitë më të shtypura fillimisht nga ushtria Serbo-Malazeze, për t’u strukturuar në formën e një nomenklature të avancuar kolonizuese dhe shtypëse nga Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene. Bazuar në burime të rëndësishme historike mund të përmendim se mbi 150 mijë shqiptarë janë dëbuar nga trevat lindore dhe shumë të tjerë janë torturuar, vrarë dhe eliminuar nga forcat Serbo-Malazeze.⁷ Është e njohur për publikun reportazhi i Leon Trockit, i quajtur “unë dëshmitari i masakrave serbe ndaj shqiptarëve në Shkup” reportazh ky i cili përshkruan në detaje soditjen e korrespondentit të gazetës ruse “Kievskaja misl” botuar në dhjetor të vitit 1912. Si formë reaksioni ndaj saj fillojnë organizime të ndryshme politike si përgjigje ndaj këtij projekti. Periudha e pas pavarësisë së Shqipërisë, që konsiderohet ndër periudhat më të vështira për shqiptarët, do të jetë në

⁷ Shih më tepër: Noel Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, Koha, Prishtinë, 2001, 298; Miranda Vickers, Midis Serbëve dhe Shqiptarëve Një histori e Kosovës, Toena, Toranë, 2004, 153.

fokus të këtij studimi, në mënyrë të veçantë vazhdimësia e nacionalizmit shqiptar, si pikënisje për një angazhim politik dhe si sublimim i një lajtmotivi për një organizim të ri politik e ushtarak, me lëvizjet politike si Komiteti për “Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës”, Lëvizjet Nacionalçlirimtare (Kaçake), Xhemijeti me protagonistët kryesorë të këtyre lëvizjeve, si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Azem Bejta, Nexhip Draga, Ferhat Draga e të tjera figura politike të kohës që i bënë ballë represionit sistematik ndaj popullatës shqiptare, dhunës dhe kolonizimit të vendbanimeve shqiptare. Gjithashtu vëmendje do t’u kushtohet edhe lëvizjeve politike të kohës në Shqipëri, gjegjësisht qëndrimeve të qeverive të ndryshme ndaj çështjes së Kosovës dhe viseve të tjera në përgjithësi.

Periodha 1945-1990, gjegjësisht, periodha e Jugosllavisë së dytë, është periodha ku shqiptarët e kuptimësojnë dhe fuqizojnë më shumë identitetin e tyre politik, me ç’rast qenien e tyre politike e aktualizojnë përmes rezistencës dhe formave të organizimit politik si të popujve të kolonizuar, siç janë protestat, grevat, referendumet dhe mekanizmat e tjerë legalë dhe ilegalë politik. Në këtë kontekst shqyrtohet shfaqja e lëvizjeve të reja politike si dhe orientimet e tyre ligjërimore mbi çështjen kombëtare shqiptare si të vetmen zgjidhje të drejtë. Këtu, do të pasqyrohet ligjërimi politik i lëvizjeve ilegale si Organizata Nacionale Demokratike Shqiptare (NDSH), Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSH), karakteri ligjërimitor i demonstratave të 68-ës, të demonstratave të 81-ës, si dhe ngjarje dhe protagonistë të rëndësishëm të ligjërimit nacionalist shqiptar të kësaj periudhe. Gjithashtu, do të trajtohen edhe oscilimet e shumta ligjërimore të lëvizjeve politike shqiptare në këtë kohë, që njëherit mund të themi se është periodha e transformimit të ligjërimit politik nga ai i logjikës kombëtare në logjikën e ndarjes territoriale dhe administrative. Përpos ngjarjeve të rëndësishme politike të kësaj periudhe do të analizohen edhe tendencat e projektit për formimin e “kombit jugosllav”, ku kishte për qëllim transformimin e identiteteve tradicionale përmes asimilimit të popujve ekzistues. Në këtë kontekst mund të përmendim edhe nismën për dallimin midis shqiptarëve të Kosovës si “Šiptari” dhe të shqiptarëve të Shqipërisë si “Albanaci”, që kishin për qëllim ndarjen artificiale midis popullsisë shqiptare. Ky gjysmëshekull i Kosovës do të jetë periodha më e rëndësishme në transformimin dhe evoluimin politik të shqiptarëve në Kosovë, gjë që në momente të caktuara, do të gjenerojë plasaritje të vogla dhe shkarje të tjera si pjesë e ndërhyrjes së Federatës Jugosllave në riformësimin e identitetit politik të shqiptarëve të Kosovës.

Në pjesën për periudhën e pas 1990-ës, të rezistencës paqësore dhe të luftës çlirimtare, analizohet ligjërimi politik i lëvizjeve dominuese të kohës si dhe i intelektualëve të shquar që njëherit artikulojnë ligjërimin politik në frymën e ligjëritimit nacionalist. Duke filluar me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), deri te Ukshin Hoti dhe Rexhep Qosja. Në këtë periudhë, ligjërimi nacionalist shqiptar paraqitet në formën e vet të ndrydhur dhe me lëkundje të përhershme konceptuale. Gjegjesisht, përjashtuar Ukshin Hotin, i cili çështjen shqiptare e artikulon në koherencë me ligjërimin nacionalist, protagonistë të tjerë këtë ligjërim ia nënshtrojnë ndryshimeve të kohëpaskohshme të rrethanave politike. Ai nuk është i artikuluar si ide imanente dhe nevojë e domosdoshme e shoqërisë përkatëse, por si ide opsionale, e nënshtuar ndaj realitetit politik.

Në kapitullin e shtatë të këtij studimi, të periudhës së para dhe pas pavarësisë së Kosovës, do të analizohen dy forma të ndryshme ligjërimore, të cilat me kohën formësohen si të kundërvëna ndaj njëra-tjetrës. Ato janë ligjërimi nacionalist dhe ligjërimi kozmopolit. Ligjërimi kozmopolit shfaqet si i mbështetur në konceptin e “shtetit multietnik”, si dhe në konceptin e “shtetit që ndërton kombin” e që në disa raste kalon në trajtën e “kosovarizmit”. Për më tepër, mbështetësit e ligjëritimit kozmopolit, argumentojnë se realiteti kosovar është një realitet i ri dhe si i tillë është i shkëputur nga rrethanat politike dhe historike të Shqipërisë. Në këtë kontekst, Kosova do të duhej të zhvillohej si një shtet i ri evropian, me kulturë dhe identitet politik të mëvetësishëm apo siç shpesh e proklamojnë si projekt të sponsorizuar nga BE-ja dhe SHBA-ja. Në ligjërimin kozmopolit ekziston mungesa e referimeve të kombit si bashkësi politike. E kundërta ndodh me ligjërimin nacionalist ku kombi është epiqendër e politikbërjes dhe politikveprimit, por megjithatë, kombi paraqitet si ecejake dhe lum që rrjedh drejt botëkuptimit perëndimor. Mbështetësit e ligjëritimit nacionalist shprehin rezistencë të fuqishme ndaj të gjitha formave të kozmopolitizmit sepse identitetin kosovar të promovuar si identitet më vete e refuzojnë dhe e konsiderojnë si inxhinering artificial. Ai shpesh, po ashtu, shfaqet edhe si manifestim i pakënaqësisë ndaj “establishmentit ndërkombëtar” dhe menaxhimit të tyre të dobët. Nga teorizimi që i bënë realitetit politik, duke e pasur në fokus kryesor çështjen kombëtare dhe zgjidhjen e saj, mund të themi se ajo përkon me orientimin ligjërimor nacionalist dhe trashëgiminë ligjërimore nacionaliste të periudhës së 1945-1999, që u promovua nga elita kulturore dhe politike kosovare.

Në këtë disertacion doktore, përmes analizës diskursive në prerje të tërthorta me zhvillim analizën e diskursit historiografik, do të hidhet dritë mbi shkarjen fillestare dhe evoluimin e një trendi të ri, diskursi të ri politik me gjenezë në nacionalizmin shqiptar por me koncepte të një realiteti të ri politik të Kosovës i cili kalon në etapën e kolonizimit, socializmit dhe tranzicionit deri në shpalljen e pavarësisë së vet dhe përpjekjen diplomatike për sovranitet të plotë ndërkombëtar. I gjithë ky angazhim politik, siç do të shohim më vonë, do të legjitimohet moralisht në bazë të së drejtës së popujve për vetëvendosje, situatës gjeopolitike të shkatërrimit të Jugosllavisë dhe aktorëve gjeopolitikë ndërkombëtarë me ndërhyrjen e tyre humanitare në Kosovë.

1. Shtrimi i Problemit

Që prej formimit të Lëvizjes Kombëtare shqiptare u shtrua “Çështja e shqiptare”, e cila për qëllim kryesor kishte krijimin e një shteti të pavarur shqiptar ku do të përfshiheshin të gjitha trojet etnike shqiptare. Lëvizja kombëtare në raport kundërthënës me Perandorinë Osmane, popujt fqinj dhe me Fuqitë e Mëdha arriti të konsolidojë veçantësinë e shqiptarëve si komb dhe i ndërgjegjësoi ata për mbrojtjen e tërësisë territoriale ku popullsia shqiptare ishte në shumicë. Shqiptarët krijuan institucionin politik kombëtar në Perandorinë Osmane, Lidhjen e Prizrenit, përmes së cilës arritën t’i integrojnë dhe sensibilizojnë shtresat më të fuqishme intelektuale, fetare dhe kulturore të vendit. Lëvizja njëherit arriti shkallën më të lartë të organizimit politik dhe ushtarak dhe si e tillë definoi qartazi se çfarë duan shqiptarët. Lidhja e Prizrenit, apo siç njihet ndryshe edhe si epoka e Rilindjes Kombëtare shtronte njëherit edhe idenë e shtetit të pavarur shqiptar me tërësisë dhe kompaktësisë territoriale të saj. Rilindësit kishin formuar një ide të qartë mbi përmasat dhe shtrirjen e territorit shqiptarë, ai ishte ngritur mbi faktorin etnik, historik dhe atë gjeografik. Në këtë kontekst, mund të përmendim Sami Frashëri, në librin tij “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë” (1899) thotë se Shqipëria përbëhej nga katër vilajete shqiptare dhe shtrihej në 80 mijë “kilometra të katërçipta”.⁸ Pra, projekti i rilindjes kombëtare në thelb kishte krijimin e një shteti të pavarur shqiptar kufijtë e të cilit përkonin me shtrirjen etnike të kombit shqiptar në territoret që ndodheshin nën administrimin e Perandorisë Osmane, çka nënkupton se Rilindësit ishin krijuesit dhe përkufizuesit e nacionalizmit shqiptar. Fillimisht duke përfytyruar kombin shqiptar nga kombet tjera dhe më pas duke i dhënë atij attribute politike nga ku dhe rrjedh ideja e krijimit të shtetit kombëtar shqiptar.⁹

Mirëpo, prej këtyre katër vilajeteve shqiptare, vetëm njëri (i Shkodrës) u përfshi përbrenda kufijve të Shqipërisë së pas vitit 1912, ndërsa tri të tjerat (i Janinës, Shkupit dhe Manastirit) u përfshinë nën Greqi dhe Serbi. Formimi i shtetit shqiptar, gjegjësisht njohja e tij nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër (1913)¹⁰ si shtet i ndarë nga pjesa tjetër e kombit

⁸ Shih: Frashëri, Sami, Vepra 2, Shqipëria ç’ka qenë ç’është e ç’do të bëhet?, Rilindja, Prishtinë, 1987.

⁹ Rilindja Kombëtare dhe vizioni i sajë politik do të trajtohet në një kapitull të veçantë në këtë punim.

¹⁰ Konferenca e Ambasadorëve në Londër 1912-1913, u ftua sipas marrëveshjes ndërmjet gjashtë Fuqive të Mëdha të kohës. Ajo zhvilloi punimet me përbërjen e pesë ambasadorëve të Fuqive të Kontinentit, si Austro-Hungarisë, Gjermanisë, Italisë, Francës dhe Rusisë të kryesuar nga ministri i Jashtëm i Britanisë së Madhe, Eduard Grey. Kështu pas tetë muaj diskutimesh, për Serbinë, Malin e Zi dhe Greqinë rezultoi me zgjerimin e territoreve të tyre në dëm të territoreve shqiptare. Kosova dhe një pjesë e mirë e Shqipërisë

shqiptar shënon njëherit edhe zanafillën e lindjes së asaj që quhet “çështje shqiptare”.¹¹ Me sanksionimin e këtij akti që u bë në Konferencën e Londrës, gjegjësisht me okupimin e tokave shqiptare lindi edhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare dhe çështja e bashkimit kombëtar shqiptar. Kështu, mund të themi se Projekti i Rilindjes Kombëtare nuk pati sukses të plotë, sepse krahas njohjes së shqiptarëve si komb dhe shtet, gjysma e shqiptarëve dhe e territoreve të tyre mbetën jashtë Shqipërisë. Në këtë mënyrë, mbeti përgjysmë edhe projekti i Rilindjes Kombëtare për homgjenizmin e kombit shqiptarë në një shtet.

Ndarja e kombit shqiptarë, njëherit prodhoi edhe “ndarjen e madhe” (H. Feraj, 2010) të pas pavarësisë, atë të çështjes shqiptare brenda shtetit shqiptarë dhe atë të çështjes shqiptare të jashtë shtetit shqiptarë. Për një pjesë të kombit krijohet iluzioni se çështja shqiptare mori një përfundim të lumtur, për atë pjesë që u përfshi në kufijtë administrativë të Shqipërisë Londineze, kështu ideja e shqiptarizms¹² pak nga pak filloi të zëvendësohet me vetëdijen shtetërore. Gjegjësisht, pas pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe detyrimet që ajo kishte për ratifikimin e marrëveshjeve me vendet fqinje, posaçërisht me Beogradin, Shqipëria kishte pranuar ekzistencën e Mbretërisë Serbe, Kroate dhe Sllovene dhe në këtë mënyrë çështja e “lëvizjes irredentiste” po kthehej në një problem serioz për shtetin shqiptarë. Pranueshmëria e kufijve të Mbretërisë së SKS e detyronte Shqipërinë të shtronte vetëm çështjen e lirive dhe të drejtave të pakicave shqiptare jashtë kufijve, gjegjësisht të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Kjo përjashtonte çështjen e bashkimit kombëtarë, gjegjësisht përpjekjen e shtetit Shqiptar për bashkimin e shqiptarëve të Kosovës dhe viseve tjera, apo të paktën shteti Shqiptarë zyrtarisht nuk mund të mbështeste këtë kauzë të nacionalistëve shqiptarë.

Për më tepër kjo ndarje bëhet edhe më e theksuar dhe me efekte më të mëdha në heterogjenizimin e mendimit politik shqiptarë gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri. Shqiptarët jashtë kufijve gjeografik të Shqipërisë “përjashtohen” nga jeta kombëtar,

lindore (sot pjesë e Maqedonisë së Veriut) iu dhanë Serbisë, Çamëria iu dha Greqisë, ndërkaq pjesë të tëra të Veriut iu dha Malit të Zi.

¹¹ Sot, me shprehjen çështje shqiptare sipas Rexhep Qoses nënkuptohet një problem që objektivisht, paraqet shqiptarët si popull i ndarë në pesë shtete: Shqipëri, në Serbi, në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe në Greqi; Shih më tepër: Rexhep Qosja, Strategjia e Bashkimit Shqiptarë, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1992, 86.

¹² Shqiptarizma, shqiptaria te rilindasit kishte kuptimin e të qenit shqiptar sipas modelit idealist-romantik, krenarë që i përket një kombi me cilësi të veçanta, njëherit është formulë veprimi për një bashkësi etnike.

koncepti hapësirë etnike mbetet i papërdorshëm. Komunizmi projekton shtetin të barabartë me kombin dhe me ideologjinë, dhe në përpjekje për të ndërtuar “kombin socialist” thëllon më tepër ndarjen shtetërore të kombit. Shqipëria në këtë periudhë kultivon idenë e vetëmjaftueshmërisë si komb, për më tepër, shqiptarët jashtë Shqipërisë i identifikon me diasporë. Mund të themi se projekti i rilindjes për një shtet të kombit shqiptarë, nuk u ndoq nga Shqipëria, por ajo shërbeu si frymë vetëm për ndërtimin e shtetit, madje për komunistët shqiptarë ajo konsiderua si ide e tejkaluar.¹³

Për shqiptarët e jashtë kufijve të Shqipërisë, posaçërisht për ata të ish-Jugosllavisë, projekti i rilindjes është projekt i papërfunduar, sepse çështja kombëtare është akoma e hapur dhe kërkon zgjidhje të drejtë. Madje ky projekt për intelektualët dhe politikanët në ish-Jugosllavi ka qenë burim i fuqishëm frymëzimi në përpjekjen për çlirimin dhe bashkimin e trojeve të tyre me shtetin amë. Kështu, për të ardhur deri tek subjekti më me interes në këtë punim, përmes së cilit synohet të hulumtohet i ligjërimi nacionalist shqiptar i pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë (1912), gjegjësisht shfaqja dhe formulimi i tij gjatë periudhës së Jugosllavisë së dytë dhe më pas, gjithmonë duke e marrë për referencë projektin politik të rilindësve shqiptarë.

2. Ravijëzim i propozimit të hulumtimit

a. Pyetja kërkimore

Pyetja kryesore: Çka e karakterizon ligjërimin nacionalist në Kosovë, pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, gjegjësisht atë të periudhës së Jugosllavisë së dytë dhe më pas?

Pyetjet ndihmëse:

1. Si interpretohet shfaqja e orientimit ligjërimor nacionalist në Kosovën pas pavarësisë së Shqipërisë, gjegjësisht a mund të themi se ky ligjërim është vazhdimësi e projektit politik të Rilindësve Shqiptarë?
2. A mund të themi se orientimi ligjërimor nacionalist në Kosovë shfaqet ndryshe dhe i ndrydhur nga mendimi nacionalist i rilindësve?

¹³ Shih më tepër: Enis Sulstarova, Publikja shqiptare 2, Instituti politik i studimeve humane, Zenit, Tiranë, 2017, 93-101.

3. A mund të themi se orientimi ligjërimitor nacionalist në Kosovë është refleksion i orientimeve të tjera ligjërimore e posaçërisht të atij socialist, real-politik, apo edhe të atij kozmopolit?
4. A mund të themi se orientimi ligjërimitorë nacionalist në Kosovë shfaqet në një formë krejt tjetër ligjërimore, gjegjësisht i orientuar në shtetin që ndërton kombin, “kombin kosovarë”?

Problemin që synoj të paraqes përmes këtij hulumtimi ka të bëjë me atë nëse ligjërimiti nacionalist në Kosovë është vazhdimësi e diskursit politik të Rilindësve Shqiptarë, apo është refleksion i orientimeve të tjera ligjërimore, të imponuara nga rrethanat politike dhe sociale të kohës. Pra, a ka arritur që ky ligjërimit të ruajë vazhdimësinë e diskursit politik të Rilindësve Shqiptarë, përkundër ndërhyrjeve sporadike për ta devijuar këtë linieratet politik siç mund të jetë integrimi sistemik i shqiptarëve në administratën shtetërore apo ideja për të projektuar shqiptarin kosovar si produkt titist (Kullashi, 2003) dhe deri tek më vonë ndërhyrja e diplomacisë ndërkombëtare pas Konferencës së Rambujesë, për ta shndërruar Kosovën një projekt europian dhe si të tillë, të ndarë nga historia dhe të shkëputur nga memoria kolektive shqiptare.

Ky punim do të mbështetet edhe në studimin shkencor të nacionalizmit, duke e shtjelluar si një dukuri komplekse tek shqiptarët në përgjithësi, por në veçanti tek shqiptarët e Kosovës. Koncepti komb zë një vend qendror në kuptimin e nacionalizmit, apo për të qartësuar edhe më tej ndërvarësinë e dy koncepteve mund të përmendim njërin ndër studiuesit më me autoritet të kësaj fushe Ernest Gellnerin i cili thotë se “nacionalizmi i krijon kombet dhe nuk është e kundërta”, dhe që nacionalizmin e përkufizon “si një parim sipas të cilit njësi politike dhe njësi kombëtare duhen të përputhen”. Koncepti i nacionalizmit nuk varet drejtpërdrejt nga përcaktimet teorike të konceptit komb, sepse kombi nënkupton një bashkësi shoqërore kurse koncepti nacionalizëm shënon një parim ose ideologji politike. Pra mund të them që në këtë punim do të trajtohet nacionalizmi dhe teoritë e nacionalizmit si parim politik dhe manifestimi i këtij koncepti në ligjërimitin politik tek shqiptarët e Kosovës ndër vite. Normalisht këtu do t’iu referohem veprave të studiuesve më të rëndësishëm të kësaj fushe, si E. Gellnerit, E. J. Hobsbawm, B. Anderson, A. D. Smith e të tjerë.¹⁴

¹⁴ Koncepti i nacionalizmit, gjegjësisht parimi nacionalist do të trajtohet në kuadër të kapitullit sfondit teorik.

Hulumtimi shkencor në këtë studim bëhet përmes analizës së ligjërimit, gjegjësisht duke përdorur analizën kritike të ligjërimit si një qasje shumë disiplinare. Kur flasim për ligjërimin kemi parasysh një grumbull njohurish, fjalësh, idesh, praktikash për një temë të veçantë, të strukturuar dhe të lidhur me elemente dhe aspekte të rëndësishme të jetës shoqërore. Bazuar në formën e strukturimit të ligjërimit në njëfarë mënyre ai përmban një vijimësi dhe koherencë logjike të idesë përkatëse të shtresëzuar në kohë dhe hapësirë të caktuar. Kështu, ligjërimet në përgjithësi kanë për qëllim krijimin, mbështetjen dhe ndryshimin e hapësirës ekzistuese. Në aspektin politik, flitet për ligjërim demokratik, komunist, socialist, nacionalist, kozmopolit e të tjera. Në këtë hulumtim kemi për qëllim identifikimin e aspekteve kryesore të ligjërimit nacionalist, gjegjësisht ligjërimin nacionalist shqiptar dhe koherencën e këtij ligjërimi ndër vite tek lëvizjet dhe intelektualët shqiptarë në Kosovë. Gjithashtu, bazuar në kontekstin historiko-politik, parimi nacionalist pashmangshmërisht përmban ligjërimin nacionalist.

Konteksti

Konteksti prej të cilit rrjedh nevoja për trajtimin e këtij projekti akademik është empirike dhe teorike. Është empirike bazuar në vëzhgimet disa vjeçare të politikbërjes në Kosovë. Në Kosovë, si edhe në çdo vend të Ballkanit, fryma multi-kulturore është realitet. Në anën tjetër, prej vitit 1912 kur tërhiqet Perandoria Osmane dhe shpallet pavarësia e Shqipërisë, Kosova pushtohet nga mbretëria e SKS-së dhe përpos që bëhet një vatër e tmerrit dhe e shtypjes nga reformat agrare, ajo poashtu bëhet vatër e lëvizjeve nacionaliste. Diskursi nacionalist është prezent në Kosovë me një ton më të sforcuar përkundër Shqipërisë, në gjuhën e burokratëve të së cilës mbizotëron diskursi kozmopolit.¹⁵ Në aspektin teorik, përmes një vështrimi teorik të analizës së diskurseve shihet se elita intelektuale shqiptare e pas Luftës së Dytë Botërore, e organizuar rreth Organizatës Nacional Demokratike Shqiptare (NDSH), Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSH), Lëvizjes Nacional Çlirimtare të Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSH), ajo e akademikëve të Universitetit të Prishtinës, së bashku me Lidhjen e Shkrimtarëve të Kosovës dhe më Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), nën eufemizmin e mbrojtjes së të drejtës së vetëvendosjes së popujve, arrin ta mbajë gjallë dhe ta bëjë pjesë të nënvetëdijes shqiptare

¹⁵ Shih: Enis Sulstarova, Ligjërimi Nacionalist në Shqipëri, Afërdita, Tiranë, 2000.

idenë dhe konceptin e shqiptarizmit. Motivi i këtyre protagonistëve mbështetet në motivin historik, ideologjik dhe gjeopolitik të kohës.

Vlerësim i literaturës

Në kontekstin e përdorimit të burimeve shkencore, mund të them se ekzistojnë pak studime që trajtojnë drejtëpërdrejt çështjen e ligjërimit nacionalist dhe në veçanti të periudhës së Jugosllavisë së Dytë tek shqiptarët e Kosovës. Në këtë hulumtim do të merren parasysh të gjithë ata autorë, libra, artikuj, shkrime, që e trajtojnë këtë tematikë studimore. Në këtë drejtim, do të analizohen veprat e studiuesve seriozë të kohës, si libri “Skicë e mendimit politik shqiptar” nga Hysamedin Feraj dhe punime të tjera të kësaj natyre nga autori; “Filozofinë politike shqiptare” e Ukshin Hotit si njëri ndër autorët me ndikim në artikullimin e vullnetit politik të shqiptarëve të Kosovës; “Pavarësia gjasa dhe shpresë” dhe “Demokracia, Kombi dhe Vetëvendosja” nga Fehmi Agani dhe punime të tjera nga autori; “Përplasja e identiteteve” nga Muhamedin Kullashi; “Vetëm nacionalizmi e shpëton kombin shqiptar”, “Udhëkryqe politike shqiptare”, e të tjera shkrime dhe punime nga Abdi Baleta; “Në fillimet e nacionalizmit shqiptar” e Nathalie Clayer; “Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike” e Oliver J. Schmitt; vepra “Kosova një histori e shkurtër” e Noel Malcolm; “Populli i Ndaluar”, “Strategjia e Bashkimit Shqiptar”, publikime dhe ligjërime të ndryshme të njërit nga protagonistëve kryesorë në mendimin politik në Kosovë, shkrimtarit Rexhep Qosja; “Nacionalizmi shqiptar” nga Milazim Krasniqi, “Kosova – djep i shqiptarizmit” nga Hamit Kokalari, “Kosova dhe shqiptarët dje, sot dhe nesër” nga Skender Rizaj, “Ligjërimi nacionalist në Shqipëri” i Enis Sulstarova, “Antologji e mendimit shqiptar : 1870-1945” i Ndriçim Kullës, “Zgjidhimi kombëtar shqiptar: 1878-1912” i Stavro Skendit, “Misioni i shekullit XX” nga Tajar Zavalani etj. Do të analizojmë dhe intelektualët, opinionistët e ndryshëm të cilët kanë provokuar opinionin me idetë e tyre, literaturën që përfshin të dhëna rreth “përplasjes së identiteteve” në dy ish-Jugosllavitë, trajtime, komente dhe analiza rreth luftës së fundit (1997-1999) dhe shpalljes së Pavarësisë së Kosovës (2008). Pjesë e shqyrtimit analitik dotë jenë edhe artikujt, shkrimet mbi krijimin e lëvizjeve politike shqiptare në mbarë hapësirat shqiptare që udhëhiqen me programe dhe agjendë politike nacionaliste.

3. Metodologjia

Metoda kyç përmes së cilës do të realizohet ky punim është ajo *cilësore*. Ligjërimi nacionalist shqiptar në Kosovë dhe vazhdimësia e tij në periudhat e lartpërmendura kërkon përdorimin e metodave të kësaj natyre. Vetë shtrirja e konceptit nëpër kohë në një periudhë të gjatë e bën të domosdoshme shfrytëzimin e kësaj metode, që ngërthen në vete rrethana të ndryshme historike, sociale, e politike. Studimi përfshin jo vetëm një hapsirë të caktuar gjeografike, politike e shoqërore, por edhe një periudhë kohore që shtrihet nga viti 1912 e deri në ditët tona. Fokusi kërkimor përfshin praktika ligjërimore të truallzuara kryesisht në Kosovë.

Hulumtimi në fjalë nxjerr në pah edhe opinionet përfaqësuesve eminentë të nacionalizmit kosovar, diskursin politik të eksponentëve të ndryshëm, programet e lëvizjeve të partive kryesore politike shqiptare, programet e qeverive, sidomos të atyre të pas vitit 1999, fjalimet dhe qëndrimet e kryetarëve të partive/qeverive përkatëse, ligjërimin publik të intelektualëve, të figurave të tjera publike në trajtë librash, esesh, artikuj gazetash, opinionesh, e të tjera.

Në vatër do të jenë edhe konceptet ideore, prespektivat ideologjike, qëndrimet filozofike, si ato të komunizmit, titizmit, enverizmit, nacionalizmit, antinacionalizmit, kozmopolitizmit dhe paneuropianizmit. Nga pikëpamja metodologjike ky punim mbështetet në një hermeneutikë të posaçme kritike të teksteve që e karakterizojnë temën në fjalë. Tekstet nuk do të interpretohen vetëm nga përmbajtja e tyre e brendshme, por do të shihen si të rrënjësura dhe të lidhura me strategjinë ligjërimore politike që synojmë ose kanë për efekt riprodhimin e një formacioni të caktuar shoqëror. Do të shpjegohet lidhja midis teksteve, gjuhës së tyre, përmbajtja e metaforave, intervistat, dokumentet, si dhe imazhe dhe video të shumta.

Metoda krahasimtare do të zë një vend të rëndësishëm në punim: do të krahasohen traditat dhe rrymat politike shqiptare me njëra-tjetrën, gjithashtu edhe traditat dhe rrymat politike shqiptare me ato joshqiptare.

Sa i përket të dhënave lidhur me periudhat më të hershme historike, punimi mbështetet kryesisht në të dhënat dytësore, që nënkupton në të dhënat historiografike dhe jo në burime të para si dokumente origjinale, arkivore e të tjera të ngjashme.

Limitet e hulmtimit dhe sfidat

Të pakta janë punimet që deri më tani janë marrë me mendimin politik kosovar. Risia e këtij punimi është kontributi që do të japë në strukturimin dhe tipizimin e mendimit politik kosovar të pavarur nga ai i Shqipërisë, nga mendim politik ku përfshihen edhe shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, të Malit të Zi dhe Luginës së Preshevës, të paktën deri në vitet e 90-ta. Një nga sfidat e këtij hulmtimi është shumësia e konteksteve të problemeve. Punimi nuk do të jetë krejtësisht kronologjik edhe pse do të ketë në fokus rrjedhën e kohës dhe ndryshimet në perceptimin e problemit të Kosovës gjatë këtyre viteve brenda mjediseve të ndryshme politike dhe kulturore. Shqyrtimi i dallimeve të perceptimeve do të thotë të kontestohet vazhdimisht këndvështrimi nga i cili shihet problemi i Kosovës. Normalisht, kjo nuk nënkupton që problematika në fjalë të trajtohet në bazë të “pëlqyeshmërisë” sonë, por qasja do të ketë në konsideratë pikëpamjet e ndryshme, që nënkupton se synon objektivitetin tipik shkencor. Ndërtimi i një tabani ideor, apo përcjellja dhe vëzhgimi i një ecurie të tillë ligjërimore, ka për qëllim të nxjerrë në pah vijimësinë dhe variacionet e ligjërimin nationalist në Kosovë nga politikanë dhe intelektualë që nga Rilindësit e deri në ditët tona.

Kontributi potencial

Qëllimi i këtij studimi është shumëdimensional. Ky studim mëton të kontribuoj sadopak në diskutimin lidhur nacionalizmin shqiptar, gjegjësisht trajton mundësinë se a mund nacionalizmi të bëhet gjenerator i zhvillimit të kombit dhe dy shteteve shqiptare. Përfundimet e këtij studimi do më shtyjë drejt alternativave të reja paradigmatiche dhe mundësive të ri-mendimit të konceptcionit politik shqiptar në Kosovë. Do të jetë një parakusht i vlefshëm teorik për shtrimin e ndonjë hipoteze se si duhet të formësohet shoqëria Kosovare dhe si duhet të realizohet organizimi politik dhe qytetar i saj. Në këtë kontekst, një punim i analizuar nga shumë faktorë: ekonomik, historik, social, politik dhe nga prizmi i ndryshimeve globale, ka për qëllim të realizojë një interpretim politik të ngjarjeve historike apo një strukturim sistematik të mendimit politik shqiptarë, në mënyrë që të arrijë të parasheh një model politik që është në koherencë linearike me subjektin politik të shqiptarit të Kosovës.

II. Sfondi teorik

1. Teoritë dhe konceptet

Studimi shkencor i nacionalizmit tashmë konsiderohet domosdoshmëri e kohës, ngaqë përbën një ndër forcat më të rëndësishme që ka ndikuar gjatë historisë së botës moderne. Mund të themi se që nga Revolucioni Francez dhe Amerikan nacionalizmi si ideologji dhe lëvizje ka qenë forcë e rëndësishme në mbarë politikën botërore. Që nga fundi i shekullit XVIII, me lindjen e shtetit si organizim politik modern, duke vazhduar me Luftën e Parë Botërore, katërmëdhjetë (14) pikat e Udrou Uillsonit, Luftën e Dytë Botërore, shpërbërjen e ish-Bashkimit Sovjetik dhe ish-Jugosllavisë e të tjera ngjarje globale, nacionalizmi konsiderohet dukuria më mbizotëruese në këto zhvillime. Rigjallërimi i nacionalizmit dhe orientimi i shteteve në politika me theks më nacional konsiderohet si një proces i gjatë historiko-politik, dhe i pashmangshëm ngase afirmimi i identiteteve kombëtare kundrejt identiteteve të tjera është i lidhur me konstelacione të caktuara shoqërore. Shumë teoricienë prestigjiozë si Gellneri, Smithi, konsiderojnë se nacionalizmi tashmë është i pazhdukshëm, sepse një kthim në besnikëritë dhe identitetet paramoderne është i paimagjinueshëm dhe i pamundshëm njëkohësisht.¹⁶

Studimi i nacionalizmit është i lidhur ngushtë me lindjen dhe zhvillimin e kombeve. Për të qartësuar edhe më tej ndërvarësinë e dy koncepteve mund të përmendim E. Gellnerin i cili thotë se “nacionalizmi është ai i cili i krijon kombet dhe jo anasjelltas”, pra parimi nationalist përdor, shfrytëzon, vë në lëvizje një shumësi traditash, zakonesh, me ngjarje të lavdishme historike të trashëguara nga e kaluara, për të ndërtuar entitete shoqërore të përbashkëta. Koncepti i nacionalizmit shënon një parim politik dhe nuk varet drejtpërdrejt nga përcaktimet teorike të konceptit komb, sepse kombi nënkupton një bashkësi shoqërore. Në këtë aspekt është e rëndësishme që bashkësia ta konsiderojë veten si komb dhe mbi këtë bazë të kërkojë që njësi e saj kombëtare të përputhet me njësinë politike.

Për Gellnerin Nacionalizmi para se gjithash është parim politik dhe më së miri mund të përkufizohet nga aspekti i këtij parimi. Ai flet për disa mënyra të shkeljes së këtij parimi, kështu sipas tij, “Kufiri politik i një shteti mund të mos përfshijë të gjithë anëtarët e kombit

¹⁶ Shih: Anthony. D. Smith, *Kombet dhe nacionalizmi në erën globale*, Botimet Dudaj, Tiranë, 2008, f. 65, 69, 169; Ernes Gellner, *Nacionalizmi*, Shtëpia e Librit, Tiranë p.v.b.

të duhur; apo ky kufi mund t'i përfshijë të gjithë ata, por përfshin, po ashtu, edhe disa të huaj; apo mund të dështoj në të dy mënyrat përnjëherësh, duke mos i përfshirë të gjithë bashkëkombësit dhe duke përfshirë, po ashtu edhe disa jobashkëkombas. Apo, më tutje, një komb mund të jetojë papërzier me të huaj në më shumë shtete, kështu asnjëri shtet nuk mund të pretendoj se është ai kombëtar.¹⁷ Nacionalizmi “nuk lejon” që kufijtë etnikë të thyhen nga ata politikë, apo mund të themi se mbi bazën e ndjenjës së thyer nacionaliste legjitimohen edhe lëvizjet kombëtare që vihen në veprim për të përmbushur këtë parim. Nga Gellneri parimi nationalist mbrohet në një frymë etike “universaliste”, pa paragjykime dhe në favor të cilësdo kombësi, që ky parim të predikohet me zemërgjerësi për të gjithë njësoj, kështu le t'i kenë të gjitha kombet kulmet e veta politike, po ashtu, le të përmbahen që të gjithat nga futja e jobashkëkombasve nën to. Kësisoj, ai promovon një nacionalizëm jo-egoist dhe formalisht “të mundshëm” për të gjithë.¹⁸

Ky parim kur u prezantua për herë të parë nga Gellneri me 1983, është marrë në përdorim edhe nga shumë studiues të tjerë¹⁹ të këtyre fushave. Hobsbaumiti termin “nacionalizëm” e përdorur në kuptimin e përcaktuar nga Gellneri, se “nacionalizmi në thelb është një parim sipas të cilit njësia politike dhe njësia kombëtare duhet përputhen”. Ai shkruan se “Ky parim nënkupton gjithashtu se detyra politike e puritanëve ndaj shtetit qëndron përmbi të gjitha obligimet e tjera publike dhe, në raste të jashtëzakonshme (sikurse në raste lufte), përmbi të gjitha obligimet e tjera të çfarëdo lloji. Kjo e dallon nacionalizmin modern nga të gjitha format e tjera, më pak imponuese, të identifikimit ndaj kombit apo ndaj grupit, me të cilat ndeshemi gjetiu.²⁰ Hobsbaumi shkruan se ai nuk është vetëm një parim politik, por parim kryesorë, përcaktues dhe mbi të gjitha detyrimet e tjera publike.

Nacionalizmi si parim i ndjenjës së identifikimit të përbashkët përqendrohet në shenjtërimin e elementeve unifikuese të bashkësisë brenda një atdheu me kufij të qartë. Zakonisht operon në emër të kulturës popullore, origjinës së përbashkët, kujtesës kolektive dhe mbi të gjitha përkushtimin për ndërtimin e kombit si entitet politik. Sipas Michael Ignatief se

¹⁷ Ernest Gellner, *Kombet dhe Nacionalizmi*, 27.

¹⁸ Po aty, 27-28.

¹⁹ Sipas Anthony Quinton që më 1967 ka pasur për kombe që nuk kanë qenë shoqëri politikisht të organizuara. Nacionalizmi është një përpjekje që të bëjë që shteti dhe kombi të përputhet nisur në rrethanat kur nuk përputhen” A. Quinton (e.d), “Political Philosophy”, Oxford University Press, 1967, f.6, cituar nga H. Feraj, Skicë e mendimit politik shqiptar, 29. Shih edhe John Breuilly, *Nationalism and the State*, p. 3, cituar nga E. J. Hobsbawm, 21.

²⁰ E. J. Hobsbawm, *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780*, Botimet Toena, Tiranë 2012, 21.

nacionalizmi si një doktrinë politike, është besimi se popujt e botës ndahen në kombe dhe secili prej këtyre kombeve ka të drejtën e vetëvendosjes, qoftë si njësi vetëqeverisëse brenda kombeve-shtete ekzistuese, qoftë si komb-shtet më vete.²¹ Pra, bashkësia shoqërore me elementet dhe karakteristikat e ngjashme duhet të ketë vullnet ta shohë veten si komb dhe kështu të kërkojë që njësia kombëtare të përputhet me njësinë politike.²²

Në këtë hulumtim, koncepti nacionalizmit do të përdoret sipas përkufizimit të Gellnerit, të mbështetur nga Hobsbaumi, Ignatief e të tjerë si një parim esencial dhe epërsor mbi të gjitha parimet e tjera politike. Trajtimi i nacionalizmit si parim politik përshtatet edhe me karakteristikat e nacionalizmit shqiptar trajtuar nga mendimtarë si Abdi Baleta, Milazim Krasniqi dhe Hysamedin Feraj. Abdi Baleta thotë se kombi shqiptar ka një program të mirëfilltë e të qartë të çështjes kombëtare shqiptare, “ka 134 vjet që ky program u është dhënë shqiptarëve dhe diplomacisë ndërkombëtare në formulimin e thjeshtë “një komb-një vilajet”. Edhe sot shqiptarët duhet të përpiqen shumë për të mbrojtur e realizuar idenë “një komb, një atdhe, një shtet”. Parimin nationalist tek Baleta shprehet si detyrë historike për të gjithë shqiptarët dhe nuk reduktohet në diçka vullnetare apo në dëshirë të një grupi njerëzish, partie politike apo një brezi shoqëror.²³ Milazim Krasniqin definicionin e Gellnerit se “Nacionalizmi në thelb është një parim, sipas të cilit njësia politike dhe njësia kombëtare duhet përputhen”, e konsideron më gjithëpërfshirës dhe se ai përkon edhe me parimin e hershëm të nacionalizmit shqiptar. Sipas Krasniqit “pa këtë objektiv themelor, nacionalizmi nuk mund të jetë i mirëfilltë dhe i vërtetë. Mund të jetë i perceptuar si nacionalizëm, por në esencë nuk është plotësisht i atillë. Mund të ketë qenë nacionalizëm në një periudhë historike, por më vonë është ndryshuar, është zëvendësuar ose shndërruar në kauzi-nacionalizëm të i perceptuar si nacionalizëm”. Ai mendon se “nëse i përmbahemi këtij definimi, më tutje mund ta kuptojmë më mirë dhe se çka është nacionalizmi shqiptar dhe cilat derivate jonacionaliste perceptohen si nacionalizëm, pa qenë të tilla”. Krasniqi e konsideron kombin shqiptar dhe nacionalizmin e tij produkt të ndikimit të lëvizjeve dhe ideologjive evropiane dhe kurrsesi ndryshe.²⁴ Në këtë kontekst edhe Hysamedin Feraj e trajton nacionalizmin shqiptar si një parim politik, ku njësia politike dhe kombëtare duhet të

²¹ Michael Ignatief, Gjaku dhe përkatësia, udhëtime në Nacionalizmin e Ri, Dituria, Tiranë, 1993, 5.

²² Për më shumë rreth termit nacionalizëm shih: Ali Pajaziti, Fjalor i Sociologjisë, Logos-A, Shkup, 2009, f. 450; Iain McLean, Fjalor Politik Oxford, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, Tiranë, 2001, f.375.

²³ Abdi Baleta, Udhëkryqë politike shqiptare, SHQK Vizioni M, Shkup, 2018, 9.

²⁴ Milazim Krasniqi, Nacionalizmi shqiptar, Logos-A, 2017, Shkup, 21-28.

përputhen. Sipas tij “ky përcaktim i nacionalizmit përputhet me thelbin, me tiparin dhe parimin thelbësor të rrymës politike shqiptare që është quajtur nacionalizëm shqiptar.”²⁵ Nacionalizmi shqiptar që nga Lidhja e Prizrenit vazhdon ta orientojë mendimin politik shqiptar edhe sot, të nxisë vetëdijen politike kombëtare dhe t’i motivojë përpjekjet për zgjidhjen e plotë të çështjes kombëtare.

Në këtë hulumtim do të shqyrtohet manifestimi i këtij koncepti në ligjërimin politik tek shqiptarët e Kosovës ndër vite, si dhe oscilimet e ndryshme ideore e politike të konceptin në fjalë tek lëvizjet politike në Kosovë. Konkretisht, *prania apo mosprania* e nacionalizmit tek lëvizjet politike shqiptare në Kosovë është objekti kryesor hulumtues i këtij punimi. Pa pretenduar një shpjegim shterues dhe vlerësim përfundimtar të çështjeve në fjalë, por vetëm një shpjegim hulumtues të një rasti të përveçëm siç është ligjërimi nationalist ndër shqiptarët e Kosovës. Do të merremi edhe me konceptin e kombit që konsiderohet si kusht për kuptimin e parimit nationalist, me konceptin e kozmopolitizmit dhe multikulturalizmit si antipode kryesore të parimit nationalist.

2. Nocioni i kombit

Shtjellimi dhe përkufizimi i nocionit “komb” është një ndër çështjet më komplekse të këtyre fushave, sepse asnjë teori deri më tani nuk ka arritur të shpjegojë saktësisht lindjen dhe dinamikën e kombit në histori. Por përgjithësisht ekziston një qëndrim i ngjashëm pothuajse i të gjithë studiuesve se kombi është dukuri e shfaqur në modernitet (Gellner, Hobsbawm, Anderson). Kur flasim për modernitetin zakonisht si ngjarje që shënon fillimin e saj merret Revolucioni Francez dhe Revolucioni Industrial, ngjarje këto që kaluan njeriun në një fazë tjetër të dinamikës shoqërore. “Kombi” dhe “nacionalizmi” janë të lidhur dhe produkt të kësaj periudhe shoqërore. Faktorë të rëndësishëm që ndikuan në krijimin e kombeve konsiderohet zhvillimi i hovshëm ekonomik dhe industrial, që mundësoi përmirësimin e gjendjes ekonomike të popullsisë së pazhvilluar dhe të marginalizuar,²⁶ arsimimi masiv i shoqërisë që karakterizohet me zbulimin e shtypshkronjës dhe botimeve të shumta që ndikuan në standardizimin e gjuhës letrare dhe mundësoi zbutjen e dallimit mes

²⁵ Hysamedin Feraj, 2010, 30.

²⁶ Shih më tepër: E. Gellner, *Kombet dhe Nacionalizmi*, 53-60. E.J. Hobsbawm, *Kombet dhe Nacionalizmi që nga 1870*, f. 46, 48, 52.

elitës dhe shoqërisë në përgjithësi,²⁷ Iluminizmi si lëvizje filozofike dhe letrare që synonte arsimimin e masave e të gjera shoqërore, arritjet e shumta teknologjike që krijuan mundësin e zhvillimit të hovshëm industrial e të tjera.²⁸ Këta mund të jenë disa nga faktorët apo rrethanat e krijuara që çuan deri në përmbledhjen e karakteristikave apo elementeve që u sinkronizuan me fjalën komb.

2.1 Përkufizimi dhe karakteristikat e një kombi

Ashtu siç e bëmë të qartë që nga fillimi i këtij punimi, nocioni i kombit do të shqyrtohet në këndvështrimin e një bashkësie shoqërore dhe varësisë së tij nga koncepti i nacionalizmit. Literatura shkencore na mëson se kombet janë shndërrime të etnive në kohët moderne (Smith); kombi është një komunitet politik i imagjinuar – dhe i imagjinuar si i pandashëm dhe sovran njëkohësisht (Anderson); kombi është një plebishit i përditshëm (Renan).²⁹ Këto dhe shumë përkufizime të tjera spikasin një gjë të rëndësishme se kombi që nga “lindja”, që nga momenti i shndërrimit nga “etnia në komb” është projekt i papërfunduar. Pra mund të themi se kombi paraqet një bashkësi etnike të shtrirë në një hapësirë territoriale të caktuar, me gjuhë të unifikuar letrare, me tradita kulturore, kujtesë kolektive historike e të ngjashme.

Në vigjile të ndërtimit të kombeve pothuajse në të gjitha kombet ekzistuese të botës ekzistonin dialekte të shumta gjuhësore brenda një komunitetit të caktuar. Një gjë e tillë konstruktua me anë të shtypit, duke i imponuar komunitetit një gjuhë përbashkuese dhe të qëndrueshme, pra “gjuha letrare”, e standardizuar në “gjuhë nacionale” përkundrejt latinishtes që dominonte në Evropë si gjuhë e shkruar. Sipas Andersonit kontribut i rëndësishëm për konsolidimin e ndërgjegjes kombëtare ishte përhapja e ngadaltë e gjuhëve vendase si instrumente të qëndrimit administrativ prej monarkëve absolutistë.³⁰ Kështu, gjuha e klasës sunduese, e njerëzve të shkolluar dhe e elitës nëpërmjet arsimit publik dhe mekanizmave administrativë fillon të marrë karakterin e një gjuhe zyrtare dhe të bëhet gjuhë e shtetit modern. Kjo përuddhë që shtrihet nga shekulli XVIII deri në atë XX vlen pothuajse për të gjitha gjuhët evropiane. Gjuha si element përbashkues dhe dallues përbën një ndër tiparet themelore të një kombi; Hobsbaumi thotë se qeniet njerëzore që flasin të

²⁷ Benedict Anderson, Komunitetet imagjinare, dy lindje & dy perëndime, Tiranë, 2013, f. 32, 33.

²⁸ Po aty, f. 62.

²⁹ Cituar nga Eric J. Hobsbawm, Kombet dhe Nacionalizmi që nga 1780, f.18.

³⁰ Benedict Anderson, Komunitetet imagjinare, f. 63.

njëjtën gjuhë konsiderohen miq, ndërsa ata që flasin një gjuhë tjetër konsiderohen armiq. Pra, ai zhvillon një nocion të rëndësishëm në këtë aspekt, të gjuhës si element përbashkues dhe dallues, apo siç e quan ndryshe edhe si “nacionalizëm filologjik”, që nënkupton ngulmimin në pastërtinë gjuhësore të leksikut kombëtar.³¹ Këtu mund të përmendim gjuhën shqipe, si një ndër karakteristikat thelbësore për unifikimin e kombit shqiptar. Themeluesit e nacionalizmit shqiptar tek elementi gjuhësor qendëruan identitetin kombëtar, sepse elementët e tjera ishin më shumë faktorë ndarës se sa unifikues.

“Etnia” si pararendëse e kombit, është element i rëndësishëm i konstituimit të kombeve sepse është pjesë e historisë njerëzore. Disa prej enive kanë mbijetuar, disa të tjera janë shkrirë në një tjetër apo kanë formuar ndonjë tjetër. Etnia i referohet popullatës, pjesëtarët e së cilës identifikohen me një emër, kanë mite të prejardhjes së njëjtë, kulturë të përbashkët, lidhje me një atdhe dhe njëfarë solidariteti që shfaqet të paktën te elita.³² Smith argumenton se si intelektualët nacionalistë ndërtojnë apo ringjallin kombin duke u bazuar tek e shkuara etnike dhe duke bërë ndërlidhje me të tashmen, në mënyrë që të legjitimojnë projektin ekzistues. Territori apo shtrirja territoriale është komponentë e trupit kombëtar pa të cilën nuk mund të mendohet kombi. Të gjitha kombet ekzistuese shtrihen në hapësira të caktuara gjeografike dhe ato të cilat nuk e posedojnë këtë element janë kombe joekzistente apo kombe të pakonsoliduara. Kujtesa kolektive apo historia, përkujtimet e ngjarjeve të së kaluarës së lavdishme si betejat, luftërat përbëjnë një element me peshë për ndërtimin e kombeve.

Zhvillimi i këtyre komponentëve ndër popuj arriti t’i vetëdijësojë edhe më shumë masat popullore për përkatësitë e tyre etnike, gjuhësore, kulturore, historike dhe kështu dalëngadalë u formua ndërgjegjja kombëtare. Në këtë rrjedhë, lidhur me lindjen e kombit shfaqen dy koncepte të rëndësishme, koncepti i kombit etnik dhe ai i kombit politik.

2.2 Koncepti i kombi kulturor-etnik

Kombi kulturor përfshin grupe njerëzish që flasin të njëjtën gjuhë, kanë të njëjtin besim, të kaluar historike të përbashkët. Idejë për kombin kulturor ndryshe quhet edhe ide e kombit etnik, primordial, objektiv, historik e të tjera. Fryma e kombeve përcaktohet nga mjedisi

³¹ E. J. Hobsbawm, *Kombet dhe Nacionalizmi që nga 1780*, f. 98.

³² Shih: Anthony D. Smith, *The Ethnic Origins of Nations*, Blackwell Publishing, 1987, f. 12-18

natyror, mënyra e jetesës, zakonet, kohezioni social dhe kulturor dhe mbi të gjitha, nga ndjenja e përkatësisë së përbashkët. Fillet e zhvillimit të këtij koncepti i gjejmë në Gjermaninë e shekullit XVIII, gjegjësisht në shkrimet e Johann Gottfried Herder dhe të Fihthes si dhe në praktikën e ndërtimit të kombit gjerman. Herderi është i mendimit që kombet janë njësi organike apo njësi “të natyrshme”, gjurmët e të cilave mund t’i gjejmë qysh në kohët e lashta; të njëjtat vazhdojnë të jenë të gjalla për sa kohë të jetojë shoqëria njerëzore. Herderi thekson rëndësinë e gjuhës, kujtesën historike të një populli, në vend të kërkimit të hapur politik për pasjen e shtetësisë.³³ Qëndrime të tilla luajtën një rol të rëndësishëm në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare dhe çuan në zbulimin e miteve, legjendave, përrallave të lashta duke ndikuar në bashkimin e Gjermanisë në një shtet të vetëm të centralizuar. Gjermania nuk ishte e bashkuar në një shtet, ishte e ndarë në një numër të madh shtetesh të pavarura, dhe mund të themi se ndër faktorët e vetëm për ndërtimin e identitetit gjerman të përbashkët është kultura dhe jo faktori politik.

Sipas, variantit të skajshëm primordialist, gjegjësisht sipas Anthony D. Smith-it, secili prej nesh ka një identitet etnik, ashtu siç ka të folurën, shikimin dhe nuhatjen; njerëzit “për nga natyra” u përkasin bashkësive të fiksuara etnike, sikurse u përkasin familjeve të tyre. Në këtë variant secili komb, siç ka “kufijtë e natyrshëm”, ka edhe origjinën dhe vend specifik në natyrë, si dhe karakter, mision dhe fat të veçantë. Në këtë këndvështrim, nuk bëhet dallimi midis kombit dhe etnisë, pra të dyja shihen si pjesë e rendit të natyrës, ndërsa nacionalizmi si veti natyrore e njerëzimit. Varianti i dytë primordialist lidhet me ringjalljen e socio-biologjisë: etnitë dhe kombet janë “të natyrshme” sepse janë zgjatime farefisnore të përzgjedhura nga evolucioni gjenetik. Varianti i tretë i Smithit thotë se etniciteti është në përgjithësi një lidhje e dhënë sociale, e fuqishme dhe paraprake, ndonjëherë me të vërtetë mbizotëruese ose që qëndron e pashprehur. Janë anëtarët ose pjesëmarrësit që i veshin një cilësi “primordiale” etnisë së tyre; në sytë e tyre lidhja etnike ka përparësi logjike dhe kohore mbi lidhjet e tjera dhe ata janë të vetëdijshëm për fuqinë dhe “efektin” e saj detyrues.³⁴ Smith e përjashton mundësinë që njeriu të mos jetë anëtar i ndonjë bashkësie etnike, sepse ajo është esenciale për kuptimin dhe rolin e tij historik, dhe se lidhjet etnike janë mbi çdo lidhje tjetër. Kombet të tilla shihen si organike, si të natyrshme për faktin që ato janë

³³ Andrew Heywood, Politika, Brezi 81’, Prishtinë, 105.

³⁴ Anthony D. Smith, Kombet dhe nacionalizmi në erën globale, 42-43.

ndërtuar më tepër nga shkaqet natyrore apo historike sesa nga ato politike. Diçka që rrjedh prej poshtë dhe është e mbështetur në rituale, tradita, legjenda shoqërore më shumë sesa nga kulturat e larta apo elitat e ndryshme kulturore. Natyrisht, kjo pikëpamje nuk e përjashton idenë e shtetit, por është e prirur ta shohë atë si mjet të domosdoshëm, si diçka që rrjedh natyrshëm dhe që ka për qëllim institucionalizimin e idealeve të veta në rendin social. Shteti shihet si mbrojtës i një kulture të veçantë, madje pretendohet se vetëm përmes shtetit mund të mbrohen njësitë kulturore.

2.3 Koncepti i kombit politik-qytetar

Ideja e kombit politik mbështetet në qëndrimin se kombet esencialisht janë njësi politike, duke aluduar më fuqishëm në besnikërinë qytetare dhe politike të kombit kundrejt asaj kulturore. Koncepti politik i kombit quhet edhe koncepti i kombit subjektiv, qytetar, i shtetasit etj. Kjo pikëpamje mbi kombin frymëzohet nga shkrimet e Jean Jacques Rousseau-së, gjegjësisht nga interpretimi nacionalist i “Kontratës Sociale”, apo thënë më mirë, nga ideja e sovranitetit popullor e shprehur në sintagmën e “vullnetit të përgjithshëm”. Një koncept i tillë përgjithësisht bazohet në përvojën e krijimit të kombit anglez, amerikan dhe në veçanti në përvojën e krijimit të kombit francez. Kjo formë e nacionalizmit që doli nga Revoluzioni Francez përcjell një qëllim të popullit apo të kombit që qeveris veten, sepse populli francez përbëhej nga “qytetarë” me të drejta dhe liri të patjetërsueshme dhe assesit të nënshtruar ndaj kurorës mbretërore. Pra pushteti sovran ishte i kombit francez. Botëvështrimi francez e konsideronte kombin si njësi politike, që qeveris veten, të lidhur qenësisht me parimet e lirisë, barazisë dhe vëllazërisë.³⁵

Në krijimin e konceptit politik të kombit ka luajtur rol edhe tradita etatiste franceze. Lojaliteti ndaj mbretit zëvendësohej me lojalitetin ndaj kombit, tiparet që i jepeshin mbretit tani i jepeshin kombit, kombi cilësohej si hyjnor, kombi ishte burim i identitetit, bartës i sovranitetit dhe burim i legjitimitetit. Dikur mbreti thoshte unë jam shteti, tani “kombi ishte shteti”. Vullneti i kombit në shumë drejtime i ngjet vullnetit të përgjithshëm të Rousseau-së, ashtu si vullneti i përgjithshëm që është i pandashëm e sovran, edhe vullneti i kombit është i pavarur nga vullneti i individëve që përbëjnë kombin dhe përcakton vullnetin e tyre.³⁶

³⁵ Andrew Heywod, Politika, f. 107.

³⁶ Hysamedin Feraj, Skicë e mendimit politik shqiptar, f. 49.

Gjithashtu janë edhe një numër i teoricienëve që mendojnë se kombet janë bashkësi politike dhe jo etnike. Benedict Anderson shtjelloi kombin modern si një “komunitet politik të imagjinuar”, të pandashëm dhe sovran njëkohësisht. Është i imagjinuar sepse anëtarët e kombit më të vogël nuk do t’i njohin, nuk do t’i takojnë, nuk do t’i dëgjojnë kurrë bashkë-anëtarët e tyre të tjerë, por gjithsesi në mendjen e secilit prej tyre jeton imazhi i bashkësisë. Në këtë kontekst mund të them se Andersoni mendon se kombet janë më shumë si pamje, shpikje mendore sesa si bashkësi e vërtetë. Sipas tij, koncepti lindi në epokën kur Iluminizmi dhe Revolucioni rrënonin legjitimitetin e sferës së dinastive hierarkike “të legjitimuara në mënyrë hyjnore”, duke u konfrontuar pashmangshmërisht me pluralizmin e gjallë të këtyre religjioneve. Pra, diçka që përmes ndërveprimit ballë për ballë mundëson nocionin e një identiteti të përbashkët.³⁷

I të njëjtit mendim mbi idenë që kombet janë bashkësi politike është edhe Eric Hobsbawmi. Ai kombin e konsideron si një entitet social parësor të pandryshueshëm, ai është i tillë vetëm për atë që ka të bëjë me një lloj të caktuar shteti territorial modern, me “shtetin-komb” dhe sipas tij nuk ka kuptim të flitet për komb dhe kombësi shkëputur nga ky realitet historik. Ai i përket një periudhe historike të veçantë dhe relativisht të vonë.³⁸ Sipas tij, kombet janë “tradita të sajuara” që duke kultivuar mitin e pastërtisë kulturore dhe vazhdimësisë historike të një populli. Nacionalizmi krijoi mitin dhe u paraprin kombeve. Hobsbawmi pajtohet me Gellnerin se “nacionalizmi krijon kombe dhe jo kombet nacionalizmin”.

Pa marrë parasysh arsyet dhe shkaqet e lindjes së kombeve një numër i madh i tyre ndjek natyrën politike të formimit. Sepse qytetarët e këtyre njësive vlerësojnë dhe kanë më shumë ndikim identitetet politike sesa identitetet etnike. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar apo edhe Zvicra konsiderohen si shembuj tipik të kombeve politike. Sipas Andrew Heywood-it kombe të tilla mund të përshkruhen si “politike” në dy kuptime: së pari, në shumë raste ata e kanë arritur shtetësinë vetëm pas një përpjekjeje kundër sundimit kolonial, në këtë rast identiteti kombëtar ndikohet thellë nga kërkimi bashkues i

³⁷ Benedict Anderson, Komunitete imagjinare, Lindje & Perëndim, Tiranë, 2013. f. 18-21.

³⁸ E. J. Hobsbawm, Kombet dhe Nacionalizmi që nga 1780, f. 21.

çlirimit dhe lirisë kombëtare. Këto kombe shpejt janë formësuar nga kufijtë territorialë të trashëguar nga ish-sunduesit e tyre kolonialë.³⁹

Këto kombe ndërtohen në baza vullnetare dhe duke u pajtuar që marrëdhëniet në mes pjesëtarëve të rregullohen nga një numër parimesh dhe qëllimesh të harmonizuara konform barazisë sociale të të gjithëve, duke përjashtuar dominimin e ndonjë identiteti kulturor të veçantë.

3. Teoritë e nacionalizmit

Ajo që është e përbashkët në të gjitha përkufizimet e nacionalizmit është se pranon rëndësinë qendrore politike të kombit. L. Greenfeld thotë se nacionalizmi është një perspektivë e veçantë një stil mendimi.⁴⁰ Pra, në thelbin e nacionalizmit qëndron ideja e kombit. Fjalori Politik i Oxfordit nënvizon epërsinë e identifikimit me njëjtësinë kombëtare, pra “tipar i përgjithshëm i parimeve të nacionalizmit është pranimi i epërsisë së njëjtësisë kombëtare mbi kërkesat e klasës, të besimit ose të njerëzimit në përgjithësi”.⁴¹ Nacionalizmi si ide në epiqendër të ligjërit politik ka kombin, duke e ndërtuar atë me elemente dhe simbole të trashëgimisë kulturore të së shkuarës paramoderne që ruhen në kujtesën kolektive të etnive. Hobsbawmi thotë se “nacionalizmi herë-herë ka marrë kulturën ekzistuese dhe e ka shndërruar në komb, herë herë e ka shpikur për këtë qëllim një kulturë, kurse më të shumtën e herëve i fshin kulturat ekzistuese”⁴². Elitat politike legjitimojnë shpikjen e traditave, prodhimin e ngjarjeve historike, shpalljen e heronjve, me tendencën e krijimit të narracionit shoqëroro-politik që do të rezultonte me ndërtimin e kombit si entitet më i lartë politik.

Nacionalizmi, si një doktrinë politike, është besimi se popujt e botës ndahen në kombe dhe secili prej këtyre kombeve ka të drejtën e vetëvendosjes, qoftë si njësi vetëqeverisëse brenda kombeve-shteteve ekzistuese, qoftë si komb-shtet më vete.⁴³ Sipas Ignatieff-it është kombi identiteti mbizotërues kundrejt identiteteve tjera që e siguron esencën e përkatësisë, dhe është nacionalizmi që dëshiron të jetëson idealin kombëtar në njësi politike gjegjësisht në shtet më vete. Ignatieff konceptin komb e lidh edhe me të drejtën e vetëvendosjes, pra të

³⁹ Andrew Heywood, 2008, f. 108.

⁴⁰ Liah Greenfeld, Nationalism: five roads to modernity, Harvard University Press, London, 1992, f. 4.

⁴¹ Iain Mc Lean, Fjalori Politik i Okxfordit, Shtëpia e librit dhe e komunikimit, Prishtinë, 2001, f. 375.

⁴² E. J Hobsbawm, 2012, f. 22.

⁴³ Michael Ignatieff, Gjaku dhe përkatësia, Dituria 2000, f. 5, 6.

qenit komb nënkupton të drejtën e vetëvendosjes dhe në rrugëtimin e realizmit të kësaj të drejte përligj edhe përdorimin e dhunës kundrejt armiqve të brendshëm dhe të jashtëm që pengojnë realizimin e kombit. Smith thotë se nacionalizmi nënkupton 1. një proces që ka të bëjë me formimit dhe ruajtjen kombeve ose shteteve-kombe, 2. vetëdijën e përkatësisë në komb, së bashku me ndjenjat dhe aspiratat për sigurinë dhe prosperitetin e tij, 3. një gjuhë dhe simbolika e 'kombit' dhe rolit të tij, 4. një ideologji, duke përfshirë një doktrinë kulturore të kombeve dhe vullnetin kombëtar dhe formulën për realizimin e aspiratave kombëtare, 5. një lëvizje shoqërore dhe politike për të arritur qëllimet e kombit dhe për të realizuar vullnetin e saj kombëtar.⁴⁴

Hobsbawmi pohon se nuk ka kuptim të flitet për komb dhe kombësi për aq sa nuk ka të bëjë me një lloj të caktuar shteti territorial modern, me shtetin.⁴⁵ Sipas Smith “nacionalizmi u paraprin kombeve, nuk është kombi që krijon shtetin dhe nacionalizmin, por anasjelltas”. Në këtë kontekst, Ben Dupre thekson se aspirata qendrore e një programi nationalist është të arrijë të qenit shtet, një status i ri që nënkupton pavarësinë dhe sovranitetin për një bashkësi, anëtarët e së cilës kanë disa arsye për të besuar se ata formojnë një ‘komb’. Sapo ky qëllim parësor të jetë arritur, atëherë objektivat e nacionalizmit janë mirëqenia e kombit dhe mbrojtja e vlerave nacionale. Nacionalistët besojnë se objektivi i shtetit-komb, ka të drejtën e besnikërisë së anëtarëve kundrejt besnikërive dhe interesave të tjera që mund ta hedhin poshtë këtë objektiv.⁴⁶

Nacionalizmi mbartë faturën e shumë ndodhive nga fundi i shekullit XVIII e këndeje në raport me motivimin e popujve për ndërtimin e identiteteve të tyre kulturore dhe politike. Nacionalizmi nga njëra anë konceptohet si një forcë progresive, çlirimtare sepse ka arritur që t’i mobilizojë popujt përkatës për ndërtimin e entiteteve të tyre etnike dhe politike. Në anën tjetër, ai konsiderohet një koncept destruktiv, sepse ka motivuar popujt e ndryshëm në konflikte të ndërsjella, që kanë sjellë humbje të mëdha njerëzish dhe mbi të gjitha ka qenë faktorë kryesorë për shkatërrimin e entiteteve “të mëdha” politike përkundrejt entiteteve “të vogla” politike. Pra, ai është çlirues, pushtues, progresiv, regresiv përjashtues, gjithëpërfshirës, ksenofobik e gjithçka tjetër, ashtu siç e thotë edhe Heywood “nacionalizmi

⁴⁴ Shih më shumë: Anthony Smith, *National Identity*, Penguin Books, 77.

⁴⁶ Ben Dupre, *Pesdhjetë ide politike*, Plejad, Tiranë, 2012.135.

merr formë nga idealet politike të atyre që e përkrahin.” Pra, nacionalizmi mund të formësohet apo të lakohet varësisht mënyrave që e përdorin atë, nga liberalët, socialistët, konservativët, fashistët apo edhe komunistët. Në vazhdim do të flasim për disa forma më universale të mënyrave të shpërfaqjeve të nacionalizmit, e posaçërisht disa nga ato që manifestohen në vendet e Ballkanit Perëndimor, posaçërisht tek shqiptarët dhe popujt tjerë fqinj.

3.1 Nacionalizmi liberal

Nacionalizmi liberal mbështetet në natyrshmërinë e ndarjeve njerëzore, pra mbështet qëndrimin se njerëzit në formë të natyrshme ndahen në grupe kombesh dhe secili duhet të ketë dhe të ndjek identitet e veçanta. Kombet janë bashkësi të njëmendëta apo organike dhe jo krijime të elitave politike dhe kulturore. Sipas tyre kombi ishte produkt i një tërësie qytetarësh, ku sovraniteti kolektiv i tyre interpretohej si shprehje e vullnetit politik, vullneti i të cilëve konstituohet në një shtet. John Stuart Mill e përkufizonte kombin thjesht në bazë të ndjenjës kombëtare, “ai shton se pjesëtarët e një kombësie dëshirojnë të jetojnë nën të njëjtën qeverisje dhe që kjo të jetë përjashtimisht qeverisje nga vetvetja apo nga një pjesë e vetvetes.”⁴⁷ Mill-i predikonte se themelimi i një shteti kombëtarë duhej të ishte i mundshëm dhe i dëshirueshëm nga vetë kombësia.

Gjithashtu ajo çka e karakterizon nacionalizmin liberal është edhe koncepti i *sovranitetit popullor* i Rousseau-së, duke e ndërlidhur idenë e kombit me vullnetit e lirë, të natyrshëm dhe kolektiv të sovranit. Në konsolidimin e mëtejshëm të këtij koncepti ka ndikuar edhe përkushtimi ndaj parimit të vetëvendosjes kombëtare me pretendimin se të gjitha kombet janë të barabarta dhe duhet të veshen me të drejtën e vetëvendosjes. Në këtë rrjedhë të mendimit A. Heywoodi thekson se nacionalizmi liberal është një formë e nacionalizmit me parime, ai nuk i përkrahë interesat e një kombi kundër një tjetri, sepse sipas tij secili komb ka të drejtën e lirisë dhe vetëvendosjes. Qëllimi përfundimtar i nacionalizmit liberal është ndërtimi i një bote me shtete kombe sovraane.⁴⁸ Në këtë kuptim nacionalizmi konsiderohet si mjet për ndërtimin e një rendi botëror me më shumë liri, barazi, siguri dhe mbi të gjitha, me krijimin e një rendi global paqësor.

⁴⁷ E. J. Hobsbawm, 2012. f. 36, 45.

⁴⁸ Andrew Heywood, 2008. f. 110.

Referuar nacionalistëve liberalë krijimi i shteteve kombe duke e zbatuar parimet uillsoniane do të ishte thellësisht demokratik dhe i drejtë, sepse nënkupton bashkimin kulturor dhe politik për të gjithë popujt. Sipas kësaj pikëpamjeje kombet jetojnë në hapësira gjeografike të dallueshme etnikisht dhe kulturalisht dhe shtetet mund të ndërtohen në përputhje me këto hapësira. Të gjitha shtetet-kombe në vete përfshijnë grupe etnike, gjuhësore, fetare të njëjta, pra ata që janë të ndërgjegjshëm me atë se ç'fars nënkupton fjala komb dhe janë në gjendje të konceptojnë veten si komb.

3.2 Nacionalizmi socialist

Përderisa nacionalizmi përkushtohet në përmbledhjen e elementeve të përbashkëta të një shoqërie dhe për të ndërtuar atë që quhet komb, socializmi është i përkushtuar në mbulimin e një hapësire më të gjerë shoqërore apo tërë njerëzimin, duke përfshirë kombe dhe kultura të ndryshme brenda vetes kështu që qeverisja në sisteme të tilla përjashton privilegjet e një kombi specifik. Mirëpo, ajo që i bashkon dhe i ndan njëkohësisht të dyjat janë veprime shoqërore për të ndërtuar entitete shoqërore të ndryshme, njëri më i vogël dhe i kufizuar, siç është nacionalja dhe tjetri, në krijimin entiteteve ku përfshihen vlera të përgjithshme, gjithëpërfshirëse apo internacionale.

Sipas teoricienëve socialistë lufta e klasave ka luajtur rol të rëndësishëm dhe progresiv në formimin e kombeve dhe të kombësive dhe në zgjimin e vetëdijes Kombëtare. Sipas Marksit dhe Engelsit, kombi dhe nacionalizmi janë produkt i pashmangshëm i lindjes së kapitalizmit. Në këtë kontekst, "Duke luftuar për formimin e kombeve dhe të shteteve të pavarura kombëtare, klasa borgjeze ka pasur parasysh, në radhë të parë interesat dhe aspiratat e veta klasore, ekonomike dhe politike, të cilat kanë mundur të realizohen vetëm në kushtet e përmbysjes së institucioneve të vjetëruara feudale, ..." ⁴⁹. Megjithëse kombi dhe çështja kombëtare janë produkte të luftës për vetëvendosje dhe të raporteve shoqërore kapitaliste, prapë se prapë çështja kombëtare nuk qe e mundur të zgjidhet drejtë në kuadrin e raporteve shoqërore borgjeze. Kështu, sipas Leninit në kapitalizëm është e pamundur zhdukja e zgjedhës nacionale, dhe që të zhdukim zgjedhën nacionale është e nevojshme që të zhduken klasat, respektivisht të vendoset socializmi. Duke e luftuar kapitalizmin në socializëm proletariati krijon mundësinë për evitimin e plotë të zgjedhjes nacionale; kjo

⁴⁹ Ekrem Murtezai, Marksizmi, socializmi dhe vetëqeverisja, Bot. II, Qendra krahinore e arsimit marksist Prishtinë, Prishtinë, 1978, 148.

ndodh vetëm kur demokracia të zbatohet në të gjitha lëmitë. Demokratizimi i proletariatit nënkupton përjashtimin e çdo pabarazie dhe çdo privilegji të ndonjë nacioni ose gjuhe nacionale.⁵⁰ Një fazë e tillë është rezultat i zhvillimit të lirë dhe të gjithanshëm të njeriut punonjës në socializëm, i cili, në mënyrë konsekuente lufton për emancipimin e plotë të çdo kombi dhe kombësie, e kësaj krijon kushte të volitshme për zhdukjen graduale të kombeve dhe të kombësive në socializëm.⁵¹ Pra, mund të themi se kombësia, e cila sipas tyre paraqitet në epokën e kapitalizmit, afirmimin më të lartë e gjen në socializëm, i cili më pas krijon kushtet objektive për tejkalimin, gjegjësisht zhdukjen graduale të saj.

Gjithashtu, edhe socializmit etatist stalinist dhe neostalinist nënvlerëson kombin dhe çështjen kombëtare duke e trajtuar si çështje sekondare të transformimit socialist të shoqërisë. Në socializëm, sipas Stalinit dhe stalinistëve, çështja kombëtare është çështje sekondare, sikundër vetë fshatarësia është strukturë sekondare në raport me klasën punëtore, respektivisht proletariatin.⁵² Pra, sipas kësaj ndarjeje nënkuptohet se proletariati është forcë sunduese dhe më e rëndësishme në socializëm, dhe në raport me këtë forcim i pushtetit të proletariatit ka përparësi në raport me çështjen nacionale si diçka që në esencë është “çështje fshatare” apo “sekondare”. Sipas neostalinistëve përveç të drejtës së kombit për vetëvendosje, ekziston edhe e drejta e klasës punëtore që ta forcojë pushtetin e saj dhe kësaj të drejte i nënshtrohet e drejta për vetëvendosje. Nënshtrimi i së drejtës së kombit për vetëvendosje të drejtës së klasës punëtore që ta forcojë pushtetin e vet, është interpretuar si dhunim i kombit të madh ndaj kombeve të vogla, si dhunim hegjemonist centralist dhe rusifikues, të cilin e ushtronte burokracia politike me në krye Stalinin.⁵³

Praktika të tilla në emër të triumfit të klasës punëtore apo socializmit si sistem qeverisës, përmes dhunës, praktikave asimiluese ndaj kombeve dhe kombësive, anulimi dhe manipulimi me territoret nacionale, kanë ndodhur në ish-Bashkimin Sovjetik apo edhe në ish-Jugosllavi. Në këtë punim do të fokusohemi te konteksti i ish-Jugosllavisë, do të apostrofohen politikat instrumentalizuese ndaj kombësive, gjegjësisht asaj shqiptare në interes të dominimit serb.

⁵⁰ Po aty, 150, 151.

⁵¹ Shaban Shehu, Marksizmi dhe Humanizmi, Flaka e vëllazërimit, Shkup, 1978, f. 78.

⁵² Ekrem Murtezai, 1978, f. 153.

⁵³ Shih: Ekrem Murtezai, 1978, f. 153.

3.3 Nacionalizmi antikolonial

Një formë tjetër e shfaqjes së fuqishme të nacionalizmit dhe përkatësisë kombëtare ka të bëjë me refleksionin kundrejt një armiku që pamundëson realizimin e një identitetit nacional. Pra, dëshira për realizimin e ndjenjës kombëtare vjen si reaktion apo si përgjigje ndaj aksionit shtypës apo diskriminues të iniciuar më herët nga një entitet më i "fuqishëm" politik. Shtypja e entiteteve kombëtare dhe moslejimi i të shprehurit të kombësisë së tyre në mënyrë të lirë, në formë reaksioni tek ata nxit ngritjen e nacionalizmit etnik dhe ndërgjegjen për të jetësuar idenë e tyre kombëtare. Dekolonizimi është thjesht zëvendësim i një "lloji" njerëzish nga një "lloj" tjetër njerëzish. Në këto rrethana lind një komb i ri, një shtet i ri që krijon marrëdhënie diplomatike, ndërton një orientimi politik e ekonomik.⁵⁴

Kjo mund të ilustruhet me shembullin e shfaqjes së nacionalizmave të fund shekullit XVIII në hapësirat e Evropës Qendrore dhe Lindore, rajone këto të cilat sundoheshin apo ishin të kolonizuara nga perandori si ajo Osmane, Ruse dhe Austro-Hungareze. Një kolonizim të tillë e kanë përjetuar edhe Shqiptarët e Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore me aneksimin e një pjesë të trojeve të tyre nga ish-Jugosllavia. Gjithashtu shfaqja e lëvizjeve anti-koloniale përgjatë shekullit XX kryesisht në Afrikë dhe Azi ka ndikuar shumë në lindjen e ndjenjës së formësuar nga dëshira për çlirim kombëtar. Fjala është për lëvizjet për pavarësi që u shfaqën mes dy luftërave botërore kundrejt SHBA-së, Britanisë, Francës, Holandës dhe Portugalisë që u dorëzuan përballë nacionalizmave lokalë.

Dekolonializimi dhe lëvizjet antikolonialiste u frymëzuan nga ideja e vetëvendosjes kombëtare dhe nga nacionalizmi evropian.⁵⁵ Kërkimi i pavarësisë politike i vendeve të kolonizuara ishte njëherit edhe kërkesë për liri ekonomike dhe politike, për t'i dhënë fund nënshtrimit dhe shërbimit ndaj industrializmit evropian dhe SHBA-ve. Pra, dëshira për të shmangur çdo lloj instrumentalizimi dhe përdorimi nga të tjerët buron nga fakti i ndërtimit të institucioneve autonome vetëqeverisëse që nënkupton përlartësimin e tyre si qenie njerëzore dhe nacionale.

⁵⁴ Franc Fanoni, *Të mallkuarit e botës*, Rilindja, Prishtinë, 1984, f. 29.

⁵⁵ Andrew Heywood, f. 115.

3.4 Nacionalizmi ekspansionist

Formën e nacionalizmit ekspansionist e përshkon një frymë agresive dhe ushtarake e veprimit, sepse nacionalizmi zgjerues nuk beson në parimin e vetëvendosjes dhe të drejtave të barabarta për të gjithë. Nacionalizmi ekspansionist apo i skajshëm u ndërtua në funksion të maksimalizimit të madhështisë nacionale, duke mos përjashtuar përdorimin e formave më radikale në funksion të realizimit të këtij qëllimi. Fryma e nacionalizmit agresiv u paraqit në fund të shekullit XIX dhe në shekullin e XX, kur vendet evropiane realizuan kolonizimin e vendeve të ashtuquajtura “të treta” në emër të prestigjit kombëtar dhe të zgjerimit të perandorive të tyre. Në këtë aspekt ndikim kanë patur edhe programet me frymëzim nationalist perandorak që shkaktuan Luftën e Dytë Botërore si ato të Gjermanisë, Japonisë dhe Italisë. Një shembull tjetër i manifestimit të nacionalizmit në formë militareske, pushtuese është edhe nacionalizmi serb me tendencën për të ndërtuar një “Serbi të madhe”.

Kjo formë e ashpër e nacionalizmit lidhet me doktrinat shoviniste. Kjo shprehje rrjedh nga emri i Nicolas Chauvin-it, ushtar francez i njohur për përkushtim fanatik ndaj Napoleonit dhe kauzës së Francës. Shovinizëm është një besim i paarsyeshëm në epërsinë e sundimit të grupit apo popullit vetjak. Shovinizmi kombëtar hedh poshtë idenë se të gjitha kombet janë të barabarta; ai nisat nga teza se disa kombe janë të përshtatshme për sundim, kurse disa të tjera për nënshtrim. Kjo formë e nacionalizmit nyjëton përmes doktrinaeve të epërsisë etnike apo racore, duke e përzier kështu nacionalizmin me racializmin, me një fjalë kombi i shovinistit shihet si unik dhe i veçantë, si “popull i zgjedhur”.⁵⁶

3.5 Ideja e nacionalizmit si kohezion i brendshëm kombëtar

Nacionalizmi si ideologji mëton të legjitimojë kombin modernë duke promovuar dhe theksuar në vazhdimësi karakteristikat përbashkuese të një populli. Kështu, nacionalizmi është treguar i vëmendshëm në përmbledhjen e vlerave të veçanta dhe shënjuese të kombit duke treguar kohezion të madh politik për integrimin e pjesëtarëve të një grupi. E kaluara e “lavdishme” historike dhe kujtesa e kolektive kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ndërtimin e vetëdijes kombëtare. Roli i kësaj të kaluare, kujtimeve, miteve, simboleve etnike dhe përdorimi i tyre prej intelektualëve dhe elitave të tjera kanë forcuar vazhdimisht

⁵⁶ Po aty, f. 114.

kohezionin e brendshëm të ndjenjës kombëtare. Në këtë kontekst, gjuha konsiderohet si një element i qëndrueshëm në përafrimin, ndërtimin dhe integrimin e një kombi. Ajo ndikon në afrimin e njerëzve dhe në përkatësinë një grupi, kështu forcon ndjesinë e përbashkët të grupit. Në këtë drejtim mund të përmenden traditat, luftërat e përbashkëta që kanë ndikuar në lindjen e ndjesisë së përbashkët kombëtare. Të gjitha këto elemente dhe të tjera të rëndësishme të një populli, nacionalizmi i ka shndërruar në forca lëvizëse për ndërtimin e kombit. Këtu duhet përmendur edhe idenë se bota është e ndarë në kombe dhe se ai është burim i gjithë pushtetit politik. Sipas Smith-it që “të jesh i lirë dhe i plotësuar duhet t’i përkasësh një kombi.” Çdo komb duhet ta shprehë natyrën e vetë autentike duke qenë i pavarur; një botë e paqme dhe e drejtë mund të ndërtohet vetëm duke u mbështetur mbi kombet e pavarura.⁵⁷ Pra, nacionalizmi si ideologji nuk është vetëm shenjë e zgjimit të vetëdijes së kombeve, por ai shpik kombet ku nuk ekzistojnë (Gellner), nga një komunitet imagjinar në një komunitet të vërtetë. Nacionalizmi nuk është aksidental, ai ka rrënjë të thella, ai është fati i njerëzimit, e jo sëmundje e rastësishme që na e kanë përcjellur shkronjësit e iluminizmit të vonë.⁵⁸ Nacionalizmi kërkon të besosh fort në diçka që duket sheshit se nuk është ashtu.

Nacionalizmi pretendon ta transformojë gjendjen ekzistuese të kombit, duke i bashkuar të gjitha njësitë e saj në një njësi politike. Ky parim, pasqyron objektivin e qartë për të ardhmen e kombit dhe njëherit mbetet parimi më konsolidues dhe gjithëpërfshirës i nacionalizmit. Normalisht, këtu është fjala për kombet të cilat akoma nuk e kanë arritur bashkimin në një njësi politike, kështu për kombet e tilla ky parim mbetet epërsor ndaj artikulimeve të tjera të këtij koncepti. Objektivi i tij është i përhershëm, i pa u mbrapsur asnjëherë, madje duke pranuar edhe modalitete të ndërmjetme apo të përkohshme për “zgjidhjen” e çështjes kombëtare, për të realizuar herët apo vonë idealin e bashkimit kombëtar. Nacionalizmi është i rëndësishëm edhe për kombet që kanë “arritur” këtë objektivi, në artikulimin e vlerave kulturore, etike, historike e sociale të kombit. Ai mbetet ndër elementet më të fuqishme për kohezionin social të një shoqërie.

⁵⁷ A. D. Smith, *Kombet dhe Nacionalizmi në erën globale*, f. 67.

⁵⁸ E. Gellner, *Nacionalizmi*, 22.

4. Multikulturalizmi dhe ideja e shtetit multi-etnik

Fillet e definimit të multikulturalizmit janë tek individi i lirë, dhe mundësia në lirinë e shfaqjes së tij. Multikulturalistët theksojnë se shumësia kulturore ekziston brenda çdo njeriu, sepse njerëzit janë të aftë për t'u identifikuar me shumë pikëpamje, ide, koncepte, me mënyrat e ndryshme të jetës, njëkohësisht secili posedon pamje të ndryshme fizike, kulturore apo etnike. Multikulturalizmi vë në shprehje diversitetin kulturorë, aty ku ekzistojnë dy ose më shumë grupe me besime apo kultura të ndryshme. Sipas Will Kymlickas postulati kryesor i multikulturalizmit është inkluziviteti, që nënkupton se nuk duhet të hidhet ajo që të përket ty apo ajo që është jotja që të bëhesh multikulturor, ata duhet të njihen dhe respektohen ashtu siç janë.⁵⁹ Në këtë mënyrë, mund të themi se është origjinaliteti dhe vërtetësia e qenies ajo që duhet të respektohet dhe të konsiderohet si e mirëqenë dhe jo si predispozitë për t'u ndryshuar. Pra, mund të themi se qasja e idesë multikulturaliste është përpjekje për gjetjen e modeleve shoqërore që t'u garantojë pavarësinë shoqërore dhe politike individëve me identitete dhe mënyra të ndryshme të të jetuarit.

Zbatimi i politikave multikulturaliste ka qenë i shoqëruar me debate e polemika të ndryshme politike dhe filozofike. Koncepti i bashkëjetesës, jo çdo herë ka gjetur mirëkuptim dhe është realizuar me vullnet, ai është përcjell me mospajtime dhe kundërthënie të shumta. Për shoqërinë multikulturore apo për idenë e shtetit multi-etnik mund të flitet nëse nënshtetasit e tij u takojnë kombeve të ndryshme, dhe asnjëra prej tyre nuk e posedon shumicën e mjaftueshme për të udhëhequr me pushtetin. Për të ekzistuar një shtet multi-etnik fillimisht duhet të dakordohen të gjitha kombet që jetojnë në të, dhe mbi bazën e parimit ku të gjithë do të përfaqësohen barabartë. Në të kundërtën e sajë, krijimi i një shteti multi-etnik pa dispozitat paraprake të dallueshmërisë numerike në mes të entiteteve, jo vetëm që nuk do të ketë sukses, por mund të rezultojë në konflikte të mundshme ndërnacionale. Pra, shteti multi-etnik vlen dhe do të funksionoj vetëm atëherë kur ekziston dakordanca e të gjitha palëve. Shoqëritë e tilla i quajmë shoqëri multikulturore, si shoqëri në të cilat pluralizmi kulturor dhe mënyra e përbashkët e të jetuarit është domosdoshmëri dhe sfidë e përhershme e shtetit.

⁵⁹ Shih: Will, Kymlicka, *Multicultural Odysseys-Navigating the New International Politics of Diversity*, Oxford Press, 2007.

Termi multikulturalizëm paraqitet shprehimisht në kontekstin politik të Kanadasë (në mbarim të viteve 70), aty ku u artikulua ideja e kombit kanadez si një komb multikulturor, i sajuar jo vetëm nga dy popujt themelues por edhe nga tërësia e imigrantëve. Me 1982, multikulturalizmi u ngrit në Kanada në parim kushtetues, i cili afirmon idenë se barazia qytetare është e pajtueshme me respektimin e dallimeve kulturore.⁶⁰ Në këtë mënyrë, zyrtarisht bëhet diferencimi nga modeli asimilues, i cili është prezent në shumicën e vendeve demokratike e sipas të cilit integrimi politik varet nga përvetësimi i normave kulturore të shumicës. Në Australi, Britani të Madhe, Zvicër dhe Holandë janë zbatuar politika të ngjashme, ndonëse multikulturalizmi nuk është ngritur në parim kushtetues. Megjithatë, për këto vende mund të thuhet se kanë zbatuar një “multikulturalizëm të integruar”. Në rastin e parë, politikat multikulturaliste synojnë shprehimisht të promovojnë respektimin e diversitetit kulturor në saje të një forme të pranimit (njohje) publik. Në rastin e dytë, fjala është më shumë për luftimin e paragjykimeve raciste. Në Zvicër, për shembull, si dhe në shumicën e shteteve multinacionale, grupet nacionale ndejnë lidhshmëri ndaj shtetit më të gjerë vetëm për shkak se ai i njeh dhe i respekton përkatësitë e tyre të ndryshme nacionale. Popullsia Zvicerane, e kuptuar si një shtetësi është 8,179,294 nga të cilët, Gjermanë janë 65%, Francezë 18%, Italian 10%, Romansch 1%, dhe të tjerë 6%.⁶¹ Pra, në një shtet me një heterogjentitet të tillë ku përafërsisht 36% të popullsisë janë të tjerë pos Gjermanë, do të ishte logjike që një Kushtetutë të reflektonte diversitetin e tillë.

Këtu mund të bëjmë edhe një digresion me shtetin e Kosovës të cilin Kushtetuta e përkufizon si “shoqëri multietnike, e përbërë nga shqiptarët dhe bashkësitë tjera etnike”.⁶² Kushtetuta pranon si gjuhë zyrtare shqipen dhe serbishten dhe gjuhë të tjera po ashtu (turqishtja, boshnjakishte, gjuha rome) pranohen në nivelin e komunave, të banuara nga këto pakica. Plani i Ahtisarit derivat i së cilës është Kushtetuta e Kosovës sforcoi dimensionet e aspektit multietnik në dëm të kombit shumicë, ngase rreth 95% përqind e popullsisë së Kosovës është shqiptare. Kjo formë e ndërtimit të shtetësisë ka prodhuar debate të shumta lidhur me përpjesëtimin që kanë këto parime me Kushtetutën. Një aspekt

⁶⁰ Shih: János Kenyeres, Aspects of Canadian Multiculturalism: History, Policy, Theory and Impact, Central European Journal of Canadian Studies, Volume 09, 2014; https://digilib.phil.muni.cz/bitstream/handle/11222.digilib/134378/2_CentralEuropeanJournalCanadian_9-2014-1_5.pdf?sequence=1, 08.07.2019.

⁶¹ Shih më tepër: Switzerland Demographics: http://www.indexmundi.com/switzerland/demographics_profile.html), July, 2016.

⁶² Kushtetuta e Kosovës, Nenin. 1.1.

i këtyre debateve shfaqet me afirmimin e një koncepti të shtetit komb, i ndërtuar mbi kriterin kushtetutorë të shtetit, mbi idenë e ndërtimit të një kombi të ri, mbi parimin se “shteti i paraprinë krijimit të kombit”.⁶³ Pikërisht për këtë, sfida për institucionet e Kosovës dhe klasës politike ka të bëjë me gjetjen e drejtpeshimeve të domosdoshme të cilat duhet sigurojnë unitetin e shoqërisë, krahas respektimit të specificiteteve kulturore të bashkësive etnike.

Kritikat ndaj multikulturalizmit janë zhvilluar në versione të ndryshme, Brian Barry kritikon qëndrimin e multikulturalistëve ndaj idealit universalist. Sipas tij, duke e ngritur praktikën e rregullave dhe përjashtimeve në rangun e një modeli politik, në mënyrë që të sendërtohet “qytetaria e diferencuar”, multikulturalistët e kompromitojnë kuptimin e barazisë së qytetarëve para ligjit. Në këtë mënyrë, multikulturalizmi favorizon një klientelizëm politik dhe rrënon bazat e solidaritetit civik, e nuk promovon një formë më të lartë të barazisë, por rikrijon kushtet për konflikte politike rreth vlerave të papajtueshme dhe njëherit i acaron, e nuk i zbutë, tensionet midis grupeve kulturore.⁶⁴ Në këtë kontekst vlen të theksohet se ekziston tendenca që universalisimi i vlerave kulturore të përdoren për legjitimitetin më të madh politik dhe për më shumë pushtet politik. Sipas Muhamedin Kullashit versione më të ashpra të kritikës së multikulturalizmit i gjejmë në Francë, në tekstet e Pierre André Taguieff. Sipas tij, multikulturalizmi bëhet i rrezikshëm për pluralizmin demokratik dhe paqen civile atëherë kur shoqërohet me programe të “diskriminimit pozitiv” apo të “aksionit afirmativ”, që pretendojnë të korrigojnë në mënyrë autoritare diskriminimin social real. Atëherë ai ushqen garat ndër-etnike e ndër-fetare, gara këto që synojnë të zëvendësojnë sistemin meritokratik, i cili nënkupton garancat për barazinë e shanseve midis individëve. Rivaliteti ndër-etnik, në veçanti, mund të radikalizohet, dhe mund të mjaftojë një shkëndija nga një konflikt i përditshëm midis dy vetave për nxitur përplasje që çojnë te luftëra qytetare.⁶⁵ Sipas kritikëve të multikulturalizmit nuk duhet shpërfillur konstelacionet reale të diversiteteve nacionale në një shoqëri, pra duke i “diskriminuar pozitivisht” sepse kjo mund të minoj konceptin e shoqërisë multikulturore. Gjithashtu, një përkufizim i tillë shtetërorë njëherit nënkupton edhe diskriminim të shumicës përkatëse, andaj nuk duhet ndjekur

⁶³ Nexhmedin Spahiu, Ngritja e kombit kosovar, 2017, f. 120

⁶⁴ Muhamedin Kullashi, Konferencë ndërkombëtare, e mbajtur më 25 Gusht 2008 në Prishtinë, Kosova dhe Bota Arabe. 2009, Prishtinë; <http://kfos.org/wp-content/uploads/2012/08/bota-arabe-al.pdf>, 10. 06. 2018.

⁶⁵ Po aty.

modeli i menaxhimit të përkohshëm të krizave për të afirmuar njërin dhe diskriminuar tjetrin, sepse kjo do të prodhojë edhe kriza të tjera. Në Kosovë shteti multietnik po imponohet padrejtësisht mbi idenë e “diskriminimit pozitiv”. Kështu, kjo gjendje jo vetëm që disfunksionalizon shtetin e Kosovës, por dhe krijon parakushtet për konflikte të reja mundshme.

5. Kozmopolitizmi

Ideja e kozmopolitizmit ka ekzistuar shumë kohë më parë se ideja e nacionalizmit, filloi me grekët e lashtë dhe që atëherë ka luajtur një rol të rëndësishëm në mendimet shoqërore dhe politike. Në shekullin e tetëmbëdhjetë, Kanti shkroi për "kushtin kozmopolit" si një domosdoshmëri racionale që lidh kombet për shkak se në epokën moderne shkelja e të drejtave përjetohej pothuajse gjithkund. Në këtë kontekst, ai thekson se “pas disa revolucioneve transformuese do të realizohet më në fund ndonjëherë, ajo që natyra e ka synimin më të lartë, një gjendje e përgjithshme kozmopolite, si përherë, ku mund të zhvillohen të gjitha dhuntitë e lindura të gjinisë njerëzore”.⁶⁶ Në fillim të shekullit nëntëmbëdhjetë edhe Hegeli vlerësoi qenien njerëzore si një çështje me “rëndësi të pafund”, sepse ai është një qenie njerëzore dhe jo për shkak se ai është hebre, katolik, protestant, gjerman, italian dhe të tjerë. Sociologu Emile Durkheim flet për ardhjen e një "patriotizmi botëror" ose kozmopolitanizmit në të cilin "shoqëritë mund të kenë krenarinë e tyre, jo duke qenë më të mëdhenjtë apo më të pasurit, por duke qenë më të drejtët, më mirë të organizuar dhe në zotërimin një kushtetute më përmasa më të mira morale”.⁶⁷ Këndeje e tutje koncepti kozmopolitizmit merr përmasa të gjëra trajtuese, duke filluar që nga këndvështrimet e ndryshme, format apo edhe mënyra e implementimit të saj në të ardhmen.

Sipas Robert Fine, Rënien e Murit të Berlinit (1989) krijoi mundësi për qasje të re ndaj konceptit universal, sepse kjo ngjarje shënon shfaqjen e një lëvizjeje të re intelektuale dhe politike, e cila është në vetvete ndërkombëtare dhe i vendos të drejtat e njeriut, të drejtën ndërkombëtare, qeverisjen globale dhe marrëdhëniet paqësore mes shteteve në epiqendër të vizionit të saj botëror. Teoria sociale kozmopolitane apo “kozopolitizmi i ri” siç e quan

⁶⁶ Shih më tepër: Immanuel Kant, *Ese ne filozofinë historike dhe politike*, Fan Noli, p.v.b. 2004, f. 19, 22; Immanuel Kant, *Drejt paqes së përhershme*, Dritan, Tiranë, 2004.

⁶⁷ Robert Fine, *Cosmopolitanism*, Routledge, London and New York, 2007, IX.

ai, nënkupton marrëdhëniet shoqërore nëpërmjet një konceptimi universalist të njerëzimit, gjegjësisht forma shoqërore në të cilën qeniet njerëzore luftojnë për njohjen reciproke dhe të trajtohen si të barabartë në kontekstin e dallimeve tona të shumëfishta.⁶⁸ Kësisoj, mund të themi se në teorinë sociale kozmopolitizmi konceptohet si përpjekje kolektive për të ndërtuar një shoqëri të përbashkët, ku njeriu si qenie njerëzore duhet trajtohet dhe të veproj i barabartë me çdo qenie tjetër njerëzore pavarësisht përkatësisë së tij kulturore dhe nacionale, kjo nënkupton krijimin e një rendi universal njerëzorë apo jetësimin e konceptit të qytetarit botërorë. Angazhim i rëndësishëm i kozmopolizmit është ai i idesë së pluralizmit, sepse kozmopolitët mendojnë se ekzistojnë shumë vlera sipas të cilave ia vlen të jetohej.

Ulrich Beck, bënë dallimin midis kozmopolitizmit dhe kozmopolitanizimit të vërtetë ekzistues, ai refuzon pretendimin se kozmopolitizmi është një zgjedhje e ndërgjegjshme dhe vullnetare, kështu mendon se kozmopolitanizmi i realitetit është kozmopolitanizëm i detyruar nga rrethanat e rëndësishme botëror si tregtia globale apo kërcënimet globale të tilla si ndryshimet klimatike, terrorizmi apo kriza financiare. Sipas tij kozmopolitanizmi nën këtë kuptim do të thotë kozmopolitanizëm latente, kozmopolitanizëm pa ndjenja, pasiv që ndërton realitetin si pasojë e efekteve anësore, ndërkohë që flamujt dhe qëndrimet kombëtare, identitetet vazhdojnë të ngrihen dhe të mbeten dominues. Në këtë kontekst ai potencon "Duke gjykuar nga standardet e larta të moralit etik dhe akademik, ky karakter i fshehtë e shndërron "kozopolitanizmin" të parëndësishëm, të padenjë për kombet, madje të dyshuar. Një ide që më parë e shtynte fazën e historisë botërore si çështje e lartë e elitës, nuk mund të zhvendoset në realitetin social dhe politik nga dera e pasme".⁶⁹ Një qasje e tillë ai e konsideron si kozmopolitizëm të pavetëdijshëm, gjysmë të ndërgjegjshëm apo një kozmopolitizëm i imponuar nga zhvillimi global i konsumit dhe i rreziqeve që mund të kanosen. Një kozmopolitizëm pa dëshirë dhe i kushtëzuar është i deformuar dhe i pasuksesshëm. Ai nuk praktikohet si detyrim etik me terma Kantian duke shtrirë në botë si përparim me autoritetin moral të reflektuar nga Iluminizmi, por si diçka e deformuar dhe profane, e veshur me anonimitetin e një efekti anësor. Një kozmopolitanizëm jo i deformuar, nga ana tjetër, vjen nga ndjenja e marrjes së eksperimentit të madh njerëzor në

⁶⁸ Po aty, 2-5.

⁶⁹ Shih më tepër: Ulrich Beck, *The Cosmopolitan Vision*, Polity Press, 2006, 19.

qytetërim - me gjuhën dhe simbolet kulturore të veta dhe mjetet për t'iu kundërvënë kërcënimeve globale - dhe kështu të kontribuojnë në kulturën e botës.⁷⁰ Kozmopolitanizmi nga ana tjetër sugjeron që ne të trajtojmë prirjet ndryshme politike dhe kulturore të individëve në formën që tejkalojnë kufijtë e shtetit komb. Ideja kozmopolite mendon se brenda pikëpamjes nacionaliste, në diversitetin e identiteve shoqërore ekziston problemi i konfliktit midis racës, fesë, kulturës, ideologjisë dhe interevsave ekonomike. Dhe kjo, sipas tyre, minon fuqinë e bashkëpunimit global dhe negocimin e marrëveshjeve transnacionale. Kështu që bëjnë thirrje për një ndryshim paradigmatic, pra nevojën për të lëvizur nga një këndvështrim i bazuar në komb, në atë kozmopolit, si më i rëndësishm.

Sot, kur flasim dhe trajtojmë efektin dhe ndikimin e kozmopolitizmit si ide kemi parasysh shtrirjen e saj në tre hapësira të pashmangshme, në kulturë, etikë dhe politikë.

Nocioni i kozmopolitizmit kulturorë nënkupton një shtresë të njerëzve që janë të aftë të komunikojnë dhe të lidhen me individ të kulturave të ndryshme, kështu përmes procesit të socializmit të dalin nga rrethet e ngushta etnokulturore dhe dal nga dal të krijojnë një identitet të ri kulturorë. Kozmopolitizmi kulturor pretendon se njerëzit nuk duhet të jenë të pandryshueshëm kulturalisht sepse kulturat ndryshojnë dhe duhet të ndryshojnë në mënyrë që të krijojmë një komunikim më të mirë dhe të domosdoshëm për kohën. Sipas Nussbaum, klasa, tradita dhe origjina nacionale dhe vendbanimi madje edhe gjinia trajtohen si attribute dytësore, sepse forma parësore morale për qytetarin duhet të jetë përkatësia e tij me humanizmin racional dhe kjo njëherit duhet të përcaktojë qëllimet e sjelljes së tij.⁷¹ Ky koncept kërkon që njerëzit me sfone të ndryshme morale, filozofike, kulturore dhe fetare të afrohen me njëri-tjetrin në mënyrë të lirë dhe me mendje të hapur dhe kështu të krijojnë qytetarin botërorë si identitet të ri shoqërorë që normalisht të konkretizohet edhe si projekt politik dhe ligjorë. Qëllimi i kësaj qasje është ndërtimi i kulturës unike botërore, pa modele të veçanta etnike, nacionale apo të tjera, duke ndërtuar një kulturë transnacionale pa identitet dhe origjinë.

⁷⁰ Po aty, 20-22.

⁷¹ Adam D. Etinson, *Cosmopolitanism: Cultural, Moral, and Political*, f. 28, 29. Në dispozicion nga: https://www.researchgate.net/publication/299637593_Cosmopolitanism_Cultural_Moral_and_Political, accessed Jun 08, 2018.

Kozmopolitizmi etik apo moral nënkupton pikëpamjen e njerëzve të përkushtuar ndaj parimeve të drejtësisë dhe trajtimit të barabartë për të gjitha qeniet njerëzit në botë. Drejtësia sociale duhet të jetë indiferente në raport me përkatësinë etnike, racore, fetare apo hapësira gjeografike, sepse vrasja, dhuna, mohimi i të drejtave nuk posedon përkatësi, të gjithë duhet trajtohen si të barabartë. Kozmopolitizmi filozofik siç njihet edhe ndryshe sipas Ferid Muhiq ka për qëllim përkushtimin ndaj parimeve të drejtësisë sociale për të gjithë njerëzit në botë, eliminimin e dhunës, uljes së dallimeve në pasuri, si dhe ndërmjet pjesës së zhvilluar dhe të pazhvilluar të botës.⁷² Kozmopolitistët moral janë të vetëdijshëm se realizimi i konceptit të drejtësisë për të gjithë qeniet njerëzore duhet të ketë bazë nga ku mund të derivojnë konceptet e tjera të drejtësisë dhe barazisë. Koncepti i barazisë morale sipas Allen Buchanan, nënkupton atë që ai e quan drejtësia e bazuar në të drejtën natyrore. Ajo përcakton se si duhet të bëjmë përpjekje pozitive për të siguruar dhe të mbrohen të drejtat themelore të të gjithëve. Kjo sipas tij kërkon edhe krijimin e institucioneve të reja dhe reformimin e institucioneve ekzistues në mënyrë që të arrihet një rend i drejtë global që njëherit është ndër parimet parësore të këtij koncepti.⁷³ Diçka e tillë është e arritshme vetëm nën rendin institucional global i cili do të jetë indiferent ndaj anshmërisë.

Kozmopolitizmi politik është i preokupuar në gjetjen e modeleve të reja të qeverisjes dhe institucioneve të reja politike duke synuar gradualisht ndërtimin e rendit politik kozmopolit. Kozmopolitizmi politik nënkupton institucionalizimin në mënyra dhe nivele të ndryshme dhe ngërthen në vete në mas të madhe edhe dy të parat kozmopolitizmin kultural, e posaçërisht atë etik. "Ideat e kozmopolitizmit politik - mund të përfshijnë, për shembull, (a) një republikë botërore, (b) një shpërndarje të institucioneve të pavarura globale, rajonale, vendore dhe komunale, ose (c) një federatë paqësore vullnetare të shteteve..."⁷⁴ Nuk ekziston një konsensus nga studiuesit e këtyre fushave e mbi ekzistimin apo jo të një republikë botërore (Kwame A. Appiah), sepse shtetet do të mohonin kategorikisht bartjen apo kufizimin e sovranitetit shtetëror nacional në një qeverie globale, kështu ata janë më të prirur ndaj krijimit të një federate paqësore apo kongrese vullnetare mes shteteve që gradualisht të ngrisin vetëdijen mbi vizionin kozmopolit. Por, pothuajse ekziston një qëndrim

⁷² Ferid Muhiq, Gambit Kozmopolit – mbrojtje kombëtare, Revista Shenja, Nëntor 2016, Nr.67, 32-26.

⁷³ Po aty, 34-37.

⁷⁴ Po aty, 39.

i përbashkët i tyre se instalimi i institucioneve me karakter global ku ka preokupim qenien njerëzore si parësore është e domosdoshme për ndërtimin e shoqërisë pa mure. Pra parësor është ideali për realizimin institucional të të drejtave dhe detyrimeve të barabarta ligjore për çdo person në botë dhe kjo do të përjashtonte çdo detyrim të veçantë ligjor që mund të pësojë ndaj autoriteteve lokale dhe kështu krijon mundësinë për realizimit të një rendi politik shumë-kombëtar global.

Kozmopolitizmi dhe nacionalizmi vazhdimisht trajtohen si koncepte politike me kundërshtime të ndërsjella mes vete, pra njëra është antitezë e tjetrës. Mbështetësit e kozmopolitizmit shprehin kundërshti ndaj çdo forme të nacionalizmit, e posaçërisht ndaj faktorit nacional sepse ai është pengesa kryesore për afirmimin dhe zhvillimin e konceptit kozmopolit. Pra, ajo që nënkuptohet si parim universal i kozmopolitizmit si ide politike ka të bëjë me zhveshjen apo depolitizimin e kombit. Kombi nuk trajtohet më si bashkësi politike, ekziston përpjekje e vazhdueshme për ta shkëputur atë nga çdo lloj ideje, doktrine apo rrjedhoje politike. Kombi në këto raste trajtohet si një realitet kulturor apo historik që po i kalon koha dhe i zhveshur nga atributet politike.

Në këtë kontekst kritikuesit e vizionit kozmopolit reduktojnë atë si koncept apo ai mund të jet i mundshëm për vendet e mëdha, apo për vendet me stabilitet politike të qëndrueshëm, gjithashtu me rrënjë të forta kulturore, territoriale dhe demografike. Kurse për popujt e vegjël akoma të pa konsoliduar politikisht dhe institucionalisht si shtete dhe jo mirë të formuar kulturalisht rrezikojnë deformimin kulturor dhe institucional të vendit të tyre. Perspektiva kozmopolite përballat me një kritik tjetër të rëndësishme, sepse ajo gjithnjë ka një qëllim politik konkret dhe ky është forcimi i nacionalizmit të kombit më të madh në numër dhe kështu të ndikoj në eliminimin e kombeve të tjerë në dobi të kombit më të madh. Kështu, kjo kritik dhe të tjerat na kthejnë në retrospektivën e alternativave të nacionalizmit demokratik si mundësi. Sipas F. Muhiq Nacionalizmi demokratik i plotësuar me elemente të nacionalizmit liberal, si liria individuale, drejtësia sociale, nacionalizmi përbën zgjedhjen më të mirë kundrejt kozmopolitizmit.⁷⁵ Pra është e kundërta e asaj që dëshirojnë të etablohet në opinionin publik se nacionalizmi atakon demokracinë apo këto nuk përputhen me njëra tjetrën, dhe sa më pak nationalist që të jemi aq më demokratik do të jemi dhe më afër aksiologjikisht me vendet më demokratike apo Evropës do të jemi.

⁷⁵ Shih më tepër: Ferid Muhiq, Revista Shenja, Nëntor 2016, Nr.67, 34-39

III. Lindja e nacionalizmit shqiptarë

Shtrirja e shqiptarëve në Ballkan në trevat e sotme të banimit dhe prejardhja nga ilirët e lashtë përbëjnë themelin dhe veçantësinë e identitetit shqiptarë. Edhe pse është e vështirë për ta argumentuar me burime dhe dokumente të shkruara historike joshkëputshmërinë nga ilirët, historiografia shqiptare e mbështetë atë në burime dhe argumente arkeologjike, linguistike, kulturore e të tjera se shqiptarët kanë jetuar gjithmonë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Greqi, Serbi e më gjerë, dhe se ata janë autokton në trojet e tyre. Pra, Ilirët shtriheshin në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik që prej mijëvjeçarit të tretë para Krishtit.⁷⁶ Ky qëndrim, mbi lashtësinë e prejardhjes së popullit shqiptarë, gjegjësisht rëndësinë e të qenit “popull historik” është zhvilluar edhe nga shkrimtarët shqiptarë të shekullit XIX, në veçanti gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare nga Pashko Vasa, Naim Frashëri, Sami Frashëri, Kristo Dako e të tjerë. Këtë qëndrim e gjejnë edhe tek autorë të huaj si gjuhëtarë, historian, gjeograf, ku mund të përmendim dijetarin suedez Johann E. Thunmann, historianin gjerman Georg Stadtmuller, filozofin gjerman Johan Gotfrid Von Herder, historiani Teodor Mommsen e të tjerë.⁷⁷ Duke u mbështetur në këto argumente dhe të tjera nga historiografia pranohet se ilirët nuk janë asimiluar plotësisht nga romakët, apo edhe nga pushtues të tjerë bullgarë, bizantinë, serbë, grekë, osmanë⁷⁸ dhe kështu kanë realizuar mbijetesën e vetë historike njëher si ilirë e më tutje si shqiptarë.

Pra, përkundër pushtuesve të shumtë shqiptarët mbijetuan dhe i rezistuan asimilacioneve nga pushtues të ndryshëm duke ruajtur konsistencën identitare. Mbijetesë, autoktonia, gjegjësisht rezistenca dhe refuzimi ndaj të huajës është elementi që i zgjoi shqiptarëve ndërgjegjen tyre nacionale, politike dhe shoqërore për të ndërtuar subjektin që do të ruaj edhe do t’u garantoj ekzistencën dhe jetëgjatësinë e identitare. Me lindjen e ndërgjegjësimit kombëtarë krijimi i shteti shqiptarë ishte qëllimi dhe vullneti i shoqërisë shqiptare për gjenerata të tëra. Për të ardhur deri tek periudha e pushtimit osman, periudhë kjo ku tek shqiptarët zgjohet vetëdija kombëtare dhe domosdoshmëria e ekzistencës së shtetit

⁷⁶ Shih më tepër: Historia e popullit shqiptar I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë/Instituti i Historisë, Tiranë, 2002, 39.

⁷⁷ Shih më tepër: Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane, Rilindja, Prishtinë, 1990; Oliver J Shmitt, Shqiptarët, Një histori midis Lindjes dhe Perëndimit, Guttenberg, Tiranë, 2012 41-48

⁷⁸ Historia e Popullit Shqiptarë, II, 35. Shih për citim edhe Historin e popullit I.

shqiptarë për të ruajtur dhe vazhduar veçantësinë kulturore, gjuhësore, historike e sociale të identitetit shqiptarë.

1. Rilindja Kombëtare

Shekulli XIX, për popullin shqiptarë shënon një epokë të re, atë të Rilindjes Kombëtare. Koha e zgjimit kombëtarë shqiptarët i gjen trevat shqiptare pjesë të Perandorisë Osmane. Trevat etnike shqiptare deri në vitin 1875 ishin të organizuara administrativisht në tri vilajete, pas këtij viti në katër vilajete, në Vilajetin e Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës. Vilajetet përbrenda tyre përfshinin edhe popullsi joshqiptare dhe ishin krijuar në atë mënyrë që popullata myslimane të jetë mbizotëruese e këtyre vilajeteve.⁷⁹ Shqiptarët zinin pozita të rëndësishme në kuadër të Perandorisë Osmane, në pozita drejtuese në funksionet e kryeministrave, ministrave, bejlerëve, guvernatorëve, ushtarakëve e të tjera.⁸⁰ Përveç kësaj në Perandorinë Osmane u zhvilluan edhe një elitë e shquar kulturore shqiptare e njerëzve që vepronin si edukatorë dhe mësues të vet sulltanit, të iç-ogllanëve jeniçerëve e të tjerë, si poet, arkitekt, shkrimtarë, kronistë në oborrin perandorak. Gjithashtu shtresa drejtuese në ekonomi dhe administratën civile e ushtarake ishin etnikisht shqiptare,⁸¹ duke e rritur kështu vazhdimisht autonominë nga qendra në drejtim të periferisë, deri sa arriti kulmin në fund të shekullit XVIII dhe në fillim të shekullit XIX në Pashallëkun e Shkodrës dhe Janinës.⁸² E tërë kjo autonomi e drejtuesve shqiptarë buronte së pari nga vet ndërtimi i Perandorisë, që bazohej në autonominë regjionale lokale, së dyti nga fuqia e saj si zotëruese e pasurive të shumta materiale dhe kulturore dhe së treti, nga shndërrimi në shkallë të gjerë i timareve⁸³ në çifligje.⁸⁴ Pra, përgjithësisht mund të themi se gjatë gjithë këtyre viteve mbizotëruan deri diku marrëdhënie të mira shqiptaro-osmane, apo siç theksonin Pashko Vasa dhe Sami Frashëri se shqiptarët deri në periudhën e tanzimatit qenë më të privilegjuar dhe deri në njëfarë mase me një respekt të ndërsjellë me osmanët, e deri në heqjen e të drejtave dhe fillimin e shtypjes së tyre.

⁷⁹ Nuray Bozbora, Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane, Dituria, Tiranë 2002, f. 115.

⁸⁰ Pashko Vasa, Vepra, 3, E vërteta për Shqipërinë dhe Shqiptarët, Rilindja, Prishtinë, 1989, 323; Sami Frashëri, Vepra 2, Shqipëria ç'ka qenë ç'është e ç'do të bëhet?, Rilindja, Prishtinë, 1987, 32-35;

⁸¹ Nuray Bozbora, 128.

⁸² Shih më tepër: Pashko Vasa, Vepra 3, 322-324; Sami Frashëri, Vepra 2, 32-35.

⁸³ Timaret ishin prona shtetërore, dmth me pushtimin e tokave nga pushteti osman, tokat shpalleshin pronë shtetërore me pronar supreme sulltanin. Dhe Timari i shndërruar në çiflig bëhej pronë private e çifligarit bashkë me të drejtën për ta trashëguar, shitur, blerë e etj., dhe nuk varej drejtpërdrejt nga sulltani sikurse timari.

⁸⁴ H. Feraj, 135.

Prishja e shqiptarëve me perandorinë filloi kah fillimi i shekullit XIX, atëherë kur Perandoria Osmane fillon të centralizoj pushtetin dhe t'u heq të drejtat komuniteteve përbrenda perandorisë dhe normalisht edhe shqiptarëve të cilët ishin të prirë dhe të përkushtuar drejt decentralizimit dhe autonomisë. Pra, zhvillimi i lëvizjeve kombëtare të shekullit XIX përkon me periudhën e reformave të para centralizuese, që filluan të ndërmerreshin në Perandorinë Osmane të viteve të 30. Porta e Lartë dëshironte ta dërgonte vendin në rrugën e evropianizimit duke forcuar pushtetin qendrorë, të rimëkëmbte fuqinë e Perandorisë e cila ishte dobësuar së tepërmi nga prapambetjet ekonomiko shoqërore, nga sistemi shtetërorë anakronik, thellësisht shtypës e parazitar, dhe nga kryengritjet e vazhdueshme të popujve të shtypur.⁸⁵ Pra, në këtë periudhë Porta e Lartë ndodhej nën presion të vazhdueshme edhe nga zhvillimet industriale që po i përjetonte Evropa. Kjo ndikonte shumë në çështjet e brendshme të perandorisë, në dobësimin e fuqisë ushtarake, në rënien ekonomike, gjithashtu nxiti pakënaqësinë e popujve joturq brenda perandorisë, të cilat më pas organizohen në kryengritjet dhe në lëvizje nacionalçlirimtare. Dhe të gjitha këto turbulenca që po ndodhnin përbrenda Perandorisë e dërguan atë që të ndërmarrë një sërë reformash për të përmirësuar gjendjen ekzistuese, kështu për të ardhur deri tek nisma më e rëndësishme, 'Reforma' që njihen me emrin 'Tanzimat'.⁸⁶ Me këto rregullime, reforma të ndërmarra Porta synonte të siguronte pasurinë dhe besimin e të gjitha shtresave pa dallime, "pa dallim etnie dhe feje", të lehtësonte çështjen e taksave fshatarësisë dhe të modernizonte administratën shtetërore që në vend të administratës së vjetër të vihej një e re duke pas model atë të shteteve evropiane. Reformat që ndërmori Porta e lartë gjatë viteve 40-ta në çështjet administrative, financiare, juridike, ushtarake dhe arsimore ishte goditje e tjetër për popujt brenda Perandorisë, të cilët ndikuan edhe më tej në ndërgjegjësimin dhe fuqizimin e lëvizjeve kombëtare të drejtuar kundër reformave të ndërmarra.

Kriza shoqërore dhe politike në të cilën kishte rënë Perandoria Osmane po bëhej më e vrazhdë dhe më acaruese ndaj popujve joturq, e posaçërisht për shqiptarët, kështu duke i shtypur pashallëqet e mëdha shqiptare dhe format e organizimit autonom të jetesës, goditja

⁸⁵ Historia e popullit shqiptar, II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë/Instituti i Historisë, Tiranë, 2002, 75; Nuray Bozborra, 119-127.

⁸⁶ Projekti i Reformave e njohur me emrin Tanzimat (Reforma, rregulla), u shpallën nga Mustafa Reshit Pasha me dekretin Perandorak (Hati Humajun) në 3 nëntorë 1839 me emrin "dekreti i Gjylhanesë". Historia e Popullit Shqiptarë, II, 76.

ndaj administratës shtetërore, gjegjësisht ndaj tërë nëpunësve civil, në çështjet e ushtrisë e të tjera. Pra, këto qëndrime të ndërmarra jo vetëm që nuk arritën t'i frenonin pakënaqësitë e shqiptarëve, por ato ndikuan në ndërgjegjësimin kombëtar të tyre. Kështu mund të themi që lëvizja nacionaliste shqiptare u parapri dhe u influencua nga këto rrethana të krijuara në Perandori, si dhënia fund pashallëqeve, kundërshtimi ndaj reformave të tanzimatit, planet shoviniste për copëtimin e tokave shqiptare, gjendja ndërkombëtare gjatë dhe pas luftës ruso osmanet (1877), ngritja e vetëdijes nacionale nga elita intelektuale shqiptare e të tjera (E. Sulstarova, H. Feraj, N. Clayer, N. Bozborra, M. Krasniqi, O. J. Schmitt e të tjerë). Këto dhe shkaqe tjera që çuan në lindjen e nacionalizmit shqiptarë që do t'i trajtojmë në vazhdim. Në përgjithësi ekziston një mendim i përbashkët i të gjithë studiuesve për shkaqet që çuan në lindjen e nacionalizmit shqiptarë, pavarësisht nëse ndonjëri nga shkaqet është më determinues se tjetri tek autorët e ndryshëm.

1.1 Reformat e “Tanzimatit” dhe fillet e ngritjes së vetëdijes kombëtare shqiptare

Ngritja e vetëdijes dhe fillimet e lëvizjes kombëtare përkojnë me këtë periudhë, respektivisht me reformat centralizuese që u ndërmorën nga Perandoria Osmane gjatë viteve të 30-ta. Porta e Lartë filloi t'i vë në jetë politikën centralizuese fillimisht përmes eliminimit të autonomive lokale dhe pashallëqeve të mëdha, kështu me forcën e armëve u eliminuan edhe pashallëqet shqiptare si ai i Ali Pashë i Janinës në vitin 1822 dhe në vitin 1831 ajo e familjes Bushatliu e cila sundonte në veriun e Shqipërisë.⁸⁷ Porta e Lartë ishte e përkushtuar në shpërbërjen e plotë dhe me mjete më të vrazhda shtresën drejtuese dhe të pabindur shqiptare, kështu edhe në vitin 1830 Mehmet Reshit Pasha vrau në pabesi të plotë në Manastir, mbi 500 përfaqësues të shtresës drejtuese, të cilët i kishte ftuar që të ndjekin një parakalim ushtarak të organizuar për nder të tyre.⁸⁸ Porta e Lartë veprroi me ashpërsi të paparë deri më atëherë ndaj prirjeve separatiste të shtresës drejtuese shqiptare. Kjo pakënaqësi që u shfaq tek të gjitha shtresat e shoqërisë ndaj masave të cekura më lartë do të shndërrohet në një lëvizje të madhe kryengritjeje pas shpalljes së Reformave të Tanzimatit.

⁸⁷ Nathalie Clayer, Në fillimet e nacionalizmit shqiptar, 143; Jusuf Buxhovi, Kosova Perandoria Osmane, Faik Konica, Prishtinë, 2015, f. 63.

⁸⁸ Nathalie Clayer, f. 144,

Reforma e Tanzimatit,⁸⁹ e cila u shpall dhe hyri në fuqi nga sulltani më 1839, rrezikoi edhe më shumë gjendjen e shtresës drejtuese dhe një numri të madh zyrtarësh që përfshiheshin në funksione të caktuara. Reformat e Tanzimatit apo siç e mbante emrin “dekreti i Gylhanesë”, i detyroi shqiptarët t’i nënshtroheshin administratës së huaj burokratike, sepse administrata e re përbëhej nga nëpunës të huaj që nuk e dinin gjuhën, zakonet, traditat e popullit shqiptarë dhe abuzonin, keqpërdornin pozitën që mbanin. Ardhja e nëpunësve të huaj joshqiptarë nga viset e ndryshme të Perandorisë për kryerjen e këtyre shërbimeve acaruan shumë popullsinë shqiptare. Reforma në shërbimin e ri ushtarak parashikonte çarmatimin e popullsisë dhe krijimin e ushtrisë së rregullt që zgjaste 4-5 vjet, ndërsa ai i rezervist (redifi) 7 vjet.⁹⁰ Ndryshimi i shërbimit ushtarak gjithashtu goditi popullsinë shqiptare sepse një numër i konsiderueshëm i tyre shërbenin në shërbimin ushtarak në nivel Perandorie, siç dihej deri në atë kohë ky shërbim ishte me pagesë kurse tani e tutje ky shërbim nuk paguhej. Një gjë shumë e rëndësishme që doli nga reformat e Tanzimatit ishte e drejta e kombësive të merrnin arsim në gjuhën amtare në shkollat publike, nga e drejt kjo që u privua pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare. Perandoria Osmane vijoi të barazonte kombin me fenë, kështu myslimanët e Perandorisë vazhdoi t’i quaj “turq”, në mesin e tyre edhe shqiptarët mysliman, ndërsa ortodoksët, qofshin këta shqiptarë, bullgarë, serbë apo vllah i quante “grek” apo “rumun” dhe ata i linte nën administrimin fetar e kulturorë të Patrikanës greke të Stambollit.⁹¹ Kësisoj, shqiptarët detyroheshin që arsimimin e tyre ta kishin sipas fesë së tyre turqisht, greqisht, italisht çka do të thotë se ata privoheshin nga gjëja me esenciale dhe elementi më unifikues që ata kishin, gjuhën shqipe. Një dekret shtesë që doli si plotësim për reformën më 1856, statusi i popullsisë jomuslimane barazohej me ato myslimane dhe kjo ishte shkas për fërkimet e reja mes bashkësive fetare.⁹² Përveç këtyre, ligjet e reja të njësuara për të gjithë perandorinë nuk përfillnin të drejtën vendore dhe zakonore, që shqiptarëve të të gjitha shtresave u dha arsye për të qenë të pakënaqur dhe kryengritës me gjendjen e krijuar. Në këtë mënyrë, si pasojë e këtyre reformave gjendja e shtresave të ulëta u keqësua edhe më tepër, si shkak i kalimit nga shoqëria agrare në shoqëri industriale, tokat e të cilëve u konfiskuan e u nxorën në shitje nga pushteti osman,

⁸⁹ Historia e Popullit Shqiptar, II, 76; Jusuf Buxhovi, Kosova Perandoria Osmane, Faik Konica, Prishtinë, 2015, 63-67; Noel Malcolm, 191-195; Nuray Bozboru, f. 119-126.

⁹⁰ Shih më tepër: Historia e popullit shqiptarë II. F. 75-77.

⁹¹ Shukri Rahimi, Gjurmime historike të Rilindjes Kombëtare, Rilindja, 1986, 69-70; Historia e popullit shqiptarë II, f. 78.

⁹² Noel Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, Koha, Prishtinë, 2001, f. 194.

ndërkaq numri shtresës së ulët nuk ishte i vogël në Shqipëri. Zhgënjimin dhe përçmimin e shqiptarëve në përgjithësi e përshkruan edhe Sami Frashëri duke thënë se “Sot Shqiptarëtë janë robër, të poshtuar’ e t’unjurë, të shkelur e të cpërnderë shumë më tepër se të tjerët kombe të Tyrqisë! Janë më të poshtërë nga Greqtë, nga Shpehtë, nga Armenëtë edhe nga Judhenjtë! Tyrqia ka ngritur besenë nga Shqiptarëtë, nuk’ i beson e i vështronsi anemik e si trathëtor, jo si shokë e si vllëzër, si i vështonte qëmoti.”⁹³

Pakënaqësitë ndaj reformave të ndërmarra përfshinin shtresat të ndryshme shoqërore dhe një numër të madh të popullsisë. Si refleksion ndaj këtyre reformave e tërë shoqëria shqiptare e u shndërrua në kryengritje të armatosur. Lufta bëhej për të përjashtuar zbatimin e politikave centraliste burokratike në viset shqiptare, njohjen e kombësisë shqiptare si kombësi më vete, trajtimin e veçantë të shqiptarëve në kuadër të Perandorisë, e të tjera. Në këtë kontekst, vlen të theksohet edhe kryengritja e Dervish Carës e viteve 1843-44, kur kryengritësit u referoheshin shembullit të organizimit të shteteve fqinje dhe shprehnin hapur pretendimin për autonominë e vendit.⁹⁴ Kryengritjet fillimisht kishin karakter lokal, mirëpo me kalimin kohës ato u përhapën dhe u bënë masive, të fuqishme duke përfshirë tërë vendin, si Prizrenin, Pejën, Gjakovën, Novobërdë, Shqipërinë Jugore, Shqipërinë e Mesme e të tjera.⁹⁵

Pra reformat filluan të interpretohet si sulm ndaj bashkësisë etnike shqiptare çka e bënte më me interes dhe të unifikuar kërkesën kundër Perandorisë. Përjetimi i reformave si sulm mbi baza etnike ndaj shqiptarëve, mobiliteti social dhe afirmimi i interesave të shtresave kryesore sociale të shoqërisë shqiptare, premisat historike dhe aktuale të afirmimit ndërmjet këtyre shtresave e bënin të nevojshme dhe të pranueshme idenë e kombit si ide përbashkuese dhe “kundër armikut të njëjtë”.⁹⁶ Kombi ishte në epiqendër të ligjëritimit dhe përbashkues i shtresave të ndryshme shoqërore për të dalë nga gjendja ekzistuese, sepse ky komunitet si komb meriton të trajtohet ndryshe dhe të ketë vëmendjen e sulltanit. Elita shqiptare, në kërkim të një tjetër burimi legjitimues prej nga mund të kundërshtonte reformat, krijoi hapësirat për futjen e konceptit të “kombit shqiptarë” si burim më i lartë i legjitimitetit (E. Sulstarova). Kryengritjet e shqiptarëve në këto periudha kohore dhe forma e

⁹³ Sami Frashëri, Vepra 2, f. 51.

⁹⁴ Historia e Popullit shqiptarë, II, 81.

⁹⁵ Oliver J. Schmitt, Shqiptarët një histori midis lindjes dhe perëndimit, K&B, Tiranë, 2012, f. 78.

⁹⁶ Hysamedin Feraj, 2010. F. 127.

artikulimit të kërkesave dëshmonin aspiratat e tyre si popull, që tashmë po hynin në periudhën e Rilindjes kombëtare me një vetëdije lartë politike dhe me ideale caktuara kombëtare. Artikulimi i kërkesave mbi të drejtat nacionale dhe politike (kërkesa për autonomi) shënojnë filltet e nacionalizmit shqiptarë, ku synohet përputhja e njësinë etnike-kulturore kombin, me njësinë politike shtetin.

1.2 Planet shoviniste për copëtimin e tokave shqiptare

Shkaqe tjera të rëndësishme që influencuan në lindjen e nacionalizmit shqiptarë janë edhe krijimi i shteteve kombëtare në Ballkan, si i grekëve dhe i serbëve. Krijimi i shteteve të pavarura në Ballkan shërbeu si “frymëzim” për krijimin edhe të shtetit shqiptar, e kjo posaçërisht pas planeve ekspansioniste të nacionalizmave Ballkanik serb dhe grek. Këto dy shtete mohonin ekzistencën e kombit shqiptarë dhe kishin plane për pushtimin e trojeve etnike shqiptare. Shteti grek dhe ai serb edhe pas pavarësisë akoma nuk kishin përfunduar bashkimin e tokave të tyre kombëtare. Kësisoj, një pjesë e territoreve greke dhe serbe ndodheshin akoma nën sundimin osman dhe krahas këtij synimi, qeveritë e shteteve përkatëse të frymëzuar nga ide shoviniste kishin shfaqur interes edhe për viset të banuara me shqiptarë. Kjo tashmë ishte shndërruar në interes themelorë të politikave të shteteve fqinje.

Kryeministri Grek J. Koleti e formuloi dhe e shpalli zyrtarisht programin politik ekspansionist, i cili hyri në histori me emrin “Megali Idea” më 1844 (Ideja e Madhe).⁹⁷ Sipas këtij programi, Greqia e Madhe përfshinte në kufijtë e sajë edhe tokat shqiptare, në fillim përbrenda kufijve të Greqisë përfshihej e gjithë Shqipëria, kurse pas viteve të 60-ta, caktohej si kufij verior herë lumi Drin, herë Shkumbini, ndërsa shovinistët më të moderuar e çonin atë deri në lumin Vjosë.⁹⁸ Po në këtë vit, Ministri i Punëve të Brendshme të Serbisë, Ilia Grashanini hartoi programin kombëtar-çlirimtar të Principatës Serbe, projekt ky për formimin e një shteti të fortë serb në Ballkan, e njohur me emërtimin “Naçertanije” (Skicë). Ky projekt do të vihej në themel të politikës serbe me pretekstin e çlirimit të tokave të sllavëve të jugut nga osmanët, kështu dhe synonin të krijonin një shtet të madh, që do të përtërinte perandorinë mesjetare të Stefan Dushanit. Përbrenda kësaj perandorie do të hynin edhe

⁹⁷ Historia e popullit shqiptarë, II, 102.

⁹⁸ Po aty, 103.

viset Shqipërisë së Veriut së bashku me Kosovën.⁹⁹ Gjithashtu edhe bullgarët bënë plane për ringjalljen e perandorisë së tyre mesjetare që do të përfshinte edhe vilajetin e Manastirit në këtë plan. Për realizimin e këtyre synimeve ndaj territorit të perandorisë shtetet ballkanike bashkërendonin veprimet e tyre, marrëveshja e parë e këtij lloji ishte ajo midis Greqisë dhe Serbisë që dokumentohej që në vitin 1860.¹⁰⁰ Elita politike shqiptare u ndien të rrezikuar nga këto projekte shoviniste të shteteve fqinje që parashihnin copëtimin, zhdukjen e viseve shqiptare dhe kështu kjo gjendje i bëri ata që të lëviznin dhe të organizoheshin politikisht për shpëtimin e tokave shqiptare.

Për rrezikun që i kanoseshin shqiptarëve nga fqinjët gjegjësisht nga fqinjët sllavë dhe grek flasin edhe Rilindësit, ku paralajmrojnë se kush janë armiqtë e shqiptarëve. Sami Frashëri në librin e tij Shqipëria çka qenë, ç'është e ç'do të bëhet? Në kapitullin "Reziqet e Shqipërisë", shkruan se "Tyrqit janë armikët' e Shqipërisë' e të shqiptarëve; edhe përpiqen, me sa u vjen nga dora ta humbasin kombërinë' e gjuhën e këtij kombi, të cilit edhe emnin duan t'ia grenë (zhdukin) fare. Greqia, Bullgaria e Serbia përpiqen ta humbasin' e ta ngrenë kobërinë shqiptare e gjuhën shqipe cilado nga ajo cop' e Shqipërisë, që ika rënë në pjesë të sajë ...".¹⁰¹ Gjithashtu në një memorandum drejtuar kontit Zih, Ambasadorë i Austro-Hungarisë pranë Portës së Lartë, Pashko Vasa shkruan se populli shqiptarë duke pas ndjenjë e vlerës së tij luftarake, me traditat e trimërive të saja dhe me krenarinë për kombërinë e vetë nuk mund t'i nënshtrohej sundimit të një shteti të vogël. "Greqia, Mali i Zi dhe Serbia janë shtete tepër të vogla që të mund të pretendojnë aneksimin e Shqipërisë. Ndërgjegjja e popullit shqiptar ngre krye kundër idesë së nënshtimit ...".¹⁰²

Ndërtuesit e ndërgjegjes kombëtare dhe të nacionalizmit shqiptarë kanë evidentuar rreziqet potenciale që i kanoseshin popullit shqiptarë, dhe se duhet të jenë të vëmendshëm në orientimet e tyre politike, kështu duke e zgjedhur strategjinë politike me të keqën më të vogël dhe rrezikun më të vogël për popullin shqiptarë. Projektet antishqiptare kanë shërbyer në rritjen e ndërgjegjes kombëtare shqiptare, e posaçërisht mëvetësinë e shqiptarëve si "popull historik". Ideologët e lëvizjes kombëtare e orientuan ligjërimin e tyre politik kundër

⁹⁹ Petrit Imami, Serbët dhe Shqiptarët ndër shekuj, Vëllimi I, Samizdat B92, Beograd, 2017, 204. Historia e popullit shqiptarë, II, 102.

¹⁰⁰ Enis Sulstarova, 2003, 30

¹⁰¹ Sami Frashëri, Vepra 2, 1987, f.59.

¹⁰² Pashko Vasa, Vepra 3, 1989, f. 356.

përpyjekjeve “panslaviste” dhe “panheleniste”, dhe duke vënë kështu theksin në identitetin kombëtarë dhe kombin si një më vete. Ai si i tillë kishte një rrugë të veçanta të formimit historik që e dërgonte në mëvetësinë tij kulturore dhe politike. Shqiptarët në këtë periudhë ishin të angazhuar kundër rrymave shoviniste, që të mos lejonin copëtimin e Shqipërisë dhe njëkohësisht të fokusuar në ndërtimin e platformës për bashkimin e tokave shqiptare.

1.3 Gjendja ndërkombëtare dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit

Periudha pas luftës ruso-osmane më 1877, sjell firmosjen e Traktatit të Shën Stefanit, sipas të cilit territoret osmane në Ballkan ndaheshin midis shteteve ballkanike duke e mohuar kështu tërësisht ekzistencën e kombit shqiptarë.¹⁰³ Rusia me këtë traktat kishte për qëllim krijimin e Bullgarisë së Madhe për të ruajtur ndikim e vet, si dhe duke formuar një Mal të Zi e një Serbi të madhe të vendoste sundimin mbi ngushticat dhe në këtë formë të dëbonte edhe Austro-Hungarinë nga Ballkani. Pas botimit të traktatit të Shën Stefanit të gjitha lëvizjet shqiptare filluan të kishin një karakter më nacionalistë, sepse vihej në pikëpyetje qenësia e tyre. Kështu takimet mes shqiptarëve u intensifikuan dhe reagimet ishin të shpejta që u manifestuan edhe me protesta të shumta ndaj fuqive të mëdha.¹⁰⁴ Gjithashtu dhe fuqitë e tjera evropiane protestuan kundër traktatit dhe organizuan Kongresin e Berlinit për rishikimin e vendimeve të tij.

Ndërkohë patriotët shqiptarë nga rreziku i copëtimin të tokave shqiptare bëheshin gjithnjë e më shumë të vetëdijshëm për nevojën e veprimit të përbashkët. Ata u mbledhën në Prizren për të formuar një lidhje ushtarake dhe politike për mbrojtjen e territoreve shqiptare, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (10 qershor, 1878). Lidhja shënoi fillimin e një periudhe të re të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Asaj i paraprinë edhe dy lëvizje të rëndësishme që quheshin komitete, Komiteti i Shkodrës, që po merrte përsipër organizimin për rezistencën kundër depërtimit të ushtrisë malaziase dhe në Stamboll një grup patriotësh shqiptarë formuan “Komitetin Qendrorë për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombit Shqiptar”. Udhëheqës i këtij “Komunitetit të Stambollit” u zgjodh Abdyl Frashëri që së bashku me krerët në Prizren miratuan programin politik që bënte thirrje për bashkimin e të gjitha tokave shqiptare në

¹⁰³ Kristaq Prifti, Koncepti i Lidhjes së Prizrenit për shtetin kombëtar shqiptar (1878-1881), Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe vendi i sajë në histori, Konferencë shkencore kushtuar 125 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, mbajtur më 9-10 Qershor 2003 Prizren, Instituti i historisë, Prishtinë, 2008, f. 21.

¹⁰⁴ Rreth reagimit shqiptar ndaj traktatit të Shën Stefanit shih më tepër: Stavro Skendi, Zgjidhja Kombëtare Shqiptare, Phoenix, Tiranë, pvb, f. 43-35.

një vilajet të vetëm dhe autonom, ku shqiptarët do të gëzonin të drejta politik, kulturore dhe ekonomike.¹⁰⁵ Nëse Kongresi i Berlinit do të vendoste t'u jepte territore shqiptare fqinjëve ata do t'i përgjigjeshin me gjuhën e luftës dhe do të luftonin deri në njeriun e fundit për të mbrojtur tokat shqiptare. Gjithashtu anëtarët e lidhjes së Prizrenit ishin dakord për çështjen e autonomisë, nevojën e bashkimit administrativ të mbarë viseve shqiptare në një vilajeti autonom shqiptarë.¹⁰⁶

Mirëpo, anëtarët e Lidhjes nuk arritën mirëkuptim për rrugët të cilët duheshin ndjekur për të arritur qëllimin, kështu ndaheshin në dy krahë; të "moderuarit" dhe "radikalët". Të parët kërkonin që kjo të bëhej pa iu kundërvënë sulltanit, kurse radikalët të kryesuar nga Abdyl Frashëri ishin të vendosur ta realizonin autonominë me çdo kusht dhe se lidhja duhet të përgatitet për të luftuar, jo vetëm kundër shteteve shoviniste fqinje, por edhe kundër Perandorisë Osmane.¹⁰⁷ Këtë dilemë të patriotëve shqiptarë e thekson edhe historiani G. Castellan se shqiptarët ishin në dilemë të angazhoheshin kundër Perandorisë Osmane përkrah popujve të krishterë, që mohonin ekzistencën e një kombësie shqiptare, ose të rreshtoheshin nën flamurin e sulltanit për të marrë prej tij si shëlbim njohjen e kombësisë.¹⁰⁸ Nacionalistët shqiptarë vendosën për të parën, gjegjësisht jo luftë të armatosur kundër Perandorisë Osmane, por kundër sllavëve dhe grekëve. Kjo zgjedhje ka pasur motiv të qartë etnik dhe jo "fanatizëm turkoman" (Castellan), ka qenë e vetëdijshme dhe është konceptuar si sakrificë për hir të kombit. Nacionalistët shqiptarë ishin të vetëdijshëm se lufta kundër të gjithë armiqve nënkuptonte luftë kundër Serbisë, Malit të Zi, Greqisë dhe Perandorisë, gjithashtu kjo duhej llogaritur se po "shpallnim luftë" edhe Fuqive të Mëdha që ishin për ruajtjen e statu-quosë së Perandorinë Osmane në Ballkan, ndërsa dhe Rusia ishte nën mbrojtjen e Malit të Zi, Serbisë, kurse Anglia e deri diku edhe Rusia nën mbrojtjen e Greqisë.¹⁰⁹ Në një artikull për "Mesager de Wienne" Abdyl Frashëri i jepte një kuptim të gjerë autonomisë, ai theksonte se "udhëheqësit e Lidhjes e shikonin shtetin autonom si një periudhë kalimtare drejt pavarësisë dhe shkëputjes së plotë të Shqipërisë nga Perandoria Osmane. Ky nuk ishte shembulli i vetëm, ngase praktika ndërkombëtare e

¹⁰⁵ Enis Sulstarova, *Ligjërimi Nacionalist në Shqipëri*, 2003, 31; Stavro Skendi, *Zgjidhjet Kombëtare Shqiptare*, f. 44,45, 46.

¹⁰⁶ *Historia e popullit shqiptarë*, II, f. 151.

¹⁰⁷ *Historia e popullit shqiptarë*, II, f. 150.

¹⁰⁸ George Castellan, *Historia e Ballkanit*, Çabej, Tiranë, f. 381.

¹⁰⁹ Hysamedin Feraj, *Skica e mendimit politik shqiptar*, f. 145-146.

sidomos ajo ballkanike kishte provuar se nëpër këtë rrugë patën kaluar edhe Rumunia (e ndarë më parë nga dy provincat autonome), Serbia, Mali i Zi, Bullgaria ose edhe Egjipti në Afrikë, të cilët në fillim fituan statusin e autonomisë, të shteteve vasale nën sovranitetin e sulltanit, për të kaluar më pas në shpalljen e pavarësisë së plotë.”¹¹⁰

Në Kongresin e Berlinit (1878) nuk u dëgjuan kërkesat e shqiptarëve dhe nën presionin e Fuqive të Mëdha Shqipëria nuk i shpëtoi cungimeve të territorit, vendimi për aneksimin e territorit në veri nga Mali i Zi (qytetin e Ulqinit), dhe korrigjimi i propozuar i kufirit në jug me Greqinë, u bë shqetësim i shqiptarëve, vendime këto që do të sfidoheshin me armë nga Lidhja shqiptare. Të zemëruar me këtë veprim, krahu radikal i Lidhjes të kryesuar nga Abdyl Frashëri, pasi morën në dorë drejtimin e organizatës, pra futën nën “kontroll” Lidhjen, shpallën një qeveri provizore që synonte zëvendësimin e sundimit Osman në katër vilajete. Perandoria Osmane e pakënaqur me këtë vendim të Lidhjes dërgoi një ushtri të tërë dhe okupoi Prizrenin dhe shpërndau ushtarakisht Lidhjen e Prizrenit, një numër i madh i anëtarëve iu kaluan gjyqit ndër ta edhe Abdyl Frashëri që u dënua me vdekje, por pastaj u fal dhe u lirua pas tre vjet burgimi.¹¹¹

Lidhja e Prizrenit ishte e para organizatë me karakter mbarë kombëtar, në të cilën morën pjesë të gjitha krahinat e Shqipërisë. Lidhja Shqiptare e Prizrenit në formën e vet të plotë dhe me elementet e rëndësishme politike dhe sociale që ajo ngërthen në vete, dëshmon ekzistencën dhe gjitha karakteristikat e një kombi, dhe me të drejtë kjo periudhë thirret me emrin Lëvizja Kombëtare Shqiptare apo Rilindje Kombëtare. Lëvizja Kombëtare e cila aktivitetin e vet e kulmoi me Lidhjen e Prizrenit hedh një hap të madh në ndërtimin e platformës ideologjike kombëtare, ajo shprehu kombin shqiptarë si një dhe të pandarë, paraqiti mbrojtjen territoriale të atdheut dhe parashtri vullnetin e palëkundur tashmë për formimin e një shteti shqiptar autonom. Lidhja Shqiptare e Prizrenit mbetet ngjarja më e

¹¹⁰ Shqipëria, e bashkuar si një vilajet i vetëm, do të kishte një status ndërkombëtar edhe pse të kufizuar, do të ishte autonome brenda territorit të vet, por e varur në marrëdhëniet me jashtë, që do të mbeteshin si më parë, kompetenca të Portës së Lartë. Megjithëse nën sovranitetin e sulltanit, Shqipëria do të gëzonte një autonomi të gjerë administrative-shtetërore, të gjitha atributet e një organizmi shtetërorë: do të kishte nënpunës civil dhe ushtarak shqiptar, shkolla në gjuhën shqipe, organe të veçanta legjislative dhe ekzekutive, forcat e saja ushtarake, kryeqendrën administrative dhe politike, buxhetin e vet që do të përdorej për zhvillim arsimor dhe ekonomik të Shqipërisë. Shih më tepër: Kristaq Prifti, Koncepti i Lidhjes së Prizrenit për shtetin kombëtar shqiptar (1878-1881), Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe vendi i sajë në histori, Konferencë shkencore kushtuar 125 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, mbajtur më 9-10 Qershor 2003 Prizren, Instituti i historisë, Prishtinë, 2008, f. 23.

¹¹¹ Shih më tepër: Noel Malcolm, f. 233-235.

madhe politike e organizimit politik për shqiptarët në përgjithësi, ajo njëherit vendosi gurë themelin e nacionalizmit shqiptarë në arenën ndërkombëtare. Ideja e Lidhjes së Prizrenit do të frymëzoj mendimin politik shqiptar deri në ditët tona, kështu duke e shpallur atë projekt akoma të pa papërfunduar dhe akoma aktual në jetën kombëtare shtetërore të shqiptarëve.

Lidhja e Prizrenit gjithmonë shërbeu dhe akoma shërben si pikë referimi për të gjithë nacionalistët shqiptarë. Mund të themi se edhe pas shpartallimit fizik të Lidhjes ajo vazhdoi punën e sajë, fryma dhe ideali i sajë i ndërtuar nga Rilindasit vazhduan me akte dhe ngjarje të rëndësishme politike të më vonshme, kështu mund të përmendim Lidhjen e Pejës (1896) e cila rishtroi programin politik në harmoni të plotë me atë të Lidhjes së Prizrenit. Gjithashtu në të njëjtën linjë ligjërimi ishin edhe Kongresi i Manastirit (1908) dhe Kongresi i Elbasanit (1908), ku u bë njësimin gjuhësorë me zyrtarizimin e alfabetit shqip me shkronja latine, me ç'rast iu dha një zhvillim të madh gjuhës shqipe, shkollave dhe botimeve shqipe si dhe akteve të tjera me karakter politik, ekonomik dhe kulturorë. Qëndrimet për ruajtjen dhe mos copëtimin e territoreve shqiptare, gjegjësisht bashkimin e trojeve shqiptare në një autonomi u parashtrua edhe në Kryengritjet e viteve 1909-1912, kështu deri në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë më 1912. Ideali i Rilindjes Kombëtare nuk përfundoi me shpalljen e Pavarësisë së Shtetit Shqiptarë, ai vazhdoi t'i frymëzoj dhe më tej nacionalistët shqiptarë në përpjekje për të jetësuar idenë fillestare, pra atë të bashkimin e trojeve shqiptare në një njësi politike.

2. Ligjërimi nacionalist

Lidhja Shqiptare e Prizrenit si lëvizje mbarëkombëtare hapi një proces të pandalshëm politik që edhe pas disfatës së saj nacionalistët shqiptarë vazhduan veprimtarinë e tyre. Rilindësit e kuptuan se tani kishte marr fund përkohësisht periudha e sulmit të drejtpërdrejtë ndaj Perandorisë Osmane dhe kishte filluar një periudhë e re e grumbullimit të forcave. Pra, Lëvizja vazhdoi, por tashmë në planin kulturor-arsimor. Rilindasit veprimtarinë e tyre e vazhdonin me botimin e letrave shqipe, librave, gazetave dhe afisheve të ndryshme që të ngrinin në shkallë më të lartë ndërgjegjen atdhetare të masave popullore. Ata punën e tyre e organizonin edhe me shoqata të ndryshme kulturore, të cilat një numër i madh i tyre u themelua pas Lidhjes së Prizrenit. Ato u themeluan kryesisht në emigracion, në kolonitë shqiptare në mërgim si në Turqi, Rumani, Bullgari, Itali, Egjipt, Amerikë e të tjera. Këtu vlen të përmendet një shoqërie kulturore e rëndësishme e cila do të organizoj botimin e një sërë

veprash mbi çështjen nacionale, si “Shoqëria e të Shtypurit Shkronja Shqip” në vitin 1879 në Stamboll, anëtarët e së cilës ishin Sami Frashëri, Naim Frashëri, Pashko Vasa e të tjerë. Tashmë, veprimtaria politike e nacionalistëve shqiptarë ishte kryesisht e fokusuar në botimin e letrave shqipe edhe pse me raste shpërthenin edhe kryengritje lokale në ndonjë prej qyteteve të Shqipërisë. Në vazhdim do të shqyrtojmë disa mendime dhe vepra të Rilindësve të cilët konsiderohen ndër më të rëndësishmet në ndërtimin e ligjërimit nacionalist shqiptarë gjatë Rilindjes Kombëtare, si nga Sami Frashëri, Pashko Vasa, Naim Frashëri, Naum Veqilharxhi, Abdyl Frashëri, Thimi Mitko e të tjerë.

2.1 Kombi në epiqendër të ligjërimit nga Rilindësit

Elita intelektuale shqiptare që po lindte në këtë periudhë u bënë bartësit kryesorë të Rilindjes Kombëtare. Kjo elitë përpunoi idenë e kombit si vlera më e lartë ekzistuese, si element që përcakton identitetin më të lartë, njëkohësisht të bënë të dallueshëm dhe të ndryshëm nga kombet e tjera. Përcaktimi i kombit në epiqendër të ligjërimit ndërtoi lëvizjen politike dhe kulturore nacionaliste.

Naum Veqilharxhi, të cilin historiografia shqiptare e njeh si ndër ideologët e parë të Rilindjes Kombëtare, thekson se kombi shqiptarë është krijuar në të njëjtën kohë me kombet e tjera dhe zë një vend të caktuar në tokë, ka karakter të veçantë, gjuhë zakone të veçanta, shekujt e tij mitologjik, heroikë, politikë dhe ruan në gjirin e tij një thesar të madh kulturorë. Ai thoshte se “Asnjë komb nuk ka rënë nga qielli”, “... shoqëria, bashkëpunimi e ka bërë njeriun”, duke aluduar në atë se kombet duhet të ndihmohen për t’u bërë dhe për të fituar ndërgjegjen që të zhvillohen me tej, sepse ai këtë e konsideronte si borxh ndaj vendlindjes, “një borxh ndaj vendlindjes”¹¹² Njeriu është i obliguar të vejë kombin para çdo gjëje tjetër, para çdo identiteti tjetër dhe vetëm në këtë formë mund ta nxjerrim nga gjendja e turpshme e mjerimit sepse një gjë të tillë ua kemi borxh vend lindjes tonë. Sipas tij, faktori vendimtar për nxjerrjen e vendit tonë nga kjo gjendje është përhapja e arsimit dhe kulturës në gjuhën amtare. Veqilharxhi, si fazë të parë të suksesit të lëvizjes nacionalçlirimtare përcaktoi ndërgjegjësimin e masave të gjera popullore me anë të arsimit dhe si fazë të dytë luftën e armatosur, veprimtarinë e tij e intensifikoi veçanërisht në

¹¹² Historia e Popullit Shqiptar, II, f. 100.

zhvillimin e gjuhës dhe letërsinë shqipe.¹¹³ Vepra e tij përbën një nga përpjekjet e para për një alfabet origjinal të shqipes, botuar për herë të parë më 1844 dhe u ribotua më 1845, me emrin “Evetar”.¹¹⁴ Veqilharxhi mendonte se vetëm përmes emancipimit arsimor dhe kulturor mund të formojmë identitetin kombëtar i cili ka karakteristika të veçanta gjuhësore, historike e kulturore me kombet e tjera. Kontribut të rëndësishëm gjatë kësaj periudhe në përhapjen e arsimit, kulturës dhe gjuhës shqipe ka dhënë edhe Konstandin Kristoforidhi me përkthime të veprave të rëndësishme fetare në gjuhën shqipe, si “Dhjata e re”, hartimin e një fjalori në gjuhën shqipe dhe mbi të gjitha botimin e abetares për të dy dialektet toskërisht dhe gegërisht.¹¹⁵ Ai bëri një punë të rëndësishme në pasurimin e gjuhës së shkruar dhe ndihmoi shumë në afrimin e dy dialekteve kryesore të shqipes. Gjithashtu përkthimet e tija ishin të rëndësishme, sidomos ato fetare, duke i shkëputur ortodoksët shqiptarë nga propaganda panheleniste mbi pretendimet e tyre se shqipja është një gjuhë e varfër dhe nuk mund të bëhet gjuhë kulturore.

Një ideolog tjetër i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare Sami Frashëri, në veprën e tij “Shqipria ç’ka qenë, ç’është e çdo të bëhet”, e vendos kombin ndër gjërat më të rëndësishme dhe më të dashura për njeriun, “Për njerinë në këtë jetë s’ka gjë më dashurë se kombëria. Çdo njeri, sikundër do t’an e t’ëmënë edhe vendin, tek ka lindur e është riturë, ashtu e do edhe kombin’ e ti.” Dashuria ndaj nënës dhe vendit ku je lindur është dashuri e natyrshme, diçka që vjen me ardhjen e njeriut në jetë, kështu sipas Samiut duhet të jetë edhe dashuria ndaj kombit. Kjo nënkupton se dashuria për kombin duhet të jetë në mesin e gjërave më të rëndësishme, më me vlerë për njeriun në jetën e tij. Në të kundërtën “Ay që s’do kombin e mëmëdhen’ e ti, është tradhëtor e i lik; i tilli s’munt të quhet njeri”, kështu nuk ka gjë më të ulët dhe të poshtër se sa ai që tradhton kombin e tij, për më tepër ai nuk mund të quhet as njeri. Por, asgjë më të përnaltësuar dhe më të shenjtë se sa dashuria ndaj kombit nuk ka për Sami Frashërin, madje shqiptari i vërtetë është në gjendje të sakrifikojë edhe gjënë më të shenjtë që ai posedon, jetën për kombin e tij. Pra Samiu shkruan se “Shqiptar’ i vërtetë vritet për kombërit të ti edhe s’mund kurrë të durojnë e të dëgjojnë njeri

¹¹³ Nuray Bozbora, 2002, f.137.

¹¹⁴ Nuray Bozbora, 202, f. 137, 201; Enis sulstarova, 2015, f. 146.

¹¹⁵ Historia e Popullit Shqiptar, 129; Nuray Bozbora, 2002, f. 139.

që t'i shajné shqiptarinë".¹¹⁶ Për Samiun kombi shndërrohet në elementin më legjitimues dhe përbashkues ndër shqiptarët e shekullit XIX.

Në këtë kontekst mund të përmendim edhe veprimtarinë e gjerë të rilindësit Naim Frashëri, vepra e të cilit u bë frymëzim dhe ndërgjegjësim për masat dhe elitat shqiptare të kohës. Në këtë kontekst, poema "Bagëti e bujqësi", ku autori i shkruan atdheun, krenarisë kombëtare dhe bukurisë së natyrës shqiptare, shpreh ndjenjat e tija patriotike dhe glorifikon gjithçka që është e Shqipërisë. Me një përshkrim të hollësishëm për natyrën ai ka për qëllim të shquaj bukurit e atdheut që të krijoj lidhje shpirtërore ndërmjet njeriut dhe atdheut të tij.¹¹⁷ Apostrofimi i maleve, fushave, bagëtisë e bujqësisë së Shqipërisë nënkupton veçantësinë e sajë si atdhe dhe se është përkatësia kombëtare ajo që u jep kuptim gjërave dhe jo e kundërta. Ajo ç'far e bën poemën të dashur dhe frymëzuese edhe për ne sot, është ndjenja e krenarisë që të jep të qenit komb shqiptar, krenaria për emrin shqiptar, "*Ti Shqipëri, më ep nder, më ep emrin shqiptar / zemrën ti ma gatove plot me dëshirë e me zjarr.*"¹¹⁸ Gjithashtu, edhe në vjershën "*Atdheu*", Naimi e përkufizon në një mënyrë të veçantë kuptimin e atdheut dhe rëndësinë që ka ai në jetën e njeriut. Ai shkruan, "*O Atdhe! më je i dashur sa më s'ka, / Më je nënë, më je motër, më je vëlla. / Nga çka rrotull më i shtrenjti ti më je, / Je më i miri nga çdo gjë që ka ky dhe .../ Nëna ime vdiq, ndaj ty të kam sot nënë, / Nëna që s'ke vdekje kurrë, faqehënë.*"¹¹⁹ Koncepti i atdheut si dashuria më e lartë që njeriu duhet të posedoj në jetën e tij, ka të bëjë me ndërgjegjësimin e popullit shqiptarë për kombin dhe Shqipërinë si atdheun e vetëm të tyre. Kjo formë e qasjes ishte në koherencë me ecurinë e romantizmit evropian, nga i cili u ndikua përgjithësisht krijimtaria e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, pavarësisht prej disa dallimeve për vet kushtet ku vepronin rilindasit.

Karakteristik e të gjithë nacionalistëve shqiptarë ishte lidhja e kombit shqiptarë me gjuhën. Tek Naimi nocionin komb e gjejmë të mbërthyer me nocionin gjuhë. Ai e shikon gjuhën, para se gjithash prej këndit kombëtarë. Sipas pikëpamjeve të tij, gjuha nuk mund të çmohet vetëm si një mjet i marrëveshjes ndërmjet njerëzve, sepse, po të çmohej vetëm ashtu, do të mbetej e panjohur natyra e saj etnike.¹²⁰ Gjuhën shqipe për Naimin nënkupton prirja për një

¹¹⁶ Sami Frashëri, Vepra 2, f. 53-55.

¹¹⁷ Shih më tepër: Rexhep Qosja, Porosia e Madhe, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 220.

¹¹⁸ Naim Frashëri, Vepra 1, Rilindja, Prishtinë, 1986, f. 119.

¹¹⁹ Po aty, f. 102.

¹²⁰ Shih më tepër: Rexhep Qosja, Porosia e madhe, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 417.

zhvillimi të mëvetësishëm kulturor të një kombi që e dallonte veten nga të tjerët. Ai këtë e shpreh në poemën e tija për gjuhën, gjuha jonë: *“Të shkruajm gjuhën tonë / kombin të ndritojmë, / / Pa shihni ç’gjuhë e mirë! / Sa shijë ka e hije, / ç’e bukur edhe e lirë, /si gjuhë Perëndije”*.¹²¹ Gjuha shqipe përkundër dallimeve dialektore që kishte përbënte elementin me përbashkues të popullit shqiptarë. Kjo i bënte të ndryshëm shqiptarët nga “të tjerët” edhe pse mund të kishin ndonjë traditë, zakon apo gjëra tjera të ngjashme. Rëndësi të veçantë gjuhës i jep edhe Sami Frashëri, duke e përkufizuar atë si gjënë që e mbanë kombin, “Me se mbahet kombëri’ e një kombi? Më parë me gjuhët të ti. Sikundër thamë edhe më sipër, gjuha është m’e par’ e m’e madhe shënj’ e një kombërije.”¹²² Gjithashtu, Ai shkruan se “Gjuha shqipe duhet të jetë një dhe e pandarë pikërisht ashtu siç duhet të jetë edhe Shqipëria”,¹²³ pra duke e barazvlerësuar gjuhën me Shqipërinë si një dhe të pandashme. Samiu me veprat si “abetarja e gjuhës shqipe”, “shkronjtorja e gjuhës shqipe”, dhe të tjera i jep gjithçka gjuhës shqipe që i duhej për t’u bërë një gjuhë e shkruar, një gjuhë e shkollës, kurse shqiptarëve një mjet më të fuqishëm për t’u afirmuar si komb dhe për ta ngritur më lart ndërgjegjen kombëtare. Rilindasit ishin të vetëdijshëm për rendësin e gjuhës si elementin më të rëndësishëm identitarë dhe kulturorë për ndërtimin e një kombi, kështu kjo i mobilizoi ata në rrugën e forcimit të mësimin të gjuhës shqipe. Pra, çështja e gjuhës ishte shumë e rëndësishme për shqiptarët, sepse me përqendrimin e tyre në gjuhë u bënë populli i vetëm “transfetarë” i Ballkanit dhe i vetmi me identitet të krijuar vetëm mbi bazën e gjuhës. Tek shqiptarët, është gjuha ajo që u etnicizua në vend të fesë, sikurse të ishte një ideologji të vërtetë kombëtare, dhe tani e tutje ashtu siç thoshte edhe Pashko Vasa “feja” e shqiptarëve do të jetë “shqiptaria”.

Identiteti kombëtar shqiptarë ngadhënjeu mbi të gjitha dallimet ekzistuese, posaçërisht ndaj identitetit fetarë. Nacionalistët shqiptarë identitetin kombëtarë e shihnin mbi identitetet fetare, sepse në të kundërtën, nëse shqiptarët do të nxjerrin identitetin fetarë si parësorë atëherë rrezikohej ekzistenca e kombit shqiptarë ngase dihet se shqiptarët i përkisnin tri besimeve, besimit mysliman, katolik dhe ortodoks. Në këtë kontekst shqiptarët e besimit mysliman do të prireshin të identifikoheshin me osmanët kurse shqiptarët ortodoks me grekët. Rilindasit përcaktonin konceptin komb si element të veçantë dhe unitarë të

¹²¹ Naim Frashëri, Vepra 1, Rilindja, Pristinë, 1986, f. 186.

¹²² Ndrëcim Kulla, Antologji e mendimit shqiptar 1870-1945, Plejad, Tiranë, 2003, f. 67.

¹²³ Stavro Skendi, Zgjidhimi Komëtar Shqiptar 1878-1912, Phoenix&Shtëpia e Komunikimit, Tiranë, 2000, f. 117.

domosdoshëm për ekzistencën e shqiptarizmës, pra kombi ishte mbulues dhe më i ngritur kundrejt identiteteve tjera. Këtu vjen në shprehje qëndrimi apo parulla e famshme e rilindësit i Pashko Vasa për Rilindjen Kombëtare, se: “*Mos shikoni kisha e xhamia / Fe e Shqyptarit asht shqiptaria*”.¹²⁴

Abdyl Frashëri shkruante se shqiptarët kanë pasur kulturën e tyre të veçantë qysh në kohët parahistorike; ata u kanë qëndruar besnik, deri në njëfarë shkalle, traditave të lashta pasi përqaftuan jo vetëm krishterimin por edhe islamizmin. Në Shqipëri dallimet fetare, nuk kanë ndonjë rëndësi përballë dallimeve shoqërore. Shoqëria shqiptare karakterizohej, sipas tij nga ndarja në krerë e në popull dhe jo nga ndarja në mysliman e krishterë.¹²⁵ Në këtë diskutim është e rëndësishme të përmendim qëndrimin e Sami Frashërit kundrejt idesë së Jeronim De Radës për një konfederatë të tre shteteve: një Shqipëri katolike, një Shqipëri ortodokse dhe një Shqipëri myslimane. Ai e hedh poshtë kategorikisht idenë e De Radës duke vendosur mbi parimin e kombësisë, se përkatësia kombëtare ishte më e rëndësishme se ajo fetare, gjithashtu ai nuk e shihte nevojën e ngjitjes në front të një princi të krishterë apo mysliman, sepse mendonte se duhej vendosur një lloj demokracie e të urtëve.¹²⁶ Samiu ngul këmbë se ndarja e Shqipërisë sipas feve është një sajim i armiqve të Shqipërisë, një diçka artificiale që nuk pajtohet as me interesat e Shqipërisë, as me gjendjen reale. Çështja e fesë është çështje e ndërjegjes së secilit, dhe se ajo nuk duhet të përzihet me kombësinë. Këtë parim Sami Frashëri e shprehte edhe në nivele të tjera, duke i dhënë epërsi të rëndësishme përhapjes së mësimin në gjuhën vendase, duke dashur ta ngrisë atë në nivelin e gjuhëve letrare. N. Clayer përmendë polemikën që Samiu kishte me gazetën *Mizan* dhe *Sabah* më 1890, i cili nuk dëshironte të përdorej shprehja “myslimanët shqiptarë”, po vetëm ajo mysliman, sepse fjala “mysliman” dhe “shqiptarë” nuk ishin sinonime, të gjithë shqiptarët nuk ishin mysliman dhe jo të gjithë myslimanët ishin shqiptarë. Duke shkuar edhe më tej sipas N. Clayer, Sami Frashëri ishte ai që futi, ose më së miri që popullarizoi fjalën *komb* në dialektin tosk dhe *kom* në dialektin geg, për të treguar kombin në gjuhën shqipe.¹²⁷

Në këtë kontekst, nacionalistët shqiptarë mohuan edhe ndarjen fisnore/krahinore që ato të ishin shkaktar për konflikte mes shqiptarëve. Pashko Vasa shkruante se “Populli shqiptarë

¹²⁴ Shih: Pashko Vasa, *Poezia, O moj Shqypni, e mjera Shqypni*.

¹²⁵ Historia e popullit shqiptarë, II, 209.

¹²⁶ Shih: Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar, Botimet përpjekja, Tiranë, 2009, f. 244-260.*

¹²⁷ Shih: Nathalie Clayer, 253-254.

ndahet në dy familje të mëdha: Gegëri dhe Toskëri; e para quhet Shqipëri e lartë dhe tjetra Shqipëri e poshtme”.¹²⁸ Ndasitë fisnore shiheshin si diçka e natyrshme nga rilindësit, dhe kështu në mënyrë të vazhdueshme tërhiqnin vërejtjen që këto dallime të thjeshta mos të jenë vija ndarëse mes tyre. Përpos Pashko Vasës edhe rilindas të tjerë mohuan apo punuan për afrimin e dialekteve shqiptare, këtu mund të përmendim edhe Naim Frashërin, ku thoshte se “Gegë e Toskë janë emra vendi e mënyrë e të folurit e dy vllazërve, është një sikur themi Shkodra e Dibran, e Gorar e Lap e Cam, e Hasan, a Perikli a Dhimosten”.¹²⁹ Rilindësit nuk lejuan që të triumfojnë platformat krahinore dhe fetare mbi identitetin kombëtarë ngase rreziku i përçarjes ishte evident dhe kjo do të ndikonte në jounitetin e shqiptarëve që njëherit ishte interes i fqinjëve dhe të gjithë armiqve të kombit shqiptarë. Parulla e famshme e Pashko Vasës se “Feja e shqiptarit është shqiptaria” u përbrendësua mjeshtërisht nga elita politike shqiptare e asaj kohe, me qëllim të tejkalimit të përçarjeve të mundshëm mbi baza fetare. Kështu, ndërtimi i unitetit të brendshëm të shqiptarëve mbi konceptin e gjuhës, kulturës, kujtesës historike, me kombin si identitet parësorë krijuan konceptin e shqiptarizmit si më të rëndësishmin kundrejt identiteteve tjera fetare apo krahinore. Vizioni politik i rilindasve ishte që idenë e shqiptarizmit ta ngrinin në ideologji kombëtare, në vetëdije kulturore dhe politike të frymëzuar nga Evropa Perëndimore.

Projekti i elitave intelektuale të shekullit XIX, ishte në funksion të krijimit të një vetëdije kombëtare, një identiteti kombëtar, përtej përçarjeve fetare, fisnore e regjionale. Dhe për këtë shkrimtarët shqiptarë të rilindjes kombëtare orvaten të “krijojnë” edhe një shumsi mitesh. Mitet si më shumë të pranishme konsiderohen *miti mbi origjinën* apo *miti mbi lashtësinë*, *miti mbi territorin*, *miti i kohës së artë*.¹³⁰

Mbi *mitin e origjinës dhe lashtësisë* së shqiptarëve si popull, qëndron se shqiptarët janë pasardhës dhe banorë më të lashtë të Evropës Juglindore. Fillimisht kjo tezë u përvetësua nga nacionalistët shqiptarë,¹³¹ sepse përmes kësaj teze është bërë përpjekje që të tregohet vjetërsia më e madhe e kombit shqiptarë kundrejt kombeve tjera Ballkanase, e posaqërisht atij grek. Në një far forme vjetërsia pretendonte epërsinë ndaj kombeve tjera fqinje dhe

¹²⁸ Ndriçim Kulla, 2003, 51

¹²⁹ Enis Sulstarova, 2003, 39

¹³⁰ Shih: Enis Sulstarova 2003, 43-53; Muhamedin Kullashi, 2003, 110-118.

¹³¹ Vjetërsia e shqiptarëve si popull u faktua edhe nga historian e shkrimtarë të huaj si Johan Thunmann, Conrad Malte-Brun, Johann Georg von Hahn e të tjerë. Shih më tepër: Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane, Rilindja, Prishtinë, 1990.

njëherit kërkonte legjitimitetin e së tashmes dhe së ardhmes së shqiptarëve si komb. Në dy esetë e tij *“Shqypnia dhe Shqiptarët”* dhe *“E vërteta për Shqipninë dhe shqiptarët”* të Pashko Vasës bënë një vlerësim të lashtësisë pellazge të shqiptarëve. Ai shkruan se “na shqiptarët jemi pa kundërshti, të birt e pellazgëvet, e se jemi populli ma i motshmise gjitha kombet e tjera”. Pellazgët janë popullsia e parë që erdhën në Ballkan dhe ndërtuan qytetërimin e vetë.¹³² Sami Frashëri, gjithashtu mbronë pikëpamjen se shqiptarët janë pasardhës të pellazgëve dhe kombi më i vjetër në Ballkan. Ai shkruan se “një komp i vjetër, m’i i vjetër’i i kombeve t’Evropës, pelasgët’ e qëmocim të mbajtur’ e të qëndruarë që nga kaq mijë vjet e tëhu sikundër’ ishin, një komp kaq i vjetërë e me gjith këtë fort i ri, që tani po zë të lulëzonjë për se pare here, ..”¹³³ Pra, ideologët e nacionalizmit shqiptarë duan t’i prezantojnë shqiptarët si pasardhës “të popullit më të moçëm të Ballkanit”, që jetojnë aty “para ardhjes sëslavëve dhe grekërve” dhe se “gjuha shqipe është gjuhë e më e lashtë e Evropës, nëna e greqishtes dhe e latinishtes”.¹³⁴

Mitin i territori, t e gjejmë tek shumë rilindas, ku përmes glorifikimit të atdheut, gjegjësisht përmes përshkrimit të vetive pozitive të teritorit të caktuar synohet krijimi i lidhjeve të ngushta dhe emocionale me kombin. Kështu, rilindësit për t’ia bërë të dashur vendin shqipëtarëve hiperbolizonin të mirat që posedon atdheu i tyre, kësisoji, ata flisnin për malet, fushat, detrat e lumenjt si pasuri që si ka vend tjetër i botës. Tek kreu se Çështë shqipëria? Sami Frashëri shkruan se Shqipëria *“është një nga më të bukurat’ vëndevet t’Evropësë. Mbase sësht’ aq i pasurëe aq pjellor, po është shum’ i bukurë. Është malësi, kamale të lartë, me shkëmbinj të rreptë e të ckrepetuarë, po edhe me pllaja të veshura, me pylle të dëndurë, me ujëra të ftohëtë, me trape që mbajnë dëborë në verë, me lule të bukura, me barëra që ushqejnë bagëtinë e shrojnë njerëzinë, ...”*¹³⁵ Tek poema e “Bagëti e Bujqësi” Naim Frashëri përshkruan Shqipërinë si një territor të pasur e të begatë me fusha të gjera, bujq e blektorë të vrytytshëm e punëtorë. Ai përmendë veç e veç edhe vendet shqiptare duke u mësuar shqiptarëve shtrirjen e atdheut të tyre dhe rëndësinë që kanë këto vende

¹³² Sikundërse pellazgët që u përmendën duelen e lëshuen dheun epatridhën e vet, e erdhën në Greqi për me zanë vend, ashtu ma vonë e mbas shumë kohet, edhe tjera farefise u lëkundën prej Aziet; edhe ato shkapërcyen detin për me kërkue dhe tjetër e me u ngulë ndër toka të mira. Ndonji, pra, që mbas pellazgësh erdhën kah deti, sikur patën ardhun këta, edhe nja dy a tri kombe tjera që kishin emrat: eolinj*), joninj e dorinj. Sh më tepër: Pashko Vasa, Vepra 3, Rilindja, Prishtinë, 1989, 243.

¹³³ Sami Frashëri, Vepra 2, Rilindja, Prishtinë, 1978, 105.

¹³⁴ Muhamedin Kullashi, 111.

¹³⁵ Sami Frashëri, Vepra 2, Rilindja, Prishtinë, 1978, 45.

për shqipërinë.¹³⁶ Në krijimtarinë letrare të rilindasve atdheu zenë një vend të posaqëm, emrat e maleve, lumenjve, e vendeve përpos përshkrimit gjeografik ku mund të përkufizohen kufijve e atdheut, kanë për qëllimi të jenë edhe pika referuese për kombin.¹³⁷

Miti i kohës së artë, e gjejmë te të gjithë krijuesit letrarë të periudhës së Rilindjes Kombëtare. Ata ndërtonin mitin e kohës së artë të popullit shqiptar duke “përpunuar e glorifikuar” të kaluarën me qëllim që të ringrisin të tashmën. Këtu, ndër figurat më të rëndësishme që zë një vend qëndrorë në ligjerimin nacionalist të rilindësve është figura e Gjergj Kastriotit Skenderbe. Në përfytyrimin e rilindësve Skenderbeu, u bë figura më e ndritur e popullit shqiptarë, i cili luftonte për lirinë e popullit të tij, por jo vetëm, sepse ai luftoi edhe për mbrojtjen e qytetërimit Europian nga pushtimi Osman. Në këtë kontekst mund të përmendim poemën heroike të Naim Frashërit, *Istoria e Skenderbeut*, ku i këndohen ngjarjeve të ndryshme, por kryesisht luftërave që shqiptarët nën udhëheqjen e Skenderbeut bëjnë kundër pushtimeve turke. Në këtë poemë Naimi synon të paraqesë krejt jetën e Skenderbeut dhe të gjitha luftërat që bëjnë shqiptarët nën udhëheqjen e tij kundër turqve në shekullin e XV.¹³⁸ Sipas Rexhep Qosjes, Naimi i jep dimensione të gjerë fytyrës madhore të Skenderbeut dhe e ngrit atë njeri në nivelin e simbolit kombëtar të luftës për liri e pavarësi. Sipas tij, Skenderbeu është mit kolektiv i popullit shqiptar dhe Naimi e nxjerr në dritë edhe njëher të gjitha anët e domethënies së këtij miti.¹³⁹ Gjithashtu, Sami Frashëri në veprën “*Shqipëria*” shkruan për figurën e Skenderbeut. Sami Frashëri nuk i përmendë kurrë çështjen fetare, përkundrazi ekzalton lidhjen e heroit me familjen e me atdheun, emfatizon virtytet e tij dhe gjendjen tragjike të vendit, lavdinë e qëndresës, e në çastin e volitshëm Skenderbeu pranon të sakrifkohet për mëmëdhenë.¹⁴⁰ Pra, mund të themi se veprimtaria e Skenderbeut në mendimin e nacionalizmit shqiptarë shërbente si model i qëndresës së shqiptarëve ndaj turqve dhe ndaj kombeve tjera të konsideruara si ‘armike’, sepse ‘kombet mike’ të përcaktuara nga rilindësit (Sami dhe Naim Frashëri, Pashko Vasa e të tjerë) gjendeshin në Perëndim. Ndërkaq, sipas H. Ferajt nacionalistët shqiptarë instrumentalizuan figurën historike të Skenderbeut për disa arsye: së pari, Skenderbeu u kujton ekzistencën e shtetit shqiptarë në të kaluarën; së dyti, Skenderbeu i shërbente nacionalizmit shqiptarë për

¹³⁶ Shih: Naim Frashëri, *Poema, Bagëti e Bujqësi*.

¹³⁷ Enis Sulstarova, 46.

¹³⁸ Naim Frashëri, *Vepra 3, Rilindja, Prishtinë, 1986*.

¹³⁹ Rexhep Qosja, tek Naim Frashëri, *Vepra 1, Rilindja Prishtinë 1986, 65*.

¹⁴⁰ Shih më tepër: Doan Dani, *Shpikja e Mesjetës, 395*.

të dalluar veten si rrymë politike nga lëvizjet panislamike të nxitura nga Sulltani dhe për të treguar prirjen drejt qytetërimit evropian perëndimor; së treti, glorifikimi i figurës së Skënderbeut si katolik nënkuptonte njëherit tolerancën fetare dhe se shqiptarët i jepnin më shumë rëndësi lidhjeve etnike kundrejt atyre fetare; se katërti, përmes figures së tij, shprehej synimi për formimin e shtetit të pavarur shqiptar dhe se Skënderbeu shërbente si shembull i vërtetimit të aftësive shtetformuese të shqiptarëve.¹⁴¹ Mund të themi se përdorimi i Skënderbeut si mit nga ana e lëvizjeve nacionaliste shqiptare ishte shumë e rëndësishme, për faktin që ai tashmë ishte një nyje e fortë për legjitimimin e ekzistencës së kombit dhe shtetit të pavarur shqiptarë. Skënderbeu u bë i pranueshëm për të gjitha lëvizjet politike shqiptare të kohës, njëkohësisht u bë figura qendrore e mendimit politik shqiptarë që nga Rilindja Kombëtare e deri më sot.

2.2 Parimi i nationalist i Rilindasve

Përbërës tjetër i rëndësishëm i një kombi përpos origjinës, traditës dhe kulturës së përbashkët është edhe elementi territorial ku ai shtrihet. Natyrshëm si çdo komb tjetër edhe kombi shqiptarë duhej të kishte territorin ku ai shtrihet. Territoret shqiptare shtriheshin në kuadër të Perandorisë Osmane dhe të ndarë në katër vilajete. Prej kohësh kërkesa dhe synimi i rilindësve shqiptarë ishte përfshirja e shqiptarëve në një territor të vetëm, brenda një vilajeti autonom, shtet autonom shqiptarë, nën sovranitetin e Perandorisë Osmane, duke u mbështetur kryesisht në kriterin gjuhësorë, etnik dhe kulturorë të shtrirjes së shqiptarëve. Sa i përket territorit shqiptarë në Perandorinë Osmane sipas Sami Frashërit, “Shqipëria munt të ndahet në 15 gatra, të cilat pas kryeqyteteve të tyre janë: Shkodra, Peci (Ipeku), Prizreni, Preshtina, Ysqypi, Manastiri, Dibra, Elbasani, Tirana, Berati, Korca, Kosturi, Janina, Gjirokastra e Preveza.”¹⁴² Gjithashtu, në vitin 1890 Abdyl Frashëri i shkruan një letër Krispit për kufijtë e Shqipërisë apo territorin ku shqiptarët shtriheshin, “Në veri, Shqipëria do të kufizohej me Malin e Zi, Bosnjën dhe Serbinë; në jug, me gjirin e Ambrakisë dhe me Greqinë. Në lindje, kufiri i natyrshëm dhe etnografik do të ishte një vijë nga kufiri serb afër Vranas që do të kalonte Vardarin, ndërmjet Shkupit dhe Velesit, duke ndjekur majat e maleve Babuna si dhe një varg malesh të tjerë, duke lënë kështu në Shqipëri Prilepin, Manastirin, Follorinën, Kosturin dhe Grevenene, deri te kufiri

¹⁴¹ Hysamedin Feraj, 140.

¹⁴² Sami Frashëri, 87; Ndrëçim Kulla, 72.

me Greqinë.”¹⁴³ Pra, siç shihet për rilindësit kriteri për përcaktimin e kufirit ka qenë kryesisht etnik dhe historik, por duke ia nënshtruar të dytin të parit, sepse kombi shqiptarë nuk mund të kishte një territor të pa banuar me shqiptarë dhe të konsiderohej pjesë e atdheut. Kjo e përforcon edhe më shumë kriterin etnik që kanë ndjekur rilindësit për përcaktimin e territoreve shqiptare, gjithashtu dhe kriteri historik që përshkruan autoktoninë dhe vazhdimësinë e shqiptarëve në këto troje. Në këtë mënyrë rilindësit, rikonfirmuan edhe elementin e kombit etno-kulturorë. Nga qenia e kombit, shqiptarët nxjerrin të drejtën e tyre për të pasur njësinë e vetë politike dhe se ajo duhet të përputhet me shtrirjen gjeografike të kombit.

Nacionalistët shqiptarë kishin opSION ruajtjen kompaktësisë territoriale dhe administrative të tokave shqiptare që rrezikoheshin nga fqinjët dhe jo nga Perandoria Osmane, dhe kjo ishte e mundur përbrenda Perandorisë Osmane. Për më tepër objektivat e kombit shqiptarë sipas Sami Frashërit dhe Pashko Vasës duhet të realizoheshin nën kupolën e Perandorisë Osmane, sepse njohja e autonomisë së Shqipërisë nga Perandoria nënkuptonte njohjen zyrtare të të drejtave të shqiptarëve mbi trojet e tyre dhe kjo do të thoshte edhe njohje nga Fuqitë e Mëdha. Njohja e përkatësisë etnike shqiptare mbi trojet e tyre do të shmangte apetitet shoviniste të fqinjëve. Rilindasit e shinin autonominë nën sovranitetin e sulltanit si zgjidhje të pranueshme edhe për Perandorinë, në krahasim me shkëputjen e plotë nga Perandoria edhe pse autonomia vlerësohej si diçka kalimtare, si një organizim i përkohshëm, deri në arritjen e kushteve më të favorshme ndërkombëtare për të shkuar drejt një shteti të pavarur.

Platforma politike e Rilindjes kombëtare përputhet me parimin e nacionalizmit shqiptarë duke i bashkuar shqiptarët në një komb me elemente të veçanta si gjuha, origjina, tradita, historia, kultura e territori dhe të drejtën e tyre për të pasur njësinë e vet politike. Rilindësit e shihnin botën të ndarë në kombe dhe kufijtë e Shqipërisë i shihnin të përputhshëm me shtrirjen e etnisë shqiptare, këtë përfytyrim ata arritën ta realizojnë me organizimin e Lidhjes si Prizrenit si organizim politik që vepronte në emër të tërë kombit shqiptarë. Kjo njëherit mbetet si parimi dhe frymëzim politik i nacionalizmit shqiptarë deri në ditët tona. Mbi këtë bazë dhe u konfigurua mendimi nationalist shqiptarë, që njëherit kishte karakter mbrojtës, sepse rilindësit parashtronin si nevojë të domosdoshme mbrojtjen e kombit nga copëtimi

¹⁴³ Stavro Skendi, 2000, 289-290.

dhe asimilimi. Nga kjo del se nacionalizmi shqiptarë nuk ishte ekspansionist dhe se nuk pretendonte futjen në dorë të territoreve të pabanuara me shqiptarë. Kjo do të thotë se parimi i nacionalistëve shqiptarë shkon konform parimit të nacionalizmit klasik i ideuar nga Gellneri, pra përputhjen e njësisë kombëtare shqiptare me njësin politike shtetin, shtetin shqiptarë.

IV. Vazhdimësia e ligjëritimit nationalist shqiptarë në Jugosllavinë e parë¹⁴⁴

Pavarësia e Shqipërisë, më 28 nëntor 1912 në Vlorë, shënon një nga ndodhitë më të rëndësishme në historinë e popullit shqiptarë. Ajo ishte konkretizim i përpjekjeve dhe i luftërave të shumta shekullore kundër pushtuesve të huaj dhe njëherit fitore e përbashkët e të gjithë popullit shqiptar. Realizimi i idealit të të shumë brezave që luftuan me të gjitha format e rezistencës që nga Kosova, Çamëria, Maqedonia Veriore, Lugina e Preshevës, dhe shqiptarëve të diasporës në përgjithësi.

Mirëpo, territoret shqiptare u ndanë në mes të Greqisë, Malit të Zi, Serbisë dhe shtetit të sapokrijuar shqiptar. Konferenca e Ambasadorëve në Londër krijoi një shtet Shqiptarë me vetëm gjysmën e territoreve dhe popullsisë shqiptare, me rreth 28.000 kilometra katrorë dhe me një popullsi prej 740.000 banorësh. Ndërsa gjysma tjetër e territoreve shqiptare mbetën jashtë kufijve shtetëror, gjegjësisht ato u dhanë fqinjëve Serbo Malazez dhe Grek.¹⁴⁵ Copëtimin e territoreve shqiptarët e pritën me zhgënjim të thellë, dhe si shkak i kësajë, ata filluan ta manifestojnë paknaqësinë e tyre në forma të ndryshme si me mitingje, protesta, shkresa drejtuara institucioneve ndërkombëtare dhe në fund edhe me kryengritje të armatosura. Kësisoj, Kosova dhe trevat tjera shqiptare nuk pranuan t'i nënshtroheshin pushtuesve të rinj serbo-malazezë, dhe patriotët shqiptarë ishin të vendosur që këtë gjendje ta kundërshtonin me luftë të armatosur në mënyrë që të çlirojnë viset shqiptare nga robëria e huaj dhe t'i bashkojnë ato me një shtet kombëtar. Shqipëria e copëtuar, apo siç njihej ndryshe Shqipëria londineze, e ndarë, e dobësuar ekonomikisht, ushtarakisht dhe politikisht ndodhej përball një sfide të rëndësishme, të mendoj për ndërtimin dhe formatin e shtetit, gjegjësisht të bëjë përpjekje të ruaj tërësinë territoriale të shtetit apo të luftoj për zgjidhjen e çështjes kombëtare, për bashkimin e trojeve etnike, të shkëputura nga trungu kombëtar. Pra kështu krijimi i shtetit shqiptar shënon njëherit zanafillën e lindjes së asaj që sot quhet

¹⁴⁴ Mbretëria Serbe-Kroate-Slllovene apo siç njihet ndryshe dhe si shtetit Jugosllav, u krijua më 1 dhjetor 1918, që nga viti 1929 mori emrin Jugosllavi. Në këtë pjesë të punimit do të përdoren të dy emërtimet, mirëpo emërtimi "Jugosllavi e parë" (ngase do pjesë e trajtimit do të jetë edhe "Jugosllavia e dytë") do të haset më shpesh për arsye pragmatike. Shih më tepër Enver Hasani, Shpërbërja e ish-Jugosllavisë dhe Kosova, Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare, Tiranë, 2000, 18.

¹⁴⁵ Oliver J. Shmit, Kosova, Histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike, Koha, Prishtinë 2012, 140.

çështje kombëtare, gjegjësisht këtu ka fillin dhe vazhdimësia e projektit nacionalist shqiptarë.

Vendimet e pa drejta të Fuqive të Mëdha në Konferencën e Londrës dhe më pas politikën agresore të Serbisë dhe Malit të Zi ndaj popullsisë shqiptare në trevat e aneksuara të Kosovës dhe viseve lindore e veriore të Shqipërisë u bënë shtytja kryesore që shqiptarët të organizoheshin në formacione të ndryshme politike dhe ushtarake. Në fokus të këtij kapitulli do të jenë intelektualët, patriotët dhe lëvizjet politike shqiptare të kohës, të cilët me veprimtarinë e tyre jo vetëm që rrezistuan vendimeve të padrejta të bashkësisë ndërkombëtare, por njëherit edhe shënuan vazhdimsinë e projektit nacionalist shqiptar. Këto lëvizje janë: Komiteti për “Mbrotjtjen Kombëtare të Kosovës”, Lëvizja Nacionalçlirimtare (Kaçake), Xhemijeti (Bashkimi), si dhe protagonistët kryesorë të këtyre lëvizjeve, si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Azem Bejta, Nexhip Draga, Ferhat Draga e të tjerë. Gjithashtu, do të kenë vëmendjen edhe ngjarje të rëndësishme politike të kohës si represioni sistematik ndaj popullatës shqiptare, dhuna, kolonizimi i vendbanimeve, shpërngulja e shqiptarëve e të tjera. Vëmendje do të ketë edhe lëvizjet politike të kohës në Republikën e Shqipërisë, qëndrimet e qeverive të ndryshme ndaj çështjes së Kosovës dhe viseve tjera në përgjithësi.

1. Ligjërimi nacionalist shqiptar në Kosovë

Pushtimi i Kosovës dhe i viseve tjera shqiptare nga Serbia dhe Mali i Zi (1912) i gjeti shqiptarët të paorganizuar dhe të armatosur dobët, sepse ishin të konsumuar nga kryengritjet e periudhës 1909-1912 ndaj Perandorisë Osmane, dhe nuk ishin në gjendje t’u rezistonin ushtrive të rregullta serbe. Popullsia shqiptare u përballë me aksionet të shumta ushtarake dhe paramilitare serbo-malazez, ku u rrënuan qytete dhe fshatra të tëra dhe u masakrua popullsia shqiptare e këtyre vendeve.¹⁴⁶ Kështu, që në fillim të pushtimi flitet për një numër të madh të të arratisurve, të vrarëve dhe të internuarve nga ushtria serbe.¹⁴⁷ E

¹⁴⁶ Për aksione të tilla të ushtrisë serbo-malazeze u tmerruan edhe një pjesë e madhe publikut evropian si Lev Bron-Stein, Trocki, që ishin ndër më të zëshmit në denoncimin e krimeve të luftës, si dhe në Serbi ngriti zërin socialdemokratit Dimitrije Tucoviç. Rreth numrit të shqiptarëve të vrarë, të arratisur, të internuar; Historia e Popullit Shqiptarë, III, 425-426;¹⁴⁶ Jusuf Buxhovi, Kosova nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar, Prishtinë: Faik Konica, 2012, 171.

¹⁴⁷ Programi kombëtar i Serbisë mbështetej në dy parime, të cilat në një mënyrë ishin kundërtë: në të drejtën historike, pra në sundimin mesjetar serb në rajon, në të cilin serbët tani, në epokën e re, nuk përbënin shumicë; dhe anën tjetër, programi kombëtar serb mbështetej në parimin etnik, pra në shumicën serbe ose në një numër të madh të popullsisë serbe, madje dhe në territore, të cilat historikisht kurrë nuk i kishin takuar

tërë kjo ndërmarrje e ushtrisë serbo-malazeze kishte për qëllim ndryshimin e strukturës etnike dhe krijimit të fakteve në teren për të drejtën e Serbisë ndaj çështjes së Kosovës. Me një fjalë, shqiptarëve dhe të tjerëve, duhej t’ju krijohet bindja se Kosova dhe viset tjera shqiptare që jashtë kufijve të Shqipërisë nuk ishin më shqiptare, por “tokë e shenjtë serbe”, e “vjedhur dhe e pushtuar prej tyre gjatë sundimit osman”, e cila ishte kthyer tashmë “djepit të vet mesjetar”(Schmitt). Kjo e fundit bëhej edhe me mjete ushtarake, por edhe me iniciativën që kishte ndërmarr shteti, që Kosova të merrte “pamjen e shenjtërisë serbe”, duke ndërtuar manastire ortodokse në çdo lokalitet, në mënyrë që shqiptarët t’u nënshtroheshin rrethanave dhe të pranonin se gjendeshin “në tokat serbe” ose të shpërnguleshin në Turqi.¹⁴⁸

Politikat agresore, shpronësuese dhe e spastrimit etnik ndaj viseve të aneksuara shqiptare u bënë shtysë kryesore për ringjalljen e nacionalizmit shqiptarë. Shqiptarët, nuk patën rrugë tjetër vetëm të organizoheshin kundër brutalitetit të pushtetit Serb. Në këtë mënyrë, ata mohonin realitetin e krijuar nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe filluan me kryengritje të armatosura apo gupe “kaçake”, për çlirimin e tokave shqiptare apo bashkimin e tyre me Shqipërinë e pavarur.¹⁴⁹ Nacionalistët shqiptarë të Kosovës gjatë kësaj periudhe nuk u lëkundën asnjëherë përball kërkesës për bashkëngjitje me Shqipërinë politike, madje duke mos e kursyer asnjë mjet edhe luftën e armatosur. Kjo qëndresë shpejt mori karakter të organizuar dhe drejtimin e saj e morën udhëheqësit kosovarë si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Sali Hoxha, Elez Isufi e të tjerë.¹⁵⁰

shtetit serb në mesjetë. Sa i përket Kosovës elita politike serbe i referohej të drejtës historike. Këtu vërehen dy strategji kryesore: njëra thekson karakterin serb të Kosovës, tjetra përpiqet të prezantoj shumicën myslimane si barbare. Shih: Oliver J. Schmitt, Kosova, Histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike, Koha, Prishtinë 2012, 128.

¹⁴⁸ Jusuf Buxhovi, Kosova nga Konferenca e Londrës deri te pretektorati ndërkombëtar, Prishtinë: Faik Konica, 2012, 171.

¹⁴⁹ Më 5 maj 1913, Isa Boletini do të deklaroj se: “Nuk i pranoni kufijtë që i ka caktuar Konferenca e Ambasadorëve në Londër. Isa Boletini në prani të Aqif Tetovës kërcënon më vonë se do të “luftoj tërë jetën kundër Serbisë nëse Evropa nuk i bashkon Kosovën dhe Shqipërisë. Në shtator të 1913 Bajram Curri, Riza Kryeziu, Jusuf Elezi dhe Qazim Lika do të gjinden në ballë të rezistencës kundër Serbisë okupatore. Këtë kryengritje do të përpiqet me dredhi ta dezorientoj oficeri Radenkoviç, duke kërkuar takim me Isa Boletinin dhe Bajram Currin. Por nga prijësit shqiptarë do të marrë përgjigjen se “lufta jonë nuk është për bukë dhe sociale, por për pavarësi nacionale të të gjitha viseve shqiptare. Le të vendosë Evropa çka të dojë, por trojet tona nuk mund tu shiten apo tu dhurohen miqve të Serbisë, me asnjë çmim. Stambollit me shekuj, prandaj do të bëjmë luftë edhe kundër Beogradit me dekada, por liria është dhe do të mbetet e jona”. Shih: Hakif Bajrami, Shqiptarët në Luftë për shtet kombëtar (1912-1918), Faik Konica, Prishtinë, 2018, 172.

¹⁵⁰ Historia e Popullit Shqiptarë, III, 429.

Për lëvizjen nacionaliste në Kosovë kruciale ishte qëndrimi dhe mbështetja e shtetit amë apo e qeveritarëve shqiptarë në rrugën e nisur, sepse ekzistenca e një qeverie patriotike në Shqipëri do të thoshte përkrahje për lëvizjet kombëtare në Kosovë. Natyrisht kjo ka të bëjë me qasjen e shtetit shqiptarë, gjegjësisht qeverive të ndryshme ndaj çështjes kombëtare në tërësi, e posaçërisht ndaj çështjes së Kosovës. Krijimi i shtetit Shqiptarë me kufijtë ekzistues domosdoshmërisht ndikoi në krijimin e botëkuptimeve të ndryshme ndaj zgjidhjes së çështjes shqiptare. Kështu u formuluan dy qëndrime: fillimisht qëndrimi se duhet ndërdua, formësuar dhe konsoliduar shteti shqiptarë dhe më pas të shqyrtohet çështja shqiptare jashtë kufijve të 1913, sepse rrethanat dhe konjunkturat ndërkombëtare impononin një qëndrim të tillë; dhe qëndrimi se pas 1913 menjëherë duhet filluar përpjekjet për zgjidhjen e çështjes shqiptare, gjegjësisht bashkimin e trojeve shqiptare me kufijtë e shtetit të tanishëm shqiptarë. Kjo ndarje argumentohet edhe nga një pjesë e madhe e elitës politike të vendit si Hasan Prishtina, Isa Boletini, gjithashtu do të shtohet edhe si kërkesë e delegacionit të Qeverisë së Durrësit në Konferencën e Paqes në Paris.¹⁵¹ Ndarja e rrymave politike shqiptare sipas këtyre dy qasjeve themelore e vë re edhe autori Bernd J. Fischer kur thotë se “... diskutimi ishte nëse duhej të nxitej menjëherë irredentizmi ose duhej pritur që të kishte stabilitet në Shqipëri, ...”.¹⁵²

Kështu mbi këtë ndarje, gjegjësisht qasjes ndaj zgjidhjes së problemit të shqiptarëve jashtë kufijve, mbi rrugën të cilët duhet ndjekur për zgjidhjen e kësaj çështjeje përcakton profilizimin e rrymës politike si nacionaliste apo jonacionaliste. Këtu mund t’ju referohem Hysamedin Ferajt kur thotë se ajo ç’far e përcakton dhe dallon lëvizjen nacionaliste nga idetë e tjera politike ka të bëjë me metodën që ajo ndjek. Pra, “nacionalizmi shqiptarë u dallua dhe u nda prej rrymave tjera të mendimit politik shqiptarë nga ideja se duhet vazhduar menjëherë veprimtaria politike, duke përfshirë edhe luftën e armatosur, për të realizuar përputhjen e kufijve të njësisë politike me njësinë kombëtare”.¹⁵³ Në këtë mënyrë, nacionalistët nuk përjashtojnë asnjë mjet madje edhe luftën e armatosur për të realizuar idealin e tyre politik, pra të përputhjes së njësisë politike me njësinë kombëtare. Për të, nacionalizmi shqiptarë nuk e thjeshtonte gjithë veprimtarinë e vet vetëm me luftën e armatosur, por kjo ka qenë një nga çështjet më të mprehta dhe kriter më dallues nga rrymat

¹⁵¹ Shih më tepër: Historia e Popullit Shqiptarë III, 124-135.

¹⁵² Bernd Fischer, Diktatorët e Ballkanit, Instituti Shqiptar për studime ndërkombëtare, Tiranë, 2008, 28.

¹⁵³ Hysamedin Feraj, 2010, 237

e tjera të mendimit politik shqiptarë. Ngase çështjet e tjera si arsimimi në gjuhën shqipe, ruajtja e kulturës, e identitetit kombëtarë dhe përgjithësisht kujdesi ndaj shqiptarëve që mbetën jashtë njësisë politike shqiptare të gëzojnë të drejtat e minoriteteve, madje edhe pranimi me fjalë bashkimi kombëtarë si e drejtë e shqiptarëve, ka qenë pikëpamje dhe veprimtari e përbashkët, jo dalluese, për të gjitha rrymat politike shqiptare.¹⁵⁴ Pra, në këtë periudhë nuk mjaftonin artikulimi i qëndrimeve politike me akses kombëtarë, por ajo ç'farë e dallonte rrymën nacionaliste nga të tjerat ishte se ajo, bashkimin e njësisë politike me atë kombëtare e shihte më primare se gjithçka tjetër madje duke e manifestuar edhe me veprimtari luftarake.

Në periudhat e tilla që po kalonin shtetet Ballkanike, ku fuqia e shteteve demonstrohej me mjete luftarake dhe me pushtime terriroresh, edhe për popullin shqiptarë ishte e domosdoshme të demonstronte fuqinë e tyre luftarake për t'i dalë zot terrirore të tyre, sepse kjo njëherit nënkuptonte fuqi dhe aftësi për të administruar me të terriroren përkatës. E kundërta e sajë, mungesa e fuqisë luftarake, apo mungesa e vullnetit, nënkuptohet me automatizëm paaftësi për t'i zotëruar dhe administruar me ato terrirore. Pra, fuqia luftarake ishte konstantë e rëndësishme në këtë periudhë historike, sepse dëshmitë e tjera nuk përbënin diferencë të rëndësishme sepse ishin prezent pothuajse në çdo rrymë politike.

Për dallim nga një numër i madh nacionalistëve kosovarë, ky kriter nuk ishte konstantë e rëndësishme e Qeverive Shqiptare, që udhëhiqnin në periudha të ndryshme kohore, gjegjësisht në mes të dy Luftërave Botërore. Këtë e shpreh edhe Abdi Baleta kur thotë se "në dekadat e para të ekzistencës së shtetit të pavarur shqiptar mbizotëroi realpolitika e shpëtimit të shtetit të cinguar shqiptar dhe heshtja për copëtimin e trojeve shqiptare."¹⁵⁵ Në këtë kontekst, mund të përmendim qeverinë e Ahmet Zogut dhe më vonë edhe Mbretërinë e tij, që është shprehur hapur kundër lëvizjeve politike që luftonin për bashkimin e terrirore të mbetur jashtë kufijve të shtetit Shqiptar. Ai përpjekjet nacionaliste të shqiptarëve të cilët mendonin se lufta për bashkimin kombëtar duhet vazhduar menjëherë dhe me të gjitha mjetet apo me luftë i quante një luks dhe "aventurizëm politik". Në vend të luftës për bashkim kombëtar qeveria e Zogut dhe qeveritë e tjera shqiptare mbështesnin idenë e vendosjes së marrëdhënieve të mira me

¹⁵⁴ Po aty, 238.

¹⁵⁵ Abdi Baleta, Udhëkryqet politike shqiptare, Logos-A, Shkup, 2018, 61.

shtetet fqinje. Kjo nuk nënkupton se ata nuk preokupoheshin dhe qëndronin indiferent ndaj çështjes shqiptare, mirëpo ato anonin më shumë drejt stabilitetit politik, ekonomik dhe institucional të shtetit Shqiptarë kundrejt luftës së armatosur për bashkimin e trojeve.

Për nacionalistët shqiptarë bashkimi i Kosovës dhe i viseve shqiptare me Shqipërinë, në një shtet të njësuar kombëtarë, ishte njëherit edhe kusht i domosdoshëm për zhvillim politik, ekonomik dhe kulturor të popullit shqiptarë.¹⁵⁶ Pra, Shqipëria nuk mund të zhvilloj një sistem politik, kulturor dhe ekonomik të qëndrueshëm pa Kosovën dhe viset tjera shqiptare. Prioritet i rrymës nacionaliste është bashkimi kombëtarë kundrejt të gjitha ideve tjera të mundshme, sepse edhe ide të tilla si për sistem politik dhe zhvillim ekonomik nuk mund të zhvilloheshin normalisht dhe suksesshëm pa një hapësirë kompakte kombëtare dhe shtetërore.

Normalisht ishte shumë e rëndësishme mbështetja politike, ideore dhe ajo luftarake e shtetit shqiptarë ndaj lëvizjeve nacionaliste shqiptare përbrenda Mbretërisë Serbe, Kroate, Sllovene. Për më tepër ato determinoheshin nga masa e mbështetjes së Shtetit amë. Nëse mbështetja ishte e fuqishme, që nënkuptonte linjën e njëjtë ideore me atë të përputhjes së njësisë politike me atë kombëtare, me çdo mjet, masa rezistencës së lëvizjeve shqiptare kundrejt pushtuesve serb ishte më rezistuese dhe më e suksesshme. Gjithashtu mosmbështetja apo edhe mohimi i lëvizjeve shqiptare çoi drejt zhdukjes së rezistencës, sepse ato luftoheshin nga të gjitha frontet, tashmë edhe nga ai shqiptarë. Qeveritarët e shtetit shqiptarë gjatë kësaj periudhe dalloheshin me dy këndvështrime, mes lojalitetit të çështjes kombëtare dhe fuqizimin e shtetit shqiptarë përbrenda kufijve ekzistues, natyrisht këta të fundit nuk mohonin bashkëngjitjen e trevave shqiptare shtetit amë, mirëpo këtë gjë e shinin si të mundshme atëherë kur krijoheshin konditat ndërkombëtare për realizmin e një gjëje të tillë.

1.1 Hasan Prishtina

Hasan Prishtina ishte njëri ndër përfaqësuesit më të denjë të idesë së nacionalizmit shqiptarë. Veprimtaria e tij politike që nga periudha e sundimit osman e deri në vdekje ka qenë e orientuar në frymën e nacionalizmit shqiptarë, gjegjësisht në përpjekje për përputhjen e njësisë nacionale me njësinë politike si misionin e tij më të shenjt jetësor. Si në

¹⁵⁶ Historia e Popullit Shqiptarë, III, 2007, 458.

aspektin veprimtarisë ideor dhe praktike, ai e kuptimësonë idenë e nacionalizmit shqiptarë, por njëherit u bë edhe frymëzuesi, organizatori dhe udhëheqësi më i devotshëm i kësaj ideje. Ai me idetë, veprimtarinë politike dhe luftën për çlirimin e popullit shqiptarë i përket lineariteti dhe konsistencës ideore të Rilindasve. Veprimtaria e tij politike, për bashkimin e popullit shqiptarë është në konsistence të plotë ndaj të gjitha pushteteve ndër vite. Këtu vlen të ju referohem deklaratës së tij të përsëritur shumë shpesh “Unë kam një rrugë të caktueme para mejet, atë kam shkel dhe atë do të shkel deri në vdekje, rrugën e indipendencës ma të plotë të Shqipnisë”.¹⁵⁷

Veprimtaria e tija nuk përfundon në vitin 1913, atëherë kur u përcaktuan kufijtë e shtetit shqiptar, por, ai e vazhdoi veprimtarin, e cila nuk përfundoi deri në ditën e fundit të vdekjes së tij (1933). Menjëherë pas 1913 Hasan Prishtina u bë njëri ndër veprimtarët kryesorë të lëvizjes kombëtare për bashkimin kombëtar, “Synimi i lëvizjes që po niste ishte çlirimi i trojeve amtare, të mbetura në zgjedhën e huaj, për t’i bashkuar ato me Shqipërinë e pavarur. Të gatshëm për veprim ishin dhjetëra mija muhaxhirë kosovarë e të tjerë, që prisnin me padurim të ktheheshin, qoftë edhe me luftë në vatrën e tyre. Udhëheqësi kosovar H. Prishtina u bë në atë kohë njëri ndër veprimtarët kryesorë të lëvizjes së saponisur për bashkim kombëtar”.¹⁵⁸ Hasan Prishtina i pa bindur me kufijtë e 1913 vazhdonte veprimtarinë me të gjitha mjetet e mundshme, këtu mund të përmendim edhe shkuarjen e tij me Mbretin Vid dhe Isa Boletinin në Hercegnovi (në gusht të vitit 1914), për të hapur Frontin kosovar që kishte synim “për të bërë luftë frontale për çdo qytet, për çdo lokalitet, për çdo krahinë të Kosovës dhe Vilajetit të Manastirit për t’i dëshmuar botës se deri ku shtrihet kërkesat e drejta të shqiptarëve për shtet dhe pushtet nacional”.¹⁵⁹ Ai gjatë viteve të njëzeta kishte organizuar luftëra të shumta antiserbe dhe një sërë veprimtarish diplomatike¹⁶⁰ sepse çështjen e bashkimit kombëtarë e shihte si imediate dhe detyrë të të gjithëve, kështu ai shprehej se “çështja e mbrojtjes së tokave shqiptare dhe kthimi i tyre trungut të vet, nuk ishte vetëm detyrë e atyre që kishin humbur atdheun nga pushtimet

¹⁵⁷ Tahir Abdyl, Hasan Prishtina, GME, Prishtinë, 2003, 13.

¹⁵⁸ Historia e Popullit Shqiptarë, III, 2007, 56.

¹⁵⁹ Hakif Bajrami, 2018, 182.

¹⁶⁰ Rreth veprimtarisë diplomatike të Hasan Prishtinës shih shkëmbimin e letrave me qendrat dhe personalitetet kryesore të diplomacisë botërore. Shih më tepër: Veprimtaria atdhetare e Hasan Prishtinës (dokumente), përzgjedhjen dhe redaktimin: Skender Asani, Mehmet Prishtina, Sefer Tahiri, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup, 2012.

fqinje, por ishte detyrë e secilit Shqiptarë, që e donte Shqipërinë”.¹⁶¹ Pra, thirrjet e Hasan Prishtinës kanë të bëjnë me atë se lufta e armatosur për bashkimin kombëtar jo vetëm se nuk e shkatërronte shtetin e krijuar shqiptar, por përkundrazi ishte mbrojtje ndaj tij dhe njëherit detyrë e secilit. Ajo ç’far e radhitë Hasan Prishtinën përkrah nacionalizmit shqiptar është ideja e vazhdimësisë së aktivitetit politik, duke mos e anashkaluar edhe luftën e armatosur për realizimin e bashkimit kombëtar. Bashkimi i Kosovës dhe gjitha viseve shqiptare të robëruara me Shqipërinë, në një shtet të njësuar kombëtarë, është kusht i domosdoshëm për zhvillim politik, ekonomik e kulturorë, në të kundërtën do të kemi një Shqipëri të mangët në çdo sektorë të jetës shoqërore. Një qëndrim i tillë e sheh veprimtarinë për bashkimin kombëtar parësore dhe parakusht për zhvillim politik, ekonomik dhe kulturorë të Shqipërisë.

Rruga nga do të shkelte Hasan Prishtina ishte shumë e qartë për të, gjithashtu edhe penguesit e kësaj rruge i kishte shumë të qartë se kush ishin dhe si duhej të sillej me ta. Ai i konsideronte armiq të gjithë ata që e pengonin bashkimin e shqiptarëve në një njësi politike, dhe të kundërtën, miq i konsideronte të gjithë ata të cilët kontribuonin në çlirimin e tokave shqiptare dhe nuk e pengonin bashkimin e tyre në një shtet. Kësisoj, ai disa herë u bë nismëtar i bashkëpunimit me përfaqësuesit dhe organizatat nacionalçlirimtare të Maqedonisë, të Bosnjës, të Kroacisë e të tjerë që vuanin nën zgjedhën e regjimeve shoviniste të huaja. Ai kërkonte respektimin e të drejtave kombëtare të të gjithë popujve ballkanikë gjë që do të arrihej sipas tij me krijimin e shteteve kombëtare në bazë të parimit të vetëvendosjes, duke përjashtuar çdo formë të hegjemonisë së njërit ndaj tjetrit.¹⁶² Luftën çlirimtare në Kosovë u përpoq ta lidhë e ta bashkërendojë me luftën e popujve të shtypur ballkanikë.

Ideve, bindjeve dhe diskursit të tija politik Hasan Prishtina i qëndroi besnik edhe me veprimtari praktike, ngase ai ishte ndër veprimtarët më të denjë të Lëvizjes Nacionale Shqiptare dhe asaj nacionalçlirimtare që nga 1908 e deri në fund të jetës së tij. Por jo vetëm kaq ai, frymëzoi, organizoi dhe realizoi kryengritje të shumta ndaj pushtuesve të tokave

¹⁶¹ Jusuf Buxhovi, Kosova nga Konferenca e Londrës deri te pretektorati ndërkombëtar, Prishtinë: Faik Konica, 2012,175.

¹⁶² Shih më tepër: Hasan Prishtina (1873-1933), ideolog i çlirimit dhe i bashkimit kombëtar të shqiptarëve, intelektual e atdhetar..., 13/08/2019 <https://www.radiokosovaelire.com/hasan-prishtina-1873-1933-ideolog-clirimit-dhe-bashkimit-kombetar-te-shqiptareve-intelektual-e-atdhetar/>, 24.12. 2019.

shqiptare, ishte përfaqësues i denjë i Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, i Lëvizjes Kaçake, bashkëpunëtor i lëvizjes Bashkimi, dhe shumë nismave të tjera individuale dhe kolektive, diplomatike dhe luftarake për çështjen kombëtare shqiptare në përgjithësi. Mundë të themi se Rilindasit e ideuan dhe projektuan kombin shqiptarë, kurse Hasan Prishtina me bashkëpunëtorët e tij ndërtuan platformën për shtetin kombëtarë Shqiptar.

1.2 Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”

Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, apo Komiteti i Kosovës siç njihet ndryshe, u themelua më 1 maj 1918 në Shkodër.¹⁶³ Komiteti doli hapur si organizatë legale me kryetarë Hoxha Kadri Prishtinën, i cili drejtonte veprimtarinë e përgjithshme politike të Komitetit, si dhe udhëheqës të tjerë të rëndësishëm si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Hysni Curri, Halim Gostivari e të tjerë, ishin të ngarkuar me organizimin e kryengritjeve në viset e robëruara; me informim dhe propagandë merrej Sali Nivica; për të kujdesur me fushën e arsimit punonte Sali Gjuka, dhe personalitete tjera që përbënin kryesinë si Ragib Kaja Begolli nënkryetar, Bedri Pejani sekretar e të tjerë.¹⁶⁴ Komiteti ishte ndër organizatat e para atdhetare e demokratike që përpunoi një program të plotë e të argumentuar shkencërisht për zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare, e cila ishte trashëguar si një problem i pazgjidhur nga periudha e Rilindjes.¹⁶⁵ Zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare udhëheqësit e Komitetit konsideronin si pjesë të zgjidhjes së çështjes kombëtare shqiptare dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë e pavarur si një e drejtë legjitime e popullsisë të këtyre trevave. Qysh në fillim të veprimtarisë së sajë ajo formuloi programin politik dhe pavarësisht rrethanave dhe gjendjes politike të krijuar në teren përmbajtja e këtij programi mbeti i pandryshuar. Programi i këtij komiteti përbëhej nga dy pika kryesore, ku qartë pasqyrohej drejtimi dhe strategjia kryesore e veprimtarisë së sajë politike, sigurimin e pavarësisë e të integritetit tokësorë të shtetit shqiptar dhe bashkimin e Kosovës e të gjitha viseve shqiptare të robëruara me Shqipërinë, në një shtet të njësuar kombëtar, si kusht i

¹⁶³ Historia e Popullit Shqiptar, III, 458; Kristaq Prifti, Kontributi i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës në rimëkëmbjen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe për bashkimin kombëtar 1918-1924”, Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, Përmbledhje kumtesash, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë Tiranë, Instituti i Historisë -Prishtinë, Tiranë: 2004, 16.

¹⁶⁴ Historia e Popullit Shqiptarë, III, 458.

¹⁶⁵ Kristaq Prifti, 2004, 27.

domosdoshëm për zhvillimin politik, ekonomik e kulturorë të njësuar të popullit shqiptarë.¹⁶⁶

Komiteti me drejtuesit e sajë e shihte konsolidimin e “Shqipërisë së lirë dhe vetëurdhëronjëse” si çështje kryesore për të ardhmen kombit shqiptar, sepse rimëkëmbja e shtetit shqiptar nënkuptonte unitetin e përgjithshëm kombëtarë dhe bërthamën rreth së cilës do të bashkoheshin edhe viset e tjera shqiptare të aneksuara nga shtetet fqinje. Komiteti konsolidimin e pavarësisë e shihte si kusht të domosdoshëm pa të cilën nuk mund të fillohej as veprimtaria çlirimtare e Kosovës dhe veprimtari të tjera të çështjes kombëtare.

Orientimin programorë të palëkundur Komiteti i Kosovës e konfirmon me kundërshtimin dhe mospranimin e politikave të Qeverisë së Durrësit të Turhan Pashë Përmetit, e cila ishte proitaliane dhe mbështeste idenë e protektoratit Italian në Shqipëri.¹⁶⁷ Komiteti nuk pranonte protektoratin apo mbikëqyrjen e shtetit Italian ndaj Shqipërisë apo të ndonjë shteti tjetër sepse ajo kishte për qëllim krijimin të një shteti të pavarur që do të hapte rrugë për krijimin e Shqipërisë etnike. Në një far forme përfaqësuesit e Komitetit të Kosovës ishin të vetëdijshëm se mbikëqyrja e mundshme ndërkombëtare e Shqipërisë, nga kushdo qoftë ajo, do të pamundësonte programin politik të Komitetit dhe Lëvizjes Nacionalçlirimtare për bashkimin e trojeve shqiptare në një shtet. Gjithashtu Komiteti dërgoi një sërë memorandumesh në Konferencën e Paqes në Paris, së cilës i kërkonte të respektohej pavarësia e shtetit shqiptar dhe të viheshin në vend padrejtësitë që ishin bërë në Konferencën e Londrës. Kështu Komiteti autorizoi Gjergj Fishtën dhe Mithat Frashërin për të paraqitur dhe për të mbrojtur çështjen e Kosovës në Konferencën e Paqes në Paris, duke u dhënë atyre edhe direktivat e nevojshme, ku theksohej se duhet "Me u përpjekë përpara pushteteve të mëdha të Antantës dhe me e kërkuar bashkimin e krahinave të Kosovës (Shkup, Kumanovë, Preshevë, Tetovë, Gostivar, Kaçanik, Ferizaj, Gjilan, Prishtinë, Vuçiternë, Mitrovicë, Jeni Pazar, Rozhajë, Pejë, Plavë, Guci, Gjakovë, Prizren) me Shqipërinë e lirë..."¹⁶⁸ Ky komitet arriti të influencojë edhe në zyrat e diplomacisë ndërkombëtare, kështu në prill të vitit 1919 presidenti amerikan Vilson e autorizoi ambasadën amerikane në Romë që ta

¹⁶⁶ Historia e Popullit Shqiptarë, III, 458;

¹⁶⁷ Kristaq Prifti, 2004, 17, 19.

¹⁶⁸ Historia e Popullit Shqiptar, III, 459.

informonte Komitetin e Kosovës se po interesohej për Shqipërinë, duke e informuar se nota e juaj ka arritur dhe se gjendja e brendshme e Kosovës ka për t'u përmirësuar.¹⁶⁹

Veprimtaria e Komitetit të Kosovës nuk përkufizohet vetëm në aspektin politiko-diplomatik, por ajo ishte aktive edhe në organizimin e veprimtarisë ushtarake. Kjo pasqyrohet kur Komiteti më 1919 përgatiti programin për çlirimin e Kosovës. Parimi kryesorë i tij ishte vetëvendosja e popujve sipas parimit “një komb-një shtet”. Në këtë periudhë Komiteti arriti të krijojë edhe çeta të organizuara, që vepronin në rajone të caktuara, si në Drenicë, në Rugovë, në Pejë, në Gjakovë.¹⁷⁰ Gjithashtu, Komiteti i Kosovës kishte përgatitur kryengritjen e përgjithshme të pranverës së vitit 1919 në 15 zona operative, e tërë kjo nën drejtimin e veteranëve të lëvizjes së popullit shqiptarë për çlirim kombëtar qysh nga periudha osmane, pra nga Hasan Prishtina, Bajram Curri, Bedri Pejani, Hysni Curri, Hoxha Kadri Prishtina, Azem Bejta e luftëtarë të tjerë të njohur.¹⁷¹ Pra, Komiteti me veprimtarinë e sajë në teren u organizua edhe në udhëheqjen e rezistencës së armatosur, përkatësisht me lëvizjen nacionalçlirimtare-kaçake.

Komiteti i Kosovës kishte përcaktuar qartë aspektin programorë dhe strategjikë të sajë, ajo kishte synim të fundit krijimin e Shqipërisë etnike, por fillimisht ishte mbrojtja e pavarësisë dhe e tërësisë tokësore e shtetit shqiptarë dhe për këtë ishte në gjendje të bashkëpunonte me çdo forcë atdhetare për arritjen e këtij qëllimi. Komiteti, gjegjësisht Hoxha Kadri Prishtina dhe Hasa Prishtina përkrahën nismën për mbajtjen e kongresit të përgjithshëm kombëtarë në Lushnjë, që do t'i bashkonte shqiptarët dhe do t'i kundërshtonte planet e Konferencës së Paqes në Paris. Qeveria e re e dalë nga Kongresi i Lushnjës përkrahu programin politik të Komitetit të Kosovës për bashkimin kombëtarë të vendit dhe sigurimin e pavarësisë së shtetit shqiptarë.¹⁷² Ajo çfarë e bënë të veçantë Komitetin si lëvizje është se ajo për realizimin e programit të sajë vuri në përdorim dy rrugë, atë paqësore, diplomatike dhe rrugën e luftës së armatosur. Pra, përpos rrugëve diplomatike që Komiteti kishte ndjekur, pra përmes kërkesave, shkresave, peticioneve, memorandumeve, letrave, botimeve, protestave dhe të tjera, ajo kishte ndjekur edhe rrugën e bashkëpunimit të

¹⁶⁹ Shih më tepër: Ethem Çeku, Shekulli i Ilegalës, Proceset gjyqësore kundër ilegales në Kosovë, Dokumente, Brezi “81, Prishtinë, 2004, 20.

¹⁷⁰ Po aty, 21.

¹⁷¹ Shih më tepër: Liman Rushiti, Lëvizja Kaçake dhe Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, Përmbledhje Kumtesash Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, 2004, 89-102.

¹⁷² Po aty, 461.

ngushtë me Lëvizjen Nacionalçlirimtare (lëvizjet kaçake) që vepronin për zgjidhjen e çështjes kombëtare që pas pavarësisë së shtetit shqiptar.

1.3 Lëvizja Nacionalçlirimtare (lëvizja kaçake)

Fillet e lëvizjes nacionalçlirimtare apo lëvizjet kaçake siç njihej ndryshe, shfaqen që nga periudha e pushtimi osman, duke vazhduar kështu edhe gjatë periudhës së pushtimit Serb. Ato rishfaqe pas pushtimit, gjegjësisht pas agresionit të forcave serbo-malazeze ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë dhe viseve tjera të pushtuara. Shqiptarët filluan të organizoheshin në grupe ose çeta të armatosura kaçake që të godisnin njësitë ushtarake policore serbe. Organizimin e këtyre grupeve e morën përsipër udhëheqësit Kosovarë, si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini, Sali Hoxha e të tjerë. Qëllimi i kryengritjeve të armatosura çlirimtare kishin për qëllimi kundërshtimin e vendimit të Fuqive të Mëdha që morën ndaj territoreve shqiptare, dhe se dëshironin bashkimin e tyre me atdheun, me Shqipërinë e pavarur.¹⁷³ Qëndresa e armatosur e popullsisë shqiptare vazhdoi edhe pas shtypjes së kryengritjes së 1913, edhe në vitin 1914 dhe 1915.¹⁷⁴ Lëvizja kaçake është forma më e lartë dhe më e dalluar e rezistencës kombëtare shqiptare.

Lëvizja Nacionalçlirimtare apo Lëvizja Kaçake, u riorganizua pas ripushtimit serbo-malazez të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare, gjegjësisht pas tërheqjes së forcave Austriake dhe Bullgare nga territoret shqiptare në përfundim të Luftës së Parë Botërore (1918). Më herët ajo ishte spontane dhe e jo e organizuar mirë, thjesht frymëzohej nga dashuria për atdheun dhe gatishmëria për ta mbrojtur atë me çdo çmim, mirëpo me shfaqjen e Komitetit veprimtaria e sajë merr qëllime të caktuara politike, në përputhje me zhvillimet ndërkombëtare, e posaçërisht me ato që kishin të bëjnë me fatin e mëtutjeshëm të shqiptarëve. Pra, tani ajo u organizua dhe u udhëhoq nga Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”.¹⁷⁵ Ndërsa për ta organizuar, strukturuar dhe kompaktësuar lëvizjen në teren u caktua Azem Bejta (Galica) komandat i çetave të armatosura në Kosovë.¹⁷⁶ Në këtë mënyrë,

¹⁷³ Kryengritja e shtatorit e vitit 1913 filloi sulmin në një ballë të gjerë nga Dibra e Ohri deri në Prizren e në Gjakovë, për t’u shtrirë më pas me viset e tjera. Kryengritësit sulmuan në katër drejtime: grupi i parë nga Qafë-Thana drejt Strugës Ohrit; grupi i dytë nga Ura e Arasit-Peshkopi-Dibër-Gostivar; grupi i tretë nga Ujmishti drejt Bicajt-Vranishtit-Prizrenit e viset e tjera të rrafshit të Dukagjinit; grupi i katërt u grumbullua në rrethin e Krasniqes e të Gashit e u hodh drejt Gjakovës, shih më tepër: Historia e Popullit Shqiptarë, III, 429.

¹⁷⁴ Po aty, 434.

¹⁷⁵ Historia e Popullit Shqiptarë, III, 461.

¹⁷⁶ Liman Rushiti, Lëvizja Kaçake dhe Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, 2004:95.

Komiteti i Kosovës krahas veprimtarisë diplomatike vendosi të përdorte edhe luftën e armatosur të çetave kryengritëse, në përpjekje për përmbushjen e qëllimit kryesorë.

Rezistenca e armatosur e lëvizjeve kaçake vazhdonte bindshëm veprimtarinë e sajë ushtarake për realizimin e “programit të kryengritjes” në të cilin parashtroheshin parimet e luftës së shqiptarëve të Kosovës për liri, të mbështetura në parimet themelore të së drejtës ndërkombëtare. Komiteti i Kosovës konsideronte se çështja e çlirimit të Kosovës dhe të trevave të tjera si problem të Shqipërisë, pjesë të së cilës ishin këto treva dhe se nuk duhet llogaritur se fati i atdheut i përket vetëm diplomacisë botërore. Në këtë mënyrë Komiteti këshillonte dhe kërkonte nga veprimtarët e tij, të përgatiteshin për t’i bërë ballë çdo rreziku.¹⁷⁷ Kështu kryengritja mori përmasa të gjëra që nga viti 1919 dhe arriti të shndërrohej në kryengritje të përgjithshme në të gjitha viset shqiptare të pushtuara nga ushtria Serbe. Çetat kundërshtonin kudo masat e pushtetit serb për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova, mbronin popullsinë nga gjenocidi serb, nga shpërnguljet me dhunë, nga dhuna për ndryshimin e fesë, dhe mbi të gjitha kishin për qëllim çlirimin e tokave shqiptare të robëruara. Megjithatë, kryengritja nuk arriti të shpërthente njëkohësisht në të gjitha viset e Kosovës dhe nuk u zhvillua me të njëjtën forcë në të gjitha hapësirat dhe kështu ajo arriti të shtypej nga forcat e shumta ushtarake të xhandarmërisë dhe njërive çetnike. Lëvizja nacionalçlirimtare shënon një ngritje në rezistencën ndaj forcave Serbe me krijimin e “Zonës Neutrale” të Junikut, zonë kjo që u formua me vendimin e Komisionit Ndërkombëtarë të Kufijve, në kufirin midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë. Kështu kjo zonë mbeti si forca strategjike e kryengritësve shqiptarë dhe nën drejtimin e Komitetit të Kosovës deri në likuidimin e sajë nga Ahmet Zogu dhe forcat Jugosllave.¹⁷⁸ Por, pavarësisht kësaj Lëvizja kaçake vazhdonte veprimtarinë deri më 1928 edhe pse veprimtaritë luftarake të saja qenë më të rralla dhe me çeta më të vogla.¹⁷⁹

Lëvizja nacionalçlirimtare apo lëvizja kaçake e viteve 1918-1928, përbënë një nga ngjarjet më të rëndësishme të rezistencës së popullsisë së Kosovës për çlirimin nga robëria serbe, ajo në mënyrë kohezive vazhdoi projektin nationalist të Rilindasve për bashkimin e trojeve shqiptare në një shtet. Ajo së bashku me Komitetin e Kosovës nuk lëvizën asnjëherë nga

¹⁷⁷ Kristaq Prifti, 2004, 31.

¹⁷⁸ Liman Rushiti, 2004, 101.

¹⁷⁹ Shih më tepër. Historia e Popullit Shqiptarë, III, 465-469.

parimet nacionaliste shqiptare të përcaktuara qysh në fillim të veprimtarisë së tyre, “për të përdorur çdo mjet për me e çlirue Kosovën e Dibrën dhe çdo vend ku flitet shqip, e me i bashkue nën sundimin e Shqipërisë së lirë”.¹⁸⁰ Përputhja e njësisë politike me njësinë kombëtare, duke mos përjashtuar asnjë mjetë, gjë të cilën e dëshmuar edhe me qëndresën luftarake ndaj pushtuesit serb, ishte qëllimi final i lëvizjes kaçake. Lufta e armatosur e lëvizjeve kaçake e gërshetuar me aspektin ideor dhe diplomatike të Komunitetit të Kosovës dhe me luftën politike parlamentare të Baxhkimit-Xhemijetit, përbrenda shtetit jugosllav kishte një qëllim të përbashkët, të pengonte politikën shoviniste serbe për asgjësimin e shqiptarëve dhe të bënte bashkë të gjitha trojet shqiptare në një njësi politike.

2.3 Partia Bashkimi (Xhemijeti) dhe përpjekja parlamentare

Presioni mbi shqiptarët e Kosovës ishte i ndryshëm dhe ishte prezent në të gjitha poret e jetës shoqërore. Ndaj të gjitha persekutimeve shqiptarët duhet t’iu përgjigjeshin, t’i kundërviheshin në mënyra të ndryshme, legale dhe jolegale, duke filluar nga veprimtaritë e sipër përmendura, shpesh në formë edhe ilegale e deri tek forma legale siç ishte Partia politike. Krahas veprimtarisë diplomatike dhe luftarake, shqiptarët u organizuan edhe në politikën aktive në Mbretërinë e SKS-së, që të zhvillonin rezistencën edhe përmes rrugëve politike apo legale. E gjithë kjo për të mbajtur gjallë frymën politike atdhetare dhe për t’i treguar botës së qytetëruar të drejtat e pakontestuar të popullit shqiptarë.

Partia Bashkimi ose Xhemijeti (turq. xhemijet-bashkimi), e cila e kishte emrin e plotë “Shoqata Islamike për Mbrojtjen dhe Drejtësi”, u formua për të përfaqësuar interesat e shqiptarëve mysliman, në Kosovë dhe Maqedoni, ajo u themelua në Shkup në dhjetor të vitit 1918.¹⁸¹ Për shkak të aktiviteteve luftarake gjatë luftërave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore popullata shqiptare nuk pati mundësi të organizohej politikisht, mirëpo menjëherë pas përfundimit të luftërave u krijuan mundësitë për organizim politik kryesisht në baza fetare në kuadër të Mbretërisë së SKS-së. Për shkak të rregullave ligjore, shqiptarët, turqit, boshnjakët dhe të tjerët, nuk kishin mundësi të organizoheshin politikisht në baza etnike,

¹⁸⁰ Liman Rushiti, 2004,102.

¹⁸¹ Bashkimi fillimisht dhe më vonë Xhemijeti, veprimtaria e sajë e kishte filluar që në kohën e Perandorisë Osmane, atëherë kur pas revolucionit të Xhon-turqëve, Lëvizja Kombëtare Shqiptare u angazhua në themelimin e klubeve shqiptare. Kështu formohet edhe klube politike dhe kulturore me emrin “Bashkimi”. Për më tepër mbi origjinën, formimin dhe veprimtarinë e sajë: Skender Asani, Xhemijeti, Veprimtaria e organizatës politike Xhemijeti në trevat lindore (1919-1925), Logos A, Shkup, 2017, 25-31; Historia e Popullit Shqiptarë, III, 469-473.

dhe ata u detyruan të bashkoheshin në baza fetare dhe kështu formuan organizatën politike të myslimanëve të quajtur “Xhemijet”.¹⁸² Pavarësisht emërimit zyrtar që ishte konform detyrueshmërisë ligjore, shumica e anëtarëve të sajë ishin shqiptarë dhe dëshmonin vetëdijen e tyre etnike shqiptare, gjithashtu këtë e dëshmonin edhe përmes veprimtarisë së tyre politike, që zakonisht në të shumtën e rasteve kamufloheshin apo mbuloreshin si nisma për të drejtat e myslimanëve në kuadër të SKS-së. Kuvendi themelues zgjodhi Këshillin Qendrorë dhe Këshillin Mbikëqyrës, dhe Kryetar i Këshillit qendrorë u zgjodh Nexhip Draga¹⁸³ nga Mitrovica, nënkryetar Sheh Sabedini nga Tetova, ndërsa sekretarë Aqif Bluta nga Pazari i Ri.¹⁸⁴

Partia Politike Bashkimi ishte tejet e kujdesshme në artikulumet dhe kërkesat politike që adresoheshin, ato kryesisht duhet të ishin të dominuara me përmbajtje fetare sepse shqiptarë nuk gëzonin mundësinë e organizimit etnik pasi që këtë të drejtë kushtetuese e kishin vetëm tre popujt që kishin themeluar Mbretërinë e SKS-së, dhe kështu mos të krijonin hapësirë për t’u etiketuar si parti etnike shqiptare, sepse do të shkaktonte reaksion te qarqet radikale serbe, dhe pastaj të eliminoheshin nga skena politike. Në thelb, partia Xhemijeti vepronte si një parti e ligjshme shqiptare, ajo bëri përpjekje për të siguruar në rrugë ligjore të drejtat themelore politike-kulturore të popullsisë shqiptare dhe të etnive të tjera myslimane. Në këtë kontekst mund t’iu referohemi deklarimeve të Xhemijetit që i dha mbi synimin e Beogradit për të aneksuar Shkodrën, “Shkodra kurrë nuk do t’i takojë Jugosllavisë dhe se duke u përpjekur ta aneksoj atë, ky shtet synon të largoj vëmendjen nga gjendja tragjike e Popullit të Kosovës”.¹⁸⁵ Sipas Skender Asani falë fuqizimit të Xhemijetit në vitet 1922-1924, Mbretëria e SKS-së nuk arriti të nënshkruaj një marrëveshje me Turqinë për shkëmbimin e popullatës, siç e kishin nënshkruar në 30 janar 1923 në Lozanë marrëveshjen e veçantë turko-greke, mbi shkëmbimin e grekëve të Anadollit me Turq të(ku u përfshinë

¹⁸² Skender Asani, Xhemijeti, Veprimtaria e organizatës politike Xhemijeti në trevat lindore (1919-1925), Logos A, Shkup, 2017, 16.

¹⁸³ Nexhip Draga prejardhja e të cilit është nga familja Draga, e cila ishte protagoniste në tri periudhat e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ali pashë Draga, babai i Nexhip Dragës, ishte anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe mori pjesë aktive në Lidhjen Shqiptare të Pejës 1899. Ai ishte deputet në zgjedhjet e para për Parlamentin e Turqisë, për Sanxhakun e Shkupit të Vilajetit të Kosovës së bashku me Ismail Qemalin, Hasan Prishtinën, Shahin Kolonjën e të tjerë. Shih: Skender Asani, Xhemijeti, Veprimtaria e organizatës politike Xhemijeti në trevat lindore (1919-1925), Logos A, Shkup, 2017, 15-21.

¹⁸⁴ Historia e Popullit Shqiptarë, III, 469.

¹⁸⁵ Po aty, 470.

shqiptarët e besimit mysliman të Çamërisë) Greqisë.¹⁸⁶ Këtu vlen të theksohet që pas presionit politik të Xhemijetit lejohet edhe hapja e Shkollës së Mesme Profesionale, përkatësisht Medreseja e Madhe në Shkup, si shkollë myslimane, kështu duke e kamufluar arsimimin në gjuhën anëtare me atë fetare.

Që Xhemijeti veprimi në mbrojtje të interesave të kombëtare, tregon edhe bashkëpunimi apo koordinimi i përfaqësuesve të tyre me Komitetin e Kosovës dhe Lëvizjen Kaçake. Ferhat Draga ishte i lidhur me Komitetin për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës me seli në Shkodër, me Hasan Prishtinën, Bajram Currin e me Azem Bejtën. Madje vëllai i vogël i Nexhip e Ferhat Dragës, Shefqet Draga ishte po ashtu kaçak dhe bashkëluftëtar i bajram Currit. Kësisoj, përmes aktiviteteve të kaçakëve Ferhat Draga e orientonte gjithë aktivitetin që t'i eliminonte zullumçarët më të mëdhenj të popullit tonë.¹⁸⁷ Xhemijeti me organet e saja kanë luajtur një rol të rëndësishëm për realizimin e të drejtave të shqiptarëve dhe demaskimin e politikave shoviniste serbomadhe ndaj shqiptarëve të Jugosllavisë së parë. Këtu është e rëndësishme të përmendim se çfarë thotë për Xhemijetin dhe për Ferhat Dragën në gazetën "Politika" të vitit 1923 babai i sociologjisë serbe, Sreten Vukosavljeviq, "Mos mendoni se kjo është një organizatë fetare, absolutisht, jo. Kur kanë qenë në rend dite në parlamentin tonë çështjet fetare, ata nuk kanë parë këtë si prioritet. Këta janë thjeshtë një organizatë nacionaliste. Madje "Xhemijetin" e udhëheqin nationalistët më të mëdhenj që kanë pasur shqiptarët, ata që e kanë organizuar Kongresin e Dibrës 1909, ku në mënyrë të qartë janë formuluar kërkesat e tyre për pavarësi, për Shqipërinë prej Adriatikut deri në Seres e në Shtip dhe rreziku i shtetit tonë vjen pikërisht nga kjo organizatë."¹⁸⁸

Partisë Bashkimi nuk i mungonin iniciativat politike për të parandaluar tendencat e hapura të Mbretërisë së SKS-së për mohimin e elementit nacional përbrenda Mbretërisë, mirëpo ato nuk merrnin vëmendjen dhe refuzoheshin. Ajo provoi të gjitha rrugët institucionale për ngritjen e etnitetit shqiptarë duke hyrë në bashkëpunim me kushte edhe me Partinë Radikale të N. Pashiq, sidomos mbi çështjen arsimore, të reformës agrare dhe kolonizimit, por kryesisht ishin nisma të pasuksesshme. Radikalët ishin të interesuar të përfitonin vetëm votat e Xhemijetit në Kuvend, ndërsa në momentet kyçe ata reflektonin ashpërsinë ndaj

¹⁸⁶ Skender Asani, 168.

¹⁸⁷ Nexhmedin Spahiu, Xhemijeti si pararendëse e LDK-së së Rugovës, Revista Shenja, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Nr. 105. Janar 2020, 34.

¹⁸⁸ Po aty, Cituar nga Nexhmedin Spahiu.

kërkesave të organizatës. Pra, Pavarësisht rrethanave të vështira dhe të pamundura në këtë periudhë Xhemijetu u përpoq të realizoj të drejtat kombëtare në kuadër të Mbretërisë së SKS-së. Këtë veprimtari ajo e vazhdoi fuqishëm deri në krijimin e fraksioneve të brendshme që e dëmtuan dhe e çuan në zhbërje (1925). Gjithashtu edhe çarja e brendshme lidhet për apo kundër bashkëpunimit me Partinë Radikale në zgjedhjet e 1925-tës, gjegjësisht me orientimet programore të dy fraksioneve të krijuara. Fraksioni i paraprirë nga Ferhat Draga¹⁸⁹ përpiqej që të dalin në zgjedhje si të pavarur, dhe kishte për qëllim parashtrimin e kërkesave për barazi nacionale dhe për të drejta politike e kulturore të myslimanëve nga trevat lindore, Kosova dhe Sanxhaku, çka nënkuptonte përpjekjen për diferencimin e organizatës nga angazhimet fetare drejt elementeve më kombëtare. Ndërsa tjetri i paraprirë nga Qenan Zijau dhe Halim Deralla apo rryma e moderuar përpiqeshin për vazhdimin e koalicionit me Partinë Radikale. Kjo ndarje kulmoi në gjysmën e dytë të vitit 1924, kur fraksioni i Qenan Zijahut formoi organizatë tjetër politike, dhe kjo rezultoi që me zgjedhjet parlamentare të 1925 Xhemijeti të mos fitoj asnjë deputet, kundrejt 14 që i kishte në legjislaturën paraprake. Orientimet programore të Xhemijetit të Ferhat Dragës shprehnin qartë luftën kundër centralizimit dhe regjimit serb, kështu dhe filloi terrori ndaj aktiviteteve politike të Xhemijetit, dhe rezultoi me burgosjen e kryetarit i Ferhat Draga dhe u kryen dhunë sistematike gjatë kohës së fushatës parazgjedhore të 1925-ës.¹⁹⁰

Ndryshimi i diskursit politik të udhëheqësve të Partisë Bashkimi, gjegjësisht Ferhat Dragës dhe anëtarëve të tjerë të Partisë i kushtoi me burgosje dhe masa të jashtëzakonshme represive. Ai fajësohej për armiqësi ndaj shtetit dhe posaçërisht për irredentizëm shqiptarë, sepse bashkëpunonte me Komitetin e Kosovës dhe se kishte lidhje me aksionet e kaçakëve në trevat lindore, Kosovë dhe Sanxhak. Fakti që Xhemijeti shprehu mosgatishmërinë për të bashkëpunuar më me Partinë Radikale të N. Pashiqit, dhe orientimi i sajë programorë filloi të kanalizohet drejtpërdrejt mbi problemet më nacionale të shqiptarëve të ish-Jugosllavisë, ajo u shndërrua në armike e shtetit. Kështu autoritetet duke e shfrytëzuar “Ligjin për Mbrojtjen e Shtetit”, arrestonin mbështetësit e Xhemijetit, në mënyrë që të eliminonin këtë forcë politike që në vete mbarte realizimin e programit dhe të drejtat kombëtare të popullit

¹⁸⁹ Ferhat Draga ishte vëllai i Nexhip Dragës, që pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, kishte filluar hapur të punoj për krijimin e Shqipërisë Etnike, dhe njihej për bashkëpunim të ngushtë me Komitetin e Kosovës dhe Lëvizjen Kaçake, Skender Asani, 83.

¹⁹⁰ Skender Asani, Xhemijeti, Veprimtaria e organizatës politike Xhemijeti në trevat lindore (1919-1925), Logos A, Shkup, 2017, 168-172,

shqiptarë. Qasja e shtetit serb ishte tërësisht shtypëse dhe eliminuese ndaj çdo iniciative me karakter nacional, pra agresioni shtetëror ishte totalizues dhe në çdo pore të jetës.

Në mënyrë të përgjithësuar mund të thuhet se lufta politike e shqiptarëve në këtë periudhë zhvillohej në të gjitha frontet. Përpyekja radikale apo jolegale e udhëhequr prej Komitetit Mbrojtja Kombëtare të Kosovës dhe Lëvizjes Kaçake, gjithashtu përpyekja legale e udhëhequr nga Partia “Bashkimi”, e cila ishte e vetëdijshme për gjendjen e krijuar dhe luftonte për të drejta të shqiptarëve në kuadër të sistemit. Kjo iniciativë njëherit e ndërmarr në formë konsesuale me përfaqësuesit e Komitetit të Kosovës dhe Lëvizjes Kaçake kishte për qëllim rezistencën e brendshme të shqiptarëve që mohoheshin dhe trajtoheshin si joekzistent nga pushteti Jugosllav. Rezistenca legale edhe pse e ndrydhur në artikulum për shkak gjendjes ekzistuese përnaltësonte çështjen shqiptare dhe të drejtën e tyre të paraparë me norma ndërkombëtare. Lufta politike dhe ushtarake e nacionalistëve shqiptarë ishte që të ruhet tërësia territoriale e popullit shqiptarë dhe se shqiptarët për asnjë çmim nuk duhet t’i lëshojnë territoret e veta. Kjo lëvizje ishin produkt lëvizjes së përgjithshme nacionale shqiptare të kohës, për të konfirmuar dhe ruajtur frymën dhe ndërgjegjen nacionale dhe detyrat që ajo kishte ndaj çështjes kombëtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare.

2. Qasja “neutrale” e shtetit shqiptarë ndaj lëvizjeve nacionaliste shqiptare në Kosovë

Rëndësia i shtetit shqiptar ndaj çështjes së Kosovës dhe viseve tjera shqiptare, gjegjësisht ndaj lëvizjeve politike të kohës determinon njëherit edhe suksesin apo mos suksesin e ndaj çështjes në fjalë. Në vazhdim do t’iu referohemi përgjithësisht qeverive të shtetit shqiptar mbi çështjen e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavinë e parë. Këtu mund të përmendim qëndrimin e Qeverisë së Vlorës ndaj kryengritjes antiserbe të vitit 1913, e cila bënte thirrje për maturi, në mënyrë që qëndrimet e saja të mos interpretoheshin si ndërhyrje e drejtpërdrejt dhe në mbështetje të kryengritjes shqiptare, përkundër asaj që ministër në këtë qeveri ishte edhe Hasan Prishtina.¹⁹¹ Qeveria e Vlorës ishte mjaft e zëshme dhe aktive mbi agresionin serb në Kosovë dhe viset tjera shqiptare dhe përkundër përkrahjes së kryengritjes së shtatorit ajo vendosi të qëndroj neutrale, të mbaj qëndrim të

¹⁹¹ Historia e Popullit Shqiptar, III, 2007, 48.

përmbajtur dhe mos të përfshihet zyrtarisht në këtë çështje. Qeveris së përkohshme të Vlorës, i mungonte uniteti i brendshëm sidomos përball fuqive ndërkombëtare, gjithashtu mbizotëronte ideja se ajo nuk mund të hynte në luftë të hapur për ndryshimin e kufijve sepse do të rrezikonte edhe atë shtet të sapoformuar.¹⁹²

Shteti shqiptarë, si shtet i ri që ishte preokupohej me njohjen ndërkombëtare të saj, andaj të gjithë ata që konsideroheshin pengesë për një arritje të tillë perceptoheshin ndryshe dhe si problem që duhet zgjidhur nga shteti shqiptarë, kështu filloi të perceptohej edhe Lëvizja Kombëtare. Qeveria e Sulejman Delvinës fërkimin e parë do ta ketë me Komitetin “Mbrotjta Kombëtare e Kosovës”, atëherë kur ajo u detyrua të pengoj zbarkimin e armëve në bregdetin shqiptar, të dedikuar për Lëvizjen e armatosur në Kosovë, e cila udhëhiqej nga Azem Galica. Në këtë rast ndërhyne personalisht kryeministri Delvina, që armët e nisura nga G. D’Ancunio të mos zbarkohen në asnjë port të Shqipërisë.¹⁹³ Përplasjet e shtetit Shqiptarë më lëvizjen kombëtare acarohen edhe më tej në vazhdim, kur Sulejman Delvina në fillim të shtatorit, do të dërgoj një delegacion në Shkodër për të hyrë në bisedime me jugosllavët, që t’ju bëj me dije përfaqësuesit të saj, Neshiq, se qeveria shqiptare nuk përkrahte kurrfarë veprimtarie të Lëvizjes së Rezistencës Kombëtare në Kosovë dhe se nuk do të lejonte as veprimet që mund të çonin te armatosja e saj nëpërmes Shqipërisë.¹⁹⁴ Të njëjtat zotime u desh t’i bëjë edhe qeveria e Iljaz Vrionit, e cila në nëntor 1920 zëvendësoi atë të Sulejman Delvinës, për më tepër edhe Iljaz Vrioni u detyrua të parandaloj ndikimin e Italisë te Komiteti “Mbrotjta Kombëtare e Kosovës” që sipas tyre, mund të destabilizonte qeverinë shqiptare për qëllimet e veta.¹⁹⁵

Qëndrimet e shtetit Shqiptar ndaj Lëvizjes Kombëtare Shqiptare u përkeqësuan edhe më tepër pas pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve (dhjetor 1920). Kjo për faktin se shteti Shqiptar brenda një afati dy vjeçar duhej t’i ratifikonte marrëveshjet shtetërore me Greqinë dhe Mbretërinë e SKS-së. Shikuar nga ky aspekt, lëvizja kombëtare projektohej si lëvizje çlirimtare për popullin e mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë, si lëvizje destabilizuese për shtetin shqiptarë, si lëvizje irredentiste nga shteti Jugosllav, apo thënë më mirë ajo

¹⁹² Po aty, 431.

¹⁹³ Shih më tepër: Hasan Prishtina, Sjellje e Serbisë Kundrejt Shqipërisë, Revista Shenja, Nr. 16, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, 2012, 21; Tahir Abdyli, Hasan Prishtina, GME, 2003, 232.

¹⁹⁴ Jusuf Buxhovi, Kosova nga Konferenca e Londrës deri te pretektorati ndërkombëtar, Prishtinë: Faik Konica, 2012, 185.

¹⁹⁵ Rreth qëndrimeve të qeveris së Iljaz Vrionit Shih: Po aty,185.

tashmë perceptohej si lëvizje irredentiste si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. Kundrejt logjikës dhe vetëdijes kombëtare triumfoj logjika dhe vetëdija shtetërore, pavarësisht se bëhet fjalë për Lëvizjen Kombëtare e cila ishte më meritorë për shpalljen e shtetit të pavarur shqiptar. Pra lëvizja në njëfarë forme u shndërrua në problem të madh shtetërorë, çka ndikoi edhe në diskurset dhe qëndrimet politike të mëtutjeshme të qeveritarëve të ardhshëm. Këtu mund të përmendim Qeverinë e Hasan Prishtinës më 7 dhjetor, si Qeverisja më e shkurtër shqiptare ndonjëherë, sepse ai ishte anëtar i Komitetit të Kosovës, dhe mbështeste vazhdimin e luftës për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Kështu, kabineti i Hasan Prishtinës dha dorëheqje më 12 dhjetor 1921, për të evituar gjakderdhjen, sepse në vend ishte krijuar një situatë e rrezikshme.¹⁹⁶

Qeveria e Nolit edhe pse u mbështet me forcë nga grupi i Komitetit të Kosovës për përmbysjen e qeverisë së Zogut, siç njihet ndryshe Revolucioni Demokratik i Nolit, ai la jashtë jetës politike shqiptarët e Kosovës që e ndihmuan në këtë proces, si Hasan Prishtinën, Bajram Currin e të tjerë, duke mbajtur kështu qëndrim neutral ndaj idesë së bashkimit të Kosovës dhe viseve tjera me Shqipërinë. Ai çështje e Kosovës e trajtonte si çështje të brendshme të Jugosllavisë, dhe kështu shpresonte që përmes Lidhjes së Kombeve, duke e ndërkombëtarizuar problemin e tyre do të mund të përmirësonte gjendja e vështirë e vëllezërve kosovarë. Noli nuk ishte i gatshëm dhe i përgatitur të kërkonte rishikimin e kufijve me Jugosllavinë, por vetëm për çështjen e Shën Naumit dhe Vermoshtit.¹⁹⁷ Fan Noli në një intervistë dhënë një gazetës nga Beogradi pohon se “U është dhënë urdhër tërë prefekturave të marrin masa të rrepta kundër të gjithë atyre që duan të përdorin Shqipërinë si bazë për të provokuar turbullira në shtetet fqinje, qofshin ata shqiptarë ose të huaj.”¹⁹⁸ Në këtë kontekst vlen të përmendet edhe qasja që Noli ka ndaj Komitetit të Kosovës dhe kauzës së tyre, kur thotë se “Sa u përket Kosoviotëve (nënkuptonte anëtarët e Komitetit të Kosovës) qeveria ka marrë masa që ata të rrinë urtë dhe ju siguroj që kanë për të ndenjur urtë. Një vend i vogël, siç është vendi ynë, i dobët dhe i varfër, nuk mund t’i lejojë vetes luksin e irredentizmit.”¹⁹⁹ Noli ishte në përpjekje të vazhdueshme për t’i bindur Jugosllavët se nuk kërkonte asgjë nga ta, e aq më pak luftë, por vetëm vendosjen e marrëdhënieve

¹⁹⁶ Taihir Abdyl, Hasan Prishtina, GME, 2003, 238.

¹⁹⁷ Rober Austin, Fan Noli dhe një revolucion i iku, Koha, 2011, 171-180.

¹⁹⁸ Mensur Raifi, Fan Noli dhe çështja e Kosovës, Shoqata e përkthyesve letrarë të Kosovës, Prishtinë, 1995, 51.

¹⁹⁹ Po aty, 52.

diplomatike në mes dy vendeve dhe njohjen nga shteti Jugosllavë. Fan Noli, për marrëdhëniet me Jugosllavinë e Greqinë që kishin aneksuar pjesën të territoreve dhe të kombit shqiptar, nisej nga ideja e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, të miqësisë, të një ere të re në marrëdhëniet me këto vende, të harrimit të së kaluarës dhe ndërtimit të një të ardhmeje të re.²⁰⁰ Qëndrimi i qeverisë së Tiranës nuk do të thoshte se qeveria shqiptare nuk e kishte mbështetjen ndaj popullsisë shqiptare në Kosovë, përkundrazi ajo bëri shumë që të ndërkombëtarizoj çështjen e Kosovës në arenën ndërkombëtare, mirëpo qëndrimi i saj nuk e kalonte logjikën shtetërore dhe nuk mund të krijonte konflikt për këtë çështje. Ky qëndrim dhe të tjerat në raport me çështjen e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare nuk mund të kuptohen dhe kalohen mbi parimin politik të nacionalizmit shqiptarë. Këtu bëhet fjalë për parimet e realpolitikës, parimet e marrjes, ruajtjes dhe forcimit të pushtetit.

I të njëjtës linjë qëndron edhe veprimtaria politike e Qeverisë së Zogut dhe më pas Mbretëria e tij. Ai i përmbahej idesë për marrëdhënie të mira me shtetet fqinje, çka e çon atë në marrëveshje me Jugosllavinë për njohjen ndërkombëtare të shtetit shqiptarë në kufijtë e Versajës, që për kundërvlerë kishte heqjen dorë nga çfarëdo përkrahje të lëvizjes irredentiste në Kosovë si dhe eliminimin e të gjitha burimeve të dukshme dhe të padukshme prej nga ajo mund të shfrytëzohej apo mbahej.²⁰¹ Kështu, duke filluar me likuidimin e Zonës Neutrale së bashku me ushtrinë Jugosllave,²⁰² dhe pastaj përndjekjen dhe vrasjen²⁰³ e figurave kryesore të Lëvizjes Nacionale, Zogu dëshmonte se Shqipëria është e përkushtuar për fqinjësi të mirë dhe po përmbushte detyrimet e saja ndërkombëtare. Në emër të fqinjësisë së mirë ai “zgjidhi” edhe detyrat e lëna nga protokollet e Fuqive të Mëdha për territoret e diskutueshme në Shën Naum dhe Vermosh, duke e njohur sovranitetin e Jugosllavisë mbi çështjet e kontestuara territoriale. Gjithashtu ai la jashtë jetës politike dhe administrative të gjithë Kosovarët, me pretekst se viset e tyre, ato që ata përfaqësojnë, ishin nën okupimin e Serbisë, dhe Kosovarët nuk mund të merrnin pjesë më në pushtetin e Shqipërisë, duke zgjidhur kështu problemin e Kosovarëve. Ahmet Zogu stabilizoi shtetin

²⁰⁰ Hysamedin Feraj, 2010, 278.

²⁰¹ Jusuf Buxhovi, Kosova nga Konferenca e Londrës deri te protektorati ndërkombëtar, Prishtinë: Faik Konica, 2012, 193.

²⁰² Po aty, 204.

²⁰³ A. Zogu zhduku disa nga kundërshtarët e tij kryesorë, pavarësisht nëse ata ishin atdhetarë të shquar dhe njerëz të nderuar nga populli. I tillë ishte Zija Dibra, Luigj Gurakuqi, Bajram Currin, Shih më tepër: Blendi Fevziu, Presidenti që u bë Mbret Ahmet Zogu, Uetpress, Tiranë, 2014, 77-86; Historia e Popullit Shqiptarë, III, 2007, 252.

shqiptarë duke i plotësuar kërkesat e fqinjëve, që ishin si kusht për fqinjësi të mirë, fillimisht duke hequr dorë ndaj çështjes së Kosovës dhe viseve tjera të mbetura jashtë kufijve etnik, pastaj duke ju falur territore shqiptare. Të kundërtën e asaj çfarë mendonin nacionalistët shqiptarë, gjegjësisht Hasan Prishtina, i cili mendonte se fqinjësia e mirë mund të arrihet vetëm pas çlirimit dhe bashkimit të viseve shqiptare me Shqipërinë sepse ato ndodheshin nën sundimin Serb dhe Grek. Pra, Zogu mendonte se brenda kufijve politik që kishte përcaktuar Konferenca e Ambasadorëve në Londër, Shqipëria mund të zhvillohej ekonomikisht, kulturalisht dhe politikisht, kundrejt idesë në nacionalistëve shqiptarë që një gjë e tillë nuk mund të bëhet. Sipas H. Ferajt, zogizmi konsiderohet armiku kryesorë i nacionalizmit shqiptarë, pas rikthimit të tij në pushtet, ai dënoi me vdekje, i ndoqi dhe i luftoi deri sa arriti dhe t'i vriste udhëheqësit e nacionalizmit shqiptarë, jo vetëm Bajram Currin, por edhe vet Hasan Prishtinën. Gjithashtu edhe sipas historianit Jusuf Buxhovi Zogu në bashkëpunim me qeverinë Jugosllave likuidoi “Zonën Neutrale” të Junikut, si zonën ku strehoheshin dhe organizoheshin Komiteti i Kosovës dhe Lëvizja Kaçake.

Qeveritë e Shqiptare përgjithësisht kishin zgjedhur rrugën e neutralitetit dhe logjikës shtetërore, kundrejt logjikës kombëtare dhe bashkimit të viseve shqiptare në një njësi politike. Ata përfaqësonin mendimin politik jo nacionalist në mendimin politik shqiptar, sepse veprimtaria e tyre politike ishte për t'iu shmangur luftës së armatosur dhe problemi kombëtar nuk duhej të zgjidhej përmes luftës, sepse një politikë e tillë konsiderohej “aventurizëm politik”(Ahmet Zogu), dhe se mund të çoj deri te zhbërja e shtetit shqiptarë. E kundërta e tyre, pra nacionalistët shqiptarë mendonin se Shqipërinë e bashkuar e pamundëson jouniteti politik dhe ushtarak i shqiptarëve, sepse nëse në mënyrë unike punohet për bashkimin e territoreve shqiptare dhe me luftë të armatosur një gjë e tillë është e mundshme. Hasan Prishtina theksonte se forcimi i lëvizjes çlirimtare të Kosovës dhe bashkëveprimi në një front do të lehtësonte ekzistencën e një Shqipërie demokratike dhe, nga ana tjetër, do të pengonte Jugosllavinë dhe zogistët që ishin strehuar atje të realizojnë planet e tyre antishqiptare kundër Kosovës dhe Shqipërisë.²⁰⁴ Nacionalistët shqiptarë për mundësin e zhbërjes së shtetit shqiptarë, nëse ata bëjnë luftë të përgjithshme popullore për bashkimin e trojeve e konsiderojnë frik që po mbjellin antinacionalistët nën ndikimin e

²⁰⁴ Mensur Raifi, Fan Noli dhe çështja e Kosovës, Shoqata e përkthyesve letrarë të Kosovës, Prishtinë, 1995, 61.

Serbisë dhe Greqisë, dhe kështu kundrejt sajë ata kishin zgjedhur dhe ishin përcaktuar për ruajtjen dhe forcimin e pushteteve të tyre individuale.

3. Ligjërimi politik serb ndaj Kosovës

Politikat represive serbe përmes agresionit, shpërnguljes, shpronësimit dhe kolonizimi, të zbatuara në mes të dy luftërave botërore dominuan diskursin ligjërimorë Serb të Mbretërisë së SKS-së. Ky ligjërim i materializuar në plane dhe projekte politike e ka origjinën nga mendësia strategjike e Beogradit për krijimin e “Serbisë së Madhe”, tek ideja Ilia Grashaninit projekti “Naçertania”. Por, ligjërimi i homogjenizimit etnik, filloi të aplikohet që nga 1912 e deri në vitin 1999, nga qarqet e ndryshme politike Serbe në Kosovë dhe viset e tjera shqiptare. Shpërnguljet e para masive të shqiptarëve u bënë menjëherë pas pushtimit dhe aneksimit të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare. Këtu, mund të përmendim aksionet e mbledhjes së armëve që organizoheshin pothuajse për çdo vit, me këtë rast arrestoheshin, torturoheshin, digjeshin shtëpitë, likuidoheshin burra, pleq, gra dhe fëmijë në tërë hapësirat shqiptare. Si pasojë e këtij terrori permanent u shpërngulën një numër i madh i shqiptarëve nga viset e tyre.²⁰⁵ Për gjenocidin serb mbi popullsinë shqiptare mund të përmendim Promemorien e tre famulltarëve të Kishës Katolike Shqiptare në Kosovë: Don Jovan Bisaku, Don Shtjefan Kurti dhe Don Luigj Gashi, dërguar me 5 maj 1930 sekretarit të Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, Erik Dramondit, në të cilën thuhej se para okupacionit serb, shpërngulja kishte qenë tërësisht e panjohur për banorët shqiptarë që shtrihen në viset të cilat tash janë nën sundimin jugosllav. Sipas tyre, “arsyet për shpërnguljen e masave që vërehet që nga viti 1912, pa dyshim se janë përndjekja e çdo shtrese, me qëllim që t’i detyrojnë t’i lëshojnë vatrat e tyre.”²⁰⁶ Ligjërimi politik Serb ishte i orientuar në dëbimin me forcë të elementit shqiptarë përbrenda Kosovës, ku përmes dëbimit, politikave shpronësuese dhe formave të ndryshme represive të ndikoj në ndryshimin e strukturës së popullsisë në Kosovë. Sipas Oliver J Schmitt, në periudhën mes dy luftërave botërore numri i shqiptarëve të Kosovës që kishin braktisur Kosovën nën presionin e autoriteteve sillej diku rreth 90.000 deri 150.000 njerëz, të cilët emigruan në Shqipëri, Bullgari dhe Turqi.²⁰⁷ Këto

²⁰⁵ Sipas vlerësimit të konsullit turk në Selanik shifrat e të shpërngulurve për në Turqi midis viteve 1918-1923 arrinte 30 000 deri në 40 000 veta, shumica e tyre ishin fshatra të banuara me shqiptarë. Shih më tepër: Historia e Popullit Shqiptar, III, 2007, 484.

²⁰⁶ Qerim Lita, Procesi i shpërnguljes së shqiptarëve nga trevat verilindore gjatë shekullit XX, Revista Shenja, E përmuajshme mbarëkombëtare politike, ekonomike dhe kulturore, nr 78, tetor 2018, 16.

²⁰⁷ Oliver J Schmitt, Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike, 158.

qëndrime ishin në përputhje me pikëpamjet e shumë zyrtarëve dhe intelektualëve serb. Këtu mund të ju referohemi anëtarëve të “Klubit Kulturorë Serb të Beogradit”, si Orestie Krstiq, që propozonte se “duhet të blihen tokat nga shqiptarët, por natyrisht vetëm, në qoftë, se nuk mund t’u merren pa ndonjë kompensim, një anëtar tjetër i këtij Klubi, Gjoka Perin, mendonte se në “Serbinë Jugore duhet të formohet një shumicë e nevojshme prej 67.5% e serbëve, prandaj enkas për këtë qëllim, ai propozonte kolonizimin e Kosovës me 470 000 kolonistë, e njëherësh edhe dëbimin e 300 000 shqiptarëve nga Kosova.”²⁰⁸

Ndërsa një ndër anëtarët më të shquar të këtij klubi Vasa Çubriloqi, akuzonte për dështimin e kolonizimit korrupsionin e lartë dhe paaftësinë e administratës serbe, gjithashtu dhe natalitetin e lartë të shqiptarëve. Sipas tij, përball shtimit të popullsisë shqiptare vetëm “dhuna brutale” mund të ruaj kontrollin serb mbi Kosovën. Gjithashtu këtë qasje ai e legjitimonte me veprimet e shteteve tjera, “Nëse Gjermania dëbon dhjetëra e mijëra hebrenj dhe Rusia zhvendos miliona njerëz nga një pjesë e kontinentit në tjetrin, evakuimi i disa qindra mijëra shqiptarëve nuk do të shkaktojë luftë botërore”.²⁰⁹ Ai dhe anëtarët e tjerë të Klubit u ndien të inkurajuar nga fryma e kohës për të ndërtuar projekte për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi dhe Shqipëri. Për t’i shtyrë shqiptarët drejt shpërnguljeve ai dhe pushteti i atëhershëm serb propozonin një sërë masash ndaj tyre, në mënyrë që jeta e tyre në Kosovë të bëhej e padurueshme. Ndër të tjera ai kërkonte që “Ligji kundër tyre të zbatohet një në një, në mënyrë që shqiptarëve t’u bëhej jeta e padurueshme në Kosovë ... duhet dënohen për kontrabandë, për prerjen e pyjeve, për dëmet nëpër ara, që lënë qentë të palidhur ... si dhe çdo masë tjetër që mund të përdorë policia. Nga aspekti ekonomik: të mos pranohen tapitë e vjetra të tokave; të konfiskohen të gjitha kullosat shtetërore dhe të bashkësive ... Lidhur me fenë, shqiptarët janë shumë të ndjeshëm. Prandaj, ata duhet sulmohen edhe në këtë fushë. Kjo do të arrihet nëpërmjet keqtrajtimit të krerëve të tyre fetarë, shkatërrimit të varrezave të tyre ... Mbetet edhe një mënyrë tjetër, të cilën Serbia e pati zbatuar me sukses pas vitit 1878: vënia e zjarrit fshehurazi fshatrave, lagjeve të qyteteve.”²¹⁰ Gjithashtu këtu vlen të përmendet edhe Marrëveshja e Qeverisë së Mbretërisë Jugosllave që nënshkroi më 1938 me Qeverinë e Republikës së Turqisë, e njohur me emrin: “Konventa turko-jugosllave për kalimin e shqiptarëve në Turqi,” e cila parashihte

²⁰⁸ Noel Malcolm, 2001, 295.

²⁰⁹ Oliver J. Schmitt, 2012, 161.

²¹⁰ Noel Malcolm, 2001, 296.

shpërnguljen 40 000 familjeve shqiptare nga jugosllavi për në Turqi, apo 300 000 banorë,”²¹¹ marrëveshje kjo që nuk u realizua sepse filloi Lufta e Dytë Botërore. Platformat e qeveritare për shpërnguljen e shqiptarëve e përkrahte edhe shtypi serb, gazeta “Politika” e Beogradit, organ kryesorë i shtypit, e quante shpërnguljen e shqiptarëve në “meritë atdhetare” për organet e administratës shtetërore që merreshin me këtë detyrë. Mund të themi se gjatë kësaj periudhe (1912-1941) një aparat i tërë shtetëror kishin për detyrë organizimin e shpërnguljes së shqiptarëve.²¹²

Në këtë linjë veprimi ishte edhe “reforma agrare” apo kolonizuese e cila u ndërmor në Kosovë dhe viset tjera shqiptare. Sipas studiuesve (Oliver J. Shmit, Hakif Bajrami, Historia e Popullit Shqiptar III) ky proces kaloi nëpër tri faza, që secila fazë ka karakteristikat e veta. Kështu në fazën e parë, 1918-1920, marrëdhëniet e pronësisë ndryshojnë pa mbështetje ligjore, me ç’rast bujqit ndërprejnë kontratat me pronarët dhe fillonin t’i shfrytëzonin tokën si pronën e vet. Me këtë rast shumë pronar të pasur e të varfër humbën tokat e tyre, e posaçërisht ata që u detyruan të shpërnguleshin nga pasiguria dhe gjendja e rëndë politike. Faza e dytë, 1920-1934, u morën kryesisht pronat kolektive të fshatrave, pronat që u emërtuan “shtetërore”, pronat private që u vlerësua se kishin sipërfaqe mbi maksimumin e lejuar me ligj, pronat e kryengritësve “kaçakë” ose të arratisurve, e posaçërisht tokat private që ndodheshin në viset kufitare me Shqipërinë. Faza e tretë, 1934-1941, e shpronësimit dhe kolonizimit shënjon mosnjohjen e dokumenteve të pronësisë së shqiptarëve, madje edhe tapitë e rregullta. Ajo vinte dorë mbi të gjitha tokat në pronësi të shqiptarëve, madje shumë fshatarëve iu murr edhe oborri e shtëpia.²¹³ Kjo na bënë të kuptojmë se reforma agrare e aplikuar në këtë periudhë kishte për qëllim përmbysjen e popullsisë etnike të popullsisë së trevave shqiptare në dobi të popullsisë sllave, përmes kolonëve serb. Gjithashtu, programe të mëdha të kolonizimit që u ndërmorën nga Mbretëria e SKS-së tregojnë se ky proces çoi në rritjen e konsiderueshme të popullsisë serbe, prej 24 përqind sa ishte më 1919 në 39 përqind më 1928.²¹⁴

²¹¹ Qerim Lita, Procesi i shpërnguljes së shqiptarëve nga trevat verilindore gjatë shekullit XX, 2018, 16.

²¹² Historia e Popullit Shqiptar, III, 2007, 484.

²¹³ Më shumë rreth procesit të reformës agrare dhe procesit të kolonizimit që u aplikua në këtë periudhë në Jugosllavinë e parë Shih: Historinë e Popullit Shqiptarë III, 2007, 477-482; Oliver J. Shmit, 2012, 153-158.

²¹⁴ Oliver J. Shmit, 2012, 154.

Diskursi politik serb lidhet tërësisht me gjetjen e metodave më adekuate për zhbërjen e Kosovës nga popullsia etnike shqiptare dhe popullimin e sajë me kolon serb, ky artikulum dominonte tërë ligjërimin politik serb në Kosovë dhe viset tjera shqiptare. Ashtu siç thotë edhe Olive J. Schmitt se në periudhën mes dy luftërave botërore Kosova ishte koloni e Serbisë në kuadër të Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene, dhe se dështimi i Jugosllavisë së parë në Kosovë shpjegon kolonizimin serb, shtypjen e popullsisë shqiptare, ndalimi i arsimit të lartë dhe plani për shpërnguljen masive të shumicës së padëshiruar shqiptare, ngase elita e Beogradit dëshironte vendin, por jo edhe shumicën e njerëzve që jetonin aty.

E gjithë veprimtaria shtetërore në Kosovë ishte ndërtuar sipas rekomandimeve dhe propozimeve të akademikëve Serb, në veçanti nga Vasa Çubrilloviqi, që kishin për qëllim serbizimin e Kosovës dhe asgjësimin e shqiptarëve, sepse argumenti demografik i popullsisë së Kosovës rëndonte mbi të gjitha “argumentet” të cilat mund t’i sajnin elita politike dhe intelektuale serbe mbi të “drejtën” e çështjes së Kosovës. Kështu me çdo kusht argumenteve tjera dhe miteve tjera mbi Kosovën duhej t’i bashkëngjithnin edhe argumentit demografik. Ky diskurs racist ndaj popullsisë shqiptarë në Jugosllavi dhe jo vetëm, dominon ligjërimin politik të Jugosllavisë së parë.

V. Ligjërimi nacionalist në Kosovë gjatë Jugosllavisë së dytë²¹⁵

Të gjitha viset shqiptare në Luftën e Dytë Botërore ishin të pushtuara nga boshti fashist, gjegjësisht nga italianët, gjermanët dhe bullgarët. Në historiografinë shqiptare kjo periudhë njihet edhe si pushtimi që realizoi në njëfarë mënyrë “Shqipërinë e Madhe”, sepse pjesa më e madhe e territoreve shqiptare ishin të pushtuar nga forcat italiane dhe më pas nga forcat gjermane. Për, Kosovën dhe viseve e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi ishte e rëndësishme që nuk ishin më pjesë e Jugosllavisë së Versajës, dhe se nuk do të përjetonin më shtypjen, dhunën, asimilimin, kolonizimin serb e mbi të gjitha shqiptarët, në njëfarë mënyre ishin të bashkuar. Viset shqiptare, pavarësisht se si quhej pushtuesi i ri, “krijesë fashiste” apo se çfarë rreziku përmbante për të ardhmen, ata kishin shumë më shumë të drejta dhe liri sesa më parë. Pushtuesi u njohu atyre një sërë të drejtash si mundësinë e përdorimit të gjuhës shqipe, zhvillimin e shkollës shqipe, u lejuan gazetatat e librat shqip, u lejua kremtimi i festave kombëtare dhe të tjera gjëra që ndikuan në forcimin e lidhjeve dhe vetëdijes kombëtare shqiptare.²¹⁶ Kësisoj, bashkimi i Kosovës dhe viseve tjera shqiptare me Shqipërinë, edhe pse u bë nga pushtuesit fashist, mundësoi krijimin e lidhjeve ekonomike, politike e shpirtërore ndërmjet pjesëve të copëtuara të kombit shqiptar. Mirëpo, tek ata ekzistonte frika e përhershme për mundësinë e rikthimit e sundimit Serbë dhe kjo u përkujtonte atyre dhunën sistematike, shpërnguljen e popullsisë, kolonizimin trojeve me serb, reformën agrare e të tjera. Kjo ndjenjë, gjegjësisht e kaluara ata i bënte më të vëmendshëm për moslejimin e ripushtimit të tokave shqiptare nga ushtritë serbe dhe Jugosllave. Kështu, ndërmorën akte të ndryshme politike si konferenca, lëvizje të shumta politike dhe ushtarake, që fillimisht mos të lejohet rikolonizimi i tokave shqiptare dhe më pas çlirimin e tyre mbi unitetin kombëtarë. Ndër lëvizje më të hershmet dhe më me ndikim që artikuluan mendimin politik në një linjë ideore me konceptin e Rilindjes Kombëtare ishte Lidhja e Dytë

²¹⁵ Partia Komuniste e Jugosllavisë organizoi kongresin e lëvizjes çlirimtare të popullit. Në mbledhjen e tij të parë, më 26 dhe 27 nëntor 1942, ky organ, që mori emrin “Këshilli Antifashist për Çlirimin e Popujve të Jugosllavisë (AVNOJ), e shpalli veten si i vetmi përfaqësues i ligjshëm i popujve të Jugosllavisë. Në mbledhjen e tij të dytë, të mbajtur më 29 dhe 30 nëntor 1943, në qytetin boshnjak Jajce (mbledhja e parë ishte mbajtur në Bihaç të Bosnja Hercegovinës), AVNOJ-i shpalli se pas luftës Jugosllavia do të organizohej mbi baza federale. Këtu dhe ishin hedhur themelet e Jugosllavisë së ardhshme. Konferenca e AVNOJ-it kishte vënë shqiptarët në një pozit të njëjtë me atë të Jugosllavisë së Parë.

²¹⁶ Historia e Popullit Shqiptarë IV, 2009, 130.

të Prizrenit, Konferenca e Bujanit, gjithashtu dhe lëvizje të rëndësishme politike si Balli Kombëtarë, Organizata Nacional Demokratike Shqiptare (NDSH) e të tjera.

Pas kapitullimit Italian, nacionalistët shqiptarë organizuan idenë e thirrjes së një kuvendi kombëtar, i cili duhej të hidhte bazat e krijimit të një organizate politike dhe ushtarake që do të mbronte trojet etnike nga rreziku i ripushtimit të Kosovës nga forcat Jugosllave, pas largimit të trupave gjermane.²¹⁷ Më 16 shtatorë 1943 ishte themeluar “Lidhja e Dytë e Prizrenit”, sipas shembullit të Lidhjes së vitit 1878, që në rast rreziku ajo do të krijonte një aleancë për t’iu përgjigjur rrezikut të mundshëm, sidomos ndaj sulmeve partizane komuniste Jugosllav. Kuvendi mori vendim për mbrojtjen e viseve të Kosovës dhe revedikimin e tokave Shqiptare Etnike, që ende ndodheshin jashtë kufijve të sotëm të atdheut. Gjithashtu referuar statutit të sajë kjo organizatë ka për qëllim mbrojtjen e tokave të lirueme si edhe të tokave të tjera të t’i ish-Jugosllavisë.²¹⁸ Lidhja e Dytë e Prizrenit në aspektin programorë dhe ideor është në koherencë të plotë me qëndrimet e Rilindësve për botëkuptimin politik dhe kombëtarë dhe mbetet vazhdimësi e koncepteve të nacionalizmit shqiptar.

Gjithashtu është e patjetërsueshme përmendja e Konferencës së Bujanit dhe vendimeve të saja si ndër argumentet më të rëndësishme të legjitimitetit të kërkesave të shqiptarëve për mëvetësi dhe vetëvendosje. Në këtë konferencë të thirrur nga themeluesit e Këshillit Nacional Çlirimtarë të Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit u sjell një Rezolutë e cila garantonte se pas fitores së forcave aleate, popullit shqiptarë t’i garantohej që të vendos vet për fatin e vetë. Në Rezolutë ndër të tjera thuhet se: “Kosova e Rrafshi i Dukagjinit është krahinë e banueshme me shumicë nga populli shqiptar, i cili, si gjithmonë, ashtu edhe sot, dëshiron me u bashku me Shqipërinë”, e se “rruga që duhej ndjekur për të realizuar aspiratat kombëtare të popullit të Kosovës është angazhimi në luftën e përbashkët me popujt e tjerë kundër pushtuesit nazist; përmes kësaj lufte të gjithë popujt, pra edhe populli shqiptar, do të kenë mundësi me vetëvendosë mbi fatin e tyre, me të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje”.²¹⁹ Partia Komuniste e Jugosllavisë ishte e bindur se në

²¹⁷ Po aty, 139.

²¹⁸ Sambile Kiçmezi-Basha, Programet politike të lëvizjes kombëtare shqiptare 1878-1990, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2013, 112, 114: Shih: Qerim Lita, Tokat e liruara 1941-1944 Përmbledhje dokumentesh, Logos-A, 2016.

²¹⁹ Historia e Popullit Shqiptarë IV, 143.

Kosovë dhe në trevat e banuara me shqiptarë nuk do të mund të zhvillohej luftë e suksesshme antifashiste, në qoftë se nuk do të kyçen shqiptarët në këtë luftë dhe kështu u premtoi atyre të drejtën e vetëvendosjes duke përfshirë këtu edhe shkëputjen.²²⁰ Konferenca e Bujanit dhe Rezoluta e saj ishin një akt i lartë i vetëvendosjes. Shqiptarët e Kosovës dhe viseve tjera e përcollën me shpresë vendimet e saja sepse fati i tyre tashmë do të vendoset sipas vullnetit të tyre të lirë. Vendimet e saja shprehnin realitetin kombëtar dhe politik të shqiptarëve, si dhe orientimin e tyre politik. Mirëpo, një e drejtë e tillë nuk ju njoh asnjëherë shqiptarëve të ish-Jugosllavisë dhe u anulua menjëherë nga Partia Komuniste Jugosllave me një letër të dërguar nga udhëheqësit e sajë. Premtimet paraprake të Serbisë se statusi i shqiptarëve do të zgjidhet pas luftës ishte përplot hipokrizi dhe shmangie momentale deri në krijimin e kushteve për ripushtimin e sërishëm të tokave shqiptare. Këtu mund të përmendim edhe letrën e Titos dërguar Enver Hoxhës dhe Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Shqipërisë, se çështja e Kosovës do të zgjidhet pas luftës, në bazë të së drejtës për vetëvendosje.²²¹ Gjithashtu kushtëzimi politik që bëhej, se vetëvendosja u takon dhe lidhej me pjesëmarrjen në luftë kundër pushtuesve, krijonte hapësirë për të mohuar këtë të drejtë, mbi mohimin apo minimizimin e pjesëmarrjes në luftë. Kështu dhe ndodhi, Partizanët Komunist të Jugosllavisë, pas Luftës së Dytë Botërore, atëherë kur forcat gjermane tërhiqen nga Shqipëria dhe Kosova, me ndihmën e Komunistëve shqiptarë, gjegjësisht Enver Hoxhës, ripushtojnë Kosovën. Pra, në vend se të zgjidhej çështja e shqiptare, shteti jugosllav shpalli gjendjen e luftës në Kosovë dhe kështu bëhet eliminimi i strukturave ushtarako-politike të Kosovës dhe në vend të tyre instalohet struktura ushtarako politike të komandës së përgjithshme të UNÇ-së së Jugosllavisë dhe Serbisë. Me këtë rast popullit shqiptarë iu mohua e drejta e vetëvendosjes dhe hapi tjetër ishte eliminimi i të gjitha forcave patriotike të cilat bënë rezistencë të armatosur kundër riokupimit të Kosovës në vitet 1944-1945.²²²

Për të ardhur kështu deri tek mohimi i tërësishëm i konferencës së Bujanit edhe me veprime politike e juridike, me një Konferencë tjetër të Prizrenit. Në mbledhjen e Prizrenit “Këshilli Krahinorë Popullor”, më 8-10 korrik 1945, në rrethana ushtarake kuvendi vendosi që me “dëshirën e popullit” Kosova t’i bashkohet Serbisë si njësi apendiks (shtojcë) e thjeshtë e

²²⁰ Sabile Kiçmezi-Basha, 123.

²²¹ Femi Agani, Demokracia, Kombi, Vetëvendosja, 31.

²²² Ethem Ceku, Shekulli I Ilegal, Brezi '81, Prishtinë, 2004, 27.

Republikës së Serbisë dhe tokat tjera shqiptare u copëtuan në tri republika të Jugosllavisë.²²³ Kjo mbledhje e kurdisur, nën regjimin ushtarak, me përfaqësues të zgjedhur dhe pa votim veproi kundër frymës dhe vendimeve të Konferencës së Bujanit, përfshiu Kosovën si Krahinë Autonome të hyjë në Serbinë federale dhe Jugosllavinë federative. Ky status plotësisht inferior i shqiptarëve të Kosovës si një minoritet i thjesht përbrenda Republikës së Serbisë, duke i mohuar të drejtën e vetëvendosjes shtoi dhe forcoi rezistencën e popullit shqiptarë. Sepse Kosova u aneksuan nga Serbia pa vullnetin e tyre të vërtetë dhe pjesët tjera shqiptare u copëtuan në njësi të tjera federale. Në këtë mënyrë, aneksimi i dhunshëm i Kosovës dhe më pas shpërndarja e trojeve tjera etnike shqiptare në republikat e Jugosllavisë, ndikoi që rezistenca shqiptare të vazhdoj organizimin politik ushtarak në forma të ndryshme.

Deri këtu një vështrim i shkurtër mbi ngjarjet e rëndësishme historike të periudhës së Luftës së Dytë Botërore që patën efekt në artikullimin e qëndrimeve politike në të ardhmen. Më tutje në pjesën e parë të këtij kapitulli do të zhvillojmë aspektet përkufizuese të ligjërimit nationalist dhe në pjesën e dytë do të kemi vëmendjen të veçantë ndaj ligjërimit nationalist të lëvizjeve politike të kësaj periudhe.

1. Përkufizimi i ligjërimit nationalist shqiptarë në Kosovë

Në këtë periudhë historike ligjërimit politik shqiptarë ndahet në dy fronte: nga legalja shqiptare e cila është e përfshirë përbrenda burokracisë Federale Jugosllave dhe mbështeste versionin zyrtar të politikës Jugosllave, dhe nga ilegalja shqiptare që është në kundërshtim me versionin zyrtar politik, dhe shërben në ilegalitet të plotë ngase luftohet nga pushteti për formën e artikullimit të zgjidhjes së problemit shqiptarë në Jugosllavi.²²⁴

Gjatë kësaj periudhe nacionalizmi nuk u formulua në formën e një doktrine teorike dhe sistematike, por gjendet i shpërndarë në një mori programesh politike, dokumentesh, shkrimesh e qëndrimesh praktike politike. Natyrisht edhe këtu nacionalizmi shqiptarë dallohet dhe ndahet prej rrymave të tjera politike shqiptare nga parimi i sajë kryesorë se nacionalizmi është në radhë të parë parim politik, ku “njësia politike dhe njësia kombëtare duhet të përputhen”. Pa këtë qëllim themelor, nacionalizmi nuk mund të jetë i vërtetë. Mund të perceptohet si nacionalizëm, por në esencë nuk është i atillë, apo

²²³ Historia e Popullit Shqiptarë IV, 366.

²²⁴ Po aty, 378-385.

kauzinacionalizëm (Krasniqi). Kështu, mund të ketë qenë nacionalizëm për një kohë të caktuar, por më vonë është ndryshuar sepse nuk i ka qëndruar besnik objektivit themelor që ka nacionalizmi. Edhe gjatë kësaj periudhe si ide, lëvizje apo organizata politike konsiderohen ato që i përmbahen parimit politik për jetësimin e përputhjes së njësisë politike me njësinë kombëtare. Sepse çështje të tjera si arsimimi në gjuhën shqipe, ruajtja e kulturës dhe identitetit, artikulimi i të drejtave nacionale, e të tjera janë veprimtari të përbashkëta dhe jo dalluese, për të gjitha organizatat politike të kësaj periudhe.

Lëvizjet politike të kohës, përfshirë lëvizjen legale dhe ilegale ecin nëpër katër rrugë politike nga të cilat profilizohen si qëndrime ligjërimore nacionaliste apo jonacionaliste. Kështu lëvizjet në fjalë kategorizohen në bazë të këtyre objektivave apo synimeve që do t'i arrinin: *Së pari*, lëvizjen për autonomi të zgjeruar të Kosovës dhe për të drejta kombëtare demokratike; *Së dyti*, lëvizjen për Republikë të Kosovës; *Së treti*, lëvizjen për bashkimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi me Republikën Socialiste të Shqipërisë; dhe *së katërti*: lëvizjen për Republikë Shqiptare përbrenda Jugosllavisë.²²⁵

Së pari, lëvizja për Autonomi të zgjeruar të Kosovës dhe për të drejta kombëtare demokratike, ishte lëvizje e cila u zhvillua në rrugë legale, kryesisht nga përfaqësuesit shqiptar në strukturat shtetërore e partiake të Kosovës. Pjesëmarrës në këtë lëvizje ishin edhe nga ata për të cilët Jugosllavia përfaqësonte “atdheun e vërtetë”. Ata artikulonin idetë dhe domosdoshmëritë e popullit shqiptarë në kuadër të legjislacionit Jugosllavë dhe se përpjekjen për ndryshimin e pozitës së shqiptarëve e shihnin në kuadër të legjislacionit federativ. Autonomistët vazhdimisht kërkonin të drejta më të mëdha në të gjitha fushat e jetës politike, ekonomike dhe shoqërore. Shumica prej tyre ishin anëtarë të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë dhe mbanin funksione të rëndësishme politike në nivel krahinor dhe federativ, çka nënkupton se ata ishin brenda vizionit politik të kësaj partie, të tillë ishin Fadil Hoxha, Xhavit Nimani, Hajredin Hoxha e të tjerë.²²⁶ Pra, lëvizja autonomiste zgjerimin e

²²⁵ Këto ndarje, orientime ideo politike, apo lëvizje i paraqet edhe teksti i Historisë së Popullit Shqiptarë, por edhe studiues të tjerë, mbi formën se si intelektualët shqiptarë e mendojnë zgjidhjen e problemit shqiptarë në Jugosllavi. Tri ndarjet e para identifikohen kryesisht në Historinë e Popullit shqiptarë dhe ndarja e fundit lëvizjen për Republikë Shqiptare përbrenda Jugosllavisë, rrjedh nga orientimet politike të lëvizjeve politike të kohës që do t'i trajtojmë më tutje dhe mbështetet edhe nga autorë të ndryshëm si: Ethem Çeku, Sabile Kiçmezi Basha, Qerim Lita e të tjerë. Shih më tepër: Historia e Popullit Shqiptarë IV, 2009 380-390.

²²⁶ Shih më tepër: Historia e popullit Shqiptarë IV, 2009, 380.

autonomisë së Kosovës e shihte në funksion të forcimit të bashkësisë jugosllave.²²⁷ Ideja e kësaj lëvizjeje përjashtohet nga parimi nacionalistë, për faktin se çështjen shqiptare në Jugosllavi e shihnin të ndarë nga shteti shqiptarë dhe nga çështja shqiptare në përgjithësi. Autonomistët nuk angazhoheshin për shkëputjen e shqiptarëve dhe bashkëngjitjen e tyre me shtetin amë, apo për Republikë shqiptare në kuadër të Jugosllavisë, por angazhoheshin për avancimin e të drejtave të shqiptarëve përbrenda federatës. Mund të themi se çështja shqiptare për ta përputhej me parimet ideologjike të internacionalizmit proletarë dhe të koncepcioneve të vëllazërim-bashkimit. Ligjërimi i tyre e shihte çështjen shqiptare të parcializuar, të shkrirë në një çështje më të “madhe”, në atë të internacionales proletare, kështu e shpërputh atë tërësisht me parimin bazë të nacionalizmit, të përputhjes së njësisë politike me njësinë kombëtare.

Së dyti, pas plenumit të Brionëve (1966), e posaçërisht pas demonstratave të 1968 deri në vitin 1981 në programet e organizatave politike u bënë ndryshime të mëdha. Filluan oscilime të shumta programore në kuadër të lëvizjeve politike, kështu të ndikuar nga mos përkrahja e idesë për bashkim kombëtarë nga shtetet perëndimore, gjithashtu edhe nga shteti amë, ideologët e lëvizjeve ilegale gjejnë rrugë të ndryshme për të ardhur deri tek qëllimi i parashtruara më parë. Në këtë mënyrë, ata fillojnë të artikulojnë kërkesën që Kosova të shpallet Republikë në kuadër të Jugosllavisë, ngase siç dihet kushtetutat Jugosllave u njihnin Republikave të drejtën e shkëputjes dhe bashkimit me shtetin amë. Kjo

²²⁷ Këtu do të ju referohemi një fjalimi të Fadil Hoxhës të vitit 1981, të mbajtur para aktivitetit politik të Universitetit të Prishtinës. Kushdo që sado pak merr vesh në politikë, e di se në botën bashkëkohore ka republika, në të cilat klasa punëtore dhe popujt nuk i gëzojnë të drejtat demokratike, ose në to janë kufizuar liria nacionale e liritë tjera. Për këtë arsye “firma” e tillë vetvetiu nuk ka kurrfarë domethënie, e në rastin konkret parulla “Kosova republikë” me përmbajtje që theksohet, do të thotë manovër e elementëve më reaksionarë shovinistë, që synojnë t’i rrezikojnë të gjitha frytet e shqiptarëve në Kosovë dhe në Jugosllavi. Prapa kësaj parulle demagogjike fshihet, në të vërtetë, tendenca për ta shpartalluar Jugosllavinë e Titos, e cila është edhe garanci e lirisë dhe e përparimit, e të gjithë banorëve të saj. (...) Në realitetin e krijuar të komplikuar historik në Ballkan, parulla për shndërrimin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në “Republikë” de fakto është e orientuar kah shkatërrimi i Jugosllavisë, kah realizimi i qëllimeve të errta irredentiste, kah paraqitja e çështjes së kufijve, gjë që në dokumentin përfundimtar të Konferencës për siguri e bashkëpunim evropian në Helsinki, çdo kërkesë për ndërrimin e kufijve u vlerësua si rrezik i madh për ruajtjen e paqes në Evropë dhe në botë. Ajo parullë është në kundërshtim me interesat e kombësisë shqiptare në Kosovë, e edhe me interesat e kombeve dhe të kombësive të tjera të Jugosllavisë. Jam i bindur thellë se kjo nuk u përgjigjet as interesave esenciale të popullit shqiptarë në tërësi. Kombësia shqiptare e Kosovës është thellësisht e vetëdijshme se ka realizuar afirmimin dhe lirinë e vet t[plotë nacionale dhe mund ta begatojë më tutje jo në konfrontim me popullin serb dhe me popujt e tjerë të Jugosllavisë, por me bashkëjetesë të fortë dhe me bashkëpunim vëllazëror me ta. Shih më tepër: Fadil Hoxha, Jemi në shtëpinë tonë, II, Rilindja, Prishtinë, 1986, 177, 173-199. Fadil Hoxha në vetën e parë, Me shënim dhe parathënie të Veton Surroit, Koha Prishtinë, 2010.

kërkesë u shpalos në demonstratat e vitit 1968, gjithashtu u sforcua edhe me demonstratat e vitit 1981.²²⁸ Kërkesa për Republikën e Kosovës, e barazisë me Republikat e tjera në kuadër të Federatës kishte për qëllim shkëputjen dhe më pas bashkimin me Shqipërinë. Ajo ç'far e bënë këtë qëndrim jonacionalist nuk është ideja e barazisë në kuadër të Jugosllavisë, sepse një qëndrim i tillë ishte real dhe i domosdoshëm nga refuzimi permanent i Enver Hoxhës ndaj Kosovës dhe çështjes shqiptare në Jugosllavi, por është ideja e tkurrjes së konceptit të territorialitetit. Kosova Republikë shfaqej si një formulë në përputhje me logjikën e ndarjes administrative aktuale, kështu duke përfshirë në kërkesën për Republikë vetëm territorin e Kosovës, pa territoret tjera shqiptare përbrenda Jugosllavisë binte në kundërshtim me logjikën kombëtare. Pra, lëvizja për Republikën e Kosovës në emër të logjikës administrative apo shtetërore, do të heq dorë nga koncepti për bashkimin e gjitha viseve shqiptare të Jugosllavisë me shtetin amë apo nga koncepti i një Republike të përbashkët të shqiptarëve në Jugosllavi me të drejtë shkëputjeje dhe bashkëngjitjeje me Shqipërinë. Shfaqja e idesë për Republikën e Kosovës njëherit nënkupton diferencim nga pjesët tjera etnike shqiptare në Jugosllavi, dhe se viset tjera duhet të bëjnë luftën veçmas në kuadër të Republikave përkatëse. Ide të tilla janë refleksion i real politikës, sepse mundësia e ndryshimit të kufijve qoftë për bashkëngjitjen e viseve shqiptare të Jugosllavisë me Shqipërinë, qoftë për krijimin e Republikës shqiptare përbrenda Jugosllavisë duke i ndryshuar kufijtë e brendshëm të Jugosllavisë interpretohej si shumë idealiste dhe pak e mundshme. Kështu ideja për Republikës së Kosovës nënkuptonte vetëm avancim të statusit politik në kufijtë ekzistues, çka shihej si reale dhe shumë e mundshme. Mirëpo, pavarësisht mundësive, ideja e Republikës së Kosovës nënkuptonte tkurrjen e konceptit të territorialitetit dhe bie ndesh me parimin kryesorë të nacionalizmit. Këtu mund të ju referohemi Milazim Krasniqi i cili thotë se “demonstratat e vitit 1968 ishin me kërkesë për republikë të Kosovës brenda Jugosllavisë, demonstratat e vitit 1981 kishin në themel të njëjtën kërkesë, demonstratat e vitit 1988 ishin një degradim, sepse kërkonin vetëm mbrojtje të autonomisë së Kosovës të vitit 1974, ... Asnjëra prej tyre nuk kishte brenda vetes elementin themelor nacionalist, projektin për bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare në një shtet etnik shqiptarë”.²²⁹

²²⁸ Milazim Krasniqi, Nacionalizmi shqiptar, Logos A, Shkup, 2017. 66.

²²⁹ Shih më tepër: Milazim Krasniqi, 2017, 66-67.

Këtu mund të sjellim një qasje ndryshe nga kjo e deri tanishmja mbi parimin nacionalist, ai i autorit të librit “Identiteti Kosovar” nga Mehmet Kraja, i cili nismën për shkëputjen e Republikës së Kosovës nga Jugosllavia e sheh si ide nacionaliste nga nacionalistët shqiptarë, “Nacionalistët kishin krijuar idenë e një republikë të Kosovës në kuadër të Jugosllavisë, në rrethana të caktuara, do të mund të shkëputej dhe t’i bashkëngjitej Shqipërisë, sepse me kushtetutat jugosllave dhe me kushtetutat e republikave bashkimi i popujve në Jugosllavi ishte bërë mbi bazën e vullnetit të lirë të popujve, që domethënë se edhe shkëputja buronte po nga kjo e drejtë”.²³⁰ Ide të tilla, gjegjësisht lëvizja për Republikën e Kosovës nuk mund të konsiderohet ide nacionaliste në parim, sepse ajo redukton parimin e territorialitetit dhe i nënshtrohet idesë së ndarjes administrative apo shtetërore që ekzistonte në kuadër të Jugosllavisë. Ideja e Republikës së Kosovës përjashtonte nga ky koncept viset e tjera shqiptare etnike në kuadër të Jugosllavisë që përbënin numër dominant të qytetarëve shqiptarë ku ata shtriheshin dhe gëzonin vazhdimësinë gjeografike me territorin e Kosovës dhe të Shqipërisë. Për nacionalistët kufijtë që ndajnë dhe pengojnë vazhdimësinë territoriale dhe etnike të një shoqërie konsiderohen pengesa që duhet kapërcyer dhe duhet delegjitimuar. Kufijtë e Jugosllavisë për nacionalistët shqiptarë nuk ishin realë dhe nuk përkonin me natyrshmërinë etnike të shqiptarëve dhe nuk duhet pranuar si të tillë pavarësisht rrethanave politike të kohës. Gjithashtu edhe për historianin Jusuf Buxhovi ideja për ngritjen e statusit të Kosovës në shkallë të republikës nuk ishte as shpërputhëse, e as kundërshtuese siç dukej, por, paraqiste një përcaktim strategjik në përputhje me rrethanat dhe logjikën politike.²³¹ Në këtë rrjedhë edhe Sabile Kiçmezi Basha parashtron oscilimet të ndryshme nga programet politike të organizatave ilegale në raport me zgjidhjen e çështjes kombëtare në Jugosllavi. Sipas sajë “Pas plenumit të Brionëve (1966), deri në vitin 1981, në programet e organizatave u bënë ndryshime të shumta. Duke e parë se nga shtetet perëndimore nuk kishte përkrahje ideja për bashkim kombëtar, ideologët e grupimeve ilegale gjejnë një rrugë tjetër për të ardhur deri të qëllimi suprem i tyre – ata kërkojnë që Kosova të shpallet Republikë në kuadër të Jugosllavisë, ...”.²³² Mund të themi se ideja për republikën e Kosovës i përket real politikës dhe logjikës së ndarjes administrative shtetërore në kuadër të Jugosllavisë dhe jo logjikës kombëtare dhe nacionaliste. Kjo qasje nënkupton

²³⁰ Mehmet Kraja, Identiteti Kosovar, UETPRESS, Tiranë, 2019, 176.

²³¹ Shih më tepër: Jusuf Buxhovi, 2017, 100.

²³² Sabile Kiçmezi Basha, 2013, 17.

diferencimin nga idetë nacionaliste, sepse zgjidhjen e çështjes shqiptare në Jugosllavi e artikulonte vetëm për shqiptarët që banonin në territorin e Kosovës duke përjashtuar kështu viset tjera shqiptare në kuadër të sajë, pra ofronte zgjidhje të pjesshme dhe jo të tërësishme të çështjes shqiptare. Ide të tilla mund të jenë të frymëzuara nga lëvizjet dhe iniciativat nacionaliste, siç janë Lidhja e Prizrenit, Rilindja Kombëtare e të tjera, mirëpo, ato i nënshtrohen real politikës dhe kalkulimeve strategjike të kohës.

Së treti, Për të ardhur deri tek idetë ligjërimore nacionaliste të lëvizjeve politike shqiptare në Kosovë gjatë periudhës së Jugosllavisë së dytë. Lëvizja për bashkimin e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare me shtetin Shqiptarë, ruan parimin kryesorë të traditës së nacionalizmit shqiptarë. Kjo lëvizje si qëllim suprem ka përpjekjen e pakompromis në përputhjen e njësisë nacionale me atë politike. Bëhet fjalë për individë dhe lëvizje politike që ruanin këtë frymë ideore përkundrejt çmimit dhe rrezikut të çështjes në fjalë, në njëfarë forme akterë të tillë nuk përjashtonin edhe luftën e armatosur për të arritur qëllimet e lartpërmendura. Tek lëvizjet e tilla vetëdija për kombin dhe të jetuarit në bashkësi është mbi të gjitha kalkulimet dhe strategjitë e mundshme të real politikës. Ide të tilla nisen nga plotfuqishmëria e shqiptarëve përballë armiqve, përball serbëve apo grekërve, gjegjësisht nga besimi se shteti shqiptarë nuk mund të realizohet as politikisht e as të zhvillohet ekonomikisht pa bashkimin kombëtarë. Pra, qëllimi i tyre ishte fillimisht çlirimi dhe më pas bashkimi i tokave shqiptare në një njësi politike. Ajo, çfarë i bënte lëvizjet e tilla nacionaliste ishte parimi tradicional i nacionalizmit dhe jokompromisi i kësaj ideje për çfarëdo çmimi që ajo mund të paguaj. Të tilla ishin lëvizja politike ilegale Organizata “Nacionale Demokratike Shqiptare”, Organizata “Lidhja e Prizrenit”, Organizata për “Bashkimin e Trojeve Shqiptar”, e të tjera që do të jenë pjesë e trajtimit.

Së katërti, shikuar dhe analizuar kontekstin kohorë dhe qëndrimet politike të subjekteve kryesore të kësaj periudhe në këtë punim është trajtuar si ide apo lëvizje nacionaliste edhe parimi për krijimin e Republikës shqiptare përbrenda federatës Jugosllave. Ky qëndrim është në konsistencë të plotë ideore me ligjërimin nationalist për dy arsye, fillimisht bazuar në qëndrimin e palëkundur të shtetit shqiptarë, gjegjësisht liderit të sajë autoritar Enver Hoxha, që çështja e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare etnike në Jugosllavi është çështje e brendshme e Jugosllavisë dhe se problemet e tyre duhet t'i zgjidhen përbrenda sajë. Gjithashtu, se ideja e Republikës shqiptare nënkuptonte autonominë e plotë politike dhe

territoriale me të drejtë shkëputjes nga Jugosllavia, një të drejtë që e parashihnin edhe kushtetutat e jugosllave. Pra, përqafimi i idesë së Republikës shqiptare është artikulum real dhe i domosdoshëm i nacionalistëve shqiptarë për të ruajtur integritetin territorial dhe nacional të shqiptarëve në Jugosllavi. Një lëvizje e tillë konceptuale ishte e domosdoshme nga disa lëvizje nacionaliste shqiptare bazuar në faktin e refuzimit të përhershëm të kryetarit të shtetit shqiptarë, Enver Hoxhaj. Sepse që nga fillimi deri në fund, çështjen e Kosovës, Enver Hoxha e ka shikuar në përputhje me konceptet ideologjike sipas teorisë së marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletarë. Mbi këto parime ka refuzuar edhe irredentizmin ideologjik të organizatave ilegale të Kosovës.²³³ Ideja e barazisë nacionale në kuadër të federatës me republikën tjera, nënkuptohej si diçka e përkohshme apo instrumentalizuese, sepse nga të qenit republikë rridhte dhe e drejta e vetëvendosjes së sajë. Lëvizja për Republikën Shqiptare në kuadër të Jugosllavisë kishte këtë qëllim, që pas fitimit të këtij statusi dhe pas krijimit të kushteve të ushtrij të drejtën e vetëvendosjes për shkëputje dhe bashkëngjitjen e sajë me shtetin Shqiptarë. Ky qëndrim konsiderohej edhe strategjik kundrejt qëndrimit të shtetit shqiptarë ndaj çështjes shqiptare në Jugosllavi. Një platformë e të tillë shfaqej edhe në programin e Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve, të Adem Demaçit e cila pati mbështetje të fuqishme edhe në viset lindore shqiptare, përkatësisht në Maqedoninë e Veriut.²³⁴

1.1Arsyet e përbrendësimit të konceptit të vendvendosjes në ligjërimin nacionalist

Një ndër të drejtat fundamentale kolektive të popujve dhe ndër parimet themelore politike të marrëdhënieve midis popujve dhe shteteve është edhe e drejta e vetëvendosjes. Pas Luftës së Parë Botërore u vendosën konceptet themelore politike për të drejtën e kombeve për vetëvendosje. Principi që atëherë u vendos, kishte të bënte me orientimin që çdo kombi t'i jepej e drejta e emancipimit shtetërorë dhe e vendosjes së sovranitetit të tillë në territore të caktuara, sipas vullnetit politik të banorëve që jetojnë aty.

Karta e Kombeve të Bashkuara që në nenin e parë, shprehë qëllimin e Kombeve të Bashkuara që të zhvilloj "marrëdhënie miqësore midis kombeve, të bazuara në respektimin e principit të të drejtave të barabarta dhe të vetëvendosjes së popujve." Përcaktimin më të

²³³ Jusuf Buxhovi, Kosova 1945-1999, 157.

²³⁴ Shih më tepër: Qerim Lita, Çështja shqiptare në RSFJ 1981-1990, Vatra, Shkup, 2014, 34.

plotë nga dokumentet e Kombeve të Bashkuara të parimit të vetëvendosjes e gjejmë në konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, si dhe në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Qytetare dhe Politike (1966): e drejta e Vetëvendosjes realizohet kur “1. Të gjithë popujt kanë të drejtën e vetëvendosjes. Në bazë të kësaj të drejte, ata përcaktojnë lirisht statusin e tyre politik dhe ndjekin lirisht zhvillimin e tyre ekonomik, shoqëror dhe kulturor. 2. Për të arritur qëllimet e tyre, të gjithë popujt mund t’i disponojnë lirisht pasuritë dhe burimet e tyre natyrore, pa cenuar kurrfarë detyrimesh që rrjedhin nga bashkëpunimi ekonomik ndërkombëtar, që bazohet në parimin e përfitimit të ndërsjellë, dhe në të drejtën ndërkombëtare. Një popull nuk mund të privohet nga mjetet e veta të jetesës në asnjë rast. 3. Shtetet palë të këtij Pakti, duke përfshirë ato që janë përgjegjëse për administrimin e territoreve jovetëqeverisëse dhe të territoreve nën kujdestari, ndihmojnë realizimin e së drejtës së popujve për vetëvendosje dhe respektojnë këtë të drejtë në përputhje me dispozitat e Kartës së Kombeve të Bashkuara.”²³⁵ Referimi që kjo Konventë i bënë të drejtës për vetëvendosje jashtë kuadrit të dekolonizimit ofron një trampolinë për pohimin apo njohjen e së drejtës për vetëvendosje edhe brenda dhe jashtë kufijve të një shteti. Në këtë kontekst Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme e përkufizon të drejtën e vetëvendosjes ku “Të gjithë popujt kanë të drejtën të vendosin lirisht fatin e tyre; në bazë të kësaj të drejte, ata përcaktojnë lirisht statusin e tyre politik dhe ndjekin lirisht zhvillimin e tyre ekonomik, shoqëror e kulturor.”²³⁶ Bazuar në të drejtën ndërkombëtare²³⁷ popujt kanë të drejtë të ushtrojnë qëllimet e tyre për arritjen e së drejtës së vetëvendosjes në forma të ndryshme, gjithnjë sipas vullnetit të tyre.

Në rastin e vetëvendosjes, mund të themi se çështja kryesore është të përcaktosh se cilët janë “ata” që kanë të drejtë vetëvendosje. Apo kush janë “ata” që mund të vendosin se cilët janë “ata” që gëzojnë të drejtën e vetëvendosjes. Në këtë kontekst “ata” mund të konsiderohen të gjithë popujt që jetojnë në një territor të caktuar. Atëherë vijmë deri tek

²³⁵ Pakti Ndërkombëtar për të drejta civile dhe politike. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966. PJESA E PARË, Neni 1. Shih <http://www.hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>

²³⁶ Deklarata për dhënien e pavarësisë vendeve dhe popujve të kolonizuar, Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme, numër 1514 (XV), me datën 14 dhjetor, 1960.

²³⁷ Në Kartën e Kombeve të Bashkuara (1845), Rezolutën 1514 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (1960), Konventën Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike (1966), Rezolutën 2625 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (1970), Akti Final I Helsinkit (1975).
<http://www.hrc.ucepeace.org/files/pages/Human%20rights%20instruments.pdf>

pyetja bazike se çka do të thotë “popuj”. Pra për të gëzuar të drejtën e vetëvendosjes së pari duhesh të jesh popull. Në raportin e Takimit të Ekspertëve të UNESCO-s për të drejtat e popujve, përcaktohet një definicion pune për “popullin”, i cili përmban këto katër kryesore: “karakteristikat e përbashkëta si gjuha, raca, religjioni; numri; vullneti i identifikimit si popull vetëdija e të qenit popull; institucionet e mundshme për shprehjen e veçorive të përbashkëta dhe të dëshirës për identitet.”²³⁸ Vihen re kriteret subjektive të përcaktimit, si nevoja për tu konsideruar popull ose komb prej të tjerëve, gjithashtu kriteret objektive si etniciteti, gjuha, historia e përbashkët, territori, po ashtu edhe vullneti politik për përgjegjësin e të qenit popull-komb.

Pa u larguar shumë nga subjekti që kemi, mund të themi që e drejta e vetëvendosjes i përket atyre popujve që kanë vullnetin për t’i takuar një bashkësie të caktuar si dhe të kenë ndjenjën e kolektivitetit, të bashkëjetesës në një shoqëri të caktuar. Andaj kjo e drejtë u takonte shqiptarëve sepse ata posedonin të gjitha elementet për të shpresuar në një të drejtë të tillë. Që nga viti 1912 Serbia ka përvetësuar në formë ushtarake Kosovën me viset e tjera shqiptare si Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi edhe Serbinë Jugore. Shqiptarët e këtyre trojeve kanë mbetur nën Serbinë dhe Malin e Zi sepse u është mohuar e drejta e vetëvendosjes, sepse nuk është përfillur vullneti i tyre. Populli shqiptarë në vazhdimësi ka shprehur vullnetin e tyre politik dhe në forma të ndryshme, sepse e konsideronte veten popull, komb dhe bashkësi, nga fakti që gëzonte edhe kompaktësinë dhe vijimësinë territoriale.²³⁹ Përkundër kësaj ata nuk gëzuan të drejtën e vetëvendosjes që pas Luftës së Parë Botërore sepse konflikti i interesave të Fuqive të Mëdha luajti një rol përcaktues.

Gjithashtu edhe pas Luftës së Dytë Botërore nuk u nxjerrën mësimet nga gabimet e Luftës së Parë, kështu Shqiptarëve u mohua e drejta e vetëvendosjes përsëri, sepse një gjë e tillë u la në duart e fuqive vendimmarrëse. Kështu gjatë Luftës së Dytë Botërore, Partia Komuniste e Jugosllavisë, organizoi kongresin e lëvizjeve çlirimtare më 26 nëntor të 1942, ky organ shpalli veten si i vetmi përfaqësues i ligjshëm i popujve të Jugosllavisë dhe u quajt ‘Këshilli Antifashist për Çlirimin e Popujve të Jugosllavisë (AVNOJ). Në mbledhjen e tij të dytë të mbajtur në Jajce të Bosnjës më 29 nëntor 1943, mori vendim se pas luftës Jugosllavia do të

²³⁸ Fehmi Agani, Demokracia, Kombi dhe Vetëvendosja, Dukagjin, Pejë, 2002, 14; Të drejtat e njeriut në të drejtën ndërkombëtare, Aktet themelore të Këshillit të Evropës dhe të KSBE-së, Albinform, Tiranë, 1994.

²³⁹ Shih më tepër: Rexhep Qosja, Strategjia e Bashkimit Shqiptarë, 114.

organizohej në njësi federale. Udhëheqësit komunist e konsideronin të rëndësishme t'i garantonin grupeve kombëtare të Jugosllavisë, se pas çlirimit të vendit, do të kishin barazi kombëtare, të garantuara nga kushtetuta. Gjithashtu u deklarua se çdo komb kishte të drejtën e vet të patjetërsueshme për t'u shkëputur, por kjo duhet të ishte pjesë e luftës revolucionare të komunistëve për çlirimin e proletariatit.²⁴⁰

Shqiptarët nuk ishin ftuar në mbledhjen e parë që organizoi 'Këshilli Antifashist për Çlirimin e Popujve të Jugosllavisë' (AVNOJ), kështu në refleksion me këtë shqiptarët organizuan Lidhjen e Dytë të Prizrenit. Më 16 shtatorë 1943 ishte themeluar "Lidhja e Dytë e Prizrenit", sipas shembullit të Lidhjes së vitit 1878, që në rast rreziku ajo do të krijonte një aleancë për t'iu përgjigjur rrezikut të mundshëm, sidomos ndaj sulmeve partizane komuniste Jugosllave. Kuvendi mori vendim për mbrojtjen e viseve të Kosovës dhe revedikimin e tokave Shqiptare Etnike, që ende ndodhen jashtë kufijve të sotshëm të atdheut.

Por, më pas, gjegjësisht pas mbledhjes së dytë të 'Këshilli Antifashist për Çlirimin e Popujve të Jugosllavisë' (AVNOJ), shqiptarët organizuan Konferencën e Bujanit. Kështu më 1 janar 1944 u organizua Konferenca e Bujanit, ku sillet Rezoluta e njohur, në të cilën shprehen qartë aspiratat e shqiptarëve. Aty thuhej "Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit asht një krahinë e banueshme ne shumicë nga populli shqiptar, i cili gjithmonë, ashtu dhe sot, dëshiron me u bashku me Shqipërinë, Prandaj, ndjejmë për detyrë me ia tregu rrugën e drejtë që duhet me ndjekë populli shqiptarë për me i realizu aspiratat e veta". Por, çështja shqiptare mbetet prapë e pazgjidhur edhe pas Luftës së Dytë dhe gjitha vendimet që u morën gjatë luftës u shkelën, sidomos ajo e Bujanit. Kështu një numër i patriotëve dhe veprimtarëve vazhduan luftën për çlirimin dhe bashkimin Kombëtarë. Konferenca e Bujanit dhe Lidhja e Dytë e Prizrenit, ishin dy aktet më të larta të vetëvendosjes. Vendimet e saja shprehnin realitetin kombëtar dhe politik të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, si dhe orientimin e tyre politik. Mirëpo, një e drejtë e tillë nuk ju njoh asnjëherë shqiptarëve të ish-Jugosllavisë dhe u anulua menjëherë nga Partia Komuniste Jugosllave me një letër të dërguar nga udhëheqësia e sajë. Premtimet paraprake të Serbisë se statusi i shqiptarëve do të zgjidhet pas luftës ishte përplot hipokrizi dhe shmangie momentale deri në krijimin e kushteve për ripushtimin e sërishëm të tokave shqiptare.

²⁴⁰ Enver Hasani, Vetëvendosja, integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti i Jugosllavisë, Buzuku, Prishtinë, 2010, 136-137.

Ishin këto dy akte të rëndësishme politike dhe njëherit tregonin vullnetin e të qenit popull dhe se shqiptarët në ish-Jugosllavi meritonin të drejtën e vetëvendosjes. Pra, mund të them së ishin këto dy ngjarje të rëndësishme politike, që ngjanin si akte të larta të vetëvendosjes sepse qëndrimet e tyre shprehnin realitetin kombëtarë dhe politik të shqiptarëve, pra një vullnet dhe orientim politik. Këto ndikuan që shqiptarët të përbrendësonin konceptin e vetëvendosjes edhe në Jugosllavinë e dytë. Ky koncept u forcua edhe më tepër nga fakti se kushtetutat e Jugosllavisë u njihnin të drejtën e vetëvendosjes Republikave, që njëherit fitonin të drejtën e shkëputjes nga Jugosllavia dhe të drejtën e bashkëngjitjes së sajë me ndonjë entitet tjetër politik. Pra, ideja e Republikës shqiptare nënkuptonte “vetëqeverisje të plotë” dhe të drejtën shkëputjes nga Jugosllavia. Mund të them se përqaftimi i idesë së Republikës shqiptare ishte oscilim real dhe i domosdoshëm i nacionalistëve shqiptarë për të ruajtur integritetin territorial dhe nacional të shqiptarëve në Jugosllavi. Një lëvizje e tillë konceptuale ishte e domosdoshme duke u bazuar në faktin e refuzimit të përhershëm të udhëheqësit të shtetit të Shqipërisë për t’u marrë me shqiptarët jashtë Shqipërisë. Gjithashtu roli i Jugosllavisë në arenën ndërkombëtare ishte i rëndësishëm dhe gëzonte autoritet nga të dy boshtet, ai Perëndimorë dhe Lindorë, ngase Jugosllavia ishte në anën e vendeve të pa inkuadruara. Kështu ideja e Republikës e konsolidonte çështjen shqiptare në Jugosllavi, ngase kushtetuta e Jugosllavisë “lejonte” që republikat të kishin të drejtë të shkëputjes dhe të bashkëngjitjes së tyre me shtetin Shqiptarë. Pra, arsyeja e kërkesës së disa lëvizjeve ilegale që shqiptarët të kenë republikën e tyre përbrenda Jugosllavisë trajtohej si diçka e përkohshme, ngase kjo njëherit ua jepte të drejtën e vetëvendosjes dhe mundësinë e bashkëngjitjes me shtetin amë. Më pas, kjo ide reduktohet në kërkesë për Republikë të Kosovës, e ideuar dhe përqaftuar nga shumë lëvizje ilegale të kësaj periudhe. Ideja e Republikës së Kosovës u projektuar konform ndarjes administrative që Jugosllavia kishte realizuar tashmë, si Krahina e Kosovës dhe Metohisë. Në idenë Kosova Republikë përfshihet vetëm territori i Kosovës dhe jo edhe viset tjera shqiptare në kuadër të Jugosllavisë.

1.2 Arsyet e përdorimit të eksponentëve “majtiste” tek disa lëvizjeve nacionaliste

Shumë lëvizje politike të kësaj periudhe përdorte eksponentë ideologjike të së majtës vetëm në logot e tyre, por disa prej tyre shkonin më tutje duke u profilizuar edhe si të tilla. Por, ajo çfarë na bënë të mendojmë se elementi majtist përbrenda programeve politike të ilegales

ishite vetëm formalisht dhe nuk zinte hapësirë shpjeguese si ide apo koncept. Në epiqendër të këtyre lëvizjeve artikulohej shkëputja territoriale e viseve shqiptare në Jugosllavi dhe bashkëngjitja së tyre me shtetin amë. Sepse siç dihet lufta për çlirim social ka epërsi absolute ndaj luftës për çlirim kombëtarë, dhe se lufta për çlirim kombëtarë në kuadër të kësaj ideologjie përligjet vetëm në atë masë sa shërben si parakusht për çlirim social. Pra, në krahasim me luftën e klasave dhe revolucionin proletar, kombi dhe nacionalizmi konsideroheshin më pak të rëndësishëm. Në një far mënyre për orientimet ideologjike të majta, gjegjësisht për ideologjinë marksiste-leniniste nacionalizmi është dukuri instrumentale, mjet dhe metodë e borgjezisë për të manipuluar dhe larguar masat nga lufta e tyre për çlirim dhe shfrytëzim klasor. Sipas Marksit dhe Engelsit kombi përfaqëson një shkallë evolucioniste të zgjerimit të bashkësive shoqërore prej familjes të fisi, prej rajonit tek kombi, kështu drejt bashkësisë njerëzore të përhershme. Shuarja e kombeve do të bëhet përmes revolucionit proletar, pas vendosjes së qeverisjes politike dhe shoqërisë pa klasa, gjegjësisht pas triumfit të internacionalizmit proletarë.²⁴¹ Andaj, ajo që i përjashton lëvizjet nacionaliste të kësaj periudhe nga ky përcaktim ideologjik është parimi nationalist që ato kanë në esencë të programeve të tyre, pra angazhimin e tyre për bashkimin e trojeve shqiptare me shtetin amë, e jo të triumfit të internacionalizmit proletarë. Për më tepër ato nuk bënin përpjekje për rivendosjen e një sistemi më të mirë socialist nga çfarë ishte, por shkëputje totale nga ky sistem që po dhunonte të drejtën e shqiptarëve për të qenë së bashku.

Mirëpo, një gjë të tillë lëvizjet politike të kohës e bënin sepse llogaritnin në përkrahjen e shtetit amë, sepse ato kishin për qëllim që të pranoheshin nga një rreth sa më i gjerë. Siç dihet se edhe shteti Shqiptarë udhëhiqej nga ideologjia marksiste-leniniste dhe vazhdimisht kritikonte shtetin Jugosllav për devijimit nga rruga e vërtet e marksist-leninizmit. Kështu udhëheqësi i saj Enver Hoxha, vazhdimisht kritikonte lëvizjet ilegale siç thoshte ai “se atyre u mungon një udhëheqje marksiste-leniniste që të çajë dallgët dhe të shfrytëzoj situatat dhe koniukturat”. Këto qëndrime të Enverit vijën pas vitit 1949, pas shfaqjes së konfliktit të Titos me Stalinin, kështu ai do të ndryshoj kursin, duke u shkëputur nga Titoja dhe duke i forcuar edhe më shumë lidhjet me Stalinin dhe Bashkimin Sovjetik. Pra, Enveri do të jetë plotësisht kundër Titos, dhe bënë thirrje vazhdimisht që të përmbysset nga pushteti me metoda

²⁴¹ Shih më tepër: Hysamedin Feraj, 2010, 58-61.

revolucionare. Sipas Enverit gjëja e parë që duhet të bëjnë Shqiptarët, është që të futen në luftë të ashpër pa kompromis kundër klikës së Titos deri në kryengritje të armatosur. Luftën ata duhet ta fitoj sa më parë. Në qoftë se e fillojnë të tjerët ca më mirë pse kështu evitohet izolimi dhe shtypja e lëvizjes së Kosovës.²⁴² Edhe pse Enveri çlirimin e popullit Shqiptarë e shihte të përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë nën proletariatin Jugosllav për të udhëhequr nga një Parti e re Komuniste, prapë se prapë ndikoi mjaft shumë në ndërtimin ligjërimorë të lëvizjeve politike të kohës në Kosovë. Kështu, ato filluan që në emërtimet e tyre të përdorin koncepte që përdorshin në ideologjitë socialiste, për shembull, “Partia Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare” e udhëhequr nga Metush Krasniqi, “Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Kosovës me Shqipërinë” apo edhe “Lëvizja Revolucionare e Bashkimit kombëtarë” e udhëhequr nga Adem Demaçi. Natyrisht koncepti “revolucion” përdoret në kontekstin e futjes në praktikë edhe “luftën” vetëm e vetëm për të realizuar qëllimin thelbësorë, të çlirimit dhe të bashkëngjijtes së tokave Shqiptare me shtetin amë. Sepse koncepti revolucion ishte më shumë shprehje dhe përdorim i kohës dhe në refleksion me ideologjitë mbizotëruese. Gjithashtu, aspektet programore ishin në koherenc me parimet nacionaliste. Kështu, shprehej edhe Ukshin Hoti, se “emërtimi i tillë ka qenë në modë atëherë sikur që sot është modë të themi se të gjithë jemi demokratë. Prapa marksizëm-leninizmit të tyre ka qenë i fshehur atdhetarizmi i tyre ... T’i marrësh programet e tyre, t’i analizosh konceptet pak më thellë, del fare qartë se ata marksizëm-leninizmin e kanë marrë vetëm si instrument për të arritur diku tjetër ...”.²⁴³ Pra ashtu siç thekson edhe Sabile K. Basha “se më 1973 në Kosovë u formua organizata “Grupi Revolucionar i Kosovës” pa detaje ideologjike, por me kalimin e kohës, kur u paraqit nevoja për përkrahje nga shteti amë, kjo organizatë ndërroi emrin në “Grupin Marksist-Leninist i Kosovës, që do të thotë se ideologjinë e nxori dhe e imponoi koha në të cilën veproi.”²⁴⁴ Apo këtu mund të përmendim edhe lëvizje të tjera politike të kohës që zgjidhjen e çështjes shqiptare brenda Federatës Jugosllave dhe me parime të marksizëm-leninizmit. Aspekti programor i tyre, në esencë e përjashton përpjekjen për zgjidhjen e tërësishme të çështjes kombëtare sepse fokusohet tek triumfi i internacionalizmi proletarë, apo edhe konteksti ideologjik dominonte kundrejt atij nacional. Pra, mund të themi se parimi i lëvizjeve politike për çlirimin dhe bashkimin e viseve

²⁴² Shih më tepër: Jusuf Buxhovi, Kosova 1945-199, 161.

²⁴³ Ukshin Hoti, Filozofia politike e çështjes shqiptare, Rozafa, Tiranë, 1995.

²⁴⁴ Sabile K. Basha, Programet politike të lëvizjes kombëtare shqiptare 1878-1990, Instituti i Historisë Prishtinë, Prishtinë, 2013, 16.

shqiptare në Jugosllavi me Shqipërinë përjashton profilizimin ideologjik majtist, për faktin se ato kruciale dhe jetësore e konsideronin bashkimin e trojeve shqiptare dhe jo fitoren internacionalizmit proletar. Tek këto lëvizje si NDSH, LRBSH, LNÇKVSHJ, e të tjera, për të realizuar këtë parim nuk mohonin asnjë metodë madje edhe luftën e armatosur.

2. Ligjërimi nationalist shqiptarë përbrenda Jugosllavisë

Shqiptarët në ish-Jugosllavi përbënin gjysmën e kombit shqiptarë në tërësi dhe të tretën për nga numri i përgjithshëm i popullsisë. Ata nuk mund të pranonin statusin e minoritetit kombëtarë sepse ishin një popull me identitet të qartë dhe karakteristika të përbashkëta që lidheshin me kompaktësinë dhe vazhdimësinë e tyre territoriale. Statusi dhe represioni sistematik i bënë ata rrezistent dhe jolegjitimues ndaj Jugosllavisë, gjegjësisht të gjithë dhe në formë të organizuar luftonin këtë sundim kolonial duke faktorizuar ndjesinë e kombësisë dhe përpjekjen për “çlirim kombëtarë”. Ideja e një Republike Shqiptare në kuadër të Jugosllavisë, si një gjendje e përkohshme dhe instrumentalizuese përbën risinë e mendimit politik të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Kjo formë e artikulimit u frymëzua nga lëvizjet shumta nëpër vende të ndryshme të botës për çlirim kombëtarë. Këto lëvizje shpërthyen në kohën e mes dy luftërave Botërore dhe u bënë shtytje e re mbas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Perandoritë e pamata të Britanisë, Francës, Holandës dhe Portugalisë u shembën përball nacionalizmit në ngjitje e sipër.²⁴⁵ Lëvizjet antikoloniale të mbështetur në nacionalizmin evropian u frymëzua nga e drejta e popujve për vetëvendosje dhe ngadhënjyen falë vendosshmërisë së tyre politike dhe shfrytëzimit të nacionalizmit si kredo politike.

Në një linjë të ngjashme ligjërimore ishte edhe veprimtaria e lëvizjeve nacionaliste shqiptare në Kosovë në këtë periudhë, të cilat preokupimin kryesorë e kishin të ngjashëm me atë të Rilindasve, çlirimin e atdheut nga okupimi, pavarësinë kombëtare dhe bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare në një njësi politike. Këtu do të trajtojmë individët, politikanët, dhe lëvizjet politike të kohës që karakterizoheshin me orientimin ligjërimor nationalist si dhe mishërimin i këtyre lëvizjeve me koncepte të reja politike.

²⁴⁵ Heywood, 115,

2.1 Programi politik i Organizata Nacional Demokratike Shqiptare

Shqiptarët që mbetën jashtë kufijve të shtetit nuk pushuan asnjëherë së kërkuari të drejtën e tyre legjitime për bashkimin me shtetin amë, Shqipërinë. Kështu në viset e okupuara u formuan dhe vepruan shumë organizata dhe grupe ilegale të cilat nuk pranuan dhe u përplasën vazhdimisht me politikat komuniste Jugosllave mbi të drejtën e tyre. Në këtë kontekst, Sabile K. Basha, shkruan se “organizatat ilegale të cilat vepronin në Kosovë karakterizohen me programet e tyre që kryesisht kishin mbështetje në kërkesat e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”. Pra, që nënkuptonte sipas saj tri gjëra kryesore, fillimisht çlirim nga okupuesi, tashmë sllav, pavarësinë kombëtare dhe bashkimin e të gjitha trojeve etnike brenda një shteti.²⁴⁶ Pra, e tillë në aspektin programorë dhe ideorë ishte edhe Organizata Nacionale Demokratike Shqiptare-ONDSH, e cila veprimtarinë e sajë e shtrinte në Kosovë dhe në pjesën Lindore të Maqedonisë, gjatë viteve 1945 e deri më 1956. Gjatë kësaj periudhe të zhvillimeve politike në Kosovë, vepronin dy forca politiko-ushtarake diametralisht të kundërta, si NDSH-ja e cila përcaktohet për luftë të armatosur kundër robërisë së re jugosllave për çlirimin e tokave shqiptare dhe bashkimin e tyre me shtetin amë, si dhe shteti jugosllav i cili tërë mekanizmin e sajë politik dhe ushtarak e kishte orientuar kah rikolonizimi i Kosovës. Gjithashtu, NDSH-ja ndjekë një politikë nacionale e demokratike pro-perëndimore dhe udhëhiqej nga patriot dhe intelektual të dalluar si Ymer Berisha, Halim Spahiu, Gjon Serreqi dhe të tjerë.²⁴⁷

Kongresi i NDSH-së miratoi dy dokumente të rëndësishme në aspektin organizativ e posaçërisht në atë ideorë, “Skemën e organizatës” dhe “Programi i Lëvizjes për lirin e tokave shqiptare”. Skema organizative kishte parasysh aspektin e shtrirjes në teren, që duhej të ishte në çdo vend qytet apo katund, koordinimin mes komiteteve e deri tek kompetencat e çdo pozicioni përbrenda organizatës.²⁴⁸ Gjithashtu dokument tjetër ishte Programi i Lëvizjes për lirin e tokave shqiptare me pesë pika: 1. Liri dhe pavarësi të plotë me të drejtë vetëqeverimi në bazë të vullnetit të popullit të shfaqur lirisht; 2. Me trojet shqiptare kuptohet krejt vendet ku banojnë shqiptarë me 60% pa dallim se si quhet krahina e vendi dhe nga është i pushtuar; 3. Lëvizja nuk ka qëndrim armiqësor kundër asnjë populli

²⁴⁶ Sabile Kiçmezi-Basha, Të Burgosurit Politikë Shqiptarë në Kosovë 1945-1990, Logos-A, Shkup, 2009, 18.

²⁴⁷ Sabile Kiçmezi-Basha, Programet politike të lëvizjes kombëtare shqiptare 1878-1990, 2013, 159.

²⁴⁸ Shih më tepër: Rreth skemës organizative të NDSH-së; Qerim Lita, KQ i NDSH-së dhe Azem Marana, Logos-A, Shkup, 2011, 104.

fqinj as kundër ndonjë partie politike, vetëm insiston në mënyrë kulturore dhe me armë do të përpiqet t'ia arrijë idealit shekullor të kombit shqiptar, që të jetë i lirë dhe vetë-sundues në shtet të vet me kufijtë etnikë; 4. Pasi të vendosen kufijtë etnikë, pa marrë parasysh tjera kushte të kufijve siç janë ato: strategjike, ekonomike, politike etj., në mënyrë miqësore do të shkëmbehet popullata e pakicave nacionale, duke i tërheq shqiptarët që do të mbeten jashtë kufijve në vend të atyre që do të shpërngulen dhe do të përcillen jashtë; 5. Në kohë paqeje lëvizja nuk do të pushojë, por do të vazhdojë shërbim roje i të drejtave të popullit shqiptar, si të atyre të brendshme, ashtu edhe të atyre të jashtme, ndërkombëtare duke u organizuar për regjim me të vërtetë demokratik dhe relacione miqësore me popujt fqinjë ballkanikë.²⁴⁹ Aspekti organizativ dhe programorë i lëvizjes pasqyrojnë unitetin politikë dhe shpirtërorë në përputhje të plotë me të drejtën historike dhe etnike të popullit shqiptarë. Për NDSH-në është e rëndësishme vetëm liria dhe bashkimi i popullit shqiptarë përkundrejt gjitha rreziqeve të kohës, në këtë mënyrë, për të realizuar një ideal të tillë parashtrajnë nevojën e përdorimit të të gjitha metodave nga ato politiko-diplomatike e deri tek ato ushtarake. Gjithashtu, lëvizja në parim nuk është armike e popujve fqinj, por është armike e atyre popujve apo lëvizjeve që po e pamundësojnë në forma të ndryshme idealin e popullit shqiptarë. Ajo në parim impononte një nacionalizëm liberal, që nënkupton se një të drejtë të tillë, për bashkimin e tokave mbi kriterin etnik, e kanë edhe popujt e tjerë. Programi i sajë kombëtar pati jehonë të gjerë sepse ishte në refleksion me gjendjen e krijuar në teren, se pushtuesi komunist po zhvillonin një veprimtari të hapur kundër shqiptarëve, e posaçërisht pas copëtimit të tokave shqiptare.

Lëvizjes filluan t'i bashkoheshin veprimtarë të shumtë dhe nacionalistë të devotshëm që nuk pajtoheshin me ripushtimin sllavokomunist dhe ishin të zhgënjyer nga mashtrimet e tyre. Kështu, për një kohë të shkurtër lëvizja arriti të shtrihet pothuajse në të gjitha trevat shqiptare të pushtuara dhe të copëtuara nga komunistët sllavë. Ajo krijoi dy komitete qendrore një në Prizren, që vepronte në Kosovë dhe një në Shkup që vepronte në trevat shqiptare në Maqedoninë e Veriut.²⁵⁰ Gjithashtu lëvizja mbante lidhje me grupet e qëndresës shqiptare kundër komuniste me botën e jashtme, në Itali dhe në Greqi. Ajo

²⁴⁹ Po aty, 105.

²⁵⁰ Komitetet qendrorë si ai i Prizrenit dhe i Shkupit krijuan edhe një numër të madh komitetesh rajonale me qëllim të përfshirjes sa më të gjerë të organizatës në trojet shqiptare. Për më tepër shih: Sabile Kiçmezi-Basha, Veprimtaria atdhetare ilegale në Anamoravë 1945-1968, I, Instituti i Historisë Prishtinë, 2013; Qerim Lita, KQ i NDSH-së dhe Azem Marana, Logos-A, Shkup, 2011.

mbante lidhje edhe me përfaqësuesit e konsullatës angleze e turke në Shkup.²⁵¹ Nga ky këndvështrim mund të themi se ajo bashkëpunonte me të gjitha subjektet të cilat mund ta ndihmonin atë në realizimin e qëllimit kryesorë të parashtruar në programin e sajë.

Platforma e miratuar në Kongres në Tanushë të Kopilaçës ishte platformë që nuk përjashtonte as veprimin ushtarak, pra, atë me luftë për arritjen e synimeve për bashkim kombëtarë. Gjë të cilën në mënyrë sporadike dhe aq sa u lejonin mundësitë e aplikonin në teren, këtu mund të përmendim se me këtë lëvizje ishin të lidhura lufta e Ferizait, Gjilanit e Mitrovicës dhe ajo e Drenicës. Koncepti luftarak ishte motoja e kësaj lëvizjeje, hapësira etnike shqiptare ishte shtrirja, ndërsa aleanca me anglo-amerikanët ishte orientimi i saj politik.²⁵² Mirëpo, përfundimi qëndresës ushtarake të drejtuar nga NDSH-ja në trekëndëshin Ferizaj-Gjilan-Shkup dhe anëmbanë Kosovës e Maqedonisë Perëndimore, nuk kishte për pasojë disfatën ushtarake sepse ata kishin korrë një sërë suksese ushtarake. Por, luftëtarët e sajë u larguan në Greqi dhe gjetiu për arsye strategjike. Në përputhje me udhëzimet që morën nga aleatët-amerikanë, të cilët, pasi që marrëveshja e Jaltës kishin përcaktuar vijat e ndarjes midis Lindjes e Perëndimit, ishin të vetëdijshëm se në ato rrethana, kur nuk pritej konfrontimi Lindje-Perëndim, dhe nuk duhej të sakrifikohej popullata e pambrojtur, mbi të cilën binte hakmarrja e pushteti.²⁵³ Qendra në Shkup të udhëhequr nga Ibrahim Kelmendi nuk u pajtuan me këtë vendim, dhe disa patriot të tjerë me shtrirje në teren si Mulla Idriz Gjilani, duke reaguar se do të luftojmë deri në fund deri në përmbushjen e idealeve kombëtare.²⁵⁴ Pas këtij momenti lëvizja ushtarake do të dobësohej por nuk do të shuhej e tëra. Kështu më pas lëvizje nacionaliste shqiptare e tubuar përreth NDSH-së u ndjek ashpër nga sigurimit shtetëror jugosllav, ata rekrutonin dhjetëra mijëra shqiptarë të rinj, të cilët i angazhonin me forcë kundër bashkëkombësve të vet ose i dërgonin drejt veriut në luftën kundër Werhmachtit.²⁵⁵

Fatkeqësisht lëvizja nacionaliste shqiptare nuk e kishte mbështetjen apo luftohej edhe nga lëvizja komuniste shqiptare e Enver Hoxhës, dhe se ajo punonte ngushtë me Jugosllavinë për t'i mposhtur irredentistët shqiptarë të Kosovës. Partia Komuniste e Shqipërisë ishte e

²⁵¹ Historia e Popullit Shqiptarë IV, 2009, 365.

²⁵² Ethem Çeku, Struktura politike e ilegales së Kosovës, Brezi '81, Prishtinë, 2006, 51.

²⁵³ Jusuf Buxhovi, Kosova 1912-1945, Faik Konica, Prishtinë, 2015, 412.

²⁵⁴ Po aty, 405.

²⁵⁵ Oliver J. Schmitt, Kosova, 2012, 173.

varur plotësisht nga Partia Komuniste e Jugosllavisë, gjithashtu i bashkonte edhe aspekti ideologjik komunistë që këtë e shprehnin edhe në teren kundër forcave nacionaliste, ajo e Shqipërisë kundër Ballit kombëtarë,²⁵⁶ një forcë politike që punonte për bashkimin e trojeve etnike shqiptare me qendër në Shqipëri, dhe ajo e Jugosllavisë kundër forcave nacionaliste shqiptare të Jugosllavi. Për më tepër PKSH-ja e ndihmonte PKJ-në në luftën e sajë kundër nacionalistëve shqiptarë.

Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare i kishte ndërmarrë të gjitha masat politike dhe ushtarake në mënyrë që Kosova t'i bashkëngjitej Shqipërisë dhe të mos mbetej edhe më tej e kolonizuar nga Serbia. Rezistenca e kësaj lëvizjeje është zhvilluar në rrethanat shumë të vështira dhe aspak të kuptueshme nga faktori ndërkombëtarë, pra pas fitores së Jugosllavisë nga fashizmi, por edhe nga shteti shqiptarë. Mund të themi se NDSH-ja, luajti një rol të rëndësishëm në veprimtarinë ushtarake në mbrojtjen e popullatës shqiptare në këto treva dhe artikulumin ideorë e politik e cila ishte në një vijë ideore me Rilindjen Kombëtare Shqiptare apo me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Pavarësisht, se ajo arriti të shuhej nga forcat komuniste jugosllave pas një varg gjyqesh me vdekje dhe pushkatimesh, mirëpo organizmi i sajë ideorë dhe politik nuk u shua asnjëherë, por ai u transformua nga një emër në një emër tjetër.

2.2 Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve

Kohën kur Lëvizja “Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve” shtriu veprimtarinë e sajë nga historiografia njihet si faza e dytë e organizmit ilegal në Kosovë dhe konsiderohet ndër periudhat më të vështira të organizimit politik. Në këtë kohë Jugosllavia u shndërrua në një vend që përkrahej edhe më shumë nga forcat e bllokut perëndimorë, ajo bënte politikë të “balancuar” mes Lindjes dhe Perëndimit. Normalisht kjo dobësonte mundësinë e

²⁵⁶ Në fund të nëntorit të 1942 u krijua organizata Balli Kombëtar, me kryetarë Mithat Frashërin. Balli Kombëtarë në programin e sajë parashikonte luftë për mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptar, për një Shqipëri të lirë etnike, demokratike, me baza shoqërore moderne, për një shoqëri ku do të mbretëronte liri e fjalës dhe e mendimit, lufta kundër pushtuesit e të tjera. Në epiqendër të programit politik të Ballit Kombëtarë qëndronte vizioni për Shqipërinë Etnike. Për këtë qëllim një pjese e udhëheqësve të sajë ngurronte të luftonte menjëherë kundër pushtuesit fashist, kështu qëndrimet politike të Ballit ishin të kundërta me qëndrimet e Partinë Komuniste Shqiptare për të cilën dhe e luftoi atë deri në fund. Balli Kombëtarë ishte ndër forcat e para politike me program nacionalist që veprroi gjatë periudhës së Luftës së Dytë Botërore e shtrirë kryesisht në viset e Shqipërisë së sotme, dhe me organizim të dobët në viset tjera shqiptare. Sidoqoftë ajo u bë frymëzim i rëndësishëm për lëvizjet e mëtejme që kishin për qëllim konceptin e bashkimit kombëtarë, e posaçërisht një pjesë e anëtarëve të sajë u bë pjesë e lëvizjeve tjera politike të më pasme në ish-Jugosllavi. Shih më tepër: Kristo Frashëri, Mbi historinë e Ballit Kombëtar, Botimet Dudaj, Tiranë, 2012.

faktorizimit të elementit shqiptarë përbrenda Jugosllavisë. Gjithashtu situata politike në Kosovë karakterizohej nga shpërnguljet, dëbimi familjeve të shumta nga vatrat e tyre, me burgosjen e të gjithë atyre që konsideroheshin si anti-jugosllav, pra shqiptarët ishin shndërruar në armiq kryesorë nga pushteti aktualë. Në këto rrethana lëvizjet politike patriotike nga të gjitha trevat u riorganizuan dhe vazhduan veprimtarinë e tyre politike.²⁵⁷ Ndër lëvizjet më me ndikim në ligjërimin politik në Kosovë është “Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve” e krijuar në vitin 1963 e udhëhequr nga Adem Demaçi. Kjo lëvizje për një kohë të shkurtër do të shtrihet pothuajse në tërë hapësirën shqiptare në Jugosllavi, si në aspektin organizativ, ashtu edhe nga aspekti i ndikimit tek popullsia shqiptare. Aspekti organizativ i sajë ishte i shtrirë në komitete dhe vepronin në qytete të ndryshme si në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Gjilan, Shkup dhe Stamboll.²⁵⁸

Autorë i Statutit dhe Programit të Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve ishte Adem Demaçi njëherit dhe ideator i kësaj Lëvizjeje. Në statutin e kësaj lëvizjeje parashtrihen qëllimet prioritare të kësaj lëvizjeje, ku thuhet së “Qëllimi i parë dhe i fundit i Lëvizjes sonë asht sigurimi i të drejtave për vetëvendosje deri në shkëputje për viset e banuara me shumicë shqiptarësh, që gjinden ende nën administrimin e Jugosllavisë ...; 2. Lëvizja jonë, për me mbërrijt qëllimin e naltëpërmendun, ka me përdorë të gjitha mënyrat dhe mjetet që i vijnë për dore prej atyne politiko-propagandistike-mjete paqësore deri te lufta e armatosun dhe kryengritjet e përgjithshme popullore-mjete jopaqësore; 3. Në realizimin e të drejtës së patjetërsueshme të popullit shqiptarë, për çlirim dhe bashkim, Lëvizja jonë ka me pranue, me miradije të madhe, çdo ndihmë e përkrahje të sinqertë,

²⁵⁷ Faza e dytë e organizimit të lëvizjeve ilegale përfshin kohën në mes viteve 1958-1968. Edhe në këtë fazë ekziston një numër i konsiderueshëm i lëvizjeve ilegale që nga ato me shtrirje lokale deri tek ato me shtrirje më të gjerë. Në vitin 1958, Metush Krasniqi formoi “Partinë Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me Shtetin Amë”, dhe në vitin 1963 Adem Demaçi formoi “Lëvizjen Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve”. Këto dy organizata do të jenë bazament i rëndësishëm për organizimin e më vonshëm të lëvizjeve ilegale në viset shqiptare në Jugosllavi. Këtu kemi trajtuar më gjerësisht Lëvizjen Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve për shkak të shtrirjes së saj më të gjerë dhe ndikimit të sajë politik. Gjithashtu, edhe në aspektin konceptual dhe artikulues janë të ngjashme, mirëpo në bazë të hulumtimit që kemi bërë del se Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve është “më mirë” e organizuar në aspektin programorë dhe konceptual si dhe veprimtaria e sajë politike është “më e shtrirë dhe më jetëgjate”. Këtu, mund të qëndroj edhe arsyeja e mungesës së materialeve ekzistuese që pasqyrojnë aspektin programorë dhe veprimtarinë e Partisë Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare më gjerësisht. Pra, do të trajtojmë të dytën për arsyet e lartpërmendura dhe njëherit për t’i ikur trajtimeve të ngjashme, përndryshe këto dy lëvizje, qëndrojnë përbrenda ligjërimin nationalist. Shih më tepër, Ethem Çeku, Struktura Politike e Ilegales në Kosovë, Prishtinë, 2006; Ethem Çeku, Shekulli i Ilegale, Prishtinë, 2004; Sabile Kiçmezi-Basha, Veprimtaria atdhetare ilegale në Anamoravë 1945-1968, I, Prishtinë, 2013.

²⁵⁸ Selatin Novosella, Demaçi Lëvizja për Bashkim, Shoqata e të Burgosurve Politik të Kosovës, Prishtinë, 2012, 75.

materiale e morale-prej kudo dhe kujdo që t'i vije e t'afrohet; 4. Lëvizja jonë nuk e drejton aktivitetin dhe luftën e vetën kundër Jugosllavisë dhe sistemit të saj shoqërorë-ekonomik-si tanësi, por aktiviteti dhe lufta e saj do të vazhdojë, do të shkojë deri në atë shkallë, sa t'i çlirojë dhe t'i bashkojë me Shqipërinë krahinat shqiptare-t'aneksueme prej Jugosllavisë.”²⁵⁹

Për realizmin e qëllimit të sajë kjo lëvizje parashihte dy rrugë kryesore, përmes aktivitetit paqësorë që mund të nënkuptonte metodat propagandistike të bindjes ndaj masave të përgjithshme, dhe përmes aktivitetit jopaqësorë që nënkuptonte luftën e armatosur dhe kryengritjen popullore. Ajo çfarë ishte risi në artikullimin politik të lëvizjes ka të bëjë me përbrendësimin e konceptit të vetëvendosjes si zgjidhje e mundshme e problemit të shqiptarëve në Jugosllavi. Kështu, ata për fillim parashihnin krijimin e një qendre politike kulturore të shqiptarëve, që edhe shqiptarët si kombet e tjera në Jugosllavi të kenë Republikën e tyre, e cila do t'i përfshinte të gjitha viset e banuara me shumicë shqiptare dhe më pas bashkimin e tyre me Shqipërinë. Një koncept të tillë ata e artikulonin duke ju referuar Kushtetutës së Jugosllavisë së vitit 1963 sepse një gjë e tillë parashihej edhe me kushtetutën jugosllave.²⁶⁰ Mirëpo, të vetëdijshëm për rrethanat, dhe nga pamundësia për të realizuar një qëllim të tillë në mënyrë paqësore, ata nuk përjashtojnë edhe mjetet jopaqësore, e deri tek lufta e armatosur për të arritur një kryengritje të përgjithshme popullore. Bazuar në strategjinë e organizatës thuhet se “lufta e tyre do të jetë e gjatë”, se e njëjta duhet t'i “përfshij të gjitha shtresat e kombit shqiptar”, gjithashtu ajo duhet të “zhvillohet në kushte dhe rrethana që e mbisundojnë brenda kombit shqiptar si dhe kushteve dhe rrethanave që mbisundojnë në mbarë botën e sotme”. Pra, sipas tyre lufta e shqiptarëve është e drejtë dhe se ata nuk kërkojnë “asgjë më shumë se ato që i gëzojnë popujt e Evropës”. Lëvizja nuk drejton luftën e armatosur kundër tërë sistemit Jugosllav, por lufta e tyre do të zhvillohet deri në çlirimin dhe ribashkimin me shtetin amë territoret e aneksuara padrejtësisht nga Jugosllavia. Programi i LRBSH-së rrihte çështjen e karakterit kombëtarë, çështjen e çlirimit kombëtarë, çështjen e bashkimit territorial, çështjen e një tregu të përbashkët dhe çështjen e një ndjenje shpirtërore për një gjuhë të përbashkët letrare.²⁶¹ Mendimi i saj politik ishte në koherencë me mendimin politik rilindas dhe me parimet politike të Lidhjes së Prizrenit, një gjë e tillë shihet edhe në analizën politike të

²⁵⁹ Sabile Kiçmezi-Basha, Programet Politike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare 1878-1990, 169.

²⁶⁰ Shih: Selatin Novosella, Kosova “64, Lëvizja për Bashkimin e Shqiptarëve, Logos-A, Shkup, 2012, 70.

²⁶¹ Po aty, 171.

programi që ajo i bënë problemit të pazgjidhur të shqiptarëve në Jugosllavi. Një gjë e tillë e shprehet qartazi dhe pa luhate në Neni e katërt të statutin e programit të saj se “... lufta e saj do të vazhdojë, do të shkojë deri në atë shkallë, sa t’i çlirojë dhe t’i bashkojë me Shqipërinë krahinat shqiptare-t’aneksueme prej Jugosllavisë”.

Gjithashtu Adem Demaçi ishte i mendimit se zgjidhja e çështjes shqiptare nuk mund të vendoset nga jashtë dhe nga lartë, por faktor kyç dhe përcaktues i zgjidhjes së çështjes së Kosovës duhet kërkuar nga brenda dhe nga poshtë. Me këtë ai dëshironte të përçonte mesazhin se forca vendimtare për zgjidhjen e kësaj çështje janë vet populli dhe rezistenca politike permanente që ai do të zhvillojë. Normalisht ai nuk mohonte rolin që mund të luajnë pozicionet e ndryshme ndërkombëtare, por kërkon që mos të shpresohet shumë në këto forca sepse ato marrin kuptim dhe janë të dobishme vetëm kur kombinohen me kushtet e brendshme dhe kur veprojnë si faktorë ndihmës dhe plotësues të tyre. Pra, përpjekja nga brenda dhe nga poshtë e çështjes së bashkimit të trojeve shqiptare duhet të jetë përqendrimi kryesorë dhe vendimtarë në përpjekjet tona të më tutjeshme. Qëndrimi veprues LRBSH-së ishte shumë frymëzues dhe pozitivë, pra moto e tyre ishte “Mos me fjet asnjë çast”! sepse çështja shqiptare në Jugosllavi është në rrjedhat e zhvillimeve progresive, kurse armiku është në rrjedhat e zhvillimeve regresive, dhe se lufta jonë le të zgjas sa të dojë, le të jetë e vështirë sa të dojë në fund të fundit ne do të dalim fituesit e sajë.

LRBSH-ja aktivitetin e sajë e shrinte në shumë fusha si në ato arsimore, kulturore, politike. Ajo propagandonte historinë, kulturën simbolet kombëtare, shpërndante flamuj, shkruante parulla kundër institucioneve partiake shtetërore dhe personaliteteve të caktuara dhe përgatitej për një kryengritje të armatosur popullore me qëllim të bashkimit të trojeve etnike me Shqipërinë.²⁶² Autoritetet Jugosllave nuk rrinin duarkryq përball këtyre aktiviteteve dhe aksioneve politike të LRBSH-së, ata përcjellshin në çdo kohë dhe çdo moment e posaçërisht udhëheqësi i kësaj organizate që pjesën më të madhe të jetës së tij kishte kaluar në burgjet e Serbisë nën akuzën e veprimtarisë ilegale. Gjithashtu mund të përmendim edhe arrestimin e 300 anëtarëve nga autoritetet jugosllave më 8 qershor të 1964 pas një aksioni për vendosjen e flamujve nëpër qytete të ndryshme të Kosovës.²⁶³

²⁶² Ethem Ceku, *Struktura politike e ilegales së Kosovës*, 2006, 88.

²⁶³ Shkëlzen Gashi, *Adem Demaçi Biografi, Rrokullia, Prishtinë*, 2010, 44.

Mund të themi se LRBSH-ja ishte ndër organizatat më të rëndësishme të pas Luftës së Dytë Botërore, ajo së bashku me organizatat e tjera politike të kësaj periudhe, ndikuan shumë në vetëdijesimin e përgjithshëm popullorë tek shqiptarët dhe shtoi formën e rezistencës përball shtetit jugosllavë. Gjithashtu ajo që ishte karakteristikë e të gjitha organizatave politike të kësaj periudhe ishte artikulumimi i zgjidhjes së problemit të të gjithë shqiptarëve në Jugosllavi, qoftë përmes konceptit të vetëvendosjes për krijimin e Republikës Shqiptare në Jugosllavi qoftë përmes konceptit të luftës së armatosur për të arritur deri te qëllimi final, pra ai i Bashkimit Kombëtar Shqiptar.

2.3 Demonstratat e 68-tës

Gjashtëdhjeteteta shqiptare nuk ishte shpërthim dhe demonstrim i rastësishëm i popullit shqiptar në Jugosllavi, por ajo ishte një akumulim nga represioni i egër serbomadhin gjatë dy dekadave të pasluftës. Gjatë këtyre viteve shqiptarët u bënë ballë fushatës së egër për shkombëtarizim e për shpërngulje masive nga trojet shqiptare. Gjithçka që ndërmerrej gjatë këtyre viteve ndaj popullsisë shqiptare si propaganda mashtruese, masat administrative, aksione të ndryshme policore, burgosjet politike, vrasjet e të tjera kishin për qëllim spastrimin etnik të popullsisë shqiptare nga këto treva.²⁶⁴ Sipas historianëve të mirënjohur si Pajazit Nushin, Ukshin Hoti e Haki Bajrami, në Turqi nga viti 1950 deri në vitin 1966 janë shpërngulur mbi 400 mijë shqiptar.²⁶⁵ Udhëheqësit Jugosllav, gjegjësisht Aleksandër Rankoviç kishin ndjekur një politikë të ashpër antishqiptare, por dhe përkundër sajë populli shqiptarë i Kosovës ruajtën vitalitetin sajë politik dhe shteti Jugosllav nuk arriti objektivat e saja. Në vitin 1966 në Plenumin Partiak të mbajtur në Brione, Ministri i Brendshëm Aleksandër Rankoviç shkarkohet nga pozita e tij nga Titoja, dhe e bënë atë përgjegjës për një sërë dështimesh politike. Në këtë mënyrë shkarkimi i tij hapi rrugën drejt një decentralizimi të më tejme të Republikës Federale të Jugosllavisë, kundrejt politikave centralizuese që ndjekte udhëheqësi serb Rankoviç.²⁶⁶ Kjo ishte periudha ku shqiptarët

²⁶⁴ Shih më tepër: Shpërnguljet massive të popullsisë shqiptare u paraprinë regjistrimi i popullsisë i vitit 1953 si edhe veprimtaria e nevojshme e diplomacisë jugosllave. Gjatë procesit të regjistrimit të popullsisë të vitit 1953 u përdorën veprime tendencioze ndaj tyre, nga detyrimet që ata të deklaroheshin si turq e deri tek akteve më brutale për detyrimin e tyre të shpërnguleshin drejt Turqisë dhe vendeve tjera; Historia e popullit shqiptar IV, 2009, 371.

²⁶⁵ Po aty, 372.

²⁶⁶ Noel Malcolm, 338.

filluan të frymonin më lirshëm dhe për më tepër pushtetarët shqiptarë në formë legale kërkuan barazimin e popullit shqiptarë me popujt tjerë të Jugosllavisë.

Andaj, në vitin 1968 pas lejes së Josip Broz Titos, në qendra të mëdha të Kosovës filluan diskutimet për ndryshimet në Statutin e Kosovës, kështu formohet Komisioni për plotësimin e Statutit të Krahinës Autonome të Kosovës dhe kryetarë i këtij komisioni ishte caktuar Fadil Hoxha, njëherit kryetar i Kuvendit Krahinor të Kosovës. Këtë hap Titoja ishte i detyruar ta bënte si patriot jugosllav që ishte dhe se pozita e tij ishte rrezikuar mjaftueshëm nga shovinizmi serb. Tubimi i parë për ndryshime kushtetuese u mbajt në Gjakovë dhe në mbledhje u kërkua ndryshimet rrënjësore të sistemit politik. Aty u kërkua që: 1. Në kushtetutën e Republikës Socialiste të Jugosllavisë, kombësia shqiptare të emërohet si kombi shqiptar; 2. Me kushtetutë dhe me ligj të përcaktohet përdorimi i flamurit kombëtar shqiptar; 3. Krahina e Kosovës të shpallet Republika e Kosovës: gjithashtu në këtë mbledhje dolën edhe këto kërkesa: a) E drejta për vetëvendosje, b) në vend të statutit Kosova të ketë Kushtetutë, c) në Dhomën e Kombeve të Kuvendit Federativ Kosova të ketë 20 përfaqësues si republikat tjera.²⁶⁷ Qëndrimet e Aktivit politik të Gjakovës u mbështetën unanimisht edhe nga aktivet politike të Prishtinës, Gjilanit, Pejës, Mitrovicës dhe të qendrave të tjera komunale në Kosovë. Në diskutimet për ndryshimet kushtetuese u implikua edhe inteligjencia e kohës, e cila me argumente shkencore paraqiste të drejtën e të gjithë popujve për vetëvendosje, në këtë kontekst edhe të shqiptarëve të Kosovës deri në shpëputje.²⁶⁸ Mirëpo, burokracia nga radhët e popullit shqiptarë iu nënshtrua presionit që ushtrohej nga nivelet e Federatës Jugosllave dhe të Republikës së Serbisë, që diskutimet të ngushtoheshin dhe të orientoheshin në të drejta shumë të kufizuara, të cilat do të fitoheshin në fund të këtyre diskutimeve. Diskutimet kundër “argumentonin” se gjoja një popull nuk mund të ketë dy shtete. Si shumë herë më parë edhe tani kur po vendosej për fatin e Kosovës, burokracia shtetërore apo versioni legal i shqiptarëve në kuadër të Jugosllavisë në krye me Fadil Hoxhën-kryetar i Kuvendit të Kosovës, Veli Devën-kryetar i Komitetit Krahinor të Lidhjes së Komunistëve të Kosovës, Xhavit Nimanin, Xhevdet Hamzën, Ali Shukriun, Sinan Hasanin,

²⁶⁷ Jusuf Buxhovi, Kosova 1945-1999, Faik Konica, 2015, 90.

²⁶⁸ Shih më tepër: Fjala është për Fehmi Aganin, Gazmend Zajmin, Ali Hadrin, Syrja Pupovci, Dervish Rozhaja, Hajredin Hoxha, Mark Krasniqi, Ismail Dumoshi, Hasan Mekuli, Vehap Shita etj. Të gjithë këta profesorë të fakulteteve të Prishtinës dhe punëtorë të njohur shkencorë, si dhe Ramdan Vraniqi-kryetar i Gjykatës së Lartë të Kosovës, Rezak Shala-Prokuror krahinor i Kosovës, Sali Bjra-kryetar i Komunitetit të Kacanikut, Bardhyl Caushi-kryetar i Gjykatës Komunale Gjakovë etj; Selatin Novosella, Demonstratat e Gjashtëdhjeteta, 40.

Kolë Shirokën, Mahmut Bakallin-kryetari i Komitetit Komunal të Lidhjes së Komunistëve të Prishtinës, e të tjerë kapitulluan politikisht në çastin e fundit para ndryshimeve kushtetuese të vitit 1968.²⁶⁹

Burokracia shqiptare e Kosovës, apo siç njihej ndryshe nga historiografia shqiptare edhe si “Lëvizja për autonomi” nuk mbështeti deri në fund realizimin e dëshirave plebishitare të popullit të Kosovës dhe e lanë atë në mëshirën e forcave regresive serbe. Pra duke e pasur parasysh këtë gjendje politike, e vetmja formë e paraqitjeve të kërkesave dhe të qëndrimeve politike kishin mbetur demonstratat. Në këtë mënyrë, shqiptarët e Kosovës të udhëhequr nga inteligjencia dhe të bartur nga entuziazmi rinor i studentëve dhe i të gjitha shtresave të tjera shoqërore, që ishin implikuar në këtë ecure politike, e kishin të qartë se nuk duhej ndalur pa marrë parasysh masat e paralajmëruara nga Beogradi. Të bindur se kërkesa për Republikën e Kosovës tashmë është kërkesë legale dhe duhej të vazhdohej insistimi në këtë kërkesë në formë trysnie ndaj politikës jugosllave dhe kësisoj të ndërkombëtarizohej sa më shumë kjo si çështje. Pra, kërkesa për Republikën e Kosovës filloi të kishte mbështetje të gjerë intelektuale, shoqërore dhe politike të të gjithë Shqiptarëve, të cilës i jepej dimension gjeopolitik dhe gjeostrategjik. Anadaj, më 27 nëntor, në të gjithë qytetet e Kosovës dhe më gjerë u organizuan demonstrata nën kërkesat “Duam Kosovën Republikë”, “Vetëvendosje”, “Kushtetutë-Republikë”, “Duam Universitetin e Prishtinës”, “Rroftë flamuri” e të tjera.²⁷⁰ Gjithashtu kërkesat e demonstruesve në mënyrë të artikuluar ishin të përmbledhura në 7 pika, ku kërkohet realizimi i plotë i të drejtave kombëtare, të gëzojmë të drejtat që gëzojnë edhe popujt tjerë, përmirësimi i kushteve ekonomike dhe sociale, e deri tek pjesa përmbyllëse “Përpara për vetëvendosje, barazi dhe Liri”.²⁷¹ Shqiptarët e Kosovës në këtë demonstratë kërkuan Vetëvendosje, Kosova Republikë, gjegjësisht Barazi me popujt tjetër të Republikës Jugosllave. Megjithatë demonstratat e nëntorit u shtypën, menjëherë të nesërmen pushteti jugosllav kishte filluar burgosjen e organizatorëve për të dënuar veprimtarinë e tyre. Demonstrata masive u organizuan edhe në qytete tjera shqiptare jashtë Kosovës, si në Tetovë dhe Ulqin. Më 22 dhe 23 dhjetorë inteligjencia e atëhershme shqiptare organizoi demonstrata masive në Tetovë, në të cilën u shtruan shumë kërkesa, si “Poshtë shovinizmi maqedonas”, “Kërkojmë hapjen e

²⁶⁹ Po aty, 45.

²⁷⁰ Historia e popullit shqiptar, IV, 2009, 386.

²⁷¹ Sabile Keçmezi Basha, Programet ... 2013, 211.

Universitetit të Kosovës!”, Kërkojmë përdorimin e lirë të flamurit kombëtar”, midis të tjerave u kërkuar lirimi i Adem Demaçit si dhe bashkëngjitja e viseve veri Perëndimore të Maqedonisë me Kosovën, përkatësisht “Krijimin e Republikës shqiptare në Jugosllavi”.²⁷²

Në këtë kontekst vërehet një ndryshim i artikullimit të çështjes shqiptare në ish-Jugosllavi, fillimisht koncepti “Republikë” zënë një vend të rëndësishëm në ligjërimin politik publik të shqiptarëve në Jugosllavi, si dhe fillimi i ngadhënjimit të ndarjes administrative në krijimin e botëkuptimit politik, gjegjësisht në formësimi e kërkesave politike të shqiptarëve të Kosovës, pra nga ideja e Republikës së shqiptarëve në Jugosllavi, tek ideja e Republikës së Kosovës.

Statusi i Republikës në Federatën Jugosllave ishte niveli më i lartë i organizimit politik, territorial dhe administrativ, ai përcaktonte dhe nivelin më të lartë të të drejtave të politike, ekonomike e shoqërore për kombin që e përfaqësonte. Kështu, shqiptarët duke kërkuar republikë, jo vetëm që kërkonin të trajtoheshin të barabar me kombet tjera në Jugosllavi, por se me kërkesën për republikë kishin parasysh edhe të drejtën shkëputjes dhe bashkimin me shtetin amë, sepse kjo u garantohej me këtë kushtetutë. Jusuf Buxhovi shprehet se ndryshimi nga bashkimi me Shqipërinë te barazia, pra te ngritja e statusit të Kosovës në shkallën e republikës së barabartë me të tjerat në Federatën e Jugosllave, nuk ishte as shpërputhës, as kundërshtues siç dukej. Por, paraqiste një përcaktim strategjik në përputhje me rrethanat dhe logjikën politike, që çonte te e njëjta, që do të thotë se populli shqiptarë mund t’i realizonte aspiratat e veta historike, bashkimin kombëtarë dhe jo më me rrugë revolucionare dhe me luftë të armatosur.²⁷³ Gjithashtu, që në këtë formë të artikulohej kërkesat e shqiptarëve të Kosovës ka të bëjë edhe me qëndrimin indiferent të shtetit Shqiptarë ndaj çështjes së shqiptarëve në Jugosllavi. Udhëheqësi i sajë Enver Hoxha e artikulon çështjen e Kosovës si çështje të brendshme të Jugosllavisë, përkundër asaj që ai mbështeste kërkesat për të drejta më të avancuara të shoqërisë shqiptare atje. Enver Hoxha shkruante se “populli i Kosovës duhet ta kuptojë se në këto koniunktura asnjëherë Shqipëria nuk mund ta atakojë as ta sulmojë Jugosllavinë. RPSH-ja s’mund të jetë kurrë agresor. Në

²⁷² Në konkluzionet e Këshillit ekzekutiv të KQ të LKM-së, të miratuar më 26 dhjetor të 1968, ndër të tjera demonstratat u kualifikuan si “armiçësore” dhe se të njëjtat patën qëllim “rrezikimin e rregullimit shoqëror, kundër integritetit territorial të Republikës së Socialiste të Maqedonisë dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë”. Shih më tepër: Qerim Lita, Çështja shqiptare në RSFJ 1981-1990, Vatra, Shkup, 2014, 36.

²⁷³ Jusuf Buxhovi, Kosova 1945-1999, 2015, 100.

qoftë se Jugosllavia atakon Shqipërinë ai është problem tjetër, Shqipëria do të mbrohet, do të luftojë dhe do të fitojë dhe problemi i Kosovës vihet krejt ndryshe”.²⁷⁴ Shqipëria e atëhershme vazhdonte ta shikonte luftën e Kosovës të lidhur ngushtë me luftën e popujve të Jugosllavisë. Kjo ishte edhe një arsye tjetër, kryesisht strategjike se pse ndryshoi artikulli politik i lëvizjes ilegale, ku kërkohet që shqiptarët të shpallnin Republikën shqiptare në Jugosllavi apo Kosova të shpallej Republikë në kuadër të Jugosllavisë.

Pas 1945-ës, çështja shqiptare në ish-Jugosllavi ishte ndarë, ajo u copëtua në shumë Republika, kjo gjendje pas 1968-ës filloi të shihej si pengesë për artikullimin e kërkesave të përbashkëta të shqiptarëve në Jugosllavi, në një farë mënyre çdo pjesë duhej t’i artikulonte kërkesat e veta sepse ato tashmë i përkisnin republikave përkatëse. Në këtë kontekst, mund të themi se ndarja administrative në kuadër të Jugosllavisë filloi të determinoj edhe çështjen e zgjidhjes së problemit të shqiptarëve në Jugosllavi. Këtu ishte dhe gjeneza e ndarjes së çështjes shqiptare në ish-Jugosllavi, ku nga ideja për një Republikë Shqiptare në Jugosllavi, në idenë për Republikën e Kosovës në Jugosllavi. Kështu, kjo ndarje nga elitës politike shqiptare fillon të konceptohet si reale, pavarësisht se ajo deri më tani artikulohej si jolegjitime dhe jo në përputhshmëri me vullnetin politik të shqiptarëve, sepse ajo nuk merrte në konsideratë dominancën etnike dhe kompaktësinë territoriale të shqiptarëve përbrenda Jugosllavisë. Pra, pavarësisht frymës mbarë kombëtare të demonstratave, që ishin reaksion ndaj represionit të vazhdueshëm të pushtetit jugosllav në tërë viset shqiptare ato filluan të shpërfaqin një diskurs të ndryshëm ligjërimor nga ai i deri tanishmi.

Për më tepër, demonstratat shpërfaqën pakënaqësinë e të gjithë shqiptarëve për tretmanin persekutues, diskriminues e çnjerëzor që po u bënte atyre Federata Jugosllave. Mund të themi se Demonstratat e 68-tës dëshmuan vullnetin politik të shqiptarëve në Jugosllavi, tashmë në mënyrë demonstrative dhe legale dëshmuan për padrejtësitë që po u bëhen dhe njëherit shtruan kërkesat e tyre për realizimin e aspiratave të tyre kombëtare. Për rëndësinë dhe seriozitetin e sajë gjithashtu fletë edhe reagimi i ashpër ndaj i institucionet federale ndaj të gjithë protestuesve anëmbanë ku ndodhën demonstratat, ku një numër i madh i tyre u burgosën, u keqtrajtuuan dhe morën dënime të mëdha si shkak i pakënaqësive të shprehura publikisht. Demonstratat e 68-tës do të ketë rol të rëndësishëm në proceset e më

²⁷⁴ Ethem Ceku, Kosova në vitet 1960-1970 dhe qëndrimi i Shqipërisë; <https://aab-edu.net/assets/uploads/2016/11/02-2009-04 - Ethem Ceku.pdf> 22.07.2019.

vonshme politike legale dhe ilegale e sidomos në artikulumin e koncepteve politike për të drejtën e shqiptarëve për vetëvendosje.

2.4 Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavisë

Periodha e pas viteve të 68-tës, e posaçërisht pas 74-tës, deri më 81, sipas historiografisë konsiderohet si faza ku lëvizjet nacionale janë shtuar dhe kanë shtrirë veprimtarinë e tyre politike edhe më gjerë. Në bazë të presionit dhe luftës së vazhdueshme të mendimit nationalist shqiptarë në Jugosllavi dhe në bazë të raportit me botën e jashtme e detyruan Titon që të bëjë një shëndrrim të rëndësishëm në jetën konstitucionale të krahinave. Më 1974 u miratua Kushtetuta e re e Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë. Por, pavarësisht statusit më ta avancuar të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, ajo nuk ishte e shkëputur plotësisht nga principet komuniste të së drejtës së kombeve për vetëvendosje. Ajo ruajti konceptin e vetëvendosjes në bazë të principit stalinist, ku ekzistonin kombet dhe kombësitë, duke i trajtuar kombet si popuj, të cilët përbënin një njësi territoriale të caktuar me të gjitha karakteristikat dhe të cilët nuk ishin pjesë të një kombi tjetër, që kishte shtetin amë. Ndërsa kombësitë, kishin të gjitha karakteristikat e kombit, por nuk quheshin kombe për shkak se ato kishin një shtet amë nga i cili ishin shkëputur. Kështu Kushtetuta e 74-tës shqiptarët e Kosovës dhe hungarezët i trajtonte si kombësi dhe që nënkuptonte mohimin e të drejtës së këtyre popujve për shkëputje apo për vetëvendosje. Edhe pse krahinat me Kushtetutë ishin pjesë e Republikës së Serbisë ato u shndërruan në element konstituvivë, si anëtar të përhershëm me të drejta të barabarta me republikat tjera.

Kjo periudhë shënoi një liberalizimi raportesh në shumë fusha të jetës sociale, gjithashtu dhe i dha një shtytje të madhe lëvizjeve nacionaliste në Kosovë. Pavarësisht avancimit të të drejtave represioni i pushtetit nuk ndalej, vazhdonte burgosja e intelektualëve shqiptarë, përmes proceseve të montuara politike, ku veprimtari i shquar i çështjes kombëtare Adem Demaçi dënohet me 15 vjet burg të rëndë. Gjithashtu ishin burgosur udhëheqja e organizatës “Grupi revolucionar e Kosovës”, si Kadri Osmani, Xhafer Shatri, Binak Ulaj, Jashar Alia, Metë Shatri etj.²⁷⁵ Këto dhe rrethana tjera vetëm sa e forcuan rrugën e nisur të nationalistëve shqiptarë për bashkimin e trojeve shqiptare me shtetin amë. Në këtë rrugë

²⁷⁵ Selatin Novosella, Procesi politik i Prishtinës, Logos-A, Shkup, 2012, 38.

qëndronte edhe Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës dhe Viseve Shqiptare në Jugosllavi e themeluar në mesin e viteve 70-ta nga Metush Krasniqi, Sabri Novosella, Jusuf Gërvalla dhe Shevqet Jashari.²⁷⁶ Kjo organizatë ishte vazhdimësi e “Lëvizjes Nacional Çlirimtare e Kosovës” të kryesuar nga Adem Demaçi dhe të tjerë. Kjo organizatë ruante koherencën ideore me organizatat tjera nacionaliste shqiptare si NDSH-ja, LRBSH-ja, dhe të tjera për bashkimi i të gjitha tokave shqiptare me Shqipërinë. Në nenin një të statutit të sajë shkruan se “lëvizja lufton për çlirimin e të gjitha viseve shqiptare të robëruara nga Jugosllavia dhe bashkimin e tyre me Nënë Shqipëri, gjegjësisht për krijimin e shtetit brenda kufijve të vet kombëtar”. Gjithashtu, në këtë kontekst mund të ju referohemi edhe një kërkesë që LNÇKVSHJ-ja publikon në revistën e sajë “Zëri i Kosovës” ku ndër të tjera kërkohet se “Shqiptarëve në Jugosllavi t’u njihet statusi i kombit dhe e drejta demokratike për vetëvendosje deri në shkëputje”.²⁷⁷ Pra, kjo organizatë përkundrejt shfaqjes së ideve tjera për zgjidhje e çështjes shqiptare vendos si që qëllim final të ketë Luftë Nacional Çlirimtare me një platformë kombëtare e ideopolitike, duke pas në konsideratë shtrirjen territoriale të kombit shqiptarë dhe domosdoshmërinë e bashkimit të tij me shtetin amë.

Gjithashtu, kjo organizatë si element të rëndësishëm për jetësimin e programit të vetë politik e sheh luftën armatosur. Për t’i realizuar këto qëllime të larta punon në përgatitjen e masave të gjëra popullore, punëtore fshatare dhe inteligjencien përparimtare, që në momentin e duhur të ngrihet në mënyrë të organizuar në Luftën Nacional Çlirimtare.²⁷⁸ Anëtari i lëvizjes do të ishte shumë lumtur në qoftë se ka fatin dhe nderin me u flijue për çështjen e kombit shqiptarë. Gjithashtu, Jusuf Gërvalla ndër aktivistët dhe intelektualët më të shquar të organizatës shkruan se “... Shoku im është gjithë ai shqiptar – punëtor, fshatar, zejtar, intelektual popullor i cili është ngritur deri në atë shkallë të ndershme revolucionare sa çështjen e çlirimit kombëtar e klasor nga nacional-shovenizmi jugosllav, Çështjen e Bashkimit të Shenjtë me Nënë Shqipëri, nuk e merr si punë, që mund të bëhet apo mund të pres për më vonë, por si luftë që duhet të marr zjarr me dhembje, me ngut, me alarm ...”.²⁷⁹ Glorifikimi i konceptit të luftës nënkupton vullnetin dhe idealin politik të pamposhtur të lëvizjes. Kjo organizatë kishte arritur një bashkëpunim të shkëlqyeshëm edhe me shtresën

²⁷⁶ Ethem Çeku, 2006, 104.

²⁷⁷ Bajram Kurti, Begzad Baliu, Gjaku i lirisë 1981-1995, III, Prishtinë, 1997, 31.

²⁷⁸ Sabile Kiçmezi Basha, Programet politike të lëvizjes kombëtare shqiptare 1878-1990, 246.

²⁷⁹ Bajram Kurti, Begzad Baliu, Gjaku i lirisë 1981-1995, III, Prishtinë, 1997, 32.

intelektuale e cila e zhvilloi edhe më shumë këtë organizatë. Këtu vlen të përmendet kontaktet e Metush Krasniqit me elementët ushtarak si të strukturave shtetërore të shtetit shqiptarë. Rol të rëndësishëm në përhapjen e idesë dhe organizimit të kësaj organizate pati edhe veprimtari i shquar i ilegales shqiptare Jusuf Gërvalla.²⁸⁰ Kështu kjo organizatë arriti të shtrihej në shumë vise shqiptare por edhe më gjerë, në Turqi dhe Gjermani. Lëvizja Nacional Çlirimtare e Kosovës Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavisë vazhdon traditën organizative dhe konceptuale të filluar nga Adem Demaçi dhe zgjeruan aktivitetin e sajë edhe në Diasporë me Isuf Gërvallën dhe Kadri Zekën.²⁸¹ Kjo organizatë dhe të tjera organizata me orientim të qartë politik luajtën një rrol të rëndësishëm në konsolidimin e më tejme të nacionalizmit shqiptarë, ajo çfarë e bënë edhe më të veçantë këtë organizatë nga të tjera është shtrirja e sajë në diasporën shqiptare, në mënyrë që edhe diaspora shqiptare të jap kontributin e vet në çështjen kombëtare shqiptare në ish-jugosllavi. Gjithashtu veprimtaria e sajë ndikoi edhe në proceset e më tejme politike para dhe pas demonstratave të 1981-tës.

2.5 Demonstrata e 81-tës

Shqiptarët synonin shfrytëzimin e legjislacionit të ri për t'u integruar në jetën sociale, politik, ekonomike përbrenda organeve administrative të Krahinës, të Republikës dhe të Federatës. Pas këtyre ndryshimeve kishin ndodhë zhvillime të lakmueshme në krahasim me të kaluarën. Në rrafshin kulturorë kishte ndryshime të theksuara, në Prishtinë u hap Universiteti tashmë i pavarur nga Beogradi, mësimet zhvilloheshin në të dyja gjuhët, gjithashtu u hapën shumë shkolla të reja dhe u rrit numri i nxënësve, studentëve e në këtë rast edhe i mësuesve shqiptarë. Ishin themeluar edhe institucione tjera të rëndësishme të cilat ndikuan në rigjallërimin dhe forcimin e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve si Instituti Albanologjik i Prishtinës, Instituti i Historisë, Arkivi i Kosovës, Biblioteka Kombëtare dhe

²⁸⁰ Ethem Ceku, *Strukturat ...* 2006, 105.

²⁸¹ Veprimtaria politike e LNÇKVSHJ-së shquhet edhe në diasporë, gjegjësisht në drejtim të organizimit të demonstratave nëpër qytete të Evropës Perëndimore. Më 1981 u organizuan demonstratat e para në Bern para ambasadës Jugosllave, pastaj pasuan demonstratat në Cyrih, Shtutgard, Dyzeldorf, Munih, Gjenevë, pastaj Francë, Belgjikë, Suedi, SHBA, etj. Këtu shquhet veprimtaria e Jusuf Gërvallës nga LNÇKVSHJ-së dhe Kadri Zekës nga MLK-së në Gjermani dhe e Sabri Novosellës nga LNÇKVSHJ në Stamboll. Gjithashtu, pas arrestimeve të fundvitit të 1981 shumica e patriotëve shqiptarë aktivitetin e tyre e vazhduan në mërgim. Këtu vlen të theksohet krijimi i Organizatës "Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi-LRSJ" në mërgim, e cila do të luftoj duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet demokratike e revolucionare, për krijimin e Republikës Socialiste Shqiptare në kuadër të Federatës Jugosllave. Kjo organizatë themelohet më 19 shkurt të vitit 1982 me bashkimin e LNÇKVSHJ-së, OMLK-së së Xhafer Shatrit, PKMLSHJ-së, FKP-së së Ibrahim Kelmendit. Për veprimtarinë e lëvizjeve ilegale në diasporë Shih: Bajram Kurti, Begzad Baliu, Gjaku i lirisë 1981-1995, III, Prishtinë, 1997, 20-38; Sabile K. Basha, *Programet ...*, 2013, 276. Lidhja Kosovare në SHBA dhe Jusuf Azemi, *Dokumente sekrete jugosllave (1971-1990)*, Vatra, Shkup, 2015.

Universitare e institucione të tjera të shëndetësore, të informimit e të tjera. Mirëpo, këto ndryshime kushtetuese dhe zhvillimet shoqërore e politike në Kosovë ishin të përkohshme, sepse zhvillimi kishte ngecur, apo thënë më mirë krahas tyre zhvilloheshin edhe veprimtari diskriminuese dhe represive ndaj shqiptarëve. Gjithashtu krahasuar edhe me republikat tjera të Jugosllavisë statuti politik, shoqërorë dhe ekonomik ishte përsëri i ulët, gjë që linte të pa mbyllur hendekun midis Kosovës dhe njërive tjera federative.²⁸² Mirëpo, ky zhvillim i hovshëm sidomos në sferën e arsimit u shndërrua në problem të papunësisë në vitet e ardhshme. Vetëm në mesin e vitit 1970 në Kosovë kishte afro 450 000 nxënës e studentë dhe 150 000 punëtorë, që do të thotë se çdo punëtorë mbante 3 nxënës student, ndërkohë që në Slloveni ky raport ishte i kundërt. Kështu ekonomi e Kosovës e kishte të pamundur të thithte në punë të gjithë kuadrot e mesëm dhe të lartë, duke shtrirë kështu papunësinë edhe në shtresën intelektualëve, çka ndikoi ndjeshëm në ashpërsimin e kontradiktave ekonomike.²⁸³ Gjithashtu kushte të rënda figuronin edhe në fushat tjera shoqërore, si në arsim, shëndetësi, e posaçërisht në zhvillimin ekonomik të vendit. Pabarazia etnike në institucionet shtetërore ishte tejet e theksuar dhe sipas N. Malcolm asnjëherë nuk u përmirësuan, më 1980 llogaritej se çdo i pesti serb kishte rrogë shtetërore, kurse çdo i njëmbëdhjeti shqiptarë merrte rrogë shtetërore.²⁸⁴ Gjuha shqipe nuk përdorej në administratën shtetërore, mbishkrimet në gjuhën shqipe ishin tejet të rralla në qytetet e Kosovës asokohe. Kështu sipas Muhamedin Kullashit ideologjia e vëllazërimit dhe barazisë së popujve shikohej nga shqiptarët gjithnjë e më shumë si një demagogji hipokrite që ka për qëllim të fsheh një politikë shoviniste të shtypjes dhe të asimilimit brutal.²⁸⁵ Në këtë kontekst realiteti i zhvilluar ishte në kontrast të fortë me garancitë kushtetuese dhe premtimeve politike mbi barazinë e popujve në Jugosllavi. Këtë politikë intelektualët shqiptarë e cilësonin si politikë kolonialiste dhe raciste e cili bëhej me tendencë nga intelektualët dhe pushteti i asaj kohe. Gjithashtu mbi të gjitha arsyet tjera figuronte se Kosova nuk ishte Republikë dhe me këtë mungesë shqiptarët ballafaqoheshin çdo ditë, e për më tepër për shqiptarët që nuk pranonin statusin e autonomisë së gjerë dhe kërkonin statusin e Republikës diskriminoheshin, arrestoheshin dhe burgoseshin. Shqiptarët vazhdonin t'i artikulojnë problemet në ish-Jugosllavi si probleme me karakter etnik e politik

²⁸² Historia e Popullit Shqiptarë IV, 389.

²⁸³ Po aty, 391.

²⁸⁴ Noel Malcolm, 2001, 340.

²⁸⁵ Muhamedin Kullashi, Përplasja e identiteteve, Dukagjini, Pejë, 2003, 94.

dhe si arsye e të gjitha problemeve tjera ekzistuese. Pra, që tejkalimi i këtyre problemeve nuk bëhet duke mohuar dhe luftuar vullnetin historik të shqiptarëve. Të pakënaqur me statusin aktual të Kosovës, ishin edhe serbët, të cilët ishin të prirur për një Serbi të fortë dhe të centralizuar. Ata ishin kundër proceseve decentralizuese të Federatës, e posaçërisht me statusin e shqiptarëve që e konsideronin si të avancuar dhe duhet hequr atë çfarë kishin fituar. Kjo gjendje nuk kënaqte asnjërin palë, aspiratat kombëtare shqiptare dhe as kërkesat e nacionalistëve serbë, kështu shtoi faktin se Titoja kishte vdekur dhe ishte e pamundur që të mbahej status quo-ja dhe kështu aspiratat e palëve e bënë të pashmangshëm konfliktin.

Si refleksion i përgjithshëm i gjendjes politike, sociale, ekonomike të akumuluar ndër breza me radhë dhe nga diskursi politik i veprimtarisë ilegale shpërthyen demonstratat masive në tërë Kosovën dhe viset tjera shqiptare në ish-Jugosllavi. Ato fillimisht shpërthyen si shkak i mungesës së kushteve në jetën universitare, por në thelb ato ishin probleme të përgjithshme etnike që mbuloreshin me përmirësime fasadë ndër vite. Demonstratat të cilat filluan me 11 mars në mensën e studentëve u përshkallëzuan dhe zgjatën gjatë gjithë pranverës së vitit 1981, dhe nga një demonstratë studentore u shndërrua në një demonstratë e gjithë popullore shqiptare. Arsyet dhe qëllimet mbi shpërthimin e demonstratës së 81-tës mund të i nxjerrim fillimisht nga parullat politike që qarkulluan në këtë demonstratë, në formën e mesazhit dhe ligjëritit politik. Në kërkesat e demonstratave të rinisë në pranverën e vitit '81 dominuan parullat për "Duam bukë, duam kushte!", "Kërkojmë punë-kërkojmë bukë", "Posht dallimet Sociale", "Poshtë borgjezia", "Kosovën Republikë", "Duam Republikë", "Republikë kushtetutë, ja me hatër ja me luftë", "E duam flamurin kombëtar", "Unitet", "Kush s'bashkohet është tradhtar", "Duam bashkimin e trojeve shqiptare", "Jemi shqiptarë e jo jugosllavë!".²⁸⁶ Në këtë shumësi kërkesash nga ato ekonomike dhe politike, në fund dominuan kryesisht ato politike, gjegjësisht në themel të të gjithave qëndroni "Kosova Republikë". Kjo formë e artikulimit të ligjëritit politik ishte kërkesë e ligjshme dhe e kamotshme e popullit shqiptarë ndaj udhëheqësve jugosllav. Sikurse programet dhe artikulimet e intelektualëve shqiptarë të angazhuar në veprimtarinë ilegale edhe tek demonstruesit e 81-it në epiqendër të ligjëritit ishte kombi shqiptarë dhe kërkesat e kombit shqiptarë kundrejt pushtetit jugosllavë. Ligjërimi artikulohej për dëshirën dhe sakrificën e kamotshme të popullit shqiptarë për Kosovën Republikë, gjegjësisht për

²⁸⁶ Historia e Popullit Shqiptar, IV, 2009, 392.

bashkimin e trojeve shqiptare si padrejtësi historike ndaj tyre. Në këto parulla shprehet edhe pamundësia për të bërë më kompromise me këtë çështje pra “Republikë kushtetutë, ja me hatër ja me luftë”, çka nënkupton edhe vullnetin vetëflijues për realizimin e këtij qëllimi.

Masivizimi i demonstratave dhe forma e reagimit të pushtetit ndaj tyre argumentuan edhe njëherë raportet e ndërtruara mbi një pabarazi kolonialiste ndaj shqiptarëve. Kërkesat e shtruara në demonstratë ishin të drejta të ligjshme dhe nuk dilnin jashtë kornizave Kushtetuese të Federatës, por pavarësisht kësaj ato cilësoheshin si “kundërrevolucionare”, si “nacionaliste e shqiptaromadhe” dhe veprime “armiqësore”. Kështu ndaj armiqve të popullit okupuesi ndërmori masa drastike, saqë mund të themi se këto masa dhe lëvizje që ndërmori pushteti jugosllav determinoi edhe jetën politike të pas këtyre viteve në ish-Jugosllavi. Kështu si kundërpërgjigje e pushtetit ishte përdorimi i armëve të zjarrit e i tankeve kundër demonstruesve që në mënyrë paqësore shprehën kërkesat e tyre. Për këtë formë të tmerrshme reagimi nga pushteti jugosllav flet edhe bilanci i 9 të vrarëve dhe 15 të ndërsa forcat e policisë serbe patën 2 të vrarë dhe 17 të plagosur. Gjithashtu një gazetë franceze flet për numrin e të dënuarve ku do të shkruaj se “Rreth 1.700 persona janë burgosur gjatë trazirave dhe 154 priten të gjykohen”. Gazeta frënge “Liberasion”, ndër të tjera, do të shkruaj: “Më shumë se 800 veta janë shpallur fajtorë, nga të cilët 400 kanë marrë dënime deri në 15 vjet burgim dhe 1.300 të tjerë kanë marrë dënime që janë kompetencë e policisë, pra më pak se një vit.²⁸⁷ Gjithashtu në epiqendër të goditjes u vu edhe Universiteti që konsiderohej si “kështjellë e nacionalizmit shqiptarë”, u dha fund bashkëpunimit arsimor, kulturor, shkencor me Republikën e Shqipërisë. Diferencimi ideologjik-politik në radhët e intelektualëve shqiptarë ishte i egër, ku mbi 300 intelektual të shquar kosovarë u izoluan, dënoheshin me largime nga puna, me ndjekje penale, madje edhe me burg.²⁸⁸ Procesi i diferencimit ideologjik dhe politik preku edhe udhëheqësit shqiptarë ku u detyruan të japin dorëheqje apo u shkarkuan nga funksionet e tyre, Mahmut Bakalli u përjashtua nga kryesia e partisë në korrik, kryetari i kryesisë së Krahinës, Xhavid Nimani kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës, B. Ouci zëvendëskryetari i

²⁸⁷ Shih më tepër: Po aty, 89, 92.

²⁸⁸ Historia e popullit shqiptarë IV, 393.

Këshillit Ekzekuti të KSA të Kosovës, P. Nushi sekretarë krahinorë për arsim, për kulturë e për shkencë, Yjaka etj.²⁸⁹

Me këtë formë të manifestimit dhe të përgjigjes ndaj pakënaqësisë politike të shqiptarëve, pala serbe tregonte vullnetin e tyre për të mbajtur shqiptarët nën sundim dhe mosnjohjen e të drejtës së tyre për vetëvendosje. Fillimisht pakënaqësitë e shqiptarëve nga forumet drejtuese të Serbisë dhe të Jugosllavisë artikulohehin si manifestim i “liberalizimit” e të “lirive të tepërta” të viteve të fundit që u kishin njohur atyre. Gjithashtu, akuzoheshin edhe udhëheqësit e shtetit shqiptarë se kishin nxitur këto demonstrata irredentiste në Jugosllavi. Më pas i mbajti për përgjegjës të këtij shpërthimi udhëheqësit shqiptarë në parti dhe në funksione shtetërore për mos aftësi të menaxhimit të mirë të funksioneve. Kështu, pushteti serb dhe Jugosllav u mundua të gjente fajtorët për situatën e shkaktuar duke mbajtur në përgjegjës të gjithë faktorët “periferik” apo jo të vërtetë mbi pakënaqësitë e shprehura. Duke mbajtur përgjegjës të tjerët për pakënaqësitë e shkaktuara dhe larg arsyt kryesore mendohej të ndryshonte mesazhin kryesorë të demonstruesve përmes ndrydhjes së vullnetit dhe dhunës. Pushteti serb dhe Jugosllav shmangu qëllimshëm arsyen e shpërthimit të demonstratave që duke shmangur apo thënë më mirë duke luftuar atë mohonte aspiratën e shqiptarëve të Jugosllavisë, gjegjësisht të Kosovës për Republikë. Kjo formë e përgjigjes me dhunë, arrestime, diferencime ideopolitike, largime nga puna, ndjekje penale ndaj vullnetit të shprehur “menaxhoi” vetëm përkohësisht gjendjen e pakënaqësisë sepse ajo ndikoi edhe më shumë në forcimin e ndërgjegjes kombëtare të shqiptarëve në Jugosllavi.

Demonstrata e '81-tës ndryshoi shumëçka në jetën politike të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Kështu autoritetet në Beograd zhvillimet politike, ekonomike dhe sociale i konsideronin si “liberalizim” dhe “liri e tepruar” ndaj shqiptarëve dhe e shihnin të domosdoshme kufizimin e kësaj “lirie” sepse shqiptarët po abuzonin me të. Në këtë kontekst, në vazhdim statusi shoqëror-politik e juridik i shqiptarëve dhe i vet krahinës Autonome të Kosovës erdhi duke u minimizuar. Jeta publike dhe politike e shqiptarëve ishte nën vëzhgim të përhershëm nga terrori policorë deri tek ndalesat e shumta që i përkisnin identitetit shqiptarë. Dhe kjo gjendje absolutisht vetëm se forcoi artikulin mbi identitetin kombëtarë si mburoja dhe elementi kryesorë për dalje nga kjo gjendje. Shqiptarët më fuqishëm se më parë vazhduan

²⁸⁹ Noel Malcolm, Kosova një histori e shkurtër, f. 351; Historia e popullit shqiptar IV, f. 393.

organizimin e veprimtarisë ilegale dhe legale në forcim të identitetit politik të shqiptarëve dhe në këmbëngulësin e tyre për të drejtën e vetëvendosjes, si një e drejtë për çdo komb që e sheh dhe e artikulon veten si popull. Shqiptarët këtë të drejtë e artikuluan si të drejtë historike që u mohua shqiptarëve që nga koha e Konferencës së Bujanit.

3. Diferencimi i mendimit nationalist shqiptarë në Kosovë, nga logjika kombëtare në logjikën e ndarjes territoriale dhe administrative

Pas ripushtimit të dhunshëm të Kosovës nga ana e partizanëve jugosllav aspiratat e shqiptarëve për të jetuar në një shtet u minuan nga marrëveshja Tito-Enver në shtatorin vitit 1944. Marrëveshja në fjalë ishte e bazuar mbi konceptet ideologjike dhe se forma e organizimit shtetërorë dhe administrativ do të jetë refleksion i këtyre koncepteve gjegjësisht mbi barazinë klasore dhe nën parullën e vëllazërim bashkimit. Pra, bëhet fjalë për ndërtimin e Jugosllavisë së dytë, ndryshe nga “Jugosllavia e Versajës” që tashmë konsiderohej si “burg popujsh” nga e cila duhet çliruar dhe të riformulojnë një Jugosllavi të re dhe të “barabartë” për të gjithë. Jugosllavia e dytë, për dallim nga e para, themelohet si shtet federal, i përbërë nga gjashtë republika Sllovenia, Kroacia, Slloveni, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Maqedonia si dhe dy krahina autonome Kosova dhe Vojvodina. Në këtë mënyrë tokat shqiptare ashtu si në Jugosllavinë e parë, në të cilat shqiptarët ishin popullatë e vetme apo shumicë e madhe, ishin ndarë në tri “banovina” si njësi administrative, tani do të ndahen në tri republika të tre popujve sllav: në Republikën e Serbisë, në Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën e Malit të Zi. Pra, Partia Komuniste e Jugosllavisë jo vetëm që nuk lejoi bashkimin e shqiptarëve të Kosovës dhe të viseve tjera shqiptare me shtetin amë të premtuar më parë, por nuk lejoi as krijimin e republikës së Kosovës, përkatësisht Republikës së shqiptarëve në Jugosllavi që ishin së paku katër herë më shumë se malazias të cilëve do t’u bëhet e mundshme krijimi i Republikës së tyre dhe afër dy herë e gjysmë më shumë se maqedonas të cilëve, po ashtu, do t’u bëhet e mundshme të krijojnë Republikën e tyre.²⁹⁰

Ligjërimi nationalist shqiptarë u artikulua në forma dhe mënyra të ndryshme, herë duke e ruajtur konsistencën e vetë ideore, herë duke rrëshqitur në artikulime të ndryshme ideologjike të kohës e të real politikës. Ajo çfarë e bënte një lëvizje me përcaktim ideologjik nationalist është ideja e bashkimit të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare me shtetin amë si

²⁹⁰ Rexhep Qosja, Strategjia e Bashkimit Shqiptarë, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1992, 180.

një element i bartur i nacionalizmit shqiptarë si qëllim suprem i sajë. Mirëpo, pas Plenumit të Brionëve më 1966, programet e lëvizjeve politike fillojnë të pësojnë ndryshime të rëndësishme ideore. Duke e menduar se Bashkimi Kombëtarë në formën se si është shprehur deri më tani është diçka tejet e vështirë dhe pa mbështetje ndërkombëtare, ideologët e lëvizjeve politike gjejnë rrugë tjera, ata kërkojnë që Kosova të shpallet Republikë në kuadër të Jugosllavisë, ngase siç e kemi theksuar se kushtetuta e lejonte që republikat të kishin të drejtë të shkëputeshin dhe të bashkoheshin me kë të donin. Sipas Sabile K. Basha “Kosova Republikë” ishte kërkesë që doli nga gjiri i popullit dhe u shpalos në demonstratat e vitit 1968. Kjo kërkesë u përkrah dhe u kërkua edhe në demonstratat studentore të vitit 1981.²⁹¹ Kjo ide filloi të përvesohej nga shumë Lëvizje politike të pas 68-ës, por sidomos pas vitit 1981. Kështu, mund të përmendim Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës, e cila në programin e saj politik kishte si objektiv ngritjen e Kosovës në nivelin e republikës në kuadër të federatës, “Qëllimi i Lëvizjes popullore për Republikën e Kosovës është që Kosova të çlirohet nga sunduesit dhe të fitoj statusin e republikës brenda Federatës së Jugosllavisë”²⁹²

Lëvizja për “Kosova Republikë” diferencohet nga logjika kombëtare, gjegjësisht nacionaliste sepse cenon parimin e territorialitetit dhe shkëputet nga parimi themelorë i nacionalizmit. Kjo ka për referencë dhe përkon me ndarjen territoriale administrative që mbretëronte në Jugosllavi, fillimisht Kosovën si Krahinë Autonome dhe më pas si Autonomi. Pra, mund të themi se parcializimi administrativ i tokave shqiptare ndikoi në organizimin e jetës shoqërore dhe në artikullimin e ligjërimit politik, gjegjësisht dominon konteksti i vijave administrative në përzgjedhjen e modelit politik. Kështu, ideja Kosovës Republikë përjashton viset e tjera shqiptare nga të qenit pjesë e republikës, çka nënkupton me automatizëm se këto pjesë do të duhet të organizonin veprimtarinë e tyre politike në kuadër të republikave përkatëse. Një ide e tillë diferencohet nga logjika kombëtare e të perceptuarit dhe të vepruarit politikisht, në logjikën e reale politike të kohës. Kjo e diferencon çështjen shqiptare në Jugosllavi, në çështje të Kosovës, edhe pse çështja shqiptare në Jugosllavi është më e gjerë se sa çështja e Kosovës, sepse përpos se në Kosovë, shqiptarët jetojnë edhe në Maqedoninë Veriore, Mal të Zi dhe në Serbinë Jugore. Territorët në të cilat jetonin

²⁹¹ Sabile Kicmezi Basha Programet politike të lëvizjes kombëtare shqiptare 1878-1990, 17.

²⁹² Shih: Po aty, 310; Milazim Krasniqi, 2017, 66.

shqiptarët në ish-Jugosllavi për nga numri janë popullsi dominante dhe territore etnikisht kompakte edhe sot. Nacionalistët shqiptarë të cilët vepronin në kuadër të Jugosllavisë kufijtë administrativ të sajë i shihnin si kufij arbitrarë dhe të dhunshëm, kësisoj, pretendonin zhbërjen e tyre dhe rimodelimin e tyre në bazë të kriterit etnik dhe historik.

4. Qasja “indiferente” e shtetit shqiptarë ndaj lëvizjeve nacionaliste në Kosovë

Qëndrimet e shtetit Shqiptarë ndaj çështjes shqiptare ka ndikuar shumë edhe në përcaktimin e qëndrimeve politikave të shumë lëvizjeve politike në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare. Shteti Shqiptarë ka qenë vend komunist që nga vitit 1945 e deri në vitin 1990, dhe atë e udhëhoqi për dyzet vjet diktatori komunist Enver Hoxha. Rruga e Shqipërisë ishte e ndryshme nga vendet e tjera komuniste të botës, për shkak se udhëheqësi i sajë i qëndroi besnik metodave staliniste të udhëheqjes deri në vdekje. Pra, bëhet fjalë për një organizim shtetërorë ku qëllim kryesorë ishte bërë shoqërizimi i shpejt dhe total i pronës në qytet dhe fshat, ku shteti ishte pronar i vetëm i pasurive të vendit, si dhe shtypja dhe likuidimi i klasave kundërshtarë përbënin qëllimin kryesorë të Partisë shtet. Në këtë rrjedhë komunistët, refuzuan zhvillimin e votimeve të lira politike që nënkupton mosgatishmërinë e tyre për të ndarë pushtetin me forca të tjera politike. Kështu, marrëdhëniet me aleatët perëndimorë anglo-amerikanë u prishën dhe ai rrëshqiti drejt vendeve socialiste apo linjës staliniste të qeverisjes. Po ashtu sistemi politik i ndërtuar në Shqipëri nga Enver Hoxha dhe Partia Popullore e Shqipërisë paraqet një sistem politik të institucioneve të dobët dhe forcim të një emri të përveçëm apo të një “diktaturë të personalizuar” (Gill). Përcaktimi politik i Enver Hoxhës drejt kampit socialist të udhëhequr nga Bashkimi Sovjetik, përcaktonte njëherit edhe politikën e saj të brendshme dhe të jashtme. Në politikën e sajë të jashtme shteti shqiptarë udhëhiqej në bazë të parimeve politike proletare, ku si parim thelbësorë kishin shpallur përkrahjen e revolucionit proletarë për vendosjen e shoqërisë socialiste dhe komuniste në shkallë botërore. Të gjitha konceptet tjera buronin nga ky parim themelorë i shtetit shqiptarë. Ajo mbështeste apo anatemonte lëvizje e ndryshme politike në proporcion më këto parime, ndërtonte marrëdhënie ndërshtetërore mbi bazën e këtyre parimeve, gjegjësisht krijonte miqësitë dhe armiqësitë me mbi këtë ligjërim ideologjik. Gjithashtu mbi këtë kurs ligjërimorë e shikon edhe çështjen shqiptare në Jugosllavi, në përputhje me konceptet ideologjike të marksizëm-leninizëm dhe të internacionalizmit

proletarë. Historiani Jusuf Buxhovi shkruan se “Nga fillimi deri në fund, çështjen e Kosovës, Enver Hoxha e ka shkuar në përputhje me konceptet në përputhje me konceptet ideologjike sipas teorisë së marksizëm-leninizëm dhe të internacionalizmit proletarë. Mbi këto parime ka refuzuar edhe irredentizmin ideologjik të organizatave ilegale të Kosovës”.²⁹³ Këtu mund të ju referohem edhe deklaramit të Enver Hoxhës në vitin 1946, ku deklarohet se Kosova duhet të mbetet në Jugosllavi, meqenëse ky shtet socialist ishte më i zhvilluar dhe më i përparuar se sa Shqipëria socialiste dhe se kur do të arrihej në komunizëm nuk do të kishte rëndësi përkatësia kombëtare.²⁹⁴ Sipas Enver Hoxhës problemet e kufijve mund të ndiqeshin dhe të diskutoheshin midis marksist-leninistëve në frymën e internacionalizmit proletarë, në mënyrë që zgjidhjet e arritura të mos kënaqin vetëm interesat kombëtare por edhe ato të internacionalizmit ndërkombëtarë.²⁹⁵ Fitorja e Internacionalizmit proletarë, madje edhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm i një shoqërie është më prioritarë se sa çështjet e karakterit kombëtarë.

Shqipëria apo enverizmi nuk përkrahte lëvizjet nacionale, por vetëm lëvizjet që i shërbenin revolucionit proletarë dhe dobësimit imperialist apo shfrytëzimit klasorë. Këtë qëndrim Enver Hoxha nuk e ndryshoi edhe pas prishjes me shtetin Jugosllav ku udhëheqësin e sajë e dënonte për gjenocid ndaj popullit shqiptarë të Kosovës dhe njëkohësisht i bënte thirrje që popullsia shqiptare së bashku me popujt e tjerë të shtypur të Jugosllavisë, krah për krah me marksistët-leninistët e vërtetë Jugosllavë, do të vazhdojnë luftën për të demaskuar klikën titiste, dhe për të mbrojtur interesat e tyre.²⁹⁶ Titizmi apo Jugosllavia kishte tradhtuar kursin ideologjik socialist dhe për këtë shqiptarët së bashku me popujt e tjerë të Jugosllavisë duhet të bëhen bashkë dhe ta luftojnë këtë sistem. Enver Hoxha, thekson se “Titua me shokët e tij janë agjent të imperializmit dhe e lidhën Jugosllavinë me qerren e imperializmit” dhe akuzon se “ata po e shndërrojnë Jugosllavinë në një burg popujsh ku mbretëronte terrori fashist hitlerian”, gjithashtu kërkon që “të vihet si çështja urgjente çlirimi i popujve të Jugosllavisë nga kjo bandë fashiste dhe nga kthetrat e imperializmit”²⁹⁷. Këtë çlirim ai e shihte si luftë e përbashkët e popujve jugosllav, e cila do të zhvillohet nën drejtimin e

²⁹³ Jusuf Buxhovi, *Kosova, 1945-1990*, 2015, 157.

²⁹⁴ *Publikja Shqiptare 2*, Enis Sulstarova, *Bashkëkohësia e Rilindjes*, Zenit, Tirnaë, 2017, 99.

²⁹⁵ Enis Sulstarova, *Ligjerimi Nacionalist në Shqipëri*, 81.

²⁹⁶ Shih më tepër: Enver Hoxha, *Selected Work, Volume IV*, The “8 NËNTORI” Publishing house Tirana, 1982, 92.

²⁹⁷ Shih më tepër: Jusuf Buxhovi, 161.

proletariatit jugosllav. Pavarësisht se gjenocidi dhe krimet që bëheshin kundër shqiptarëve ishin me motive nacionale dhe kishin për qëllim asimilimin, gjegjësisht asgjësimin e shqiptarëve nga këto troje, sipas Enver Hoxhës lufta nuk duhej të bëhej për kërkesa të veçanta nacionale por për rindërtimin e socializmit për të mos dobësuar shtetin jugosllav dhe socializmin botërorë në përgjithësi.

Nga ky qëndrim ideologjik Enveri nuk hoqi dorë asnjëherë, këtë e dëshmon kur deklarohet se kishte përcjellë gjendjen e lëvizjeve patriotike në vitet e gjashtëdhjeta, për të me rëndësi ishte kauza ideologjike marksiste-leniniste e përgatitjes së Shqiptarëve të Kosovës dhe të Jugosllavisë mbi frymën e saj që të rrëzoj titizmin dhe t'i hapeshin rrugët rikthimit të marksistëve dhe leninistëve në kreun jugosllav, se sa kërkesat e tyre për çlirim dhe bashkim kombëtar të grupeve ilegale nga fundvitet e pesëdhjeta dhe të fillim viteve të gjashtëdhjeta.²⁹⁸ Ai kritikon ashpër udhëheqësin lëvizjet nacionale të kësaj periudhe dhe se ajo duhet të udhëhiqet nga udhëheqës më parime marksiste-leniniste, gjithashtu dhe mohon kategorikisht përfshirjen në luftë të shtetit shqiptarë. Kështu ai shkruante “populli i Kosovës duhet ta kuptoj se në këto koniunktura asnjëherë Shqipëria nuk mund ta atakojë as ta sulmojë Jugosllavinë. RPSH-ja nuk mund të jetë kurrë agresore. Në qoftë se Jugosllavia atakon Shqipërinë ai është problem tjetër, Shqipëria do të mbrohet, do të luftojë dhe do të fitojë dhe problemi i Kosovës vihet krejt ndryshe.²⁹⁹ Atë çfarë kërkonte Enver Hoxha ishte tepër utopike sepse bëhej fjalë për shqiptarët të cilët ishin nacionaliteti më i shtypur i kësaj federate dhe shumica e popujve tjerë përkundër pakënaqësive kishin drejta shumë më shumë se shqiptarët sepse i përkisnin njësive të tyre politike në kuadër të federatës.

Më 27 nëntor të 1968, në disa qytete të Kosovës, të Maqedonisë, gjithashtu dhe në treva tjera shqiptare shpërthyen pakënaqësitë në mënyrë demonstrative ku kërkohet “Duam vetëvendosje deri në shkëputje”, “Duam bashkimin e viseve të banuara me shqiptarë me Kosovën”, “Duam kushtetutë”, “Duam universitet”, “Rroftë Shqipëria”, “Rroftë Enver Hoxha”, e mbi të gjitha parulla “Kosova Republikë”. Pala jugosllave në mënyrë indirekte akuzonte Shqipërinë për ndikim në këto ngjarje për faktin se në këto ditë ndodhën edhe festimet e ditës së Pavarësisë së Shqipërisë. Enver Hoxha në mënyrë kategorike e mohoi këtë akuzë

²⁹⁸ Jusuf Buxhovi, 163.

²⁹⁹ Ethem Ceku, Kosova në shtendosjen e raporteve Shqiptaro-Jugosllave në vitet’ 60-70. http://ëëë.southeast-europe.org/pdf/18/dke_18_ab_dk_Ethem-Ceku_Kosova.pdf, 10. 10. 2019.

indirektë të shtetit jugosllavë për ndikimin e Shqipërisë në këtë ngjarje, ai shkruan se “natyrisht ne nuk kemi as gishtin më të vogël në këto demonstrata, ne nuk zhvilluam asnjë punë agjente dhe subversive as në Jugosllavi, as në Kosovë. Titistët e dinë këtë, por ia do puna ta shpifin. Hedhja e parullave pro shqiptare Enver Hoxha ua atribuoi “provokuesve të futur në radhët e demonstruesve që duan t’i japin ngjyrë tjetër demonstratave”. Enver Hoxha shfaq hapur mendimin për çështjen e Kosovës si një çështje e të drejtave nacionale.³⁰⁰ Ai çështjen shqiptare përbrenda Jugosllavisë e sheh në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të pakicave duke u përmbajtur kështu parimit të mos ndërhyrjes në punët e brendshme të një shteti tjetër. Tirana zyrtare vazhdimisht përsëriste qëndrimin refuzues ndaj Republikës së Kosovës duke e konsideruar atë si diçka të “kurdisur nga titistët” dhe mund të bëhet qendër e reaksionit kosovarë. “Kjo e ashtuquajtur Republikë e jashtme shqiptare nga titistët mund të bëhet qendër e reaksionit kosovar dhe e të arratisurve fashistë e kriminel lufte shqiptarë që gjenden në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë kurth nuk duhet të bien shqiptarët e Kosovës. Ata duhet të luftojnë këtë manovër të ndyrë të titistëve të cilët kanë mundësi ta luajnë këtë letër”.³⁰¹

Për të ardhur deri tek viti 1981, gjegjësisht tek demonstratat e radhës të organizuara nga lëvizjet nacionaliste shqiptare, të cilën Enver Hoxha nuk e quan më “kurth titist ndaj shqiptarëve të Kosovës që nuk duhet besuar”, por kërkesën kryesorë të artikuluar në këtë demonstratë të Kosovës Republikë e futi në Rezolutën e Kongresit të Partisë në formë të një dokumenti të rëndësishëm. Ai shkruante se “Kërkesa për t’i njohur Kosovës statusin e Republikës brenda Federatës është një kërkesë e drejtë, ajo nuk cenon ekzistencën e Federatës”.³⁰² Shqipëria insistonte mbi këtë të drejtë të shqiptarëve të Kosovës, mirëpo atë e artikulonte me konceptet e marksizëm-leninizmit dhe duke nxjerrë argumente gjithnjë të natyrës ideologjike.

Shteti shqiptarë në vazhdimësi kërkonte avancimin e të drejtave të shqiptarëve në Jugosllavi e posaçërisht atyre në Kosovë në sektorin kulturorë, arsimorë dhe ekonomik. Mirëpo atë e bënte në kuadër të koncepteve të marksist-leniniste fillimisht, ndërkohë zgjidhjen e të drejtave brenda Jugosllavisë dhe më vonë duke potencuar kërkesat e tyre si të drejta dhe të

³⁰⁰ Shih më tepër: Ethem Ceku, Kosova në shtendosjen e raporteve Shqiptaro-Jugosllave në vitet’ 60-70. http://ëëë.southeast-europe.org/pdf/18/dke_18_ab_dk_Ethem-Ceku_Kosova.pdf, 10. 10. 2019.

³⁰¹ Jusuf Buxhovi, Kosova 1945-1999, 167.

³⁰² Po aty, 169.

barabarta me popujt e tjerë të federatës. Pra, siç shihet nga trajtesa e më sipërme edhe lëvizjet nacionaliste apo ilegale nuk e kishin mirëkuptimin e duhur të shtetit amë, sepse ato linçoheshin si irredentiste, revizioniste sepse ishin kundër parimeve të marskizëm-leninizëm. Pra, gjithçka që në esencë nuk përcaktonte këtë kurs veprues anatemohet nga shteti shqiptarë pavarësisht nacionalitetit apo gjendjes së nacionalitetit shqiptarë në këtë entitet. Gjithashtu edhe përkundër përpjekjeve të shumë lëvizjeve për t'u përshtatur ideologjikisht me shtetin amë, ato u refuzuan sepse sipas Enverit lëvizjes ilegale i "mungon një udhëheqje marksiste-leniniste që të çajë dallgët dhe të shfrytëzojë situatat dhe koniukturat". Në përgjithësi shteti shqiptarë, gjegjësisht udhëheqësi i sajë këto lëvizje i shihte si provokim apo siç i quante ai "kurth titistë dhe mashtrim i madh titist" dhe se shqiptarët duhet të luftonin për të drejtat e tyre nacionale në përputhje me ideologjinë marksiste-leniniste, ku si pikënisje duhet të kishin "luftën kundër revizionizmit jugosllav" si dhe përmbysjen e sajë me rrugë revolucionare. Pra, ligjërimi dhe veprimtaria e lëvizjeve nacionaliste në Kosovë anatemohet apo përjashtohet sepse vihej si shprehje e vullnetit politik të shqiptarëve jashtë doktrinës marksiste-leniniste, për më tepër ai pretendonte se shqiptarët e Jugosllavisë një ditë do të përmbysin Titon dhe renegatët e tij në dobi të Jugosllavisë internacionaliste staliniste.

5. Ligjërimi politik jugosllav ndaj çështjes shqiptare në Jugosllavi

Ligjërimi politik jugosllavë kishte rënë nën ndikimin e projekteve nacionaliste serbe, kjo vërehet jo vetëm me ndarjen arbitrare të territoreve shqiptare në njësi të ndryshme administrative, por edhe me qëndrim armiqësorë ndaj çështjes shqiptare në përgjithësi. Pushteti Jugosllav ushtronte dhunë ndaj atyre që bënin rezistencë kundrejt pakënaqësive që kishte krijuar me statusin e shqiptarëve në këtë federatë. Qëndrimet armiqësore ishin ndaj Lëvizjeve Nacional Çlirimtare dhe ndaj të gjitha lëvizjeve ilegale Jugosllavi. Rezistenca ishte bashkuar në Ballin Kombëtarë dhe në Organizatën Nacionale Demokratike Shqiptare, ku sipas Miranda Vickers gjatë viteve 1944-46, 36 mijë deri ndoshta 47 mijë shqiptarë ishin viktimë të ekzekutimit sistematike masive nga komunistët gjatë ditëve të etheve revolucionare, dhe më vonë të misionëve "kërko dhe shkatërro" dhe programeve të "paqëtimit", "çarmatosjes" dhe "rehabilitimit", torturave të policisë dhe epidemive të

etheve të tifos që kapin njësitë ushtarake.³⁰³ Sipas Oliver J. Schmitt, si në pjesët tjera të Jugosllavisë sundimi komunist filloi me një kasaphanë, duke vazhduar kështu pandërprerë aktet e dhunshme ku qindra rekrut u vranë qëllimisht gjat marsheve të dhunshme drejt Malit të Zi, përkatësisht në Tivar, gjithashtu u zhvilluan procese të mëdha kundër pjesëtarëve të rezistencës shqiptare, me rast u shpallën shumë dënime me vdekje.³⁰⁴ Sidomos lufta, arrestimi, dënimi, dhuna dhe dëbimi ndaj lëvizjeve ilegale nuk u ndërpre në asnjë moment nga pushteti komunistë deri në shkatërrimin e tij. Për të pasqyruar formën e trajtimit ndaj shqiptarëve gjatë kësaj periudhe mund të ju referohem Sabile Bashës ku thekson se vetëm gjatë periudhës 45 vjeçare, 1945-1990, ndaj shqiptarëve në ish-Jugosllavi u shqiptuan gjithsejtë 66672 vjet e 7 muaj burgim, ose 666 shekuj, 72 vjet e 7 muaj për 7684 veta. Sipas saj shqiptimi i të gjitha këtyre viteve burgim ishte bërë me një strategjitë paramenduar mirë për përdorimin e dhunës ndaj shqiptarëve, me qëllim që nga trojet e veta të ndjekëshin dhe të shkombëtarizoheshin sa më shumë.³⁰⁵

Jeta politike dhe shoqërore në Kosovë gjatë periudhës 1944-66 shënon një sërë procesesh të dhunshme nën sloganin “vëllazërim bashkimit të popujve”. Politikat asimilacioniste vazhdonin duke u mohuar shqiptarëve mësimin dhe gjuhën shqipe në veçanti në fushën e arsimit, kulturës dhe punësimit. Kjo kishte për qëllim ndërtimin e një identiteti të ri jugosllav, që në esencë si projekt shihte një tendencë të kamotshme, vullnetin për asimilimin e pakicave. Politikat e asimilimit kishin për synim ndërprerjen e lidhjeve midis shqiptarëve të Shqipërisë dhe atyre të Jugosllavisë. Gjithashtu në diskursi zyrtar politik bëhej dallimi midis shqiptarëve të Kosovës, të quajtur “Siptari”, dhe shqiptarëve të Shqipërisë, për të cilët përdorej fjala “Albanaci”, dhe kishte për qëllim një ndarje artificiale midis popullsisë shqiptare. Gjithashtu paralelisht me këtë ndaj shqiptarëve ushtrohej trusni të drejtpërdrejta që të vetë deklaroheshin me kombësi turke, kështu myslimanët shqiptarë gjatë regjistrimit të popullsisë në vitin 1953 u detyruan të ndryshojnë kombësinë e tyre, ky shkombëtarizim kishte për qëllim shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi, çka dhe kishte ndodhë që një numër i madh i tyre nga frika e persekutimit u shpërngulën për në Turqi. Këtë proces e kishte shoqëruar edhe aksioni i mbledhjes së armëve, ku u torturuan rreth 30 mijë veta dhe 100 e humbën jetën, me arsyen se kinse shqiptarët po përgatiteshin për kryengritje të

³⁰³ Shih më tepër: Miranda Vickers, 2004, 187.

³⁰⁴ Shih më tepër: Olivern J. Schmitt, 2012, 173-4.

³⁰⁵ Sabile Kicmezi Basha, Të burgosurit politik ..., 2009, 9.

armatosur dhe për bashkim me Shqipërinë, me ç'rast kishte për qëllim terrorizimin e shqiptarëve që t'i detyronin ata të braktisnin vendin.³⁰⁶ Këto ishin metoda të policisë serbe që në vazhdimësi torturonin dhe u bënë presion qytetarëve për gjithçka, ata nxjerrin pretekste të ndryshme si flamurin, librat, gjegjësisht librat e letërsisë apo historisë shqipe, me qëllim që t'i detyronin ata të braktisnin vendin. Kështu ideologjia e vëllazërim bashkimit dhe e barazisë së popujve shikohej si hipokrizi që kishte për qëllim fshehjen e politikave shoviniste të shtypjes dhe asimilimit. Ideologjia komuniste edhe pse i referohej një koncepti multikulturorë të jetesës, atij të internacionalizmit proletarë, ajo prapë nuk arrin të largohet nga barra e nacionalizmit serb, ku përmes asimilimit dhe politikave represive të ndikoj në ndryshimin e strukturës së popullsisë, posaçërisht në Kosovë ku shqiptarët ishin shumicë dominante.

Një kthesë e rëndësishme politike ndodhi pas vitit 1966 në Jugosllavi, gjegjësisht pas shkarkimit të Ministrit të Punëve të Brendshme Aleksandër Rankoviçit, i cili u akuzua për deformim të policisë, për procese të montuara politike, për dëbimin e dhunshëm të shqiptarëve, diskriminim ndaj pakicave, përgjithësisht për shkeljen e të drejtave që garantoreshin me kushtetutë. Në fakt tani pretendohet federalizmi i vërtetë i Jugosllavisë nga modeli centralist që ajo kishte ndjekur deri më tani. Kështu bazuar në kërkesat e shqiptarëve të cilët manifestohen me vrull në demonstratat e 68-ës dhe presionit të vazhdueshëm të klasës politike serbe, pushteti federativ imponoi një zgjidhje kompromisi, duke u bazuar në amendamentet e 1968, u plotësua më Kushtetutën e 1974 ku zhvendoste pushtetin te njësitë federale. Kosova bëhet njësi federale me të gjitha organet që kishin republikat dhe të drejtën e vetos për të gjitha ligjet në nivelin federal, por ajo nuk quhej apo nuk ishte në nivelin e Republikës.³⁰⁷ Megjithatë, kjo kushtetutë nuk ishte shkëputur plotësisht nga konceptet komuniste të të drejtës së kombeve për vetëvendosje. Këto koncepte buronin nga konceptet staliniste ku ekzistonin kombet dhe kombësitë, me ç'rast kombet ishin popuj dhe shërbenin në njësi territoriale të caktuar me të gjitha vetitë nacionale dhe nuk ishin pjesë e një kombi tjetër i cili kishte shtetin e vetë amë. Kështu kombësitë sipas koncepti komunist, kishin të gjitha tiparet e kombit por nuk quheshin kombe sepse kishin shtetet e tyre amë nga i cili ishin shkëputur. Me këtë qasje shqiptarët

³⁰⁶ Shih më tepër: Historia e Popullit Shqiptarë IV, 371-2.

³⁰⁷ Muhamedin Kullashi, 99.

dhe hungarezët me kushtetutën e 1974 quheshin kombësi, që nënkuptohet se atyre u mohohet e drejta e shkëputjes. Jugosllavia vazhdon që shqiptarët të mos i trajtoj në mënyrë të barabartë me popujt e tjetër të Jugosllavisë. Në vitet në vazhdim, kishte zhvillim të lakmueshëm në shumë sfera të jetës shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Shqiptarët kishin filluar të jenë më shumë prezent në jetën publike nëpër institucione të rëndësishme duke pretenduar përfaqësim proporcional nëpër organet e krahinës, të Republikës dhe Federatës. Në Prishtinë u hap Universiteti i pavarur nga Beogradi në dy gjuhësi, si dhe u hapën shumë shkolla të reja kështu u rrit numri i nxënësve, studenteve, i mësuesve dhe në përgjithësi u rrit numri i të arsimuarve në shoqëri. Mund të themi se ndryshimet kushtetuese dhe ndryshimet në proceset politike, ekonomike e shoqërore ishin të përkohshme. Statusi politik, ekonomik e shoqërorë krahasuar me republikat tjera ishte përsëri i ulët, çka linte të hapura çështjet midis statusit të shqiptarëve dhe Federatës. Sipas Noel Malcolmit, pabarazia etnike u korrigjua pjesërisht, më 1971, ndërsa serbët dhe malazezët përbënin 21% të popullatës, ata përbënin edhe 52% të të punësuarve, gjithashtu pabarazia në punësimin publik asnjëherë nuk u përmirësua, sipas tij më 1980 llogaritej se çdo i pesti serb kishte rrogë shtetërore, kurse çdo i njëmbëdhjeti shqiptarë merrte rrogë shtetërore.³⁰⁸ Më 1980, Kosova kishte përqindjen më të lartë të papunësisë në vend , me 10.5 %.³⁰⁹ Trysnia e papunësisë ishte numër në rritje, të rinjtë kryenin shkollën e mesme apo universitetin dhe me pak mundësi punësimi, kështu dhe thellohej hendeku në mes të Kosovës dhe pjesës tjetër të Jugosllavisë, kjo bënte që tensionet të ngiteshin në vazhdimësi. Gjithashtu, shqiptarët vazhdonin të arrestoheshin për nxitjen e nacionalizmit dhe irredentizmit, kështu anëtarët e lëvizjeve kombëtare vazhdojnë të dënohen, arrestohen e keqtrajtohen. Demonstratat e 68-ës dhe të 81-ës, ishin akumulim i pakënaqësisë ndaj shtetit Jugosllav fillimisht për statusin e tyre politik, nga i cili burojnë të gjitha problematikat e jetës shoqërore. Shpërthimi i pakënaqësisë në të gjitha qendrat e rëndësishme shqiptare në Jugosllavi dhe kërkesat të cilat paraqiteshin në formë parullash, tregonin qartë për kërkesat e shqiptarëve ndaj Republikës. Demonstratat u cilësuan si “irredentiste”, “destruktive” e “kundërrevolucionare” dhe si kundër kushtetuese, e ky shpërthim vinte si shkak i “liberalizimit” dhe “lirive të tepërta” që kishin në federatë.³¹⁰ Kjo nënkuptonte se federata

³⁰⁸ Noel Malcolm, Kosova, 340.

³⁰⁹ Miranda Vickers, 234.

³¹⁰ Shih më tepër: Historia e Popullit Shqiptarë IV, 2009, 390-3.

akoma nuk kishte bërë zgjidhje optimale për nacionalitetet dhe se demokracia e proklamuar para botës ishte fasadë.

Nga demonstratat e 81-ës asgjë më nuk ishte si më parë, statusi shoqëror, politik dhe juridik i shqiptarëve erdhi duke u minimizuar edhe më shumë. Beogradi vendosi një praktikë të diferencimit politik në Kosovë, me qëllim për të çrrënjosur nacionalizmin shqiptarë. Në vazhdimësi denoncohej “nacionalizmi dhe separatizmi shqiptarë”, kështu në vitin 1986 vjen në shprehje Memorandumi i Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve, sipas Miranda Vickers ky dokument famëkeq i njohur si SANUM Memorandum (Memorandumi i ASSHA), hapi zyrtarisht të ashtuquajturën çështja serbe: gjendja e serbëve në Jugosllavi. Memorandumi argumentonte që në federatë populli serb kishte mbetur i ndarë dhe i përçarë, ai paralajmëronte luftë në Kosovë po të mos merreshin aksione drastike për të zgjidhur ato që serbët i konsideronin çështje madhore të krahinës, gjithashtu kërkonte reduktimin e menjëhershëm të statusit të autonomisë së Kosovës, shkëputjen e të gjitha lidhjeve me Shqipërinë dhe faktikisht deshqiptarizimin e plotë të sajë.³¹¹ Memorandumi përforcoi ligjërimin shovinist serb ndaj çështjes së Kosovës sepse ai thërriste edhe në ndryshimin e strukturës etnike të rajonit, e cila do të duhej të ndryshonte në favor të sllavëve, kështu mund të themi se memorandum i hartuar nga intelektual serb, i kryesuar nga Dobrica Qosiq pati jehonë në opinionin serb dhe në veprimet politike të ardhshme të udhëheqësisë Komuniste, që rezultoi me suprimimin e autonomisë së Kosovës më 1989.

Mund të themi se qasja e Jugosllavisë ndaj çështjes shqiptare ishte tejet tendencioze dhe aspak e ndërtuar në frymën e koncepteve multikulturalisete apo të vëllazërim-bashkimit që promovoheshin. Politika Jugosllave e ndikuar pothuajse në të gjitha etapat e saja nga nacionalizmi serb nuk realizoi aspak qenien shqiptare kundrejt të drejtave që duhej të gëzonte një popull apo kundrejt të drejtave që gëzonin komunitetet tjera përbrenda Jugosllavisë. Ajo vazhdimisht mohoi popullin shqiptar si popull, duke mos u njohur asnjëherë statusin e kombit por vetëm atë të kombësisë kështu me automatizëm iu mohuan edhe e drejta e tyre për vetëvendosje. Federata Jugosllave në versionin e nacionalizmit serb kishte për qëllim, parcializimin, asimilimin, shpërnguljen dhe ndrydhjen e vullnetit politik të shqiptarëve, në mënyrë që të dobësonte rolin e shqiptarëve në federatë e posaçërisht në rajon kundrejt çështjes Serbe.

³¹¹ Miranda Vickers, 2004, 270.2

VI. Rezistenca paqësore dhe luftaqlirimtare

Etnicizimin e identiteteve e projektoi modeli kushtetues i Jugosllavisë së dytë. Në këtë sistem u shpikën dhe u fragmentarizuan grupe etnike në interes të jetëgjatësisë së Federatës. Kombet pa status të republikës që konsideroheshin “kombësi”, i nënshtroheshin presionit shoqëror dhe politik për t’u përshtatur grupeve më të fuqishme apo Kombeve me status të republikës. Ky proces rezultoi të jetë i gabueshëm sidomos ndaj shqiptarëve sepse presioni masiv ndaj tyre vetëm se e përshpejtoi ngritjen e vetëdijes nacionale të popullsisë. Emancipimi i përgjithshëm shoqërorë ndikoi edhe më shumë në emancipimin e tyre nacional, gjegjësisht në raport me statusin e tyre në Jugosllavi dhe mbi ardhmen e tyre si shoqëri. Proceset e ndryshme shoqëror dhe ndryshimet kushtetuese që ndodhën gjatë kësaj periudhe për shqiptarët ishin të përkohshme, sepse statusi i tyre politik, shoqëror dhe ekonomik krahasuar me republikat tjera në Jugosllavi nuk ishte i barabartë dhe kështu shqetësimi dhe përpjekja për prosperitet vazhdoi. Gjithashtu të pakënaqur me këtë gjendje ishin edhe serbët, për statusin e “avancuar” të Kosovës me Kushtetutën e 1974-ës. Serbët e Kosovës të frikësuar nga vetëdijesimi i vazhdueshëm i shqiptarëve dhe se prestigji i tyre i dikurshëm po vazhdonte të venitej filluan të mbledhin argumente kundër autonomisë së zmadhuar krahinore të Kosovës, në atë që njihet si “Libri Blu”.³¹² Kërkohej rikthimi i kontrollit të Beogradit mbi gjykatat e krahinës, mbi policinë, mbrojtjen territoriale dhe politikat ekonomike, pra për më tepër kërkonin rikthimin e Kosovës në periudhat e para 68-ës, që nënkupton një periudhë dhe shtypje të re për Kosovë. Për nacionalistët serb, e vetmja zgjidhje ishte një Serbi e fortë, pavarësisht nëse shkelë edhe mbi të drejtat e tjerëve. Kjo gjendje paralajmëronte pashmangshëm një konflikt të ardhshëm.

Nacionalizmi serb, nën ndikimin e të cilit kishte rënë udhëheqësia Jugosllave filloi të zbatojë diferencimin ideo-politik mbi intelektualët shqiptarë të Universitetit të Prishtinës dhe më gjerë. Kështu pas këtyre ngjarjeve, statusi i shqiptarëve dhe i Krahinës Autonome të Kosovës shkoi duke u minimizuar. Gjendja e tyre shoqërore dhe politike shkante vetëm duke u rënduar, e sidomos pas ardhjes së Milosheviqit si kryetar i Partisë Komuniste të Serbisë më 1987. Ai në vazhdimësi bënte përpjekje për sensibilizimin e opinionit serb për pozitën e

³¹² Shih më tepër: Miranda Vickers, 225.

disfavorshme kushtetuese, territoriale dhe ekonomike të Serbisë në Federatën Jugosllave. Këtë Millosheviqi e bënte nëpër mitingje të shumta që ai organizonte për sensibilizimin e opinionit serb, ku mund të përmendim parullën e famshme të tij për legjitimimin e asaj që ai kërkonte, se “Serbët e humbën në paqe atë që e fituan në luftë”.

Shqiptarët gjatë kësaj periudhe mitingjeve të Millosheviqit iu përgjigjeshin me kundër mitingje, për arsye se paralajmërohej suprimimi i autonomisë së 74-ës, kështu dhe ndodhi më 28 mars 1989, duke i dhënë parlamentit serb dhe qeverisë serbe të gjithë pushtetin vendimmarrës. Kërkesat e shqiptarëve ishin tejte të reduktuara nga ajo që ata kishin artikulluar deri më tani, kështu shqiptarët në dimrin e 1988-89 kërkonin ruajtjen e Kushtetutës së vitit 1974. Këtu mund të përmendim minatorët e Trepçës, që hynë në grevë një muaj para ndryshimeve kushtetuese, për mbrojtjen me çdo kusht të autonomisë së 74-ës.³¹³ Nga kjo periudhë e tutje në Kosovë mbretëronte gjendja e jashtëzakonshme sepse presioni, dhuna, terrori shtetëror i Serbisë u shoqëruar me viktima dhe qindra të burgosur u shndërrua në kryefjalë të pushtetit. Kjo formë sjelljes së pushtetit serb kundrejt shqiptarëve, ndikoi edhe më shumë në ndërgjegjësimin tyre mbi të ardhmen e tyre shoqërore dhe politike.

1. Ligjërimi nationalist shqiptar, përpjekja për pavarësi dhe shtet ndërtim

Zhvillime të reja ndodhën në territoret shqiptare në Jugosllavi në këtë periudhë. Pas pavarësive të njëpasnjëshme të republikave jugosllave shqiptarët përsëri mbetën të ndarë në mes Serbisë dhe Malit të Zi që formuan një federatë të re jugosllave dhe Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (IRJM). Beogradi kishte anuluar autonominë e Kosovës (1989), e cila u përjetua si një ripshtim tjetër i Serbisë ndaj Kosovës. Një akt i tillë nuk ishte risi për intelektualët shqiptarë, sepse “Libri i kaltër”, “Memorandumi” i akademikëve Serb, si dhe diferencimi ideo-politik që po aplikohesh ndaj shqiptarëve e posaçërisht ndaj shtresës intelektuale, paralajmëronte kanosje e mëtejme e gjendjes ekzistuese. Serbia kishte filluar një terror shtetëror për të rrënuar çdo strukturë institucionale të Kosovës. Kjo gjendje vetëm se e shtyri dhe e përshpejtoi definimin e ligjëritimit politik të shqiptarëve të Kosovës për të ardhmen e tyre. Ligjërimi politik i kësaj periudhe ishte vazhdimësi e ligjëritimit politik të

³¹³ Enver Bytyci, 2007, 66.

prodhuara nga lëvizjet politike ilegale, që si ide kishte filluar me demonstratat e 68-ës dhe ishte sforcuar si qëndrim politik me demonstratat e 81-ës. Pothuajse të gjitha organizatat politike dhe më pas partitë politike dominoheshin nga kjo frymë ligjërimore.

Në Jugosllavi, pas trysnisë së vendeve perëndimore, ishte aprovuar ligji për organizimin e lirë politik të qytetarëve në shoqata dhe parti politike, kështu i hapi rrugë themelimit të partive politike shqiptare në Kosovë.³¹⁴ Tani ligjërimi politik në Jugosllavi artikulohej nga aspekte dhe subjekte të ndryshme. Ndër shqiptarët ky ligjërim nyjëtonte rreth zgjidhjes së çështjes kombëtare dhe të ardhmes politike të popullit të Kosovës. Ajo çka e karakterizonte fillimisht subjektet politike shqiptare në Kosovë ishte papërcaktueshmëria definitive programore në lidhje me statusin e shqiptarëve në Jugosllavi. Fillimisht artikulohej qëndrimi për barazi të plotë me popujt e tjerë të Jugosllavisë në Federatë apo Konfederatë, kurse më vonë nuk përjashtohej mundësia edhe për opsione tjera politike, pra varësisht rirreshtimeve të ndryshme në federatë. Në këtë rrjedhë mund të përmendim edhe prononcimin e Ibrahim Rugovës, që kishte dhënë për Zërin e Amerikës më vitin 1989, në filllet e formimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), se “Jugosllavia duhet të jetë federatë demokratike e kombeve dhe e kombësive, që duhet të ketë organizimin shtetëror të republikave dhe krahinave, pra, edhe Kosova të ketë vendin e vet të barabartë në federatën e Jugosllavisë”.³¹⁵ Pra, në filllet e saja LDK-ja, si subjekt dominant për nga mbështetja politike si dhe subjektet e tjera politike dhe shoqërore përcaktohen për barazi në kuadër të federatës.

Në funksion të kësaj ideje, partitë politike shqiptare më 2 korrik të vitit 1990-të, deputetët shqiptarë të Kuvendit të Kosovës nuk pranuan të miratonin amendamentet për kushtetutën jugosllave dhe atë serbe, pasi ato nuk e parashihnin Kosovën si njësi politike më vete. Në këtë mënyrë ata shpallën “Deklaratën Kushtetuese”, ku deklarohet pavarësia e Kosovës nga Serbia dhe barazia e sajë me njësitë tjera të Federatës. Deputetët e Kuvendit të Kosovës më

³¹⁴ Pluralizmi politik ndër shqiptarët erdhi me partinë e parë politike shqiptare jokomuniste, Lidhja Demokratike e Kosovës pikëpamjet programore të së cilës do të diskutohen më poshtë. Parti kjo e cila u angazhua për zgjidhjen e problemit kombëtarë dhe për ngritjen e një shoqërie civile në Kosovë. Pas sajë u formua Partia Social Demokrate e Kosovës, Partia Fshatare e Kosovës, Partia Parlamentare e Kosovës, Partia Demokratike e shumë parti e shoqata të tjera demokratike.³¹⁴ Gjithashtu, u formuan edhe parti të tjera politik në mbarë hapësirë Jugosllave, kryesisht me emërtime të ndryshme dhe të koordinuar me partitë e tjera politike në Kosovës Shih më tepër: Jusuf Buxhovi, 2015, 221. Historia e Popullit Shqiptar, IV, 2009, 396.

³¹⁵ Ibrahim Rugova, Pavarësia dhe Demokracia, Intervista dhe artikuj, Fjala, Prishtinë, 1991, 90.

7 shtatorë shpallën Kushtetutën e Republikës së Kosovës në Kaçanik, apo siç njihet ndryshe Kushtetuta e Kaçanikut.³¹⁶ Gjithashtu, deputetët e Kosovës shpallën Kosovën të pavarur nga Serbia dhe kështu statusi i sajë u ngrit në shkallën e njësisë federative, i barabartë me të tjerat.

Mirëpo, rrethanat dhe zhvillimet e ndryshme politike jashtë dhe brenda Jugosllavisë ndikuan në avancimin e qëndrimit politik të shqiptarëve. Kështu, bashkimi i Gjermanisë, gjegjësisht shturja e Paktit të Varshavës, rënia e bipolaritetit dhe e “luftës së ftohtë”, gjithashtu dhe shkëputja e Kroacisë, Sllovenisë dhe e Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë nga Jugosllavia në vitin pasues kishte ndryshuar krejtësisht qëndrimin e udhëheqësisë politike shqiptare. Në refleksion me ngjarjet, “Parlamenti i Republikës së Kosovës”, miratoi “Rezolutën mbi Pavarësinë dhe Sovranitetin e Kosovës” (22 shtator 1991). Ky vendim iu nënshtrua votës popullore në një referendum të organizuar nga 26-30 shtator 1991.³¹⁷ Kështu 87 përqind e të gjithë banorëve me të drejtë vote në Kosovë, prej tyre 99.87 përqind votuan për Pavarësinë. Dhe në përputhje me këtë votë parlamenti i Kosovës ndryshoi Kushtetutën e Kaçanikut dhe shpalli Pavarësinë e Kosovës më 19 tetor 1991. Në njëfarë forme, shqiptarët e Kosovës dhe e viseve tjera të Jugosllavisë qëndrimet e tyre politike i ndërtonin në refleksion me rrjedhat politike brenda dhe jashtë Jugosllavisë. Nëse të “Tjerët” kanë të drejtë të kërkojnë diçka tillë, atëherë edhe “Ne” e posedojmë këtë të drejtë. Nëse Kroacia, Sllovenia dhe Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë kishin të drejtë të shpallnin republikat e tyre, atëherë edhe ne kishim të drejtë të shpallnim një të tillë. Mund të themi se klasa politike në Kosovë nën udhëheqjen dominante të LDK-së së Ibrahim Rugovës ishte shumë e kujdesshme dhe pragmatiste në artikulumet politike, që përjashtonte çfarëdo qëndrimi politik që rrezikonte paqen, sepse gjithçka duhej të vije natyrshëm dhe paqësisht.

Oscilimet politike rreth papërcaktueshmërisë së zgjidhjes së statusit të shqiptarëve në Jugosllavi vazhdonin edhe më tej dhe në kontekst me rrjedhat politike të kohës. Kështu pas

³¹⁶ Po aty, 397.

³¹⁷ Në bazë të nenit 97 alineja 1 pika 8 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi I Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 1991, përcaktoi tekstin e pyetjes për Referendum mbi Republikën e Kosovës si shtet Sovran dhe I pavarur. Pyetja/ Në bazë të deklaramit tuaj të lirë, luteni që të përgjigjeni (duke rrethuar fjalën “PO” ose “JO”) se a e aproveni, si vendim të vullnetit tuaj politik, Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës mbi Republikën e Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur, me të drejtë të pjesmarrjes konsituive në lidhjen e shteteve – republikave sovrane (në Jugosllavi).

shpalljes së pavarësisë, “Komiteti Koordinues i Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi”,³¹⁸ me Ibrahim Rugovën në krye, miratoi një deklaratë politike në tetor të vitit 1991 duke parashtruar tre opsione për zgjidhjen e “çështjes shqiptare në Jugosllavi”. 1) Nëse kufijtë e jashtëm dhe të brendshëm të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë (RSFJ) do të mbesin të pa ndryshuar, kërkohet statusi i një shteti sovran dhe të pavarur me të drejtë bashkimit në një bashkësi të re shtetesh sovrane jugosllave. Shqiptarët etnikë brenda Serbisë, Maqedonisë dhe Malit të Zi duhej të gëzonin statusin e një kombi dhe jo të ishin pakicë kombëtare brenda saj. 2) Në qoftë se do të ndryshoheshin vetëm kufijtë e brendshëm të RSFJ-së e jo të jashtëm, kërkohet një Republikë Shqiptare që përfshinte, përveç Kosovës, trevat në Serbinë Jugore, Malin e Zi dhe Maqedoni të banuar nga shqiptarët. 3) Në rastin e ndryshimit të kufijve të jashtëm, shqiptarët me referendum dhe një deklaratë të përgjithshme do të shpallnin bashkimin territorial me Shqipërinë dhe krijimin e “një shteti të pandarë shqiptarë në Ballkan me kufijtë etnikë shqiptarë”, që do të thotë, brenda kufijve të shpallur nga Lidhja e Parë e Prizrenit më 1878.³¹⁹ Papërcaktueshmëria politike e klasës politike në Kosovë vazhdonte edhe pas referendumit për pavarësi dhe shtet sovran. Kjo njëherit tregon se ligjërimin politik i shqiptarëve i nënshtrohej totalisht rrethanave dhe vullneteve të tjera politike. Opsionet e lartë paraqitura shprehin zgjidhje të ndryshme të “çështjes shqiptare” në Ballkan duke u nisur nga opsioni real, optimal dhe ai maksimal.

Mirëpo, pavarësisht këtij qëndrimi në Kosovë,³²⁰ vazhdonte konsolidimi i shtetit të Pavarur të Kosovës nga Jugosllavia, apo siç njihet ndryshe nga historiografia si “*Lëvizja për Republikën me të drejtë për vetëvendosje*”. Partitë politike shqiptare në Kosovë organizuan zgjedhjet e përgjithshme dhe presidenciale më 24 maj 1992. Kurse në tetor të vitit paraprak ishte formuar qeveria e përkohshme e Republikës së Kosovës, me kryetar Bujar Bukoshin

³¹⁸ Komiteti Koordinues i Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi, përbëhej nga të gjitha partitë politike shqiptare në ish-Jugosllavi, partitë politike nga Kosova, Maqedonia, Lugina e Preshevës dhe Mali i Zi. Ky veprim kishte të bënte me hartimin e një platforme të përbashkët me të cilën subjektet politike shqiptare shfaqeshin kundruall krizës dhe zhvillimeve të saj të paparashikueshme në mënyrë që të deponohej edhe qëndrimi shqiptarë në përputhje me sugjerimet e faktorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë Amerikanëve dhe Gjermanëve, për veprimet e përbashkëta dhe me mjete të civilizuar. Shih më tepër: Jusuf Buxhovi, 2015, 238.

³¹⁹ Miranda Vickers, 2004, 307.

³²⁰ Platforma e përbashkët e partive politike shqiptare në Jugosllavi, nga Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi, sipas J.Buxhovit ishte bërë nën tryshinë e faktorit ndërkombëtarë, gjegjësisht të atij Amerikan dhe Gjermanë në mënyrë që subjektet të shfaqeshin gatishmërinë e tyre kundrejt krizës dhe zhvillimeve të paparashikueshme dhe në këtë mënyrë të adaptohej një qëndrim shqiptarë në përputhje me sugjerimet e faktorit ndërkombëtarë.

nga LDK-ja. Ndërsa në zgjedhjet e mbajtura për President të Republikës së Kosovës u zgjodh Ibrahim Rugova nga rradhat e LDK-së. Gjithashtu, ishte votuar edhe për parlament të Kosovës, në të cilën shumicë deputetëve i kishte fituar LDK-ja.³²¹ Që nga kjo kohë, në Kosovë, organet shqiptare dhe ato serbe filluan të punonin në mënyrë paralele, ai i Republikës Socialiste të Serbisë dhe Republikës së Pavarur të Kosovës. “Kosova e pavarur” me institucionet e krijuara apo siç njihet ndryshe “shtetin paralel”, kishte për qëllim ndërkombëtarizimin e problemit të sajë dhe jetësimin e shtetit të Kosovës në mënyrë *paqësore*. Ajo çka e karakterizonte këtë rrymë politike të dominuar kryesisht nga Lidhja Demokratike e Kosovës ka ndjekur një qasje paqësore, gjegjësisht sipas tyre problemi i Kosovës duhet të zgjidhet në mënyrë pragmatike dhe paqësore, njëherë si republikë e pavarur brenda Federatës Socialiste të Jugosllavisë dhe më pas si shtet i pavarur.

Një formë tjetër e zgjidhjes së çështjes së Kosovës, e cila paraqitej në këtë fazë ishte ideja e “*Bashkimit kombëtarë*”. Fillimisht ndiqet nga intelektual të shquar si Ukshin Hoti e Rexhep Qosja dhe më pas edhe nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) që artikulonin se Kosova e Pavarur dhe jo vetëm, duhet të bashkohen me Shqipërinë si shtet amë. Ideja në fjalë artikullohet në mënyrë shkencore mbi të drejtën historike, të drejtën etnike, mbi vazhdimësinë gjeografike të territoreve shqiptare, e mbi të gjitha mbi të drejtën e popujve për vetëvendosje. Ata argumentojnë se populli shqiptarë plotëson të gjitha kriteret e parapara nga e drejta ndërkombëtare që të ndërtoj njësinë politike mbi njësinë kombëtare. Kjo ide mbështetet edhe nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës që fillimisht ishte paraqitur me idenë maksimaliste, qëllimi së cilës ishte të çliroj dhe t’i bashkojë trojet e pushtuara të Shqipërisë. Mirëpo, UÇK-ja, gjegjësisht përfaqësuesit e sajë politik me nënshkrimin e “Marrëveshjes së Rambujesë” i nënshtrohet trysnisë ndërkombëtare dhe pranon të çarmatoset pa realizuar objektivin e saj sublim. Gjithashtu, pas dështimit të opsionit të parë, pra të qasjes paqësore të zgjidhjes së çështjes shqiptare, UÇK-ja e sheh si domosdoshmëri opsionin *militarist apo ushtarak* për zgjidhjen e çështjes në fjalë.

Ide tjetër për zgjidhjen e çështjes e Kosovës ishte ajo “*Autonomisë së Kosovës*”, e mbështetur nga Partia e Ante Markoviqit “Bashkimi Demokratik i Jugosllavisë (UJDI). Kjo ide, apo mbështetësit e sajë besonin se Jugosllavia mund të demokratizohet dhe shqiptarët e

³²¹ Rreth procesit zgjedhor të 24 majit 1992, mbarëvajtjes, rezultateve, vëzhguesve ndërkombëtar të këtij procesi shih: Historia e Popullit Shqiptarë IV, 398; Miranda Vickers, 317.

Kosovës duhet të jenë pjesë e këtij demokratizimi, duke marrë pjesë fillimisht në zgjedhe dhe më pas duke e votuar Bashkimin Demokratik të Jugosllavisë. Kjo parti, gjegjësisht kjo ide, nuk gëzonte mbështetje ndër shqiptarët por vetëm nga disa individë,³²² duke e pasur parasysh të kaluarën mohuese që shqiptarët kishin përjetuar në të kaluarën në këtë entitet. Kjo ide, mbështeste qasjen *reformiste*, sepse përmes reformave mund të bëhet ajo që nuk është bërë deri më tani nga autoritarizmi i Slllobodan Millosheviqit dhe paraardhësve të tij.

Në këtë periudhë, ligjërimi nacionalist shqiptarë në Kosovë paraqitet në formën e sajë të ndrydhur dhe me lëkundje të përhershme konceptuale. Ky ligjërim i nënshtrohet ndryshimeve të kohëpaskohshme të rrethanave politike. Ai nuk është i artikuluar si ide imanente dhe nevojë e domosdoshme e shoqërisë përkatëse, por si ide që ruan tagrin e përputhshmërisë me realitetin. Ligjërimi nacionalist shqiptarë në këtë fazë pas pavarësive të njëpasnjëshme të shteteve të ish-Jugosllavisë si objektiv kryesorë kishte përcaktuar pavarësinë e Kosovës si kompromis të përkohshëm. Ky objektiv ndonëse i reduktuar nga parimi nacionalist doktrinar vjen si shkak i rrethanave të disfavorshme të krijuara në këtë periudhë: së pari, ngritja e shteteve të sapodalura nga Jugosllavia në subjektivitete ndërkombëtare, e posaçërisht të Maqedonisë së Veriut, ku pjesa më e madhe e popullsisë dhe territoreve shqiptare pas Kosovës ishte në këtë shtet;³²³ së dyti, tashmë çështja shqiptare në ish-Jugosllavi ishte parcializuar edhe më tej dhe se çështja shqiptare nuk është më vetëm çështje e brendshme e Jugosllavisë; së treti, shtetet që fituan pavarësinë nga Jugosllavia, u bënë në kufijtë e ndarjeve administrative dhe territoriale që u bënë në dy Jugosllavit, kështu nuk u bënë ndryshime të vijave kufitare në pavarësimin e këtyre shteteve; së katërti, rol të rëndësishëm luan edhe qëndrimi shtetit amë Shqipërisë, që edhe pas ndryshimit të sistemit politik çështjen shqiptare e sheh konform ndarjes territoriale dhe administrative të deri tashnishme në Jugosllavi, për më tepër ajo mban qëndrim se “autonomia për Kosovën ishte zgjidhje e pranueshme”, në këtë kontekst mund të përmendim edhe njohjen e Maqedonis së Veriut nga Shqipëria; së pesti, gjendja e

³²² Intelektualët që u përfshinë në iniciativën për themelimin e UJD-it në Prishtinë ishin publicisti Veton Surroi (botues i revistës “Koha” dhe më vonë i gazetës “Koha Ditore”) dhe Shkëlzen Maliqi. Shih më tepër: Jusuf Buxhovi, Kosova 1945-1999, 2015, 221.

³²³ Pas shpërbërjes së federatës jugosllave, Maqedoni, në vitin 1991, me referendum shpallet shtet i pavarur, sovran dhe të pavarur. Subjektiviteti ndërkombëtar-juridik i shtetit definitivisht u konfirmua më 8 prill të vitit 1993, kur me aklamacion në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Maqedonia u pranua si anëtare e 181-të në Organizatën botërore. Shqipëria e njohu pavarësinë e IRJM pak ditë pas njohjes së saj nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, më 26 prill, 1993. Më 24 dhjetor, 1993, Shqipëria dhe IRJM vendosën marrëdhënie diplomatike.

shqiptarëve në Ballkan ishte e pafuqishme për të nisur një lëvizje të gjithëmbarshme kombëtare; së gjashti, qëndrimi i bashkësisë ndërkombëtare i palëkundur në mos ndryshueshmërinë e kufijve në Ballkan, gjithashtu ajo bënte përpjekje për integrimin e Kosovës në Jugosllavinë e re. Mbi këto rrethana politike pavarësia e Kosovës u ligjërua si objektiv përkohshëm kryesorë i ligjërimit nacionalist të kësaj periudhe. Këtu, mund të ju referohemi ligjëruesve të nacionalizmit shqiptar si Abdi Baletës dhe Hysamedin Ferajt që argumentojnë “se nacionalistët nuk mendojnë se bashkimi kombëtar i shqiptarëve do të arrihet menjëherë, hapa dhe zgjidhje të ndërmjetme janë domosdoshmëri. Në këtë kuptim, ata e pranojnë Republikën e Kosovës si një kompromis të përkohshëm”.³²⁴ Pra, në kuadër të ligjërimit nacionalist shqiptarë konsiderohen ato lëvizje që pavarësinë e Kosovës e shohin si projekt të pashmangshëm drejt bashkimit kombëtarë. Gjithashtu, për të realizuar këtë objektiv ata nuk përjashtojnë as luftën e armatosur apo rrethana dhe përpjekje të ndryshme politike në funksion të qëllimit kombëtar.

Çështja shqiptare, si një dhe e pa ndarë nuk u artikulua nga lëvizjet dominante të kohës, por edhe kur ajo u artikulua si e tillë, ajo iu nënshtrua trysnisë ndërkombëtare dhe u tjetërsua. Gjatë kësaj periudhe ligjërimit nacionalist shqiptarë nuk i përballoi realpolitikës dhe presionit ndërkombëtarë. Pra, Ky mendim u ndrydh dhe reduktoi edhe më tej çështjen e Kosovës pas nënshkrimit të marrëveshjes së Rambujesë, e që më pas derivoi Rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara e cila e shndërroi Kosovën në protektorat ndërkombëtar deri më vitin 2008-ë. Pra, mund të themi se teorikisht dhe konceptualisht Delegacioni i Kosovës me nënshkrimin e Marrëveshjes së Rambujesë ndërpreu dhe e vuri në dilemë procesin e pavarësisë së Kosovës.³²⁵ Kosova nuk mund të vetë vendos më për fatin e vetë përkundër përpjekjeve nga delegacioni Kosovarë që këtë të specifikoj edhe në marrëveshje. Në këtë kontekst mund të ju referohemi Ramë Bujës anëtarë i delegacionit të Kosovës në Konferencën Rambujesë i cili potencon se “Në vërejtjen rreth Referendimit, Delegacioni ynë insiston në futjen e këtij teksti “Tri vjet pas nënshkrimit të Marrëveshjes, populli i Kosovës, në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar,

³²⁴ Shih më tepër: Enis Sulstarova, Ligjerimi Nacionalist në Shqipëri, 2003, 116.

³²⁵ Referuar Kapitullit të 8, neni I, pika 3 e Kornizës së Marrëveshjes shkruhet se “Tri vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të mbahet një takim ndërkombëtar, për të përcaktuar mekanizmin për zgjidhjen përfundimtare për Kosovën të bazuar në vullnetin e popullit, në opinionet e autoriteteve relevante, të përpjekjeve të çdonjërës palë, të cilët kanë të bëjnë me implementimin e kësaj marrëveshjeje dhe aktit final të Helsinkut, si dhe të bëjë një vlerësim përmbajtjesorë të Marrëveshjes dhe të shqyrtoj propozimet nga çdonjëra palë rreth masave plotësuese.” Dokumenti i Rambujesë, Marrëveshja e përkohshme për Paqen dhe Vetëqeverisjen në Kosovë, Rambuje 23 shkurt 1999.

përmes referendumit do të caktojë statusin final të Kosovës”, por kjo nuk u pranua nga pala ndërkombëtare.³²⁶ Në këtë dokument nuk figuron askund shprehja popullore apo komb shqiptar, por bashkësi nacionale shqiptare ashtu sikurse serbët në Kosovë, pra një gjë e tillë e pamundëson të drejtën e vetëvendosjes dhe referendumin. Gjithashtu, dokumenti parashihte të kishte vetëm sigurimin publik, ku mungonte ai shtetërorë, që nënkupton se atë do të vazhdoj ta ushtroj Serbia dhe RSFJ-ja, kështu ajo me këtë dhe akte tjera të kësaj marrëveshje njihte integritetin territorial dhe sovranitetin e RSFJ-së mbi territorin e Kosovës.³²⁷ Në këtë kontekst edhe pse nuk u nënshkrua marrëveshja nga pala serbe dhe procesi i implementimit nuk u vu në zbatim asnjëherë, por nënshkrimi i sajë nga pala shqiptare ndrydhi dhe vuri në rrezik jo vetë idealin e tyre politik, por edhe vullnetin politik të qytetarëve të Kosovës dhe interesat e saja. Klasa politike në Kosovë transformoi apo hoqi dorë, qoftë edhe përkohësisht nga i ideali dhe vullneti politik i qytetarëve të Kosovës.³²⁸ Në këtë rrjedh, mund të them se ligjërimi nacionalist shqiptarë në këtë periudhë u ndrydh dhe u dominua tërësisht nga realpolitika, dhe kështu ai u artikulua vetëm nga intelektual të shquar në formë individuale.

Më poshtë do të elaborojmë më gjatë filozofinë politike të këtyre subjekteve, gjegjësisht, ligjërimi politik me motive kombëtare dhe ligjërimin nacionalist shqiptarë dhe besnikërinë e tyre ndaj idesë.

1.1 Lidhja Demokratike e Kosovës

Lidhja Demokratike e Kosovës është formuar më 23 dhjetor 1989. Programi saj është i ngjashëm me alternativistët slloven e kroat rreth çështjeve të përgjithshme.³²⁹ Themelimi i saj ishte refleksion i drejtpërdrejtë i suprimimit të autonomisë së Kosovës nga Milosheviqi.

³²⁶ Ramë Buja, Konferenca e Rambujesë, Vertigo Prizren, Prishtinë, 2004, 88.

³²⁷ Shih më tepër: Dokumenti i Marrëveshjes, Kapitulli 1, Neni 1, pika 3 dhe 4, Neni 9, Pika 1a, 1b.

³²⁸ Në Kosovë akoma ekziston një debat i hapur mbi efektet negative dhe pozitive të marrëveshjes së Rambujesë, dhe nëse kjo marrëveshje derivoi një sërë aktesh tjera më pas që nuk përkonin me vullnetin e qytetarëve të sajë. Gjegjësisht është dashtë të nënshkruhet apo jo një marrëveshje e tillë, dhe se a transformoi vullnetin politik të qytetarëve të sajë Delegacioni i Kosovës me nënshkrimin e sajë. Mos nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje nga pala Serbe i bëri shqiptarët moralisht fitues sepse pas sajë pësuan bombardimet e NATO-s ndaj forcave ushtarake të RSFJ-së, në të kundërtën do të kishim një gjendje tjetër, pra implementimin e kësaj marrëveshjeje që në esencë ishte kundër vullnetit të qytetarëve të sajë, kundër parimeve të UÇK-së dhe traditës shekullore të rezistencës shqiptare në këto troje. Por, gjithashtu nga kjo marrëveshje rrjedhën apo rezultuan edhe Rezoluta 1244, Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 15 maj 2001, e të tjera që nuk përkonin me vullnetin politik të popullit të Kosovës. Për më tepër rreth këtij diskutimi shih: Kosova lufta dhe paqja (intervista), intervistuar nga Shkëlzen Gashi, Drejtorja për Kulturë Komuna e Prishtinës, Prishtinë 2019.

³²⁹ Shih më tepër: Ibrahim Rugova, Pavarësia dhe Demokracia, Fjala, Orishtinë, 1991, 93.

Në këtë kohë në Kosovë u shpall gjendja e jashtëzakonshme dhe u instalua një regjim policoro-ushtarak me elemente apartheidi. Beogradi mori nën kontroll të gjitha strukturat e pushtetit shtetëror të deriatëhershëm në Kosovë. Në këtë mënyrë ajo filloi të ushtrojë represion ndaj të gjithë atyre që penguan miratimin e amendamenteve kushtetuese, me ç'rast policia serbe arrestoi 216 intelektualë që nënshkruan një apel në të cilin kundërshtonin heqjen e autonomisë së Kosovës.³³⁰ Në Jugosllavi funksiononte Partia e Bashkuar Demokratike Jugosllave (UJDI) e Ante Markoviqit, mirëpo ajo nuk gëzonte përkrahje nga shqiptarët ngase interesimi i tyre ishte krijimi i një partie autentike nacionale, që do të prezantonte vullnetin politik të shqiptarëve të artikuluar ndër vite dhe të jetë në përputhshmëri me nevojat e kohës. Kështu, të dalë nga Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, krijohet Këshilli Nismëtarë për Themelimin e LDK-së. Kësaj nisme iu bashkëngjiten intelektual të shquar të kohës, si akademik Idriz Ajeti, Dervish Rozhaja, Mark Krasniqi, Anton Ceta, Zekiria Cana, Gazmend Zaimi, Femi Agani e të tjerë.

Ajo çfarë ishte e rëndësishme qysh në fillim, por edhe për objektin tonë studimorë është programi politik i sajë, sepse varësisht programit politik ajo do të regjistrohej si parti politike apo do të refuzohej. Në këtë kontekst ekzistonte qëndrimi i përbashkët se programi duhet të jetë i thjeshtë dhe përmbante kërkesa substanciale. Fillimisht, 1) të kërkohej barazi në Federatë si subjekt i saj; 2) të kërkohej pluralizëm politik; 3) të kërkohej demokraci dhe 4) të kërkohej ekonomia e lirë e tregut.³³¹ Këtu e rëndësishme ishte kërkesa e parë, qoftë edhe për lehtësim në regjistrim në kuadër të federatës. Kjo më pas shprehet edhe në deklaratën e parë programore të LDK-së më 1989.³³² Mirëpo, LDK-ja edhe lideri i sajë Ibrahim Rugova fillimisht do të artikulonin pozitën e shqiptarëve në federatë si të barabartë me të tjerët. Ky qëndrim ndërlidhej me fatin e përgjithshëm të Jugosllavisë, nëse fati i sajë do të jetë ndryshe, dhe nëse popujt e tjerë do të pavarësohen nga federata këtë të drejtë duhet ta ketë edhe populli shqiptarë i Kosovës. Ai këtë qëndrim e artikuloi duke u bazuar në fatin e Jugosllavisë apo edhe në vullnetin politik të popujve të tjerë në Jugosllavi. Nëse të gjitha popujt aktual të Jugosllavisë do të pranonin të vazhdonin brenda kësaj njësie atëherë LDK-ja

³³⁰ Buxhovi, Kosova 1945-199, 2015, 217.

³³¹ Shih më tepër: Po aty.

³³² Shih më tepër: Milazim Krasniqi, Sekretet që nuk i mori me vete Ibrahim Rugova, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2017, 272.

do të kërkonte që Kosova të jetë njësi e barabartë politike me popujt e tjerë të sajë. Një qëndrim i tillë tregonte kursin pragmatik të LDK-së.

Këtë qëndrim LDK-ja dhe lideri i sajë Ibrahim Rogova do ta ndryshonin pas një sërë ngjarjes ndërkombëtare dhe rajonale, posaçërisht pas bashkimit të Gjermanisë dhe rënies së sistemit bipolar botërorë, gjithashtu dhe me shpalljen e pavarësisë së Sllovenisë dhe Kroacisë nga Federata. Pra, në këtë rrjedhë bëhet i qartë edhe fati i Jugosllavisë në të cilën shqiptarët edhe ashtu po mbaheshin dhunshëm dhe pa vullnetin e tyre. Pra, LDK-ja dhe shumica e klasës politike homogjenizuan qëndrimin për Pavarësinë e Kosovës si një njësi më vetë politike. Ky njëherit do të jetë edhe rruga e LDK-së dhe liderit të sajë deri në arritjen e këtij qëllimi. Pra, ashtu siç thoshte edhe tashmë Presidenti i Kosovës Ibrahim Rugova “Një Kosovë të pavarur dhe asnjëse, e hapur si ndaj Shqipërisë, ashtu edhe ndaj Serbisë, është një zgjidhje optimale për të gjithë në rajon”.³³³

LDK-ja shtetin sovran dhe të pavarur, mendonte ta realizonte përmes mjeteve paqësore dhe refuzimit të dhunës. Në njëfarë forme ajo preferonte një lloj status-quo deri në pjekjen e kushteve që kjo çështje të zgjidhej në frymën paqësore dhe me mbështetje ndërkombëtare. Mirëpo, kjo gjendje dhe durimi i qytetarëve me versionin paqësorë të LDK-së do të ndryshojë pas organizimit të Konferencës së Dejtonit më 1995, kur u vendos që Bosnjë-Hercegovina të njëhej si shtet i pavarur dhe sovran. Në shoqëri filloi të konceptohet lufta si mundësi për realizimin e qëllimit, sepse tashmë ishte krijuar tradita, që pas mjeteve paqësore, të kalohet me ato radikale dhe më pas paqja përmes ndërmjetësismit ndërkombëtarë, ashtu siç ndodhi me Kroacinë dhe me Bosnja Hercegovinën. Por, LDK-ja pavarësisht kësaj vazhdoi të insistonte në mjete paqësore, madje edhe duke mohuar UÇK-në në fillimet e saja. Një deklaram i vrazhdë nga udhëheqja e atëhershme LDK-së, madje edhe nga kryetari i sajë, duke e quajtur Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës “dorë e zgjatur e Serbisë”.³³⁴ Mirëpo, kjo nuk ishte një mohim permanent apo shterues, por strategji politike dhe element shtesë në betejën e filluar. Sipas Milazim Krasniqit, arsyeja se pse LDK-ja qëndronte larg koncepteve të luftës dhe se mosdeklarimi me kohë për këtë çështje kishte për qëllim të ruante veprimin legal të sajë dhe të institucioneve. LDK-ja sipas tij, me këtë

³³³ Miranda Vickers, 2004, 340.

³³⁴ Shih më tepër: Rexhep Qosja: Dhunëtarët e histories, 5 Nëntor 2019, <https://www.koha.net/arberi/192466/rexhep-qosja-dhunetaret-e-historise/>, 1. 11. 2019.

qëndrim ka pasur orientim strategjik për zgjedhjen e çështjes së Kosovës dhe me mjete politike, kështu ajo nuk ishte e përgatitur për luftë.³³⁵ Pra, në një far forme ajo fillimisht “përfashtonte” idenë e luftës për arsye pragmatike dhe politike, ky qëndrim ndante aspektin zyrtar apo legal dhe atë ilegal të LDK-së, sepse nuk mungonte participimi i tyre në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, për realizimin e objektivit të sajë Kosovën e Pavarur.

Ligjërimi i saj politik ishte me motive të fuqishme kombëtare dhe për këtë u shndërrua në një lëvizje politike dhe nacionale e denjë për t’i rezistuar regjimit të atëhershëm. Platforma e sajë kristalizoi fuqishëm idenë e pavarësisë së Kosovës, që i shpinte shqiptarët në një realitet tjetër dhe tejet më avancues nga ku ishin para viteve të 90-ta. Ajo e shpinte kombin shqiptarë drejt lirisë shoqërore dhe kombëtare, që ishte ideal i shumë gjeneratave. LDK-ja dhe koncepti i sajë arriti një qëllim tejet thelbësorë dhe të rëndësishëm për kombin në këtë fazë, ajo tashmë “ndërkombëtarizoi çështjen e Kosovës” dhe kërkesat e popullit shqiptarë. Siç thekson edhe Hysamedin Feraj se “LDK e çoi para çështjen kombëtare shqiptare: jashtë, bota mësoi se në Jugosllavi ka shqiptarë, se shqiptarët kanë kërkesa të qarta politike dhe se ekziston problemi i quajtur Kosovë; brenda, popullsia u përbashkuar rreth një shprese dhe një projekti politik”.³³⁶

Ligjërimi politik i LDK-së nuk përkon me ligjërimin nationalist autentik apo doktrinarë. Pavarësinë e Kosovës e shihte si një entitet politik më vete dhe të denjë, dhe jo si proces apo fazë kalimtare. LDK-ja nuk kërkonte dhe nuk parashikonte bashkimin e Kosovës me Shqipërinë, qoftë edhe në të ardhmen, çka e përjashtonte këtë ligjërim nga të qenit ligjërim nationalist. Ajo Kosovën e parashikonte si subjekt të barabartë me shtetet tjera, gjegjësisht raporti i sajë me Shqipërinë do të jetë i ngjashëm si me atë të Serbisë, si dy shtete të njëjta rajonale ndaj të cilave do të ketë marrëdhënie të njëjta ndërshtetërore. Edhe pse pavarësia e Kosovës nga nationalistët shqiptarë mund të konsiderohet një arritje e rëndësishme drejt qëllimit final, apo ajo mund të konsiderohet si “projekt i ndërmjetëm” drejt idesë së bashkimit kombëtarë shqiptarë, mirëpo një gjë e tillë nuk u promovua asnjëherë nga LDK-ja dhe lidërshipi politik i atëhershëm i saj. Gjithashtu, përbrenda interesimit të sajë qëndronin edhe pakicat shqiptare në shtetet e rajonit gjegjësisht në Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe

³³⁵ Milazim Krasniqi, *Sekretet ...* 2017, 319.

³³⁶ Hysamedin Feraj, *Ecja me shqiptarinë apo me partinë?*, Zëri, janar 03, 2016.

https://zeri.info/zerat/70138/ecja-me-shqiptarine-apo-me-partine/?fbclid=IwAR2gZiUpUvRaPPënN9c5nXovzUp-HB7MY4_Ql95MlaOYypfPT8ShY5bëLLI, 10. 11. 2019.

Serbi ku për të cilat kërkonte statusin e maksimal dhe të gjitha të drejtat që rrjedhin nga kjo, pra që nënkuptonte zhvillimin e tyre përbrenda entiteteve përkatëse. Qëndrimet e pakicave në fjalë do të duhet të kontribuonin si qytetarë integral në shtetet përkatëse për ngritjen e mirëqenies së tyre. Pra, qëndrimet e saja politike projektonin si ideal Republikën e Kosovës, si shtet sovran dhe të pavarur, dhe mundësinë e sajë për bashkëpunim me shtetet dhe popujt tjerë si subjekte sovrane. Por, nënshkrimi i marrëveshjes së Rambujesë nga LDK-ja dhe lideri i sajë e bënë atë edhe më reduktuese nga objektivi i sajë për jo kompromis në çështjen e Pavarësisë së Kosovës. Ata njohën integritetin territorial dhe sovranitetin shtetëror të RSFJ-së ndaj territorit të Kosovës, ku dhe vuan në dilemë pavarësinë e sajë. LDK-ja iu nënshtrua presionit ndërkombëtar dhe realpolitikës mbi statusin përfundimtarë të çështjes së Kosovës, çka nënkupton se me nënshkrimin e marrëveshjes së Rambujesë dhe akteve të tjera që lindin si rezultat i saj, siç është Rezoluta 1244 e Kombeve të Bashkuara për Kosovën e cila rikonfirmoi sovranitetin dhe integritetin territorial të RSFJ-së mbi Kosovën, dhe vendosi bazat e administrimit ndërkombëtar të përkohshëm dhe pa afat për Kosovën,³³⁷ Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,³³⁸ e të tjera ndërprende dhe prolonguan procesin e pavarësisë së Kosovës. Këto marrëveshje njëkohësisht ishin në kundërshtim me vullnetin e popullit të Kosovës dhe interesave të tij sepse ato defaktorizuan institucionet dhe qytetarët e Kosovës. Pra, mund të themi se ligjërimi politik i LDK-së pavarësisht se është i frymëzuar nga koncepti i shqiptarizmit apo nga aktivitete dhe ngjarje të rëndësishme historike, si Rilindja Kombëtare, Lidhja e Prizrenit, Konferenca e Dytë e Prizrenit, Konferenca e Bujanit e të tjera, ajo mbetet jashtë të qenit mendim nationalist. Ideja në fjalë përjashton integritetin territorial të shqiptarëve ku ata shtriheshin historikisht. Lidhja Demokratike e Kosovës me liderin e sajë Ibrahim Rugovën, mbeten të përkushtuan në zhvillimin kombëtarë shqiptarë, por jo për njësinë politike të kombit shqiptar.

1.2 Ukshin Hoti

Njëri ndër intelektualët e rëndësishëm dhe më me ndikim në perceptimin dhe interpretimin e filozofisë politike shqiptare gjatë kësaj kohe është edhe Ukshin Hoti. Ai u bë i njohur dhe i pavdekshëm për mendimin politik shqiptarë sepse u martirizua për veprimtarinë dhe idenë

³³⁷ Shih më tepër: Rezolutën 1244 e Kombeve të Bashkuara për Kosovën, 10 Qershor, 1999.

³³⁸ Shih më tepër: Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 15 Maj, 2001.

Marrëveshja e Rambujesë është përfshirë në Rezolutën 1244, në pikën 11a, në të cilën flitet për vendosjen e autonomisë substanciale dhe vetëqeverisjes në Kosovë.

e zgjidhjes së çështjes shqiptare. Pas bashkimit të Gjermanisë, ai ndërtoni ligjërimin teorike mbi çështjen e bashkimit kombëtar të shqiptarëve që artikullohet ndër të pakt intelektual të kohës.

Argumentet e tija për çështjen e bashkimit kombëtarë i gjejmë të shpërndara nëpër shkrime, opinione dhe intervista që janë të përmbledhura në librin “Filozofia politike e çështjes shqiptare”. Ndër qëndrimet e tija të rëndësishme ka të bëjë me atë se populli shqiptarë duhet të bëjë një organizim më aktiv në aspektin e sinkronizimit të brendshëm në mënyrë që ai të trajtohet si subjekt ndërkombëtar e jo si objekt, ashtu siç realisht po trajtohet. Mos trajtimi adekuat nga ndërkombëtarët, ka të bëjë me pozitën tonë të brendshme, se “gjithmonë kemi mbetur të shtypur për shkak se nuk kemi pasur guxim t’i zgjidhim problemet e brendshme paralelisht me zgjidhjen e pozitës ndërkombëtare”. Kështu për t’u marrë seriozisht nga ndërkombëtarët, doemos duhet të bëjmë zgjidhjen e pozitës sonë të brendshme. Pra, një gjë e tillë bëhet atëherë kur rezistenca është më aktive në aspektin e brendshëm, “kjo nënkupton se duhet të jesh më i pranishëm në ngjarjet, më agresiv në kërkesat, më i vendosur në pikëpamjet e tua dhe më demokratik në hapësirën informative”. Ai me këtë kritikon luhatjet dhe qëndrimet ospionale të klasës politike shqiptare në Kosovë për zgjidhjen e çështjes kombëtare. Gjegjësisht, ai aludon në paraqitjen e tre opsioneve për zgjidhjen e problemit të shqiptarëve në Jugosllavi nga Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare, paraqitjen e shqiptarëve në Konferencën e Londrës dhe të Gjenevës. Kështu sipas tij, Shqiptarët në këto konferenca është dashur të paraqiten me një kërkesë maksimale, gjithashtu kërkesa maksimale do të impononte një delegacion të vetëm shqiptarë nga Jugosllavia, me katër delegacione që ata ishin prezantuar aty, nënkupton se ata janë pajtuar me statusin e tyre, me një zgjidhje parciale të problemit. Pra sipas tij, “një popull është i gatshëm të luftoj për një opion të caktuar ose nuk është i gatshëm. Është çështje e vlerësimit të subjekteve politike se për cilën çështje je i gatshëm të luftosh”.³³⁹

Mos uniteti dhe zgjidhja opsionale, që ekzistonte në fillim të viteve 90-ta, ndërmjet partive politike shqiptare nënkupton që çështja shqiptare në Jugosllavi të lihet në duart e faktorit të jashtëm. Dhe për këtë faktori shqiptarë mund të ketë pasoja serioze sepse faktori i jashtëm nuk i sheh gjërat nga interesi jonë i brendshëm. Në këtë mënyrë, duhet t’i shqyrtojmë

³³⁹ Ukshin Hoti, Filozofia Politike e Çështjes Shqiptare, Rozafa, Tiranë 1995, 165-170.

hesapet mes veti, që të kemi një qasje serioze, të dinjitetshme që artikulon kërkesën imanente të popullit shqiptarë. Pra, ai aludon në ndërtimin e opsionit që është në interes zhvillimor të kombit shqiptarë, atë të bashkimit kombëtarë. Ukshin Hoti këtë e shpreh në fjalën e tij të mbrojtjes para Gjykatës serbe në Prizren, më 29. 09. 1994, duke thënë se “Bashkimi i popullit shqiptar dhe i trojeve shqiptare në një shtet duhet të jetë parakusht për çfarëdo rregullimi të mëtejshëm të marrëdhënieve ndërshtetërore në këtë pjesë të Ballkanit.” Sipas tij, është një akt me rëndësi të shumëfishtë për zhvillimin e mëtejshëm të situatës në këtë pjesë të Evropës, bashkimi i popullit shqiptar nënkupton një të drejtë historike dhe imperativ të kohës.³⁴⁰ E drejta e popullit shqiptarë për t’u bashkuar buron edhe nga fakti se ai nuk ka qenë ndonjëherë i pyetur për caktimin e kufijve që e cungojnë nga të gjitha anët.³⁴¹ Vullneti për bashkim nuk vjen nga dëshirat ekspansioniste apo vullneti për të pushtuar tokat e të tjerëve, por mbi bazën e një të drejte të mohuar historikisht dhe si diçka imanente.

Çështjen e bashkimit kombëtarë tek Hoti nuk bazohet në arsyetime mitologjike apo qëndrime joracionale, por si një e drejtë që u është mohuar me vite shqiptarëve, dhe për këtë populli nuk duhet të dëshmohej më tepër në aspektin e gjuhës, kulturës, bashkësisë apo pozitës gjeografike. Shqiptarët tashmë kanë pjekurinë e duhur politike për veten, për vendin dhe për interesat e veta në rajon. Bashkimi i shqiptarëve doemos duhet të jetë në gjendje t’i kontribuojë zgjidhjes së sajë të drejtë, dhe “zgjidhjes së drejtë të çështjes shqiptare me bashkimin e tyre në kontekst të proceseve integrative të Evropës”. Hoti thekson se objektivat politike shqiptare kanë karakter të të drejtave të natyrshme dhe demokratike dhe jo të maksimalizimit të fuqisë më qëllim të instrumentalizimit të sajë në lojën e vjetër të fuqisë. Kështu, lufta politike e popullit shqiptarë është e motivuar nga kërkesat legjitime të shqiptarëve për zhvillim, dhe assesi në mohimin e nevojave apo të drejtave të ngjashme të serbëve. Ashtu siç Gjermania nuk u bashkua për inat të ndonjë vendi tjetër, apo me qëllim që të dëmtoj interesat e ndonjë vendi tjetër, por për hir të interesave të tyre kombëtare dhe zhvillimore. Bashkimi i popullit shqiptarë duhet të jetë shprehje e vullnetit të tij dhe nuk duhet të paragjykohej, gjithashtu kjo duhet t’i paraprij çfarëdo forme të bashkimit federal ose konfederal, ose formave të tjera të bashkimit në

³⁴⁰ Po aty, 136-138.

³⁴¹ Po aty, 125.

tërësi të mëdha. Shqiptarët nuk mund të jenë ta bashkuar përbrenda entiteteve të tjera politike, por vetëm përbrenda një entiteti politik shqiptarë si shprehje e vullnetit të tij historiko-politik.

Hoti në çështjen e bashkimit, shtetin Shqiptarë e sheh si bartës të këtyre proceseve gjithashtu dhe si të paprekshëm sepse ai është boshti rreth të cilit duhet të sillemi. Në këtë mënyrë, nëse nocioni komb nënkupton përmbajtjen anglo-saksone, që do të thotë kombi i konstituuar si shtet atëherë do të ishte e natyrshme dhe e logjikshme që Shqipëria të jetë bartëse e një politike gjithë shqiptare. Në këtë kuptim mund të flitet për interesa vitale të kombit: a) të ekzistoj si komb; b) si komb i konstituuar në shtet-Shqipëri, c) të bashkohet.³⁴² Ekzistimi i Shqipërisë shtet thelb, pra si shtet i gjithë shqiptarëve dhe i trojeve shqiptare asnjëherë nuk duhet të vihet në pikëpyetje, dhe se Shqipëria duhet të jetë bartëse e një politike panshqiptare.

Parulla "një komb-një shtet" mbetet udhëheqësja kryesore në jetën politike të Ukshin Hotit, këto qëndrime më qartë i shpreh edhe me rastin e zgjedhjes Kryetar i Partisë Uniteti Kombëtarë,³⁴³ në një deklaratë politike. Siç njihej ndryshe shkurtimisht UNIKOMBI, Kosovën Republikë të pavarur e konsideron hallkë me rëndësi transitore drejt bashkimit përfundimtar të kombit, por jo edhe përfundim të këtij procesi. Për këtë shkak, "ajo angazhohet njëkohësisht për inicimin, zhvillimin dhe forcimin e atyre proceseve që çojnë drejt realizimit të këtij qëllimi; si parti, ajo do të investojë përpjekje dhe mund të duhur për përsosjen e vazhdueshme të organizimit të vet në funksion të këtij qëllimi; që do ta mundësojnë këtë." Shikuar në këtë kontekst ligjërimi nacionalist i Ukshin Hotit mbetet më autentik në këtë periudhë kohore. Edhe pse në disa shkrime të më hershme çështjen shqiptare në Maqedoninë e Veriut e shihte si bartëse e shtetësisë të sanksionuar me kushtetutë, dhe të drejta të garantuara të shqiptarëve në Mal të zi dhe Serbi Jugore, prapë se prapë bashkimin e Republikës së Kosovës me Shqipërinë e artikulonte si një të drejtë të pakontestuar. Këtë të arritur nuk e sheh si çështje të përfunduar, por si një hap të rëndësishëm drejt bashkimit kombëtar dhe kështu zotohet për angazhim në realizimin e

³⁴² Po aty, 48.

³⁴³ Shteti duke e parë tek aktivizimi i tij politik rrëzikun e prishjes së barazpeshës politike dhe të marrëveshjeve të heshtura me subjektet e pasivizuara politike shqiptare të Kosovës, e burgos sërish dhe e dënon me 5 vjet burg nën pretekstin e antarësimit në LPRK e në UNIKOMB me qëllim të minimit të sistemit kushtetues e të tërësisë territoriale të Jugosllavisë. Ukshin Hoti, *Filozofia Politike e Çështjes Shqiptare*, Rozafa, Tiranë 1995, 137, 138, 196.

këtij qëllimi sublim. Në fjalën e tij të mbrojtjes para gjyqit më Gjykatën e Qarkut në Prizren (29.09.1994), për bashkimin kombëtare thotë se edhe shkenca e konstaton se një territor kompakt me 115 mijë km², nga Kongresi i Berlinit (1878), e gjer më sot, është ngushtuar në 55 gjer 65 mijë km², në të cilat tani populli shqiptarë është shumicë. Në konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-13), shteti shqiptarë u krijua në një sipërfaqe prej pak a shumë se 28 mijë km². Dallimi midis kësaj shifre 65 mijë km² në të cilat jeton sot në shumicë populli shqiptarë në trojet e veta historike, duhet të inkuadrohet në shtetin e njësuar shqiptar.³⁴⁴ Pavarësisht këtij qëndrimi të fundit që nuk ekziston një prerje definitive, por ai aludon në bashkimin politik të të gjithë shqiptarëve sepse në vendet ku ata jetojnë janë shumicë absolute dhe kanë kompaktesinë territoriale. Në aspektin konceptual dhe ideorë, ligjërimi politik i Ukshin Hotit mbetet ligjërim nacionalist më i avancuar i kohës, krahasuar me artikulimet e tjera politike nga individ dhe subjekte të tjera politike të kohës. Martirizimi i tij, është i lidhur drejtpërdrejt me idetë e tija politike mbi çështjen shqiptare, dhe mbi të gjitha ajo që i bënë edhe më legjitimuese qëndrimet e tija, është sakrificat e tij deri në vetëmohim, apo siç thoshte ai “Bëje ose Vdis për ta vararë vdekjen”.

1.3 Rexhep Qosja

Një artikules i mirë i çështjes shqiptare dhe të drejtës së tyre në Jugosllavi është edhe Akademik Rexhep Qosja. Ai duke e trajtuar teorikisht procesin e shpërbërjes së Jugosllavisë, vjen në konkludim se për shqiptarët zgjidhje e drejtë dhe e përhershme, mbetet vetëm bashkimi kombëtar, si zgjidhje që del nga zbatimi i të drejtës për vetëvendosje. Gjithashtu, ai mbrojt me argumente para akademikëve serb tezën se Kosova dhe territoret e tjera të banuara nga shqiptarët në Jugosllavi janë toka shqiptare. Problemet kombëtare janë trajtuar në shumë intervista, ligjërata apo artikuj publicistikë, gjithashtu në librin “Strategjia e Bashkimit Kombëtar”, botuar më 1992, “Populli i ndaluar” shkrimet e të cilit janë shkruar dhe botuar prej vitit 1985 deri në 1990, ku shpreh të drejtën e pakontestuar të shqiptarëve. Rexhep Qosja përmes botimeve ka ndikuar në ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare në Jugosllavi, duke e përshkruar gjenocidin e përjetuar të shqiptarëve në tokat e tyre të pushtuara.

³⁴⁴ Po aty, 133.

Çështja shqiptare ekziston prej se ekziston Lëvizja Kombëtare Shqiptare, qëllimi themelorë i së cilës dikur ishte krijimi i shtetit të pavarur shqiptarë në trojet etnike shqiptare, kurse qëllimi themelorë i së cilës sot duhet të jetë bashkimi i Kombit të ndarë shqiptar. Sipas Qoses çështja shqiptare është çështje e asaj lëvizjeje që e quajmë Rilindje Kombëtare. Ai shpjegon se me shprehjen çështja shqiptare nënkupton problemin që, objektivisht paraqesin shqiptarët si popull i ndarë në pesë shtete: në Shqipërinë, në Serbinë, në Maqedoninë, në Malin e Zi dhe në Greqinë. Çështja shqiptare kështu e ndarë, është pasojë e politikës së ashtuquajtur evropiane të baraspeshës artificiale, e cila kërkesat e të mëdhenjve, do t'i plotësojë në dëmin e të vegjëlve, sikundër ishin shqiptarët. Ai tërheq vërejtjen se çështja shqiptare asnjëherë nuk u shtrua me vendosmëri, madje është heshtur për fajin e dy faktorëve, prej rrethanave politike ballkanike dhe evropiane dhe prej vet pozitës politike të vet faktorit politik. Ai artikulonte nevojën e domosdoshme të zgjidhjes së kësaj çështjeje, sepse ajo tashmë u ndërkombëtarizuar, me aktet vetëdijësuese politike të pas 1878, 1912-13, 1919-1924, 1941, 1943, 1946 dhe 1974 dhe asnjëherë nuk do të hiqet prej rendit të ditës së diplomacisë evropiane dhe botërore.³⁴⁵

Ligjërimi politik i Qoses, në këtë periudhë historike ishte konform zgjidhjes politike të tërësishme të çështjes shqiptare në Jugosllavi. Ligjërimin e qendërzon në vendosmërinë që duhet ta ketë faktori shqiptarë për zgjidhjen e çështjes. Ai shkruante se çështja shqiptare në Jugosllavi është çështje shumë komplekse dhe e rëndë sepse janë të ndarë në tri republika, dhe zgjidhja e kësaj varet prej tre faktorëve, prej vet shqiptarëve si faktor i parë, prej serbëve, maqedonasve dhe malaziasve si faktorë i dytë dhe prej faktorit evropian, përkatësisht botërorë si faktor i tretë. Mirëpo, kjo do të varet shumë më shumë prej faktorit të parë së të tjerëve, sepse sa më i zëshëm, sa më i vendosur, sa më i fortë të jetë faktori shqiptar aq më i madh do të jetë edhe roli i faktorit evropian e botërorë dhe anasjelltas. Kështu që pavendosmëria apo heshtja e faktorit shqiptarë do të ndikoj që i vogël të jetë edhe roli i faktorit evropian e botërorë për zgjidhjen e çështjes shqiptare.³⁴⁶

Rexhep Qosja kërkon shtruarjen e drejt të çështjes shqiptare në Jugosllavi, gjithashtu kritikon ligjërimet parcialet shtrimit të kësaj çështjeje, duke aluduar në atë se nuk jemi duke

³⁴⁵ Shih më tepër: Rexhep Qosja, Strategjia e Bashkimit Kombëtarë, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1992, 86-88.

³⁴⁶ Po aty, 89.

kërkuar zgjidhjen e drejtë dhe reale. Ai thekson se çështjen shqiptare më së shpeshti e reduktojmë në çështjen e Kosovës. Pra, sipas tij çështja e Kosovës nuk mund të njësohet me çështjen shqiptare në Jugosllavi, sepse çështja e Kosovës nuk e mbulon në tërësi çështjen shqiptare në Jugosllavi. Edhe pse ai e konsideron se Kosova është përbërës më i rëndësishëm, mirëpo ajo nuk është e tërë çështja. Ligjërimi i tij fokusohet si tërësi në çështjen e shqiptare në Jugosllavi, siç thekson ai “Çështja shqiptare në Jugosllavi duhet shikuar kështu, si çështje e shqiptarëve të Kosovës, të Maqedonisë, të Malit të Zi dhe të komunave shqiptare të Serbisë Jugore, e jo vetëm si çështje e Kosovës, sado shtruarja e tillë, e tërësishme, e kësaj çështjeje, në shikim të parë mund të duket se njëherë për njëherë e ndërlikon edhe më shumë zgjidhjen e çështjes shqiptare!”. Qosja është i vetëdijshëm për kompleksitetin e çështjes në fjalë, por ai assesi nuk pranon që kjo çështje të reduktohet, “çështjen shqiptare ne nuk kemi të drejtë, as nuk mund të zbresim në interesa momentale politike as të kësaj apo të asaj pjese të popullit shqiptarë e aq më pak të kësaj apo të asaj partie politike”. Ai refuzon “maturin” politike duke refuzuar që çështjen shqiptare ta shtroj vetëm si çështjen e Kosovës, “tregojmë maturi politike sot, por bëjmë gabime politike historike”.³⁴⁷ Kështu ne asnjëherë nuk mund të pranojmë që pjesa të zëvendësoj tërësinë, nuk mund të pranojmë zvogëlimin momental sepse nuk dihet se ku mund të ndalet zvogëlimi, përvoja historike na mëson se nëse çështja nuk shtrohet drejtë, atëherë nuk mund të pretendohet zgjidhje të drejtë.

Ligjërimi i Qosës ndërtohet në tërësi me çështjen shqiptare, pra ajo ekziston si çështje Ballkanike, përkatësisht si çështje evropiane, për shkak se ekziston si shtet Shqipëria si shtet i përbërë vetëm prej gjysmës së popullit shqiptar me të cilin synon, dëshiron dhe ka të drejtë të bashkohet me gjysmën e tij të ndarë. Sipas tij një e drejtë e tillë është e natyrshme e një populli të ndarë e të persekutuar ndër vite. Kështu sipas tij, pavarësisht se çka do të ndodh me Jugosllavinë dhe të ardhmen e sajë politike, partitë politike në programet e tyre politike duhet të artikulojnë të drejtën e vetëvendosjes së popullit shqiptar dhe bashkimit të tij me Shqipërinë, por këtë të drejtë do të përpiqen ta realizojnë me mjete demokratike dhe paqësore.³⁴⁸

³⁴⁷ Po aty, 91.

³⁴⁸ Rexhep Qosja këtë qëndrim politik, pra të drejtën e vetëvendosjes e artikulonte edhe para viteve të 90-ta, sepse sipas tij, vetëm ashtu mund ta pushtojë lirinë; që të ketë shtetin e vet – sepse vetëm ashtu mund të mbrojë fatin e vet; ta jetojë në demokraci – sepse vetëm ashtu mund t’i zhvillojë plotësisht të gjitha fuqitë e

Qosja, gjithashtu kritikon pavendosmërinë e spektrit politik shqiptarë, gjegjësisht partitë politike shqiptare që akoma nuk ishin përcaktuar se për çfarë zgjidhje të çështjes shqiptare jemi. Atyre ju mungon qëndrimi i përbashkët se cila do të ishte zgjidhja rreth së cilës do të bashkoheshin të gjitha subjektet politike. Ai aludon në atë se partitë politike kanë mundur të regjistrohen në kuadër të federatës vetëm ato të cilat në programet e tyre janë pajtuar me kërkesa minimale për zgjidhjen e çështjes shqiptare, praktikisht vetëm çështjen e Kosovës. Për më tepër, faktori politik shqiptarë del me kërkesa të ndryshme para Jugosllavisë dhe para faktorit ndërkombëtarë, që tregon joparimitetin dhe politikën jo serioze të shqiptarëve kundrejt kësaj çështjeje. Sikurse Ukshin Hoti, edhe Qosja kritikon qëndrimet opsionale të partive politike shqiptare në raport me zgjidhjen e çështjes shqiptare. Kjo tregon për pavendosmërinë e faktorit politik shqiptarë në këtë periudhë kohore që më së paku iu duhej jouniteti, kështu një pjesë e madhe e tyre ndrydhin vullnetin politik shqiptarë të deklaruar historikisht.

Ligjërimi politik i Qoses është në këtë periudhë ishte në koherencë të plotë me ligjërimin nacionalist shqiptarë, ngase ai vendosmërisht mendon se Bashkimi Kombëtar, do të ishte e vetmja zgjidhje e drejtë dhe e vetmja zgjidhje e përhershme e çështjes shqiptare. Gjithashtu kjo njëherit do të ishte edhe zgjidhje e tërësishme e çështjes shqiptare. “Argumenti” i vetëm i atyre që kundërshtojnë këtë ide është se bashkimi i shqiptarëve cenon integritetin territorial të Serbisë, të Maqedonisë, e të Malit të Zi, apo krijimit të “Shqipërisë së madhe”. Mirëpo, sipas tij asnjë konventë, ligj, marrëveshje apo rezolutë ndërkombëtare nuk njeh konceptin e shteto madhe, prandaj edhe Shqipëria e madhe është kërkesë për një shtet që do të përbëhej prej trojeve në të cilat pjestarët e një kombi përbëjnë popullatën e vetme a shumicë dërmuese të popullatës së atyre trojeve. Përkundrazi, Qosja thekson se mund të flitet për një “Serbi të madhe” sepse në të bënë pjesë Kosova me rreth 90 përqind popullatë shqiptarë, apo “Maqedoni e madhe” sepse në të bënë pjesë Maqedonia Perëndimore me 80 përqind popullatë shqiptare, apo “Mal të Zi të madh” sepse në të bëjnë pjesë ato territore shqiptare që kanë qenë më 1912 dhe janë okupuar, aneksuar nga Mali i Zi dhe janë edhe sot shumicë dërmuese apo popullatë e vetme shqiptare.³⁴⁹ Në këtë kontekst mund të përmendim kritikën e Qoses drejtuar Presidentit Sali Berisha i cili kishte deklaruar në një

veta krijuese. Shih më tepër: Rexhep Qosja, Populli i nadluar, Mega Medium, Prishtinë, 1990, 207-8; Rexhep Qosja, Strategjia e Bashkimit Kombëtarë, Instituti Albanologjik, Prishtinë, 1992, 98.

³⁴⁹ Shih më tepër: Po aty, 105-109.

intervistë për Bujku se “ideja e një Shqipërie të Madhe nuk merret në konsideratë në qarqet politike serioze shqiptare”, ndërkaq Qosja iu përgjigj duke e kritikuar për “ngatërrim të shprehjes “Shqipëri e Madhe” me “Shqipërinë Origjinale”. Shqipëria dhe Kosova s’mund të quhet Shqipëri e Madhe. Është, gjithsesi, z.President, një Shqipëri Origjinale... një Shqipëri natyrale... një Shqipëri e vërtetë. ... Shqipëria si ka pranuar kurrë kufijtë e sajë ekzistues dhe është përpjekur gjithmonë t’u kujtojë qarqeve ndërkombëtare që këta kufij janë të padrejtë, duke e ndarë tokën shqiptare në dysh.”³⁵⁰ Ligjërimi nacionalist i Rexhep Qosjës është i ngjashëm me ligjërimin nacionalist të Rilindësve sepse, ai artikulon një mendim nacionalist mbrojtës dhe assesi ekspansionist, duke pretenduar vetëm ato pjesë të territoreve ku popullsia dërmuese është shumicë e madhe, parim ky që është vendosur nga Rilindja Kombëtare. Sepse toka është e atyre që jetojnë në të, dhe kjo nuk mund të quhet cenim i integritetit territorial të Serbisë, Maqedonisë apo Malit të Zi.

Ligjërimi politik i tij, artikullohet mbi të drejtën e popujve për vetëvendosje, pra mbi të drejtën natyrore, etnike, historike, të popujve për të jetuar së bashku dhe njëkohësisht pa iu shkelur ketë të drejt të gjithë atyre popujve që ato i plotësojnë kriteret e të qenit popull. Në vitin 1998 Qosja themeloi partinë e tij politike, Lëvizja e Bashkuar Shqiptare (LBSH). Pastaj, formoi një koalicion që e udhëhiqte ai, ‘Lëvizja e Bashkuar Demokratike’ (LBD). Partia e tij kishte mbështetjen e ish të burgosurve politikë dhe partive të tjera që e përkrahnin rezistencën aktive. LBD-ja haptazi mbështeti veprimtarinë e UÇK-së.³⁵¹ LBD-ja me Qosjen si përfaqësues të saj, mori pjesë në Konferencën e Rambujesë, ajo çka në esencë lëkund koherencën e qëndrimeve të tija politike me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

Ai ishte pjesë e delegacionit Kosovarë së bashku me Ibrahim Rugovën, Hashtim Thaçin dhe Veton Surroin, të cilët nënshkruan marrëveshjen e Rambujesë. Sipas Petrit Imamit kjo marrëveshje parashihte: 1) tërheqjen e pjesës më të madhe të forcave ushtarake jugosllave dhe të forcave paramilitare nga Kosova; 2) kthimin e autonomisë politike në Kosovë; 3) periudhën kalimtare trevjeçare pas skadimit të së cilës do të mbahej referendumi për ardhmërinë e Kosovës; 4) çarmatosjen e UÇK-së; 5) sistemimin e forcave të armatosura paqësore të NATO-s në Kosovë.³⁵² Pra, ashtu siç u theksua edhe më lartë se kjo marrëveshje

³⁵⁰ Miranda Vickers, 2004, 326.

³⁵¹ Abetarja e pushtetit: Libërth mbi politikën, njerëzit dhe partitë në Kosovë, IKS, Prishtinë, 2011, 25.

³⁵² Petrit Imami, Serbët dhe Shqiptarët ndër shekuj, 298.

njuh integritetin territorial dhe sovranitetin e RSFJ-së mbi Kosovë, gjithashtu dhe ndrydhi vullnetin politik të qytetarëve të Kosovës për një shtet të pavarur dhe sovran. Qosja si nënshkrues i marrëveshjes së Rambujesë qoftë edhe përkohësisht heq dorë nga zgjidhja e tërësishme e çështjes shqiptare që ai e promovon në fillim të viteve të 90-ta. Pavarësisht, nëse Qosja dhe ky delegacion ishin të informuar se pala serbe nuk do të nënshkruante marrëveshjen, nuk e përjashton atë nga përgjegjësia e heqjes dorë nga artikulimet e mëparshme që ai kishte bërë. Kjo marrëveshje, madje nuk mundësonte as zgjidhjen e pjesshme të çështjes shqiptare në Jugosllavi, të cilën Qosja e anatemonte dhe e trumbetonte si zgjidhje jo të drejtë, ajo parashihte rikthimin e autonomisë së Kosovës. Edhe pse mund të themi se “autonomia” ishte e kushtëzuar me rishqyrtimin e tërësishëm të marrëveshjes pas tri viteve, ajo prapë se prapë mbetet zgjidhje e pjesshme e çështjes shqiptare në Jugosllavi dhe në Ballkan. Qosja nuk i qëndron besnik ligjërit të vet politik mbi zgjidhjen e çështjes shqiptare në Jugosllavi, dhe kështu me nënshkrimin e marrëveshjes së Rambujesë nga ana e tij, ndrydhi dhe prolongoi vullnetin politik të popullit të Kosovës për lirinë dhe pavarësinë e sajë. Por, pavarësisht kësaj Rexhep Qosja nuk heq dorë nga artikulimi i tij për pavarësinë e shtetit të Kosovës dhe më pas bashkimin e Kosovës me Shqipërinë si hap i rëndësishëm i bashkimit kombëtar shqiptarë.³⁵³

Ligjërimi nacionalist i Rexhep Qoses pëson oscilime sidomos me nënshkrimin e marrëveshjes së Rambujesë, por ai vazhdon të artikuloj bashkimin e Kosovës me Shqipërinë pa lëkundje, që sipas tij si proces herët apo vonë do të ndodhë. Megjithatë, mund të themi se Rexhep Qosja, mbetet ndër artikulesit më të denjë të mendimit politik shqiptarë të kësaj periudhe dhe jo vetëm, ai shtroi drejt dhe rrjedhshëm nevojën e popullit shqiptarë. Argumentimet dhe qëndrimet e Qoses janë të drejta dhe të argumentueshme shkencërisht, dhe nuk janë joracionale dhe utopike. Shtrimi në këtë formë i zgjidhjes së çështjes shqiptare, ka bërë që kjo të ketë ndikim edhe në artikulimet e ardhshme politike për këtë problematikë, apo thënë më mirë ato do të kenë reflektim deri në zgjidhjen e plotë të çështjes shqiptare në Ballkan.

³⁵³ Rexhep Qosja: Shqipëria dhe Kosova do të bashkohen, 18, 02, 2020: <https://www.gazetaexpress.com/rexhep-qosja-shqiperia-dhe-kosova-do-te-bashkohen/> 3. 4. 2020.

1.4 Ushtria Çlirimtare e Kosovës

Shqiptarët e Kosovës ishin mjaft shpresues se çështja e tyre do të jetë temë thelbësore në Konferencat ndërkombëtare për Jugosllavinë, e cila vetëm se ishte në proces të shpërbërjes. Zhgënjimi filloi me Konferencën e Londrës, më pas të Gjenevës, dhe në fund në Konferencën e Dejtonit. Në asnjërën nga Konferencat e përmendura çështja e Kosovës apo çështja shqiptare nuk u vendos në rend të ditës. Kjo ndikoi shumë në vetëdijesimin politik të shqiptarëve se qëndrimi “paqësorë” apo përmes një politike që do të rezultojë si marrëveshje me ndërmjetësim ndërkombëtare tashmë ishte opsion i pamundshëm. Shqiptarëve nuk i mbetet opsion tjetër vetëm se ai i luftës, apo ngadhënjimit të mendësisë radikale, gjegjësisht përmes luftës të pretendoj paqen, lirinë. Kështu, përmes radikalizmit të gjendjes, përmes mjeteve të luftës, shqiptarët rikonceptuan formën e veprimit për t’u përgjigjur rezistencës së dhunshme të pushtetit serb dhe për të realizuar idenë e nisur për lirinë e trojeve shqiptare. Ajo, në formë të organizuar, pra në formën e Ushtrisë së organizuar, zyrtarisht pohohet se u themelua më 17 nëntor të vitit 1994.³⁵⁴

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, rrënjët e saja i ka në organizatat politike të cilat vepruan për zgjidhjen e çështjes shqiptare në Jugosllavi. Veçanërisht organizatave të cilat vepruan në vitet e 70-ta, si Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK), e cila u krijua në vitin 1982, e më vonë Lëvizja Popullore e Kosovës (LPK).³⁵⁵ LPK-ja që nga vitet e 90-ta kishte krijuar sektorin e veçantë, i cili ishte marrë kryesisht me organizimin ushtarak dhe furnizimin me armatim nga vendet e ndryshme. Kështu ky formacion erdhi edhe më shumë në shprehje me dështimin e propagandës pacifiste për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Edhe pse e vogël në aktivitete ilegale dhe kryesisht në diasporë, ideja e për ushtrinë çlirimtare filloi të përvetësohet nga një numër i madh i popullsisë që tashmë e shihnin si të vetmen mundësi për realizimin e qëllimit. Ngase kështu ndodhi edhe me popullin Boshnjak dhe Serb në Bosnja Hercegovinë , ku të dy popujt pas konfliktit të armatosur realizuan qëllimet e tyre politike.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, edhe pse e krijuar nga shqiptarët e Kosovës ajo u mbështet me të gjitha format nga të gjithë shqiptarët anë e mbanë botës. Në këtë mënyrë ajo mori epitetin e një lëvizjeje gjithëshqiptare fillimisht, jo vetëm për nga aspekti organizativ por

³⁵⁴ Petrit Imami, Serbët dhe Shqiptarët ndër shekuj, Samizdat B92, 2017, 241.

³⁵⁵ Sabile Kiçmezi Basha, Programet ..., 341.

edhe për nga objektivat që ajo kishte parashtruar si qëllimi më sublim. Këtu mund të ju referohem programit të sajë, ku me 27 prill të 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së kishte bërë një deklaratë politike, me këtë rast kishte deklaruar se “UÇK përfaqëson tërësinë e forcave të armatosura të Kosovës dhe viseve të tjera të pushtuara; qëllimi i saj është t’i çlirojë dhe t’i bashkojë trojet e pushtuara të Shqipërisë”. Karakteri ligjërimorë i sajë i përket mendimit nacionalist sepse ajo ruan parimin e territorialitetit dhe se nuk do të rresht se luftuari deri në bashkimin kombëtarë. Karakteri mbrojtës dhe çlirimtarë ka vetëm një qëllim fitimin e lirisë dhe arritjen e paqes për popullin, “duke e pasur këtë gjë në mendje do të luftojë dhe do të bëjë sakrifica”.³⁵⁶ Ajo shpreh gatishmërinë që përmes luftës dhe vetëmohimit të realizoj qëllimin sublim të popullit shqiptarë, atë të bashkimit kombëtarë. Aspekti programor i sajë dhe jo vetëm e bënë atë një lëvizje me karakter nacionalist mbrojtës dhe assesi ekspansioniste. Pra, asaj fillimisht nuk i mungonte gjithë përfshirja dhe integralitetit.

Gjithashtu, ajo çfarë e bënë me karakter nacionalist këtë lëvizje është edhe betimi i ushtarit të UÇK-së, ku thuhet se “Unë, ushtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, betohem se do të luftojë për çlirimin e tokave shqiptare dhe bashkimin e tyre. Do të jem përherë ushtar besnik, luftëtar i denjë i lirisë, vigjilent, guximtar dhe i disiplinuar, i gatshëm që në çdo kohë, pa e kursyer as jetën time, të luftoj për t’i mbrojtur interesat e shenjta të atdheut. Nëse shkel këtë betim, le të ndëshkohem me ligjet më të ashpra të luftës dhe nëse tradhtoj, qoftë i humbur gjaku im. Betohem! Betohem! Betohem!”. Programi politik i UÇK-së në aspektin parimorë është në përputhje të plotë më idenë e projekteve dhe lëvizjeve të hershme nacionaliste sepse nuk u mungon gjithë përfshirja. Në këtë kontekst mund të ju referohemi Muhamet Pirrakut i cili shkruan se “Programi politik i UÇK-së dhe Betimi i ushtarit të UÇK-së, vinin si zë i ndërgjegjes politike kombëtare nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit përmes Lidhjes “Besa-besë” të Pejës, Kryengritjes së Madhe të Kosovës për Autonominë e Shqipërisë, Akti i Pavarësisë së Shqipërisë, Lëvizjes Kombëtare Kaçake të Kosovës, Mbrojtjes Kombëtare të Kosovës, Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Kosovës, Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare, Lëvizjes për Lirimin e Tokave Shqiptare, Lëvizjen Revolucionare për Çlirimin dhe

³⁵⁶ Po aty, 343.

Bashkimin e Shqiptarëve, Lëvizjes Popullore të Kosovës dhe të Lëvizjes Kombëtare Çlirimtare të Kosovës.”³⁵⁷

Mirëpo, ajo që e nxjerrë UÇK-në nga karakteri gjithë përfshirës dhe integralistë është se veprimtarinë e saj ajo e ushtroi vetëm në hapësirën e territorit të Kosovës, duke u reduktuar kështu qëllimin e sajë vetëm në zgjidhjen e çështjes së Kosovës. Gjithashtu, nën diktatin e faktorit ndërkombëtarë, UÇK-ja, gjegjësisht përfaqësuesi i sajë politik Hashim Thaçi nënshkroi marrëveshjen e Rambujesë për Kosovën, e cila marrëveshje ishte shmangie drastike nga vizioni, parimet, vullneti politik dhe tradita shekullore e rezistencës së popullit shqiptarë. Marrëveshja e Rambujesë njohu integritetin dhe sovranitetin territorial të RFJ-së mbi Kosovës dhe jo vetëm, ajo gjithashtu parashihte një të ardhme të pa definuar për Kosovën e cila nuk ishte më përgjegjëse për fatin e sajë në formë drejtpërdrejt, e mbi të gjitha ajo parashihte edhe çarmatosjen e UÇK-së.³⁵⁸ Me këtë akt, Ushtria Çlirimtare e Kosovës kishte hequr dorë nga realizimi i qëllimit të sajë sublim të paraqitur në filllet e saja të veprimtarisë, pra luftën e pa kompromis për çlirimin dhe bashkimin e tokave shqiptare. Mund të thuhet se pala Kosovare e nënshkroi marrëveshjen duke llogaritur në mosgatishmërinë e palës serbe për të nënshkruar këtë marrëveshje, por pavarësisht kësaj, me nënshkrimin e saj UÇK-ja braktis parimet programore që ajo kishte paraqitur në filllet e saja, për më tepër ajo pranon të çarmatosjen dhe “kthimin e autonomisë politike për Kosovën”. Këtu mund të përmendim Fatmir Humollin një ish pjesëtarë i UÇK-së i cili thotë se “Marrëveshja nuk është dashtë të nënshkruhet për arsye se është njohur sovraniteti i RFJ-së ndaj Kosovës; është shkelur lufta e UÇK-së; është shkel betimi i UÇK-së; është shkelë e drejta e popullit shqiptarë për të jetuar i lirë.”³⁵⁹ Kjo e bënë joparimore dhe e vë ndesh me parimin e nacionalizmit shqiptarë këtë lëvizje sepse ajo bëhet reduktuese dhe parciale me veprimet e saja. Në këtë kontekst mund t’ju referohem Milazim Krasniqi i cili thotë se “Edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës pati oscilime programore. Në fillim ajo deklarativisht e kishte në program luftën e armatosur për bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare, pra një program nationalist. Këtë objektiv e pati lansuar në publik Jakup Krasniqi, në konferencën e parë për shtyp, si zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por, më vonë, UÇK-ja u fokusua në luftën

³⁵⁷ Muhamet Pirraku, Për Kauzën e UÇK-së, Grafobeni, Prishtinë, 2006, 246.

³⁵⁸ Ramë Buja, Konferenca e Rabujesë, Vertigo, Prishtinë, 2006, 288; Petrit Imami, Serbët dhe Shqiptarët ndër shekuj, 298.

³⁵⁹ Kosova lufta dhe paqja (intervista), intervistuar nga Shkëlzen Gashi, Drejtorja për Kulturë Komuna e Prishtinës, Prishtinë 2019, 24.

për çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës, duke hequr dorë nga projekti nacionalist". Nga aspekti i standardit teorik të nacionalizmit, këto projekte dhe kërkesa nuk mund të trajtohen si vazhdues të projektit dhe lëvizjes së hershme nacionaliste shqiptare, sepse u mungonte gjithë përfshirja, integriteti.³⁶⁰ Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje dhe pranimin e çarmatosjes së sajë, ajo ndrydhi vullnetin dhe objektivin për të cilin ishte themeluar, për çlirim dhe bashkim kombëtar. Por, pavarësisht se UÇK-ja i nënshtrohet realpolitikës dhe presioneve politike që derivohen nga situatat e atëhershme politike, ajo prapë mbetet njëra ndër lëvizjet më me ndikim në zgjidhjen e statusit të ardhshëm të shtetit të Kosovës, apo thënë më mirë ajo ishte determinantja kryesore për Republikën e Kosovës. Ajo mbetet frymëzimi i tashëm dhe i ardhshëm për rikonfigurimin e vullnetit politik të shqiptarëve.

2. Qasja e Shqipërisë ndaj çështjes së Kosovës

Në dhjetorin e vitit 1990 edhe në Shqipëri morën hov ndryshimet e mëdha sociale e politike. Ndryshimi nga sistemi komunist në atë demokratik nënkuptonte çlirimin e shoqërisë shqiptare nga izolim total me botën e jashtme. Gjithashtu, u thye edhe monopoli politik një partiak i organizimit të jetës politike, kështu Byroja e Politike e Partisë së Punës e drejtuar nga Ramiz Alia kishte lejuar organizimin në baza plurale, që më pas fitoi dhe fryma pluraliste, gjegjësisht fitoi Partia Demokratike e udhëhequr nga Sali Berisha. Organizimi politik demokratik kishte ngadhënjyer tashmë në Shqipëri dhe kjo do të thoshte shpresë edhe për Shqiptarët e Kosovës, ngase në botëkuptimin e tyre politik e shoqërorë Shqipëria asnjëherë nuk ishte larguar prej Kosovës, pavarësisht sistemit politik që ajo kishte aplikuar vullnetshëm apo dhunshëm.

Shpresat ishin rritur edhe më shumë kur në vitin 1992 kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha u shpreh se njëri nga qëllimet e partisë së tij ishte bashkimi kombëtarë i shqiptarëve. Mirëpo, entuziazmi i këtyre qëndrimeve nuk zgjati shume, sepse kur ai merr postin e presidentit deklaroi për një hapësirë demokratike të shqiptarëve në Ballkan dhe se autonomia për Kosovën ishte një zgjidhje e pranueshme, ngaqë deri aty arrinte përkrahja ndërkombëtare.³⁶¹ Arsyeja se pse Sali Berisha hoqi dorë nga ideja e bashkimit kombëtarë sipas Miranda Vickers kishte të bëjë me gjendjen katastrofale ekonomike që mbretëronte në atë kohë në Shqipëri, dhe kundrejt mbështetjes financiare për administratën e tij,

³⁶⁰ Milazim Krasniqi, Nacionalizmi shqiptar, 68.

³⁶¹ Enis Sulstarova, Ligjërimi Nacionalist në Shqipëri, 106.

ndërkombëtarët kërkonin që ai të zbuste deklaratimet e tija nacionaliste. Në këtë mënyrë rezultoi ndryshimi i qëndrimit zyrtar të Tiranës se kufiri shqiptaro-jugosllav nuk duhej të ndryshoj me forcë, ai kishte pranuar nocionin e autonomisë për Kosovën. Shqipëria në cilësinë e vendit fqinjë, vazhdimisht përsëriste thirrjet për ndalimin e dhunimit të të drejtave të njeriut që u bëheshin shqiptarëve në Jugosllavi. Zyrtarët e saj nuk përsërisnin më kërkesën apo nevojën e ndonjë ndryshimi të kufijve ndërkombëtar. Këto qëndrime të shtetit amë, gjegjësisht të Presidentit Berisha ndikuan edhe në ftohjen e marrëdhënieve me Presidentin e Kosovës, që ishte i pa lëkundur në idenë e pavarësisë. Këtë e argumenton edhe Jusuf Buxhovi, kur thotë se Berisha u kërkonte çaktivizimin e rezistencës institucionale Ibrahim Rugovës, dhe kështu ai duhej të lëshojnë pe para të ashtuquajturës “frymë demokratike në Serbi”, së cilës shqiptarët duhej t’i ndihmonin që “të demokratizohet” Serbia! Sali Berisha do t’ia kërkojë këtë Ibrahim Rugovës dy herë brenda tre vitesh, më 1993, 1996.³⁶²

Gjithashtu edhe Fatos Nano në cilësinë e Kryeministrit më 1997, në një intervistë të dhënë revistës së njohur gjermane “Der Spiegel”, në pyetjen e gazetarit se a do t’i kërkojë I. Rugovës të heqë dorë nga pavarësia e Kosovës, kryeministri i Shqipërisë, F. Nano, përgjigjet se për të pavarësia është diçka e pakuptimtë, “E ç’kuptim ka pavarësia në një Evropë pa kufij, në qoftë se jeni një qytetarë evropian? Pavarësia do të thotë barazi dhe ruajtje e të drejtave të njeriut. Unë flas shkurtimisht me Rugovën dhe jam i bindur se edhe ai do të mbështes një zgjidhje evropiane për kombin tonë shqiptar. Megjithatë, unë dyshoj se Presidenti i Jugosllavisë, Millosheviqi, është në gjendje të bëjë reforma demokratike.”³⁶³ Qëndrimin e hapur kundër pavarësisë së Kosovës Kryeministri Nano nuk mund të kamuflojë as me idenë e Evropës dhe të drejtave të njeriut. Kontradiktat e qëndrimit të tij janë të mëdha, për faktin që Jugosllavia nuk ishte Evropa dhe se Kosova nuk po kërkonte pavarësi nga Evropa, por nga një vend si Jugosllavi që dhunshëm e mbate Kosovën përbrenda saj, dhe pse deri më sot asnjëherë nuk treguan gatishmëri për realizimin e të drejtave të njeriut për shqiptarët e Kosovës. Fatos Nano, përkundër mosbesimit të tij se Jugosllavia nuk do të mund të demokratizohet nën Millosheviqin, ai u thotë shqiptarëve të Kosovës se pavarësia është e pakuptimtë, thjesht hiqni dorë nga ajo dhe qëndroni në një Jugosllavi jodemokratike.

³⁶² Jusuf Buxhovi, 2015, 389; Abdi Baleta, Vetëm Nacionalizmi e shpëton kombin Shqiptar, Rimëkëmbja, Tirana, 2005, 30.

³⁶³ Cituar nga Hysamedin Feraj, Pavarësia është e shenjtë, Koha, Tiranë, 1997, 13.

Reduktimi i qëndrimit të Shqipërisë si pasojë e presionit të madh ndërkombëtarë, bëri që Shqipëria çështjen e Kosovës ta sheh si çështje të brendshme të Serbisë, gjegjësisht të Jugosllavisë. Mbi këtë presion mund të themi se edhe shteti i Shqipërisë nuk e njohu Pavarësinë e Kosovës me referendumin e 1991-ës ashtu siç e kërkonte praktika e marrëdhënieve ndërkombëtare. Kuvendit Popullorë kishte marr vendim për njohjen e shtetit të Kosovës, mirëpo ky vendim nuk u ndoq nga një vendim qeveritarë. Që nga fillet e pluralizmit në Shqipëri, vëmendja dhe trysnia ndërkombëtare ishte e madhe, sepse konflikti në Jugosllavi kishte shpërthyer dhe shqiptarët kishin rishfaqur pakënaqësinë ndaj federatës dhe kërkesën e tyre për pavarësi. Qëllimi i ndërkombëtareve ishte që Shqipëria të mos përzihej direkt në një mosmarrëveshje të mundshme me Jugosllavinë, kështu paraprakisht të reduktonin një konflikt të mundshëm shqiptaro-serbë. Mund të shihet si e natyrshme apo lehtësisht e arritshme një gjë e tillë në një Shqipëri të brishtë dhe të rraskapitur ekonomikisht, që vazhdimisht “kërcënohej” me mbështetje financiare për administratën e shtetërore në dëm apo ne dobi të ndonjë çështjeje. Shqipëria edhe më pak e vëmendshme dhe aktive do të jetë ndaj çështjes së Kosovës kur ajo përfshihet në një “luftë civile” si pasojë e skemave piramidale që kishte kapluar vendin.

Shteti Shqiptarë, luajti një rol të rëndësishëm në ndërkombëtarizimit e çështjes së Kosovës dhe interesave të tyre. Ajo së bashku me strukturat e atëhershme paralele shtetërore e përçuan vullnetin e popullit të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Në këtë fazë shteti reduktoi qasjen e sajë ndaj Kosovës, qoftë edhe për arsye pragmatike që mos të përfshihej direkt në konfliktin e Kosovës, edhe pse kjo e binte ndesh me deklaratimet e saja se e njëjtte vullnetin politik të popullit të Kosovës. Tirana raportet me Kosovën dëshironte t’i mbështeste në linjën e përcaktimeve strategjike, të sillej në raport me interesat e saja shtetërore, pra rreth zgjidhjes së çështjes së Kosovës të mos bjerë ndesh me faktorin ndërkombëtarë, të cilët siç dihej nuk kishin në konsideratë vullnetin e kosovarëve të shprehur me referendum.

Ligjërimi nacionalist në Shqipëri gjatë kësaj periudhe u artikulua nga Partia e Rimëkëmbjes Kombëtare (PRK),³⁶⁴ gjegjësisht nga nismëtarët e sajë, si intelektualët e shquar Abdi Baleta

³⁶⁴ Në vitin 1994, nga Partia Demokratike në Shqipëri (PD), u shkëput një forcë e re politike Partia e Djalit Demokratike (PDD) ku më pas u transformua në Partia e Rimëkëmbjes Kombëtare (PRK). Kjo parti ka qëndruar jashtë garës për pushtet duke i bojkotuar të gjitha zgjedhjet që janë zhvilluar në Shqipëri.

dhe Hysamedin Feraj, kryesisht përmes artikujve publicistik duke analizuar ngjarjet politike nga këndvështrimi nacionalist. PRK-ja në programin e vet shprehet qartë për bashkimin e të gjitha territoreve shqiptare dhe pjesëve të kombit shqiptar në një shtet të vetëm si e vetmja zgjidhje e çështjes shqiptare me moton “një komb, një atdhe, një shtet”. Ndër veçoritë kryesore të kësaj partie politike janë përcaktimi i parimit të bashkimit kombëtar si parim themelor të sajë, përcaktimi i bashkimit të të gjitha pjesëve të kombit shqiptar dhe territoreve shqiptare në një shtet të vetëm, gjithashtu përcaktimi për të pranuar edhe sakrificën e luftës së armatosur për çlirimin e bashkëkombasve dhe territoreve shqiptare.³⁶⁵ Gjithashtu Abdi Baleta në vitin 1995 shkruan se “Midis shqiptarëve ekzistojnë kufijtë e dhunës dhe kurrfarë kufijsh të tjerë të natyrshëm. Ekzistojnë edhe dallime të shkaktuara nga këto kufij artificial të dhunshëm.” Ai argumenton se pavarësisht shtetësive të ndryshme që kanë aktualisht shqiptarët në Ballkan, ata formojnë një komb dhe kanë të drejtën të kenë një shtet kombëtar të vetëm. Ndër të tjera ai thotë se në periudhën e paskomunizmit tipar dallues i Evropës është themelimi i shteteve të reja kombëtare dhe përse për shqiptarët rekomandohet një proces i kundërt, pra duke ju referuar gjendjes së shqiptarëve në Ballkan pas shpërbërjes së Jugosllavisë.³⁶⁶ Sipas Ferajt “Bashkimi kombëtar nuk bëhet vetëm për hir që të realizohet një normë: Drejtësia. Ai ka kuptim të bëhet sepse shton aftësitë tona për të fituar në konkurrencë dhe për të shpëtuar nga vuajtjet e të pafuqishmit.”³⁶⁷ Bashkimi kombëtar është me interes, sepse shton aftësitë konkurruese të kombit shqiptarë që nga epërsitë ekonomike, kulturore, territoriale, e të tjera për të arritur mirëqenien shqiptarëve në shumë fusha të jetës shoqërore. Pra, bashkimi kombëtarë njëkohësisht nuk lejon që populli shqiptarë të dominohet nga vendet fqinje. Për A. Baletën dhe H. Ferajn në realizimin e bashkimit kombëtar nuk duhet përjashtuar asnjë rrugë, as luftën e armatosur të kombinuar me përpjekje politike dhe ligjore aty ku mundësojnë rrethanat. Nacionalistët nuk mendojnë se bashkimi kombëtar i shqiptarëve do të arrihet menjëherë, hapa dhe zgjidhje të ndërmjetme janë domosdoshmëri, kështu ata pranojnë Republikën e Kosovës si kompromis të përkohshëm drejt bashkimit kombëtar shqiptar.³⁶⁸ Në Shqipërinë paskomuniste ligjërimi nacionalist në mënyrë autentike dhe parimore propagandohet nga PRK-ja, gjegjësisht nga

³⁶⁵ Hysamedin Feraj, Pavarësia është e shenjtë, Koha, Tiranë, 1997, 107.

³⁶⁶ Abdi Baleta, Shqiptarët përballë shovinizmit serbo-grek : përmbledhje e zgjeruar e përmbledhjeve dhe intervistave, Koha, Tiranë, 1995, 128-9.

³⁶⁷ Hysamedin Feraj, Pavarësia është e shenjtë, Koha, Tiranë, 1997, 10.

³⁶⁸ Shih më tepër: Po aty, 177; Enis Sulstarova, 117. Hysamedin Fera, 1997, 141.

përfaqësuesit e sajë si Baleta dhe Feraj duke mbështetur hapur idenë e bashkimit kombëtarë dhe duke mos anashkaluar metodë, formë dhe strategji për arritjen e një qëllimi të tillë. Edhe pse me mbështetje të vogël dhe të vetëm me këtë formë ligjërimore Abdi Baleta dhe Hysamedin Feraj mbeten ndër të vetmit argumentues dhe mbështetësit e nacionalizmit shqiptarë si zgjidhja vetme për zgjidhjen e çështjes shqiptare në Ballkan.

3. Ligjërimi jugosllav ndaj çështjes së Kosovës

Ligjërimi politik Jugosllav i kësaj periudhe nuk ndryshoi qëllimin, por vetëm formën dhe metodën nga ato parapraket. Serbia kishte filluar një terror shtetërorë, një dhunë të planifikuar ndaj shoqërisë shqiptare në Kosovës. Pas rrënimit të autonomisë së Kosovës, Beogradi mori në dorë të gjitha mekanizmat institucional dhe shoqërorë në Kosovë. Me anë të aparatit ushtarako policorë mori në dorë të gjitha strukturat pushtetit në Kosovë, të cilën e legjitimonin me “tragjedinë serbe në Kosovës”. Në këtë mënyrë ajo filloi represionin ndaj të gjithë atyre që kishin penguar miratimin e amendamenteve kushtetuese, ndaj atyre që kishin shpallur Kosovën njësi më vete politike. Policia e Serbisë vazhdoi me atë që më së miri dinte ta bënte, izolimin e intelektualëve në mesin e tyre politikan, gazetarë, profesorë të universiteteve dhe krijues të ndryshëm të cilët i burgosi dhe ushtroi dhunë ndaj tyre. Sipas Oliver J. Schmit, Serbia filloi një politikë gjithëpërfshirëse të serbizimit, e cila të kujtonte masat mes dy luftërave botërore dhe ato të periudhë se Rankoviçit. Serbizimi përfshiu të gjitha fushat e jetës shoqërore, fillimisht arsimin, ku u hoqën planprogramet shqiptare dhe u zëvendësuan me ato serbe, u minimizua gjuha shqipe, gjitha mediumet u futën nën kontroll dhe gazetarët u larguan nga puna, spastrimet përfshijnë edhe jetën teatrale e kulturore, largimet e gjithanshme nga puna e pësuan edhe administrata publike dhe sektori i shëndetësisë ku gjithsej 90 përqind e shqiptarëve të punësuar në ekonominë shtetërore e pësuan.³⁶⁹ Kosovarët pësuan një lloj apartheidi shoqërorë ku shteti përmes dhunës dhe brutalitetit ushtarako policorë futi nën kontroll gjithçka publike. Ashtu siç u kishte premtuar edhe lideri Serb Millosheviç në mitingun e 28 qershorit të 1989-s të në Gazimestanit se “Serbia do të arrinte qëllimet e saja me të mirë ose me dhunë”, që nënkuptonte se Serbia do të përdorte çdo mjet për realizmin e qëllimeve të saja hegjemoniste të artikuluar më parë edhe nga akademikët dhe intelektualët Serb.

³⁶⁹ Oliver J. Schmitt, 2012, 247.

Presioni nga prania gjithnjë më e madhe e ushtrisë Jugosllave dhe policisë Serbe në vazhdimësi prodhonte emigrimin e kosovarëve jashtë vendit. Një numër i madh i shoqërisë shqiptare kaluan në vendet fqinje dhe një numër i madh i tyre në vende të ndryshme të botës nga pamundësia për t'u përballur me këtë regjim brutal që kishte për qëllim dëbimin e popullsisë shqiptare. Një numër i madh i njerëzve merreshin dhe poshtëroheshin nëpër stacione të policisë me akuza të inskenuara dhe të pa baza. Gjithashtu numër i madh ishte edhe i atyre që mbaheshin nëpër burgje me akuza të ndryshme politike. Kështu që nga instalimi i gjendjes së jashtëzakonshme përqendrimi i shtetit ishte në dëbimin e popullsisë nga Kosova, sepse siç deklaroheshin hapur ata dëshironin tokën e Kosovës dhe jo popullsinë e sajë. Miranda Vickers këtë eksod masiv të popullsisë shqiptare do të quaj "spastrim i heshtur etnik". Kështu programi i serbizimit vazhdonte të implementohej suksesshëm.

Jeta ekonomike dhe sociale ishte rënduar edhe më shumë nga metodat restriktive që përdorte shteti serb. Shqiptarët dhe serbët nuk frekuentonin më të njëjtat hapësira, ata iu shmangeshin me çdo kusht kontaktit me njëri tjetrin, frekuentonin lokale të ndryshme, përdorin mjete të ndryshme urbane. Sepse jeta shoqërore zhvillohej e ndarë në dy pjesë, nga institucionet të udhëhequra nga shteti Serb që frekuentonin pothuajse tërësisht serbët dhe institucionet të udhëhequr nga shteti paralel i Kosovës dhe që frekuentoheshin vetëm nga shqiptarët. Shqiptarët këtë gjë e bënë të mundshëm nga fondi humanitarë të krijuar në diasporë dhe iniciuar nga Qeveria e Kosovës që tashmë funksiononte në ekzil. Mirëpo, ato ishin të pamjaftueshme për plotësimin e tërësisht të nevojave të shoqërisë kosovare. Kjo gjendje u bë edhe më shqetësuese me fillimin e konfliktit të armatosur, popullsia civile, si gra, fëmijë pleq dhe të tjerë të pa armatosur dhunoheshin, ekzekutoheshin dhe masakroheshin. Këtu mund të përmendim masakrën e Reçakut, një fshat në afërsi të Shtimes, forcat policore serbe ekzekutuan dyzet e gjashtë Shqiptarë, shumë prej tyre fëmijë dhe të moshuar.³⁷⁰ Masakra e Reçakut i parapri dhe zgjoi faktorin ndërkombëtarë për të reaguar më pas për të mos lejuar më eksode tjera shoqërore.

Veprimet e atëhershme të pushtetit Serb që përmes eksodit të serbizoj Kosovën, ishin frymë politike e frymëzuar nga akademikët dhe intelektualët serbë me një mori planesh që kishin hartuar për rikthimin e "djepit të tyre Kosovën". Shteti serb përmes aparatit të saj shtetërorë nuk po zgjidhte mjetë për të realizuar këtë qëllim, fillimisht përmes diskriminimit

³⁷⁰ Shih më tepër: Petrit Imami, Serbët dhe Shqiptarët ndër shekuj Vëllimi II, 2017, 271.

sistematik duke prekur të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe kështu duke përshkallëzuar masat deri tek përdorimi i forcës, gjegjësisht brutalitetit më çnjerëzor të mundshëm. Pra, ligjërimi i tyre politik kishte vetëm një synim final, territorin e Kosovës nën sovranitetin dhe integritetin territorial të Serbisë apo të “Jugosllavisë së re” të Slobodan Millosheviqit. Mirëpo, bashkësia ndërkombëtare nuk lejua përsëritjen e një skenari të tillë dhe reagon përmes forcës ushtarake ajrore për të parandaluar qasjen “spastrimin etnik” të popullsisë dhe njëherit parandaluan ambiciet shoviniste të Millosheviqit dhe shtetit serbë ndaj Kosovës.

VII. Ligjërimi politik para dhe pas Pavarësisë së Kosovës

Shpërthimi i një lufte të hapur ndërmjet policisë dhe ushtrisë serbe nga njëra anë dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga ana tjetër ndërkombëtarizuan nevojën e domosdoshme të zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Ndërkombëtarizimi i plotë i kësaj çështjeje u bë atëherë kur serbët nisën një fushat të gjerë të spastrimit etnik, duke kryer krime ndaj popullatës civile dhe duke i detyrua ata të shpërngulen në drejtim të vendet e ndryshme perëndimore dhe fqinje. Kështu, kjo katastrofë humanitare i detyroi fuqitë ndërkombëtare të ndërhyjnë ushtarakisht pas dështimit të konferencës së paqes mes serbëve dhe shqiptarëve në Rambuje të Francës. Delegacioni serb nuk nënshkroi marrëveshjen, kësaj NATO-ja filloi luftën ajrore kundër Serbisë, e cila pas disa muajve të bombardimeve në territorin e saj e pranoi marrëveshje. Pas marrëveshjes Kosova “mbikëqyret” apo “qeveriset” nga një ekip ndërkombëtar nën mandatin e 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.³⁷¹

Intervenimi ushtarak i NATO-s kundër Serbisë më 1999 i dha fund pranisë ushtarake serbe në Kosovë. Gjithashtu, prania ushtarake dhe civile u vendos më pas sipas autorizimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Duke u mbështetur në autorizimet e kapitullit VII të Kartës së OKB-së, Rezoluta 1244 i jep Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) pushtetin më të lartë civil në Kosovë,³⁷² ndërsa forcave të udhëhequra nga NATO, siç ishte KFOR-i u jep pushtetin më të lartë ushtarak.³⁷³ Përkundër paqartësisë për statusin përfundimtar, UNMIK-u morri mbi vete funksione shtetërore. Ndonëse Rezoluta 1244 e njeh sovranitetin nominal të Republikës Federale të Jugosllavisë (RFSJ) mbi Kosovë, ajo të njëjtës i merr të gjitha veçoritë e shtetësisë mbi Kosovën. Për më

³⁷¹ Shih: Po aty, f. 312-319.

³⁷² Shih më tepër: Mandati i Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) është përcaktuar nga Këshilli i Sigurimit përmes Rezolutës së tij 1244 (1999). Misioni ka mandat për të ndihmuar në sigurimin e kushteve për një jetë të qetë dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe për të avancuar stabilitetin regjional në Ballkanin perëndimor. Mandati i UNMIK-ut, <https://unmik.unmissions.org/sq/mandati> 2. 02. 2020.

³⁷³ Shih më tepër: KFOR janë një trupë e armatosur ndërkombëtare e formuar nga bashkësia ndërkombëtare pas luftës në Kosovë me qëllim të sigurimit të armatosur të Kosovës. Formimi i kësaj trupe nën komandën e NATO-s është thirrur nga OKB-ja më 10 qershor 1999 në rezolutën 1244 me qëllim të krijimit të një hapësire sigurie për kthimin e refugjatëve të luftës. Qendra komanduese e trupës gjendet në kryeqytetin e Kosovës. NATO's role in Kosovo, http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48818.htm 2. 02. 2020.

tepër, Rezoluta e lë të hapur statusin, deri në zgjidhjen e statusit të ardhshëm.³⁷⁴ Mandati ndërkombëtar i vendosur në Kosovë ishte i përkohshëm dhe e obligonte atë në detyrën që të udhëheqë procesin politik drejt përcaktimit të statusit final të Kosovës. Kështu, gjendja ekzistuese kishte hegjemonizuar aspektin ligjërimit të partive politike dhe organizatave të shumta që fokusohen në raport me zgjidhjen e statusit të Kosovës, si shtet të pavarur dhe sovran.

Marrëdhëniet e shqiptarëve me sllavët në Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën e Serbisë në këtë periudhë kanë qenë tejet të tensionuara. Kështu, kah marsi i vitit 2000 Lugina e Preshevës (Presheva, Bujanoci dhe Medvegja) ishte bërë vatër kryesore e shqetësimit ndërkombëtar në rajon. Me këtë rast u shfaq Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit (UÇPMB) për të ndaluar shtypjen, denigrimin dhe ngritjen e statusit të kësaj popullate. Bashkësia ndërkombëtare përmes Marrëveshjes së Konçulit, imponoi një zgjidhje që parashihte amnisti për luftëtarët dhe një program të miratuar për reforma sociale dhe politike, si dhe futjen e një force policore shumetnike. Në përjashtim të disa përmirësimeve në rend, shumë pak elemente të marrëveshjes gjetën zbatim.³⁷⁵ Gjithashtu edhe shqiptarët e e Maqedonisë së Veriut vazhdimisht kanë kërkuar të ju njihet statusi i kombit shtet formues dhe të gëzonte këto të drejta thelbësore që i takonin, si përdorimi i shqipes si gjuhë e dytë zyrtare, përfaqësim proporcional nëpër të gjitha institucionet e republikës e të tjera. Pas përpjekjeve të pasuksesshme paqësore të partive politike për jetësimin e këtyre të drejtave doli në skenë Ushtria Çlirimtare Kombëtare e shqiptarëve në vitin 2001 që filloi luftën e armatosur për jetësimin e këtyre të drejtave. Pas ndërhyrjeve ndërkombëtare në gusht të këtij viti u arrit marrëveshja e Ohrit që parashikonte ndryshimet kushtetuese dhe reformat të thella për përmbushjen e kërkesave të shqiptarëve.³⁷⁶ Mirëpo, përkundër marrëveshjes dhe marrëveshjeve të tjera problemet ndëretnike mes shqiptarëve dhe “maqedonasve” akoma vazhdojnë, gjegjësisht shqiptarët akoma nuk gëzojnë të drejtat e të qenit shtet formues. Konfliktet e shqiptarëve në Luginë të Preshevës dhe të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut ishin të motivuara me statusin e

³⁷⁴ Shih më tepër: Të gjitha përgjegjësitë legjislative dhe ekzekutive që kanë të bëjnë me Kosovën, përfshirë administrimin e gjyqësisë, i takojnë UNMIK-ut dhe ushtrohen përmes Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm” (Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1. Neni.1.1).

³⁷⁵ J.Pettifer & M Vickers, Çështja shqiptare riformësimi i Ballkanit, Bota shqiptare & Edicioni Libri, Tiranë-New York, 2007, 405

³⁷⁶ Shih më tepër: Marrëveshja Kornizë Ohrit, gusht 2001.

pazgjidhur të çështjes së Kosovës, kështu në njëfarë forme të impononin edhe zgjidhjen e statusit të tyre politik që kishin shfaqur historikisht pakënaqësinë me këtë gjendje. Mirëpo, vullnetet e tyre politik u ndrydhën nga faktori ndërkombëtarë dhe mosmbështetja e gjithëmbarshme shqiptare, ato u interpretua si një luftë për të drejta më të avancuara në kuadër të republikave ekzistuese.

Në funksion të zgjidhjes përfundimtare të statusit për Kosovës palët kishin themeluar ekipet e tyre negociatore. Pala shqiptare kishte themeluar “Ekipin Negociatorë” me udhëheqës Presidentin Ibrahim Rugova. Gjithashtu pjesë thelbësore e këtij ekipi ishte platforma politike e miratuar edhe në Parlamentin e Kosovës e cila theksonte se “Pavarësia e Kosovës ishte e pa negociueshme. Ky është një lëshim që e bëjmë në emër të stabilitetit e të paqes në rajon, sepse më e mira do të ishte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë”. Ndërsa të kundërtën e sajë e deklaronte pala serbe, Kryeministri serb Kushtunica deklarohet se “Për ne, për Serbinë, pavarësia është jashtë diskutimit... Pavarësia është diçka që për autoritetet serbe jo vetëm nuk mund të pranohet, por duhet hedhur poshtë”.³⁷⁷ Pala serbe insistonte se statusi politik i Kosovës duhet të jetë një autonomi përmbajtjesore në kuadër të Serbisë. Ndërkaq bashkësia ndërkombëtare rekomandon se zgjidhja e ardhshme e statusit të Kosovës duhet të jetë në pajtime Rezolutën 1244 dhe me të drejtën ndërkombëtare, si dhe në pajtim me kufijtë aktualë ndërkombëtarë. Bashkësia ndërkombëtare përcaktoi ish-Presidentin Finlandez Martti Ahtisaari për të ndërmjetësuar në negociatat mes palës shqiptare dhe asaj serbe. Pas shumë muaj negociatash, më 2 shkurt 2007, Martti Ahtisari u dërgon Prishtinës dhe Beogradit dokumentin i cili paraqet bazën për të ardhmen e Kosovës si një shoqëri shumetnike, ku të gjithë bashkësitë, si shqiptarët, serbët dhe të tjerët duhet të jetojnë të sigurt.³⁷⁸ Dokumenti në fjalë trajtonte çështjet praktike, si decentralizimi, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare, çështjet ekonomike dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Kështu më pas, Kosova e pranon Propozimin e Martti Ahtisaarit, ndërsa Serbia e refuzon. Më 17 shkurt të 2008-ës, Kuvendi i Kosovës e shpall Kosovën shtet të pavarur dhe sovran në përputhje me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, të hartuar nga Përfaqësuesi Special i OKB-së, Martti Ahtisaari. Kosova njihet si shtet i pavarur nga shumica e shteteve më të zhvilluara të botës. Partitë politike vazhdojnë

³⁷⁷ Enver Bytyqi, 2007, 281.

³⁷⁸ Shih: Petrit Imami, Serbët dhe Shqiptarët ndër shekuj Vëllimi II, 413.

preokupimin e tyre në konsolidimin e më tejme të shtetit të Kosovës dhe përpjekjen për integrimin e sajë në institucionet ndërkombëtare.

1. Ligjërimi nacionalist shqiptarë dhe ligjërimi kozmopolit

Nacionalizmi dhe kozmopolitizmi si opsione filozofike dhe politike zakonisht trajtohen me përjashtime të ndërsjella. Mbështetësit e idesë së kozmopolitizmit shprehin kundërshtime të fuqishme ndaj të gjitha formave të nacionalizmit sepse ato janë pengesë për afirmimin e konceptit kozmopolit. Kozmopolitizmi sugjeron që ne të trajtojmë prirjet ndryshme politike dhe kulturore të individëve në formën që tejkalojnë kufijtë e shtetit komb. Konkretisht bëhet fjalë për *Kozmopolitizmin politik*³⁷⁹ që është i preokupuar në gjetjen e modeleve të reja të qeverisjes dhe institucioneve të reja politike, duke synuar gradualisht ndërtimin e rendit politik kozmopolit. Parim universal i kozmopolitizmit si ide politike ka të bëjë me zhveshjen apo depolitizimin e kombit. Kombi nuk trajtohet më si bashkësi politike, ekziston përpjekje e vazhdueshme për ta shkëputur atë nga çdo lloj ideje, doktrine apo rrjedhoje politike. Kombi në këto raste trajtohet si një realitet kulturor apo historik që po i kalon koha dhe i zhveshur nga atributet politike. Kërkohet që të bëhet dallimi midis kombit si dashuri dhe nacionalizmit si urrejtje, sepse shpresat janë të braktiset nacionalizmi, por jo kombi.³⁸⁰ Në këtë kontekst kritikuesit e vizionit kozmopolit e reduktojnë atë si koncept i mundshëm vetëm për vendet e mëdha, për vendet me stabilitet politike të qëndrueshëm, me rrënjë të forta kulturore, territoriale dhe demografike të cilët do të mund të kontribuonin për një vizionin kozmopolit. Kurse për popujt e vegjël akoma të pa konsoliduar politikisht dhe institucionalisht si shtete dhe jo mirë të formuar kulturalisht rrezikojnë deformimin kulturor dhe institucional të vendit të tyre. Këtu mund t'ju referohemi elitës politike të shtetit të Kosovës që është orientuar tërësisht në integrimin e institucioneve transnacionale duke lënë tërësisht anash agjendën politike nacionale, integrimin dhe konsolidimin institucional përbrenda nacional.

Gjithashtu perspektiva kozmopolite përballat me një kritik tjetër të rëndësishme, sepse ajo gjithnjë ka një qëllim politik konkret dhe ky është forcimi i nacionalizmit të kombit më të

³⁷⁹ Shih më tepër në kapitullin e parë, trajtimin e kozmopolitizmit kulturor, etik dhe politik.

³⁸⁰ Enis Sulstarova, *Ligjërimi Nacionalist*, 2003, 13.

madh në numër dhe kështu të ndikoj në eliminimin e kombeve të tjerë në dobi të kombit më të madh. Kështu kjo kritik dhe të tjerat na kthejnë në retrospektivën e alternativave të nacionalizmit demokratik si mundësi. Kjo nënkupton afirmimin e kombit si e drejtë, si vlerë morale, ku përmes sundimit të ligjit ndërtohen raport korrekte për të gjithë qytetarët. Sipas F. Muhiq-it Nacionalizmi demokratik i plotësuar me elemente të nacionalizmit liberal, si liria individuale, drejtësia sociale, nacionalizmi përbën zgjedhjen më të mirë kundrejt kozmopolitizmit.³⁸¹ Pra është e kundërta e asaj që dëshirohet të etablohet në opinionin publik, se nacionalizmi atakon demokracinë apo këto nuk përputhen me njëra tjetrën, dhe sa më pak nationalist që të jemi aq më demokratik do të jemi dhe më afër aksiologjikisht me vendet më demokratike apo Evropës do të jemi.

Në këtë pjesë të do të trajtohen ligjërimin nationalist shqiptar dhe ligjërimin kozmopolit që shfaqet në trajtën e një “teorie të kosovarizmit” të ideuar mbi konceptin shoqërisë multietnike dhe të idesë se “shtetit ndërton kombin”, projektin e “kombit kosovarë”. Mbështetësit e opsionit nationalist shprehin rezistencë të fuqishme ndaj gjitha formave të kozmopolitizmit, kështu identitetin kosovar të promovuar si identitet politik dhe nacional e konsiderojnë si inxhinering artificial, të pa mundshëm, gjithashtu bashkimin kombëtar e shohin prioritet ndaj nismave për integritet rajonale, evropiane apo globale. Ligjërimin nationalist kombin e sheh në epiqendër të politikbërjes dhe politikveprimit, që së fundmi është bërë i dukshëm tek disa subjekte politike shqiptare. Shfaqja e ligjërimin nationalist shqiptar, si nga partitë politike ashtu edhe nga struktura të tjera kulturore e organizatave, artikullohet si manifestim i pakënaqësisë së “establishmentit ndërkombëtar” dhe menaxhimit të tyre të dobët. Gjithashtu nga teoretizimi që i bëhet asaj, na bënë të nënkuptojmë se kjo linjë ligjërimore është rrjedhë e trashëgimisë nationalist e pa shkëputur nga narracioni historik kombëtarë shqiptarë.

Në anën tjetër, mbështetësit e ligjërimin kozmopolit, argumentojnë se realiteti Kosovar është një realitet i ri dhe si i tillë është i shkëputur nga rrethanat politike dhe rrjedhat historike të Shqipërisë. Në këtë kontekst, Kosova do të duhej të zhvillohej si një shtet i ri Evropian, me kulturë dhe identitet politik të mëvetësishëm apo siç shpesh e proklamojnë si

³⁸¹ Shih më tepër: Ferid Muhiq, E përmuajshme mbarëkombëtare politike, ekonomike dhe kulturore, Revista Shenja, Viti VI, Nr.67, Nëntor, 2016.

projekt të sponsorizuar nga BE-ja dhe SHBA-ja. Ky ligjerim i referohet vazhdimisht rëndësisë së integritit në organizatat mbinacionale si BE, NATO dhe nismave të tjera rajonale kundrejt integritit brenda kombëtarë. Siç argumenton edhe Anthony D. Smith se kjo qasje nuk mbron rolin historik të shtetit kombëtarë, por kërkon ta depolitizojë atë, kërkon ta bëjë të pa dëmshëm, në të mirë të segmenteve më të gjëra të njerëzimit, duke e kthyer kombin në një dukuri të kulluar kulturore apo folklorike, të zhveshur prej gjithë domethënies politike. E përbashkëta e të gjitha këtyre rrugëve është ideja e shqitjes së kombit prej fushës politike dhe kthimit të tij në sferën kulturës dhe të shoqërisë civile, një ide e tillë e tradhton një moskuptim serioz të natyrës së nacionalizmit. Kjo formë ligjërimore zotron pothuajse tërë rrafshin politikës aktuale, e sidomos te periudhës së para dhe pas pavarësisë së Kosovës. Këtu dominon gjuha i integritetit në institucionet ndërkombëtare kundrejt bashkimit ndër shqiptarë, apo fraza e mirënjohur tashmë se bashkimi i shqiptarëve mund të bëhet vetëm në Bashkimin Europian me integrimin e gjithë shqiptarëve në familjen europiane. Pra ligjerimi politik në Kosovë është në përplasje të fortë me historinë dhe sakrificën e gjatë të popullit shqiptarë dhe represionit të huaj për ta orientuar atë në një histori suksesei në arenën ndërkombëtare.

2. Koncepti “multietnik” i shtetit dhe fokusi pan-europian i tij

Vendosja e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në formën e një “protektorati”, “mbikëqyrësi”, “rregullatori” apo “udhëheqësi” si fazë transitore për tek statusit final i Kosovës, kishte për qëllim të organizonte zhvillimin e institucioneve të përkohshme drejt një qeverisje autonome. Asaj iu dha mandati për të ndërtuar institucione kredibile që populli i Kosovës të qeveriste veten, në mënyrë që të krijohen kushtet për zgjidhjen finale të statusit të Kosovës. Pra, esenca kryesore e këtij misioni ishte, ajo që zyrtarët e sajë e përsërisnin shpesh “ta transformonin Kosovën në një shoqëri, në të cilën të gjithë prestatë e sajë do të jetonin të sigurt dhe me dinjitet”. Në njëfarë mënyre ajo vente në “test” shoqërinë kosovare për formën e orientimit politik dhe institucional të tyre. UNMIK-u në esencë nuk e “paragjykonte” statusin final të Kosovës, sepse një gjë e tillë do të përcaktohej pasi që institucionet vetëqeverisjes të ishin ndërtuar, atëherë kur bashkësia ndërkombëtare të kishte vlerësuar nëse ishin pjekur kushtet për një gjë të tillë. Në njëfarë forme misioni i sajë dhe i trupës ndërkombëtare kishte për mision “bërjen” e Kosovës vend të pranuar dhe të jetueshëm për të gjithë komunitetet që ndodhen në të. Ajo angazhohej

për krijimin e një identiteti të përbashkët mbietnik, për krijimin e një shoqëri, në të cilën ndasitë e vjetra janë pak të rëndësishme, se sa interesat e reja të përbashkëta. Iain King dhe Whit Mason theksonin se përmes presionit, gjegjësisht presionit diplomatik, financiar dhe ushtarak si dhe entuziazmit për perspektivën e integritit evropian, si faktorë bindës i shtyejn përpara politikat të nevojshme për të “bërë” e shoqërinë shumetnike të mundshme.³⁸² Këtë e pohon edhe Mehmet Kraja se që nga viti 1999, në emër të tolerancës dhe frymës integruese, në Kosovë kishte filluar eksperimenti më i madh i krijimit të një shoqërie pa identitet nacional. Arsyeja e tejkalimit të identitetit duhej të sillte një frymë të re në Ballkan, sepse sipas perëndimorëve identiteti nacional në gadishullin konfliktor ishin një nga shkaqet e luftërave dhe tragjedive që kishin ndodhur. Në rastin e Kosovës gjetja quhej tolerancë multietnike, njësoj sikurse në kohën e jugosllavizmës, dhe pa i hequr asnjë detaj konceptit të vëllazërim-bashkimit e përkthyer në tolerancë multietnike.³⁸³

Në këtë kontekst qëndrimi i palës shqiptare ishte unik, ai konceptohej nga Grupi Negociator³⁸⁴ i dekretuar nga Presidenti i Kosovës dhe me platformën e sajë të miratuar në Parlamentin e Kosovës. Për palën shqiptare “Pavarësia e Kosovës është e panegociueshme. Ky është një lëshim që e bëjmë në emër të stabilitetit e të paqes në rajon, sepse më e mira do të ishte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë”. Ky qëndrim përqafohej nga të gjithë negociatorët e Kosovës, përjashtuar pakicën serbe në Kosovë që koordinohet me shtetin Serb dhe ishte kundër çfarëdo lloj pavarësie për Kosovën, sepse synonte ruajtjen sovranitetin të Serbisë mbi Kosovën. Në këtë platformë mbi bazën e së cilës do të negociohej statusi i ardhshëm i Kosovës, ishin tre parime mbi të cilat nuk do të pranohet të negociohet: së pari, Kosova nuk do të lejohej që të ndahej dhe territori i saj nuk do të lejohej të tjetërsohej; së dyti, do të ishte i ndaluar bashkimi i sajë me një vend tjetër kufitar; së treti, nuk do të lejohej rikthimi i statusit të paraluftës.³⁸⁵ Gjithashtu, edhe Presidenti Ibrahim Rugova, njëherit edhe kryetari LDK-së deklaronte se pavarësia e Kosovës është “një kompromis dhe optimum i të gjithë shqiptarëve në rajon, e them edhe tani, sepse ne nuk kemi kërkuar bashkim me Shqipërinë që do të krijonte probleme të reja. Prandaj një Kosovë

³⁸² Iain King dhe Whit Mason, që të dy kishin punuar për UNMIK-un nga periudha 200-2004. Shih më tepër; Iain King dhe Whit Mason, Paqe me çdo kusht, si dështoi bota në Kosovë, Koha, Prishtinë, 2007, 246.

³⁸³ Mehmet Kraja, Identiteti Kosovarë, 445.

³⁸⁴ Udhëheqës i Grupit Negociatorë ishte Presidenti i vendit Ibrahim Rugova, Kryetari i Parlamentit Nexhat Daci, Kryeministrit Bajram Kosumi, Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës Hashim Thaçi dhe Kryetari i Partisë Ora Veton Surroi. Koordinator i këtij grupi ishte përcaktuar publicisti Blerim Shala.

³⁸⁵ Shih më tepër: Enver Bytyçi, 2007, 279, 283.

e pavarur do të qetësonte këtë pjesë të Evropës e botës, një Kosovë në Bashkimin Evropian, në NATO dhe në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës”.³⁸⁶

Koncepti i Pavarësisë ishte në themel të çdo kërkesë nga lidershipi politik i Kosovës. Ajo ishte në gjendje të gëlltiste çfarëdo “të mete” në aspektin përmbajtjesor dhe kushtetutorë të statusit të ardhshëm të Kosovës përpos mungesës së pavarësisë. Lidershipi politik i Kosovës në njëfarë forme predeterminedonte një “identitet ndryshe” nga ai shqiptarë, sepse vetëparandalonte mundësinë e bashkimit të Kosovës me një shtet fqinjë, pra qoftë ai edhe Shqipëria. Kosova ishte e gatshme për një “identitet të ri” politik që do ta dallonte dhe identifikonte atë si të ndryshëm nga çdo vend tjetër i rajonit. E panegociueshme për të ishte edhe rruga e sajë në proceset euroatlantike, kështu Kosova ishte e mbyllur për Shqipërinë dhe e hapur, gjegjësisht me interes për të qenë pjesë e Bashkimit Europian dhe NATO-s. Në këtë formë Kosova determinon statusin dhe rrugën e sajë politike si të ndryshme nga vendet e tjera të rajonit.

Kështu dhe ndodhi kur Sekretari i përgjithshëm i OKB-së Martti Ahtisaari pas udhëheqjes së bisedimeve midis Prishtinës dhe Beogradit për statusin e Kosovës, kishte paraqitur një propozim gjithëpërfshirës për zgjidhjen e çështjes së statusit të Kosovës. Në radhë të parë, specifikoi statusin dhe rolin e bashkësisë serbe në Kosovë. Propozimi theksonte një decentralizim të gjerë, i cili specifikisht kishte të bëjë me bashkësinë serbe në Kosovë, që parashihte krijimin e komunave të reja me një autonomi të gjerë komunale. Pikë tjetër kishte të bënte me mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë fetare dhe kulturore të komunitetit serb në Kosovë. Për më tepër, ky propozim përkufizonte Kosovën si shoqëri shumëetnike, gjegjësisht Kushtetuta e sajë duhet të jetë shoqëri shumëetnike, e cila qeveriset në mënyrë demokratike, dhe me respektimin të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të vetë legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Në këtë kontekst, ajo çka e legjitimonte identitetin e ri të Kosovës ishin simbolet e veçanta kombëtare, duke përfshirë flamurin, stemën dhe himnin, të cilët duhet me çdo kusht të pasqyronin karakterin shumë etnik të sajë. Gjuha zyrtare në Kosovë duhet të jetë gjuha shqipe dhe gjuha serbe. Ndër të tjera, Kosova nuk do të ketë pretendime territoriale ndaj asnjë shteti apo pjesë të ndonjë

³⁸⁶ Platforma e Grupit Negociator të Kosovës është Pavarësia, <https://www.evropaelire.org/a/1010479.html>, 06 tetor, 2005.

shteti dhe nuk do të kërkoj bashkim me asnjë shtet apo pjesë të ndonjë shteti dhe të tjera propozime të rëndësishme mbi të cilat duhet ndërtuar Kushtetuta e Kosovës.³⁸⁷

Martti Ahtisaari kishte parashikuar “pavarësi të vëzhguar” për Kosovën, term ky i papërdorur ndonjëherë në fjalorin e shkencës së marrëdhënieve ndërkombëtare. Kosova si një shtet relativisht i pavarur nga Serbia, do të vazhdojë të vëzhgohet nga ndërkombëtarët për formën e procedimit të shtetësisë së sajë. Ajo që ishte e qartë për të gjithë, Kosova do të fitonte pavarësinë bazuar mbi këtë planë, mirëpo nuk e shkëpuste plotësisht Kosovën nga sovraniteti i Serbisë. Një pjesë e popullsisë së sajë, gjegjësisht serbët si dhe territori ku jetojnë ata, do të gëzonin sovranitet të dyfishtë, kështu do të “drejtoheshin” nga Prishtina dhe Beogradi njëkohësisht. Ky ishte ndër shqetësimet e mëdha të shtetit, sepse serbëve u jepte një pozitë të fuqishme dhe të privilegjuar në aspektin politik dhe juridik, si dhe fuqi e përgjegjësi asimetrike në krahasim me komunat e tjera në Kosovë. Pakoja e Ahtisarit e përkthyer në Kushtetutë e njëj Kosovën si shoqëri shumëetnike, duke sakrifikuar 95% të shoqërisë shqiptare në dobi të 5% të shoqërisë serbe, kështu ajo anashkalon çdo segment të kombit, historisë dhe kulturës kombëtare shqiptare. Në anën tjetër, po kjo pako, e legjitimuar dhe e pranuar unanimisht nga institucionet e Kosovës, e njëj identitetin kombëtar të serbëve, historinë, traditën, kishat, manastiret dhe tërë trashëgiminë e saj kolonialiste e hegjemoniste mbi Kosovën. Kështu, Kushtetuta e Kosovës e konsideron pakicën serbe si shtet formuese me afro 5% të popullsisë, dhe përkundër privilegjeve të shumta që siguron ajo, pala serbe nuk e ka pranuar atë, duke kërkuar që e tërë Kosova të mbetet edhe më tej koloni e Serbisë.

Kosovës si shoqëri multietnike, determinohet njëherit si shtet me identitet politik më vete, që nënkupton se Kosova e pavarur nuk është shtet nacional i shqiptarëve, kështu mund të themi se nacionalizmi shqiptarë nuk është në thelb të ndërtimit të shtetit. Projekti i pavarësisë përkundër aspekteve kalkulative gjatë rrugës mund të konsiderohet si akt i motivuar nga parimet dhe motivet nacionaliste, mirëpo aspekti përmbajtjesorë i sajë e zhveshë atë nga ky parim. Në këtë gjendje, Kosova e kishte përgatitur rrugën që në asnjë rrethanë të mos bëhej Shqipëri, gjithashtu dhe të heqë nga agjenda politike çështjen e bashkëngjithjes me shtetin amë. Mehmet Kraja shkruan se Kosova me identitet të ndryshuar, me identitet joshqiptarë do të lidhej sa me Shqipërinë, po aq edhe me Serbinë, gjithmonë

³⁸⁷ Petrit Imami, Serbët dhe Shqiptarët ndër shekuj Vëllimi II, Samizdat B92, 2017, 416

duke krijuar një mundësi Serbisë që ta ushtroj ndikimin e saj në Kosovë, dhe që nga dita e parë, ta bëjë Kosovën shtet jofunksional.³⁸⁸ Në një linjë të njëjtë të mendimit qëndron edhe autori Milazim Krasniqi, kur shkruan se Kosova e pavarur nxjerr jashtë kalkulimeve nacionaliste çështjen shqiptare, sepse kjo formë e shtetit, mbyllë rrugën e bashkimit me Shqipërinë.³⁸⁹ Projekti i Pavarësisë së Kosovës u bë në partneritet të plotë me ndërkombëtarët, sepse një gjë të tillë e obligonte Marrëveshja e Rambujesë, intervenimi i NATO-së dhe misionet e ndërkombëtare. Kështu, ndërkombëtarët që nga fillimi ishin të përkushtuar për gjetjen e një zgjidhjeje që do të shuante pakanqësitë e palëve në konflikt, duke imponuar dekombëtarizimin e kësaj shoqërie nga identifikimi kombëtar shqiptarë në dobi të të gjithë nacionaliteteve përbërëse. Për më tepër M. Krasniqi thekson se “Shteti i Kosovës është denacionalizuar nga politikat e UNMIK-ut, KFOR-it, EULEX-it dhe gjithë agjencive e faktorëve ndërkombëtarë që punojnë në këtë vend që nga viti 1999.”³⁹⁰ Në këtë rrjedhë mund të themi se projekti i shtetit të Kosovës i imponuar nga aktet dhe misionet e ndryshme ndërkombëtare është legjitimuar nga lidhshipi politik shqiptarë me kushtin e të qenit i pavarur. Pra, të qenit i Pavarur dhe shoqëri multietnike, me pamundësinë e bashkëngjites së ndonjë shteti tjetër në rajon, i imponon Kosovës aspektin ligjërimitorë ideologjik pan-europian. Kosova tashmë me një “identitet të ri” politik, të “kombit shumetnik” apo “kombit kosovarë”, do të jetë e përkushtuar në plotësimin e kriterëve për t’u anëtarësuar në Bashkimin Europian, NATO-n, OKB-në dhe institucione tjera ndërkombëtare.

Kështu, lidhshipin politik i post pavarësisë vazhdon konsolidimin e shtetit multietnik të Kosovës dhe përpjekjen e sajë për anëtarësim në institucionet ndërkombëtare si kauza të vetme të shtetit të Kosovës. Këtë orientim ligjërimitorë e dëshmojnë edhe programet e partive politike, impenjimi i institucioneve të Kosovës, strategjitë ndryshme qeveritare, shoqëria civile e të tjera. Pra, dominon orientimi ligjërimitorë pan-evropian me nuanca të kozmopolitizmit kundrejt ligjërimeve tjera politike. Në epiqendër të këtij ligjërimit nuk është kombi shqiptarë, por aspekti konstitucional i shtetit të Kosovës. Këtu mund të ju referohemi programeve të partive politike më të rëndësishme të kohës dhe orientimin e tyre ligjërimitorë të drejtuara kah proceset integruese. Programin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK)

³⁸⁸ Mehmet Kraja, Identiteti Kosovar, 450.

³⁸⁹ Shih më tepër: Milazim Krasniqi, Nacionalizmi Shqiptarë, 2017, 69.

³⁹⁰ Po aty, 70.

rëndësi të posaçme i kushtohet integritimeve të Kosovës në familjen Evropiane. Kosova, si një shtet i ri evropian, ndihet pjesë e familjes evropiane dhe, si e tillë, kultivon vlerat e paqes, demokracisë, prosperitetit, zhvillimit dhe bashkëpunimit rajonal. Ajo angazhohet për arritjen e kriterëve të përcaktuara nga BE-ja për integrimin e Kosovës. LDK-ja integrimin e Kosovës në BE e sheh si një projekt me rëndësi vitale për qytetarët dhe për shtetin e Kosovës dhe beson se procesit të 'evropianizimit' të Kosovës, duhet t'i prijë 'evropianizimi' i partive politike, institucioneve dhe shoqërisë kosovare. Për më tepër, ajo beson se integrimi i Kosovës dhe i Ballkanit Perëndimor në BE sjell paqe, prosperitet dhe stabilitet për këtë pjesë të Evropës.³⁹¹ LDK-ja bashkëpunimin ndër shqiptarë e sheh në kuadër të proceseve integruese rajonale dhe evropiane, gjegjësisht "parimet e saj i mbështet në stabilitetin politik rajonal dhe në perspektivën integruese".³⁹² Për më tepër këtu mund të ju referohemi edhe kandidates për Kryeministre të Kosovës e dominuar nga LDK-ja për zgjedhjet e 6 tetorit 2019, Vjosa Osmani, e cila thotë se "e para, bashkimin e Kosovës me Shqipërinë për momentin nuk e shikoj si një alternativë e cila mund të bëhet. Për shumë arsye, sepse dy shtete do jenë pjesë e BE-së. E dyta, për ne si LDK republika e Kosovës është projekt i përhershëm dhe e treta është se unë i shoh të dyja vendet si të suksesshme në komunitetin ndërkombëtar, në komunitetin e vendeve të lira. Nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën."³⁹³ LDK-ja Kosovën e sheh si një projekt të përhershëm dhe me të ardhme në bashkimin evropian Kosovën, për më tepër që të dy vendet si Kosova dhe Shqipëria do të jenë pjesë e komuniteteve të lira, pra në Evropë.

I ngjashëm është edhe vizioni i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në statutin e së cilës thuhet se PDK-ja ka për qëllim integrimin sa më të shpejtë të Republikës së Kosovës në strukturat euro-atlantike dhe përfaqësimin dinjitoz të saj kudo në botë. Vizioni i PDK-së është bërja e Kosovës shtet krenar dhe Evropian.³⁹⁴ Gjithashtu edhe kryetari i sajë dhe njëherit i nominuari për kryeministër të Kosovës nga kjo parti thekson se "Shqipëria dhe Kosova do të bashkohen të dyja në Bashkimin Evropian".³⁹⁵ Pavarësisht se origjina e PDK-së

³⁹¹ Programi i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

³⁹² Po aty.

³⁹³ Vjosa Osmani kundër Albin Kurtit për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë: Kosova, projekt i përhershëm; Publikuar me 13 Nëntor 2019; <https://ballkani.info/vjosa-osmani-kunder-albin-kurtit-per-bashkimin-e-kosoves-me-shqiperine-kosova-projekt-i-perhershem/>, 2. 12. 2019.

³⁹⁴ Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës.

³⁹⁵ Kadri Veseli: Kosova dhe Shqipëria do të bashkohen, 27 Maj 2017; <https://lajmi.net/kadri-veseli-kosova-dhe-shqiperia-do-te-bashkohen/>, 2.12.2019.

vjen nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ajo angazhohej për legjitimin e konceptit të shtetit të Kosovës, si identitet më vete dhe me vizion evropian. Ligjërimi i sajë politik nuk del jashtë konjunkturave shtetërore dhe konstitucionale të shtetit të Kosovës. Me të njëjtin diskurs ligjërimorë shprehet edhe e Kryeministri i tanishëm i Kosovës dhe njëherit kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) se “ne jemi të interesuar të krijojmë vetëm fqinjësi të mirë me të gjitha shtetet. Jemi me i respektua fqinjët ashtu sikurse e dini marrëdhëniet me Maqedoninë Veriut, Malin e Zi, Shqipërinë janë të mira, po vështirësitë janë me Serbinë, por është çështje e vendimit për respektim të ndërsjellë të kufijve ekzistues nga Serbia duke e njohur pavarësinë e Kosovës.”³⁹⁶ Aspekti Kushtetues me esencë “kosovarizmin” si identitet më vete ndodhet në qendër të konsolidimit të brendshëm dhe institucional të shtetit të Kosovës. Për jetësimin e këtij koncepti shtetërorë janë angazhuar të gjitha partitë politike qeverisëse të pas pavarësisë së Kosovës. Përkundër idealeve të para luftës, që shoqëria shqiptare në Kosovë ishte angazhuar me tërë qenien e tyre për bashkëngjitje me Shqipërinë, tani një ideal i tillë shihet si i “tejkaluar” nga kjo klasë politike. Kështu, objektiva tani ishin drejt projekteve “më të mëdha” politike, siç janë integrimi në Bashkimin Evropian, në NATO e të tjera.

Republika e Kosovës dhe institucionet e saja kanë hartuar madje edhe një sërë strategjish për gjetjen e mënyrës më të shpejt për integrimin e Kosovës në institucionet ndërkombëtare, sepse identiteti i sajë i vërtetë realizohet në kuadër të projektit evropian. Ato i referohen prioriteteve politike, siç janë përcaktuar në “strategjinë e zgjerimit” si ato në fushën e reformave politike, zhvillimit ekonomik dhe social, forcimit të integritetit rajonal dhe bashkëpunimit territorial, avancimit të të drejtave të komuniteteve, respektimit të ligjit dhe zhvillimit të demokracisë në vend dhe të tjera. Këtu mund të përmendim Strategjinë Kombëtare për Integrimin Evropian “Kosova 2020” të hartuar nga Presidenti i Kosovës, i cili pasqyron vizionin dhe qëllimin e Kosovës për të përshpejtuar procesin e integritetit evropian dhe trajton mangësitë serioze me të cilat Kosova ende po ballafaqohet, si dhe shtjellon synimet që ne synojmë t’i arrijmë për ta afruar Kosovën me BE-në.³⁹⁷ Në raport me integritetin ndërkombëtar mund të ndryshojë vetëm formulimi dhe modeli i strategjisë që

³⁹⁶ Thaçi për “bashkim kombëtar”, Haradinaj për fqinjësi me Shqipërinë, 27 Maj 2019; <https://www.gazetaexpress.com/thaci-per-bashkim-kombetar-haradinaj-per-fqinjesi-me-shqiperine/>, 2.12.2019.

³⁹⁷ Shih më tepër: Strategjia Kombëtare për Integrimin Evropian “Kosova 2020”, <https://www.president-kgov.net/repository/docs/StrategjiaKombetareIntegrimEvropian.pdf>, 2. 12. 2019.

do të ndjekin Qeveritë, një qasje të tillë kanë aplikuar të gjitha Qeveritë e pasluftës dhe paspavarësisë në Kosovë. Këtu mund të ju referohemi edhe Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, i cili thekson se “synimi ynë është integrimi në Bashkimin Evropian. Kosova do të bëhet BE, duke kryer me përkushtim detyrat e shtëpisë në të mirë të jetës së secilit qytetar të Kosovës”, gjithashtu “Kosova, pa asnjë dilemë, synon anëtarësimin në NATO”.³⁹⁸

Të gjitha Partitë Politike, përjashtuar Lëvizjen Vetëvendosje që do të trajtojmë më poshtë, mendojnë fuqizimin e shtetit multietnik të Kosovës, ku të gjithë do të jetonin të barabartë sepse kjo do t'i afronte edhe më shumë drejt perspektivës evropiane si synimi kryesorë i partive politike dhe të gjithë udhëheqëseve të deritanishme të Republikës së Kosovës. Karakteristikë e këtij ligjërimi është mungesa e parafytyrimit të kombit shqiptarë si bashkësi politike, ai trajtohet si një realitet historik që i ka “kaluar koha” dhe i zhveshur tërësisht nga atributet politike. Kjo qasje depolitizuese ndaj kombit shqiptarë ka për qëllim ta bëjë atë të padëmshëm dhe në të mirë të “shtigjeve të reja” të njerëzimit. Pra, Kosova e transformuar nga një shoqëri dominante shqiptare në një shoqëri multietnike, vazhdon të projektoj të ardhmen drejt një shoqërie botërore, apo kozmopolite.

Ligjërimi nacionalist shqiptarë konsideron se për të tjetërsuar rrugën bashkimit të kombit shqiptarë janë shpikur projekte të shumta dhe situata nga më absurde të mundshme. Kështu ndërtimin konstitucional të idesë së shtetit të Kosovës me premisën si “komb multietnik” nënkupton bjerrjen e mëtejme nga ideja e shqiptarizmit. Këtu mund të përmendim Abdi Baletën njërin nga artikulesit më besnik të ligjëritimit nacionalist shqiptarë, i cili thotë se projekti për hibridin e “kosovarizmit” është një eksperiment i keq ndër-kombëtarë, që bëhet në Kosovë për shndërrimin e kombit të formuar historikisht në shoqëri amorge multietnike. Kjo u shkakton një dëm të madh shqiptarëve, sepse i largon edhe më shumë se deri tani pjesët e ndara të kombit të tyre, pra i çon drejt zhbërjes, jo drejt përsosjes së organizimit kombëtar shqiptarë.³⁹⁹ Këto projekte i ngjajnë projekteve të mëparshme të ish-Jugosllavisë ku përmes imponimit të modeleve të tyre përpiqeshin të tjetërsonin kombin, identitetin dhe qëllimin sublim të shqiptarëve.

³⁹⁸ Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, shtator, 2017. https://www.min-rks.net/repository/docs/programi_i_geberise_se_republikes_se_kosoves_2017_2021.pdf 14.12.2019.

³⁹⁹ Abdi Baleta, Udhëkryqe politike shqiptare, 372.

3. Kosova dhe ideja e shteti si “pronar” i kombit

Shpallja e Kosovës shtet mbi identitetin territorial të shtetit po shqyrtohet dhe promovohet nga disa analist dhe udhëheqës publik si “komb” kosovarë, apo idenë se shteti është pronar i kombit. Në pronësi të shtetit është kombi dhe i takon shtetit të “shpik” apo ta “transformoj” kombin për të ndërtuar hegjemonitetin shtetërorë, ndryshe nga pikëpamja moderne se kombet janë pronar të shteteve apo kombet krijojnë shtetin. Mbështetësit e kësaj pikëpamje janë individ të caktuar analist dhe studiues si Nexhmedin Spahiu, idenë e së cilës e ka trajtuar në shumë shkrime publicistike dhe më pas të përmbledhur në vepra si, “Drejt Kombit Kosovarë”, “Foshnjëria e Kombit Kosovarë”, “Ngritja e Kombit Kosovarë”, e të tjera shkrime, gjithashtu dhe publicisti Halil Matoshi me disa shkrime dhe analiza publicistike.

Sipas autorëve të lartë përmendur teorinë mbi kombin përpiqen të argumentojnë duke u bazuar në atë se edhe shteti krijon kombin, për këtë përdorin argumentet se shtetet kanë ekzistuar edhe në mesjetë edhe në antikë atëherë edhe kur kombet nuk kanë ekzistuar. Sipas Nexhmedin Spahiut, në Mesjetë, pronar të shteteve kanë qenë mbretërit, perandorët, sulltanët, kanat, shahët raxhët e të tjerë, ndërsa në kohën moderne, pronarë të shteteve janë kombet. Në një far forme ai aludon se Shteti medoemos duhet të ketë në pronësi kombin, pavarësisht nëse kësaj i paraprinë shteti. Ai këtë e argumenton edhe duke ju referuar Organizatës së Kombeve të Bashkuara, sepse ajo nuk është një organizatë quhet Organizata e Shteteve të Bashkuara. Pra, sipas tij, kombet qofshin monoetnike apo multietnike, monofetare apo multifetare, monoracore apo multiracore janë pronarë të shteteve moderne, dhe se vetë ekzistenca e një shteti është dëshmi e ekzistencës së një kombi përkatës.⁴⁰⁰ Në këtë kontekst mund të ju referohem edhe Halil Matoshin njërit nga ata që pretendon se kombi kosovar është produkt i shtetit dhe se me kalimin e kohës ai do të rikonfigurohet si komb me tipare të plota. Sipas Halil Matoshit: “...në kushte normale, popullsia në territorin e Republikës së Kosovës, si rezultat i zhvillimeve shoqërore do të evoluonte në kategorinë më homogjene shoqërore të quajtur komb, në këtë rast kosovar”. Për më tepër, Kosova është ngjizur në komb gjatë tërë shekullit 20, kurse më 17 shkurt e ka

⁴⁰⁰ Nexhmedin Spahiu, Ngritja e Kombit Kosovar, Prishtinë, 2017, 120.

shpallur shtetin kombëtar, ndërsa maturimi i kombit do të bëhet kur ajo të bëhet pjesë e OKB-së.⁴⁰¹

Në Kosovë, përkatësia etnike e shumicës është shqiptare, në këtë kontekst i bie që shqiptarët janë titullar të kombit kosovar. Mirëpo, të kundërtën e sajë e thotë N.Spahiu, se mbi bazën e një etnie ka raste që u krijuan dy e më shumë kombe dhe ka shumë kombe shumë etnike. Kështu, ai argumenton se është kundër përkufizimit të J.G Fichtes i cili thoshte se çdo popull që flet një gjuhë të veçantë ka të drejtë të ketë shtetin e vet, me një fjalë çdo etni duhet të jetë një komb.⁴⁰² Ngjashëm e artikulon e Halil Matoshi, për më tepër ai pohon se gjuha dhe feja nuk janë elemente të vetme përcaktuese për krijimin e kombeve, duke i artikuluar ato si relative në këtë raport. Ai shkruan se “Përderisa etnia është konstantë, kombi është variabël. Kombi shqiptar është krijuar nga Rilindja si komb i gjuhës shqipe. Por gjuha as dhe religjioni nuk janë përcaktues të vetëm për kombkrijim. Kombi brazilian flet portugalisht kurse ai Meksikan flet spanjisht. Për me u ngjizë një komb duhet të ekzistojnë disa parakushte si vetë-njohja dhe njohja nga të tjerët, i një bashkësie njerëzish që ka një identitet të fortë, që ka përvetësuar “traditat e shpikura”; figurat unifikuese, kohezioni shoqëror dhe historia të përbashkët pastaj duhet të ekzistoj një lëvizje çlirimtare dhe kombformuese,”⁴⁰³

Shteti i Kosovës ka lindur nga konflikti, gjegjësisht nga shpërbërja e një konstruksioni federalist, të modelit sovjetik, lëvizja kombformuese kosovare ka nisë artikulumin e tyre gjatë viteve 1968 – 1981 për Republikë, kurse gjatë viteve 90-ta ka avancuar në synimin për shtet sovran e demokraci dhe se asnjëra nga këto lëvizje, nuk e kishin bashkimin me Shqipërinë, në programet e tyre politike. Ky komb tashmë njihet edhe nga të tjerët, gjegjësisht nga kombet tjera rreth 120 kombe të botës, posedon simbolet e veta kombëtare, ushtrinë kombëtare, (neni 126 i Kushtetutës), kombëtares e futbollit anëtar i FIFA’s dhe Komitetit Olimpik Ndërkombëtar dhe merr pjesë në garat ndërkombëtare, posedon

⁴⁰¹ Pirro Prifti, “Kombi Kosovar”, një projekt anti-kombëtarë; 25/10/2016, <https://sot.com.al/opinion-editorial/“kombi-kosovar”-një-projekt-anti-kombëtar>, 2. 12 2019.

⁴⁰² Nexhmedin Spahiu, 2017, 133.

⁴⁰³ Halil Matoshi: Kombi kosovar nuk ka lindur sot, i ka fillesat që nga lëvizja e vitit 1968, 23/11/2019, <https://gazetametro.net/halil-matoshi-kombi-kosovar-nuk-ka-lindur-sot-i-ka-fillesat-qe-nga-levizja-e-vitit-1968/> 3.12.2019.

dokumentet identitare, ndërkombëtarisht të njohura dhe elemente të tjera që posedojnë kombet.⁴⁰⁴

Ligjërimi politik artikulon kombin kosovarë mbi bazën kushtetuese të shtetit të Kosovës, si shtet multi-etnik, dhe mbi idenë e kombeve si koncepte imagjinare dhe konstruksione artificiale. Ideja e krijimit të kombit në emër të shtetësisë dhe përpjekja për të legjitimuar atë si një projekt ndërkombëtar, është një përpjekje për të “transformuar” identiteti shekullor shqiptar, të shkëputur nga historia, tradita e kultura shqiptare, gjegjësisht për ta depolitizuar atë nga aspirata për bashkim kombëtarë. Kështu, ligjërimi nacionalist anatemon këtë ide si ide përçarëse dhe tendencioze dhe se shteti i Kosovës është vetëm një konstruksion i përkohshëm deri në arritjen e bashkëngjitjes së tij me Shqipërinë. Gjithashtu, kjo ide bie ndesh edhe me parimet apo teoritë e komb-formimit, siç e kemi artikulluar edhe në kapitullin e parë, se kombet formohen para themelimit të shtetit dhe se shteti është produkt i kombit dhe në interes të kombit. Për më tepër, kombi si ide moderne është formësuar në shekullin e XVIII dhe XIX, dhe më pas njihet si periudha e konsolidimit të kombeve në shtete apo përpjekja për krijimin e shteteve-kombe. Kombi Kosovarë në esencë është i pamundur dhe nuk mund të ekzistoj si i tillë, sepse ai është një identitet që është zhvilluar dhe frymëzuar në kuadër të identitetit kombëtar shqiptarë. Një ide e tillë, gjegjësisht tendencat për diferencimin e kombit shqiptarë e ka origjinën në fillim të Jugosllavisë së dytë, ku kjo e fundit dëshironte t’i shfrytëzonte dallimet gjuhësore (dialektore) të gegërishtes me shqipen standarde të Shqipërisë për të krijuar një identitet të veçantë kosovarë, i ndryshëm nga ai shqiptarë, ngjashëm siç ndodhi me maqedonasit bullgarë. Gjithashtu edhe Oliver Jens Schmitt mendon se autoritetet e atëhershme Jugosllave kishin provuar këtë mundësi për të jetësuar dallimin identitar mes “Sipatr” dhe “Albanci”, por kjo ishte hedhur poshtë dhe nuk ishte përfillur aspak nga shumica e elitës shqiptare të asaj kohe.⁴⁰⁵ Kështu, më pas u theksua “unjësimin e gjuhës shqipe”, sepse me këtë mendohej uniteti i kombit shqiptarë andej dhe këndeje kufirit, pra gjuha vazhdoi të kuptohet si simbol i veçantë i identitetit shqiptarë, si një identitet mbarë kombëtar dhe jo rajonal. Në këtë kontekst, mund të themi se gjuha shqipe për kombin shqiptarë është dallues nga të tjerët dhe unifikues i brendshëm i kombi, dhe njëkohësisht si njëri ndër

⁴⁰⁴ Po aty.

⁴⁰⁵ Oliver Jens Schmitt, 2012, 182.

komponentët kryesorë të kombit shqiptarë. Pikërisht është gjuha e unjësuar shqipe që mohon në esencë ekzistencën e një kombi kosovarë. Pra, mund të themi se ideja e kombit kosovarë është një ide e paqëndrueshme dhe artificiale, ngase nga “veçantitë” rajonale nuk mund të lind kombi sepse ato janë brenda korpusit identitarë të kombit shqiptarë të ngjizur në epokën e krijimit të kombeve. Një ide e tillë nuk gëzon mbështetje nga qytetari shqiptarë i Kosovës dhe mbetet më shumë si një ide e artikuluar në letër dhe pa mbështetje shoqërore. Qytetari shqiptarë i Kosovës nuk e sheh vetën të ndryshëm në asnjë aspekt me qytetari i Shqipërisë, dhe shtetin e Kosovës nuk e sheh përtej identitetit politik dhe e koncepton atë si një shtet të përkohshëm shqiptarë.

4. “Bashkimi” i shqiptarëve në Bashkimin Evropian

Përtej ligjërimit politik “kushtetues”, të “kombit shumetnik” të shtetit të Kosovës dhe idesë së “kombit kosovarë” dhe si antipod i ligjërimit nacionalist shqiptarë artikulohet ideja e bashkimit të shqiptarëve në Bashkimin Evropian. Perspektivën “euroatlantike” të shtetit të Kosovës e “mveshin” me idenë e “bashkimit” të të gjithë shqiptarëve përbrenda një entiteti tjetër politik siç është Bashkimi Evropian. Elita politike nuk e artikulon idenë e bashkimit kombëtarë për arsye se ndryshimi i kufijve në Ballkan sjell luftëra dhe katastrofa, kështu kufijtë do të humbasin kuptimin përbrenda Bashkimit Evropian dhe për këtë duhet synuar edhe më shumë integrimin. Kjo ide nuk mbështetet vetëm nga shumica e klasës politike në Kosovë por edhe nga klasa politike shqiptare në Shqipëri, Maqedonin e Veriut dhe nga politikanët e viseve e tjera shqiptare. Thënë më mirë çështja e integritimeve evropiane ka mbizotëruar të gjitha ligjërimet politike në mbarë hapësirën shqiptare pas komuniste. Ky ligjërim është më prezent dhe rangohet edhe si më i rëndësishëm se çështja kombëtare, sepse shumica e politikanëve dhe intelektualëve shqiptarë besojnë se “zgjidhja” e kësaj çështjeje merr fund me integrimin e rajonit në Bashkësinë Evropiane. Në këtë kontekst, Kosova do të duhej të zhvillohej si një shtet i ri Evropian, me kulturë dhe identitet politik të mëvetësishëm apo siç shpesh e proklamojnë si projekt të sponsorizuar nga BE-ja dhe SHBA-ja. Mungesa e referimeve të kombit si bashkësi politike mbizotron këtë ligjërim politik. Ky ligjërim i referohet vazhdimisht organizatave mbinacionale si BE, NATO dhe ky orientim zotron pothuajse tërë rrafshin politikës aktuale.

Kufijtë janë të pandryshueshëm dhe është i pamundshme realizmi i Bashkimit Kombëtar shqiptarë, kështu duhet synuar dhe luftuar për integrimin në Bashkimin Evropian si e

ardhmja e të gjithë popujve dhe e të gjithë shqiptarëve. Në këtë formë shqiptarët e shohin më të mundshëm bashkimin me popujt e tjerë në një entitet siç është Bashkimi Evropian pjesë të së cilës janë popuj dhe kombe të ndryshëm, sesa bashkimin me kombin e tyre. Shqiptarët mohojnë vullnetin e tyre të lirë në raport me bashkimin e tyre në një njësi politike, dhe pohojnë fuqishëm këtë vullnet si të lirë dhe demokratik për tu integruar në institucione ndërkombëtare. Shqiptarët edhe pse e kuptojnë se integrimi evropian është përtej vullnetit dhe fuqisë së tyre, prapë janë të prirur se një gjë e tillë do të ndodhë. Sipas Enis Sulstarovës, shqiptarët nuk besojnë në njësimin kulturor e politik të kombit shqiptarë dhe shqetësimi për çështjen shqiptare duhet të burojë vetvetiu, nga të qenit komb dhe nga qenia shqiptare si e tillë. Ai thekson se “Mungesa e programeve dhe strategjive të shumicës së partive shqiptare për zgjidhjen e drejtë të çështjes shqiptare, tregon se këto forca nuk kanë besim në vetvete dhe në fuqinë e kombit shqiptar dhe se presin zgjidhje nga integrimet mbikombëtare.”⁴⁰⁶ Për më tepër, Bashkimi kombëtar nuk mund të zëvendësohet nga integrimi evropian, gjegjësisht ky i fundit duhet të frymëzoj të parin.

Dihet mirëfilli vlerat që promovon Evropa perëndimore dhe në qendër të këtyre qëndron respektimi i vullnetit të lirë të popujve si determinues kryesorë i entiteteve të tilla mbikombëtare. Në këtë mënyrë, si shembull mund të merret rruga që ndjek Gjermania dhe Franca për krijimin e BE-së, të njëjtën rrugë mund të ndjek Kosova dhe Shqipëria në fushën e zhvillimit dhe integritimit ekonomik, arsimorë, kulturorë, politike dhe fusha të tjera derisa Bashkimi kombëtar të jetë rrjedhojë e natyrshme e një kërkese mbarëshoqërore. Gjithashtu, bashkimi i dy Gjermanive, duhet të shërbej si shembull tjetër i ngadhënjimit të vullnetit të popujve. Shqipëria, Kosova dhe shqiptarët e trojeve duhet të ndjekin të njëjtën strategji për bashkimin shqiptarë, përmes shprehjes së vullnetit të lirë të popullit shqiptarë. Gjermanët nuk mbitheksuan disnivelin që ekzistonte në të dy anët, mirëpo ata mbitheksuan gjërat e përbashkëta, gjegjësisht kombin dhe vullnetin e tyre për të jetuar në bashkësi të njëjtë. Kështu, shqiptarët duhet të kuptojnë dhe të ju qasen të dy “projekteve” si jo përjashtuese të njëra tjetrës, sepse asnjëra tjetrën nuk mund të zëvendësojë, e posaçërisht bashkimin kombëtarë si ideal i shumë gjeneratave, nuk mund të zëvendësohet nga asnjë projekt jashtë nacional. Si shembull mund të marrim bashkimin e Gjermanive, se po të ishte e kundërta,

⁴⁰⁶ Enis Sulstarova, Bashkimi Kombëtar nuk zëvendësohet nga integrimi evropian, Jun 4, 2017; <https://shenja.tv/enis-sulstarova-bashkimi-kombetar-nuk-zevendesohet-nga-integrimi-evropian/>, 4. 12. 2019.

Gjermania Lindore do të detyrohej të bashkohej me Gjermaninë Perëndimore përbrenda projektit BE-së dhe jo me një bashkim klasik duke u bazuar mbi vullnetin e popullit. Pra, projekti i bashkimit kombëtarë nuk zëvendësohet me projektin e integritimeve evropiane, atë çfarë po mundohen të na servirin politikanët shqiptarë, ashtu siç thekson edhe Ukshin Hoti se shqiptarët bashkimin po e kryejnë në pajtim me parimet e lirisë, demokracisë dhe vetëvendosjes që qëndrojnë në themel të Evropës së sotme.⁴⁰⁷ Sipas tij, bashkimi kombëtarë shtyhet përpara me të njëjtat parime universale mbi të cilët po synohet integrimi evropian dhe ruajtja e paqes dhe e rendit ndërkombëtar.

Integritet evropiane assesi nuk zëvendësohet me “integritin shqiptarë”, ndër të tjera përbrenda këtyre entiteteve nuk shtrohet veçmas çështja kombëtare shqiptare, por ajo shtrohet së bashku me çështjet e tjera dhe obligimeve që kanë në kuadër të bashkësisë evropiane dhe ndaj popujve në mbarë botën. Kështu, çështja shqiptarë nuk trajtohet si diçka e veçantë, por në kuadër të së tërës, pra prapë se prapë çështjet thelbësore të kombeve mbeten përbrenda sovraniteteve shtetërore përkatëse. Milazim Krasniqi për bashkimin e shqiptarëve në Bashkimin Evropian e konsideron si një kalkulim pragmatik politik e gjeopolitik, i cili synon akomodimin e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Serbisë e Malit të Zi në gjirin e Bashkimit Evropian, ku këto shtete do të jenë të bashkuara sa më njëra tjetrën aq edhe me Estonin, Irlandën e Portugalinë. Kjo për të cilën po përpiqen politikanët shqiptarë nuk ka fare të bëjë me nacionalizmin shqiptarë.⁴⁰⁸

Ligjërimit i politik i shqiptarëve se çështja shqiptare do të zgjidhet përbrenda integritimeve evropiane ka të bëjë me një artikullim mbi “bashkimin artificial apo virtual” të popullit shqiptarë. Kështu klasa politike duke u ndier të pafuqishëm për ta bërë historinë e tyre, i janë përshtatur gjeopolitikës dhe ideologjive të të fuqishmëve (Sulstarova). Një formë e tillë e artikullimit për zgjidhjen e çështjes shqiptare, si formë madje e vetme, nuk përkon me ligjërimitin nationalist shqiptarë, përderisa çështja shqiptare mendohet të zgjidhet në kuadër të një entiteti më të madh politik dhe e partikularizuar si çështje e brendshme e sovraniteteve të tjera shtetërore.

⁴⁰⁷ Ukshin Hoti, Ismail Kadare, Bisedë përmes hekurash, 2000, 107.

⁴⁰⁸ Milazim Krasniqi, 2017, 76.

5. Ligjërimi nacionalist shqiptarë në Kosovën e pas luftës

Mbështetësit e opsionit nacionalist ligjërimorë shprehin rezistencë të fuqishme ndaj gjitha formave të kozmopolitizmit. "Identitetin kosovar" e shohin brenda korpusit identitar shqiptarë dhe jo si identitet më vete, kështu ata e refuzojnë atë sepse e konsiderojnë si inxhinering artificial apo si zhvillim i "identitetit në saks" (Muhiq). Ligjërimi nacionalist, kundërshton argumentet se realiteti Kosovar është një realitet i ri dhe si i tillë është i shkëputur nga rrethanat politike dhe rrjedha historike Shqiptare. Kosova nuk do të duhej të zhvillohej si identitet politik i mëvetësishëm sepse ajo është pjesë e pandashme e realitetit shqiptarë. Kombi gjegjësisht "uniteti kombëtarë" është në epiqendër e politikbërjes dhe politikveprimit, ndryshe nga ligjërimi kozmopolit. Fillimisht ky mendim shfaqet si manifestim i pakënaqësisë së "establishmentit ndërkombëtar" dhe menaxhimit të tyre të dobët që bëhet me Kosovën si "protektorat", dhe kështu duke u truallizuar teorikisht me ligjërimin nacionalist shqiptarë të periudhës 1945-1999 e deri tek referimet mbi rilindjen kombëtare për të legjitimuar Kosovën si pjesë të pandashme të shqiptarizmes. Ky ligjërim fillon të artikullohet nga një lëvizje politike, parti politike, po ashtu edhe nga struktura të tjera kulturore e organizatave. Këtu posaçërisht do të trajtojmë "Lëvizjen Vetëvendosje", si lëvizje me e përafërt me ligjërimin nacionalist e shfaqur që nga Kosova e pasluftës.

Ajo çka e bënë të ndryshme "Lëvizjen Vetëvendosje" nga partitë e tjera politike, ka të bëjë me vendosmërinë e sajë për të drejtën e vetëvendosjes së popullit të Kosovës, që nënkupton se shteti i Kosovës duhet të jetë në përkushtim të përmbushjes së vullnetit të popullit të sajë. Referuar programit të sajë, ajo angazhohet për ndryshim të pjesëve të Kushtetutës së Kosovës të cilat e kufizojnë sovranitetin e shtetit të Kosovës përfshirë këtu heqjen e Planit të Ahtisaarit që e ndan territorin, institucionet dhe kulturën mbi baza etnike, ndërkohë që përjetëson sundimin ndërkombëtar mbi Kosovën. Vetëvendosje angazhohet për heqjen e nenit 1.3 që ia ndalon të drejtën Kosovës që të bashkohet me një shtet tjetër, përkatësisht me Shqipërinë, sepse kjo mohon mundësinë e shprehjes së vullnetit të popullit shqiptar për bashkim kombëtar.⁴⁰⁹ Vetëvendosje është ndër lëvizjet e vetme politike që artikulon vullnetin politik të shtetit të Kosovës për bashkëngjitje me Shqipërinë.

⁴⁰⁹ Programi i shkurtër i Lëvizjes Vetëvendosje.

Shfaqja e Lëvizjes Vetëvendosje në vitin 2005 në skenën politike në Kosovë anashkalon njëherit të gjithë ligjërimet politike mbizotëruese, për të krijuar një ligjërim të ri politik mbi të tashmë dhe të ardhmen politike të Kosovës. Zanafilla e Vetëvendosjes, ndodhet në aktivitetet dhe aksionet e shumta të KAN-it (Rrjeti i Aksionit për Kosovën), që kishin për qëllim të krijojnë një qytetari aktive në Kosovë, të dedikuar në promovimin e vlerave universale në fushat e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe drejtësisë sociale.⁴¹⁰ Ajo u ngjiz si domosdoshmëri për rezistencë, karshi statusit të pazgjidhur të Kosovës, faktorit ndërkombëtarë, si dhe kundër bisedimeve me Serbinë si imponim nga faktori ndërkombëtarë. Në Manifestin e Vetëvendosjes, shkruhet se Administrimi i UNMIK-ut në Kosovë është regjim antidemokratik. Përkohshmëria e papërcaktuar e UNMIK-ut është bërë e padurueshme. Pushteti i tij këtu është antiteza e vetëvendosjes. Realizimi i vetëvendosjes nënkupton ikjen e administratës së UNMIK-ut nga Kosova. Prezenca ndërkombëtare në vendin tonë (përpos përfaqësive diplomatike) të jetë e redaktueshme në ca mekanizma të domosdoshëm për monitorimin e të drejtave të pakicave.⁴¹¹ Kështu nën parullën “Jo negociata, vetëvendosje!”, artikullohet fillimisht kritika për padrejtësinë dhe më pas zgjidhja si imperativ për popullin e Kosovës. Në këtë kontekst, mund të ju referohem edhe Latif Mustafës i cili shkruan se “Lëvizja Vetëvendosje!, gjatë kohës, formësoi një koncepton dhe program filozofik human, duke u bazuar në të drejtën e popujve për vetëvendosje, një e drejtë kjo që i motivoi edhe shumë lëvizje dhe popuj të Lindjes së Mesme dhe Afrikës Veriore për të krijuar shtetet e tyre nacionale. Ngjashëm siç konsiderohej Anglia në Egjipt e Palestinë ose Franca dhe Italia në Tunizi dhe Marok, edhe UNMIK-u konsiderohej si fuqi kolonialiste në Kosovë. Anti-kolonializmi, mund të themi se ishte indi konceptor i përbashkët i lëvizjeve islamike të shekullit XIX dhe Lëvizjes Vetëvendosje në shekullin XXI.”⁴¹² Kjo lëvizje në thelb të sajë vendos individin dhe vullnetin e tij të lirë, që si vullnet i lirë ai është në gjendje të shpërfaqë këtë me veprimtari aktive për të jetësuar këtë vullnet, tashmë të artikuluar dhe të qendëruar në të drejtën e popujve për vetëvendosje.

⁴¹⁰ Historik i ‘Lëvizjes Vetëvendosje!’, https://www.vetevendosje.org/ep-content/uploads/2019/01/Historik_i_Levizjes_VETEVEDOSJE1494292852.pdf, 12. 12. 2019.

⁴¹¹ Manifesti i Vetëvendosjes, Lëvizjes Vetëvendosje; <https://www.vetevendosje.org/ep-content/uploads/2019/01/Manifesti-11494292623.pdf>.

⁴¹² Latif Mustafa, Në frymën e shekullit radikal, Revista Shenja; <http://shenja.mk/index.php/opinion-analize/17483-ne-frymen-e-shekullit-radikal.html> 14.12.2019.

Vetëvendosja prezencën e UNMIK-un e konsideronte si regjim antidemokratik, sepse ajo kushtëzonte zgjidhjen e statusit të Kosovës përmes negociatave dhe kompromiseve. VV-ja ishte ndër lëvizjet e vetme politike që kundërshtonte të gjitha iniciativat që e pengonin Kosovën në procesin e shtet ndërtimit. Ajo kundërshtonte UNMIK-un, Rezolutën 1244, gjithashtu dhe Marrëveshjen e Rambujesë, sepse përmes këtyre dokumenteve Kosova nuk mund të bëhej shtet, ngaqë këto garantonin integritetin territorial të Jugosllavisë, Serbisë mbi Kosovën.⁴¹³ Ajo nuk ndryshoi kursin e veprimit edhe ndaj “Planit të Ahtisaarit”, por edhe misionin ndërkombëtarë për sundimin e ligjit EULEX-in pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës. Gjithashtu VV-ja kundërshtonte dhe e konsideronte fajtoresh klasën politike në Kosovë për varësinë ndaj faktorit ndërkombëtarë, për zhveshjen e Kosovës nga vlerat autentike nacionale dhe i mban me përgjegjësi për ngecjen në procesin e shtet ndërtimit. Pra me një fjalë, VV-ja ishte iniciativa e vetme opozitare e të gjitha atyre, të brendshëm dhe të jashtëm, që e “pengonin” fillimisht Pavarësinë Kosovës dhe më pas procesin e shtet ndërtimit.

Në esencë të diskursit të sajë politik është ideja për krijimit kombit të bashkuar shqiptar si produkt i konceptit të vetëvendosjes. VV-ja, konceptin e vetëvendosjes e lidhë me vullnetin e popullit të Kosovës të mohuar ndër vite, për ta rishfaqur atë si refleksion që duhet të ndodhë gjithmonë në të tashmën. Në programin politik të sajë shkruan se meritore për Kosovën e sotme është rezultat i ndjekjes së idealeve të lirisë, barazisë e drejtësisë të brezave që bënë historinë e rezistencës legale e ilegale, paqësore e të armatosur të popullit tonë përgjatë gjithë shekullit XX, e që kulmoi me luftën çlirimtare të UÇK-së. Lëvizja angazhohet për përkufizimin kushtetues të Kosovës si shtet i shqiptarëve dhe gjithë qytetarëve të Kosovës.⁴¹⁴ Ajo e sheh Pavarësinë e Kosovës si proces drejt bashkimit me Shqipërinë si e vetmja zgjidhje e drejtë dhe e domosdoshme për shqiptarët.

Lideri i kësaj Lëvizje shprehet edhe për trojet tjera shqiptare jashtë Shqipërisë dhe Kosovës në raport me bashkimin kombëtarë. Ai thotë se fillimisht duhet të fillohet nga hapi më i domosdoshëm dhe i rëndësishëm që është ai i bashkimit të Kosovës dhe Shqipërisë, më pastaj duhet të ndihmohen shqiptarët në Mal të Zi, Luginë të Preshevës dhe Maqedoninë Perëndimore-Iliridë, që të organizohen sa më mirë, sepse e drejta nuk mund të realizohet pa

⁴¹³ Manifesti i Vetëvendosje!, Lëvizja Vetëvendosje.

⁴¹⁴ Programi i shkurtër i Lëvizjes Vetëvendosje.

organizim.⁴¹⁵ Mund të themi se ai bashkimin kombëtarë e artikulon si proces që fillimisht që duhet të ndodhë mes Shqipërisë dhe Kosovës, kështu më pas të vazhdohet me konsolidimin kulturorë, arsimor, nacional dhe politik të shqiptarëve trojeve për të ruajtur kohezionin kombëtarë nga programet anti-shqiptare. Në këtë kontekst, Albin Kurti i referohet edhe Shkupit si qyteti me më shumë shqiptarë që ishte para tridhjetë viteve, kështu sipas tij shqiptarët duhet të zhvillojnë dhe sofistikojnë kritikën dhe të kundërshtojnë dimensionin nacional shovinist të shtetit të Maqedonisë së Veriut i cili po i shfrytëzon dhe po i shtyp shqiptarët. Pra, në mënyrë decisive nuk e thekson bashkimin e trojeve të tjera shqiptare, por sipas tij, bashkimi kombëtarë është proces dhe si hap i parë është ai i Shqipërisë me Kosovën jetë një shtet i fuqishëm shqiptarë.⁴¹⁶

Në epiqendër të këtij ligjërimi është kombi politik, dhe fillimisht integraliteti brenda shqiptarë. Gjithashtu, VV-ja ka qëndrim të ndryshëm nga pjesa tjetër e lidërshiptit politik Kosovare për artikullimin e idesë së bashkimit të shqiptarëve në Bashkimin Evropian. VV-ja mendon se bashkimi i shqiptarëve dhe Bashkimin Evropian nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën. Politikanët shqiptarë nga mosgatishmëria për të artikuluar bashkimin kombëtar, po e justifikojnë apo po e zëvendësojnë me integrimet e mundshme evropiane. Shqiptarët kanë nevojë të bashkohen ndërmjet vete, dhe se bashkimi kombëtar nuk mund zëvendësohet asnjëherë me Bashkimin Evropian, sepse ne kemi shumë nevojë edhe për njërin e edhe për tjetrën. Bashkimi kombëtar do ta bënte më të fuqishëm dhe më konkurrues kombin tonë, ndërsa Bashkimi Evropian do ta bënte të barabartë kombin tonë me kombet e tjera evropiane.⁴¹⁷

VV-ja, për herë të parë në vitin 2010 merr pjesë zgjedhjet nacional dhe bëhet pjesë aktive e jetës politike në Kosovë. Diskursi i saj kritik zënë një vend të rëndësishëm në jetën politike dhe publike në Kosovë, dhe për kohën që po flasim ajo përbën rreth 25% të votuesve, duke dalë e para në zgjedhjet e tetorit të vitit 2019. Ajo ç'far e bënë të rëndësishme këtë lëvizje është besnikëria e sajë ndaj ideve dhe koncepteve të parashtruara deri më tani. Sipas

⁴¹⁵ Albin Kurti - Bashkimi kombëtar i shqiptarëve i domosdoshëm, video, Mar 30, 2012; <https://www.youtube.com/ëatch?v=97h5c0qEtKc>, 12. 12. 2019.

⁴¹⁶ Albin Kurti Për bashkimin kombëtar, video; Apr 12, 2015; https://www.youtube.com/ëatch?v=_5OZVE029k 12.12.2019.

⁴¹⁷ Lëvizja Vetëvendosje, Bashkim për bashkimin, 19 11 2012; <https://www.vetevendosje.org/bashkim-per-bashkimin/> 13.12.2019.

analistëve të shumtë koherenca ideore e VV-së ka të bëjë me të qenit parti opozitare dhe pamundësia e sajë për të qeverisur. Kështu, mbetet të shihet nëse VV-ja ju qëndron koherent idealeve të saja politike, sidomos idealit të sajë për bashkimin kombëtarë për të cilin edhe është akuzuar për populizëm dhe instrumentalizim të çështjes kombëtare për interesa ditore politike.

Lëvizja Vetëvendosje është vazhdimësi e ligjërimit nacionalist e shfaqur gjatë periudhave të ndryshme historike, e posaçërisht gjatë periudhës 1945-1999. Ky ligjërimit shpërfaqet dhe truallizohet në refleksion me realitetin e krijuar politik, gjegjësisht në kundërshtim me misionet ndërkombëtare në Kosovë, me idenë “kosovarizmit” dhe “kombit multietnik” pjesë të së cilave në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme janë edhe shumica e partive politike në Kosovë dhe një numër i madh i shoqërisë civile, pra, ndaj gjitha formave të kozmopolitizmit që argumentojnë se shteti i Kosovës është një realitet i ri dhe si i tillë është i shkëputur nga rrethanat politike dhe rrjedhat historike të shqiptarizmit.

Ligjërimiti nacionalist shqiptarë në Kosovën e pas luftës, ka filluar të ndikoj edhe në koncepte e projekte të tjera politike e social, për të cilën më meritorë është Lëvizja Vetëvendosje. Këtu mund të përmendim edhe një parti tjetër politike e cila e artikulon pothuajse ngjashëm me VV-në idenë e shqiptarizmit. Fjala është për Lëvizja për Bashkim (LB), që si subjekt politik përpiket për zgjidhjen e çështjes së pazgjidhur shqiptare. Mirëpo, ajo e shtron më ndryshe zgjidhjen e çështjes shqiptare. Kështu, ndër qëllimet dhe detyrat e para të saja është zgjidhja e çështjeve të mbetura në mes të Kosovës dhe Serbisë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, gjithashtu angazhohet për heqjen e barrierave kushtetuese që pengojnë të drejtën e popullit shqiptarë të Kosovës për të vendosur për fatin e vetë. Pra, si pikë e tretë, pas realizimit të dy pikave të para ajo përpiket për mbajtjen e referendumit për bashkimin e Republikës së Kosovës me Republikën e Shqipërisë që njëherit është thelbi i programit politik.⁴¹⁸ Pra, sipas LB-së, janë dy hapat kryesor, të cilat na afrojnë bashkimin kombëtarë, integrimi dhe zgjidhja politike për veriun e Kosovës dhe Luginën e Preshevës. Fillimisht procesi i integritimeve kombëtare që do ishte njëherit edhe parapërgatitje për bashkim të plotë mes Kosovës dhe Shqipërisë. Integrimi duhet të ndodhë nëpër fusha të rëndësishme shoqërore si në atë ekonomike, telekomunikacionit, politika të jashtme të përbashkëta, unifikimin e sektorit energjetik, politika të përbashkët të sigurisë, politika të

⁴¹⁸ Programi politik i Lëvizjes për Bashkim.

përbashkëta kulturore, sport të integruar. Por, ajo që do të mundësonte bashkimin e Shqipërisë me Kosovën është zgjidhja përfundimtare e çështjes shqiptaro-serbe. Sepse LB-ja, gjegjësisht udhëheqësi i sajë Valon Murati e artikulojnë se çështja të papërfunduar dhe kjo duhet të kaloj përmes zgjidhjes së çështjes së Veriut të Kosovës (Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zveçanit) dhe Jugut të Serbisë (Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit). Kështu, sipas tyre përmes një dialogu politik në mes të dy vendeve, që do të duhej të përfundonte me aplikimin e standardeve të njëjta për të dy popullsitë do të shtronte rrugën për zgjidhjen e problemit shqiptaro-serb. Aplikimi i standardeve të njëjta do të mund të dërgonte edhe në ridefinimin e kufijve në mes të Kosovës dhe Serbisë duke u bazuar në vullnetin e popullsisë përkatëse.⁴¹⁹ Pra përmes zgjidhjes së çështjes Kosovë-Serbi përmes zbatimit të parimit të reciprocitetit, do të krijohen rrethanat për një marrëveshje të re politike në mes të Kosovës dhe Serbisë, gjë që do të çonte në rënia e Pakos së Ahtisaarit dhe rrjedhimisht edhe ndalesës për bashkim me Shqipërinë.

LB-ja nuk gëzon popullaritet të lartë në shoqërinë Kosovare, por ajo mbetet një artikulum i rëndësishëm teorik i konceptit të shqiptarizmes dhe me ndikim në mendimin politik Kosovarë. LB-ja mbetet nën hijet ligjërimore të Lëvizjes Vetëvendosje, gjithashtu, ajo çka e bënë të shihet me skepticizëm nga ana e qytetarëve këtë lëvizje, është përfshirja e sajë në platformat e ndryshme politike, gjegjësisht me ato platforma politike që nuk qendëronin kombin si koncept politik dhe nuk angazhoheshin për kauzën e bashkimit kombëtarë. Gjatë vitit 2014-2017, Valon Murati kryetari i kësaj Lëvizjeje ka qenë Ministër i Diasporës në Qeverinë e Kosovës, që nënkupton se platforma e këtij subjekti politik është shkrirë përbrenda platformave të tjera politike me orientime ligjërimore jonacionaliste. Në zgjedhjet e tetorit të 2019-ës, LB-ja ishte pjesë e listës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), që nënkupton se ajo për mbijetese politike është përfshirë në një listë që nuk përkon me linjën dhe kauzën e sajë politike.

Mund të themi së ligjërimi nacionalist në Kosovë ka filluar të teorizohet dhe inkorporohet edhe nga grupacione të ndryshme shoqërore në Kosovë, e tërë kjo si shkak i dështimeve të shumta në jetën shoqërore, kulturore e politike. Pavarësisht, se këto grupe, nuk artikulojnë tërësisht një ligjërim të tillë ndaj jetës publike dhe politike, por ato ndikohen nga ky diskurs

⁴¹⁹ Valon Murati, Bashkimi Kombëtar si një process, 05.11.2012;

<https://levizjaperbashkim.org/informacion/press-release/bashkimi-kombetar-si-nje-proces> 14.12.2019.

qoftë në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme. Për më tepër ajo po e stimulohet edhe nga një sërë dështimesh në proceset e integritimeve euroatlantike, kështu si dështimi në liberalizimin e vizave, dështimi i anëtarësimit të Kosovës në UNESCO e Interpol, mungesa e njohjeve të reja, gjithashtu përballja me “diplomacinë agresive” serbe që po rezulton me “çnjohjen” e Kosovës nga disa vende, e të tjera. “Refuzimi” që po u bëhet asaj nga institucionet ndërkombëtare po ndikon në rikthimin e kursit ligjërimorë me përmbajtje më nacionale, duke u dhënë hapësirë më të madhe programeve integruese me Shqipërinë kundrejt atyre ndërkombëtare. Pra, pavarësisht, se ky ligjërim po shtrihet në masë nga dështimet e një procesi dhe nuk po zhvillohet si një ide autentike dhe e domosdoshme ajo po fillon të zërë vend të rëndësishëm në artikulet publike dhe politike në Kosovë.

Në këtë periudhë ligjërimi nacionalist shqiptarë në formën më autentike se të tjerët artikulohej nga Lëvizja Vetëvendosje. Ligjërimi politik i VV-së paraqitet si diçka e natyrshme dhe e domosdoshme për popullin e Kosovës dhe jo si ligjërim që e kërkon koha apo bazohet në kalkulimet e tashme politike. Ligjërimi nacionalist tek ajo shfaqet në një linjë të ngjashme ligjërimore me protagonistët dhe idetë nacionaliste ndër vite, duke e argumentuar atë si një koncept të vetëm politik dhe në dobi të mirëqenies së përgjithshme të shqiptarëve në Ballkan. Kështu, duke dekonstruktuar konceptet dhe programet e tanishme politike si të pa dobishme dhe si diçka që e zhveshin shqiptarin e Kosovës nga trashëgimia kulturore, kombëtare dhe politike, ajo artikulon kombin politik si projektin e vetëm të dobishëm për shqiptarët.

VIII. Përfundim

Gjatë rrugëtimit të këtij hulumtimi, disertacioni ndodh shpesh që pyetjet e shtruara hipotetike që sillen vërdallë qenies së hulumtuesit atrofizohen, shumëfishohen gjë që lëkundin edhe bindjet fillestare në lidhje me motivin dhe pyetjen kërkimore të hulumtimit. Meqë është një progres dialektik intenca për t'i qëndruar besnik objektit kryesor dhe refuzues ndaj tundimeve që tërheqin temat e tjera me interes po ashtu të veçantë por që në prapavijën e përgjithshme zhvendosin ecejaken e hulumtimit deri në transformim rrënjësor të saj. Po që se i kthehem pyetjes kërkimore që kemi shtruar krejt në fillim të këtij disertacioni, ka të bëjë me dallimet në tipare midis diskursit nacionalist shqiptar që rezultoi me pavarësinë e Shqipërisë londineze dhe diskursit nacionalist pas Shqipërisë londineze dhe tej saj. Përmes këtij punimi kemi arritur të identifikojmë dhe klasifikojmë etapat e zhvillimit të këtij diskursi nacionalist përfshi figurat kryesore intelektuale, liderët dhe organizatat politike. Nëse mund ta shprehim së një përfundim tentativ fillestar mund të themi se krijimi i dy realiteteve të reja, siç ishte Jugosllavia dhe Shqipëria në njërin anë dhe Kosova si njësi administrative dhe krahinore do të jenë fillet e një realiteti apo ripërmasimi të ri politik në aspektin diskurziv por bazuar në modelin e diskursit nacionalist shqiptar dhe teleologjinë e tij duke u formësuar në mendim politik kosovar. Le ta marrim, më në mënyrë më koncize duke e përfshirë analizën diskurseve dhe historike.

Formimi i shtetit shqiptarë, gjegjësisht njohja e tij nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër (1913) si shtet i ndarë nga pjesa tjetër e kombit shqiptarë shënon njëherit edhe zanafillën e lindjes së asaj që quhet “çështje shqiptare”. Me sanksionimin e këtij akti që u bë në Konferencën e Londrës, gjegjësisht me okupimin e tokave shqiptare lindi edhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare dhe çështja e bashkimit kombëtar shqiptarë. Në këtë mënyrë, mbeti përgjysmë edhe projekti i Rilindjes Kombëtare për hegjemonizmin e kombit shqiptarë në një shtet.

Ndarja e kombit shqiptarë prodhoi edhe “ndarjen e madhe” të pas pavarësisë, ata të çështjes shqiptare brenda shtetit shqiptarë dhe atë të çështjes shqiptare të jashtë shtetit shqiptarë. Për një pjesë të kombit krijohet iluzioni se çështja shqiptare mori një përfundim të lumtur, për atë pjesë që u përfshi në kufijtë administrativë të Shqipërisë Londineze, kështu ideja e shqiptarizms pak nga pak fillon të zëvendësohet me vetëdijen shtetërore.

Për, shqiptarët jashtë kufijve të Shqipërisë, të paktën për shumë veprimtar dhe intelektual shqiptar, posaçërisht ata të ish-Jugosllavisë, projekti i rilindjes konsiderohej projekt të pa përfunduar, sepse çështja kombëtare është akoma e hapur dhe kërkon zgjidhje të drejtë. Madje ky projekt për intelektualët dhe politikanët në ish-Jugosllavisë ka qenë burim i fuqishëm frymëzimi në përpjekjen për çlirimin dhe bashkimin e trojeve të tyre me shtetin amë. Njëri ndër përfaqësuesit më të denjë të idesë së nacionalizmit shqiptarë të pas shpalljes së Pavarësisë dhe ndërmjet dy luftërave botërore është Hasan Prishtina. Ai me idetë, veprimtarinë politike dhe luftën për çlirimin e popullit shqiptarë i përket lineariteti dhe konsistencës ideore të Rilindësve. Hasan Prishtina jo vetëm që i qëndroi besnik bindjeve dhe ideve të tija, por ai frymëzoi, organizoi dhe realizoi kryengritje të shumta ndaj pushtuesve të tokave shqiptare. Kështu si pjesë e Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, i Lëvizjes Kaçake dhe si bashkëpunëtor i lëvizjes Xhemijeti, ndërtuan platformën për shtetin kombëtarë Shqiptar.

Për të vazhduar me linearitetin e mendimit nationalist shqiptar në Kosovë është ai i Lëvizjes Nacional Demokrate Shqiptare (NDSH), në krye me Azem Maranën, lëvizje kjo e cila me veprimtarinë e saj në Kosovë dhe në pjesën Lindore të Maqedonisë kishte për objektiv fillimisht çlirim nga okupuesi, pavarësinë kombëtare dhe bashkimin e të gjitha trojeve etnike brenda një shteti. Organizmi i sajë ideorë dhe politik nuk u shua asnjëherë, por ai u transformua nga një emër në një emër tjetër. Bazuar edhe në pyetjen e parë ndihmëse, përgjigjen që ofrojmë është se ligjërimi nationalist ka vazhduar të jetë pjesë e pandashme e veprimtarisë politike dhe e diskursit të përgjithshëm politik shqiptar, ngaqë akoma konsideroj si paradigma e vetme dhe një modus operandi i kohës.

Sa i përket pyetjes tjetër ndihmëse në lidhje me transformimin e diskursit nationalist në Kosovë, kemi trajtuar figurën figurën më emblematike dhe përmbledhëse në ligjërimin politik në Kosovë, Adem Demaçin dhe Lëvizjes Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve (LRBSH). Ai përmes idesë së Republikës Shqiptare përbrenda Jugosllavisë artikulonte formën e shkëputjes së shqiptarëve nga ish-Jugosllavia. Republika shqiptare nënkuptonte autonominë e plotë politike dhe territoriale me të drejtë shkëputjes nga Jugosllavia, një të drejtë që e parashihnin edhe kushtetutat e jugosllave. Ideja e barazisë nacionale në kuadër të federatës me republikën tjera, nënkuptohej si diçka e përkohshme apo instrumentalizuese, sepse nga të qenit republikë rridhte dhe e drejta e vetëvendosjes së sajë. Ky qëndrim konsiderohej edhe strategjik kundrejt qëndrimit të shtetit shqiptarë ndaj

çështjes shqiptare në Jugosllavi. Një platformë e të tillë politike shfaqej edhe në programin e ndryshme të lëvizjeve ilegale në Kosovë deri në vitet e tetëdhjeta.

Për të ardhur deri tek, diferencimi i mendimit politik në Kosovë, gjegjësisht nga idetë dominante si ishin Bashkimi i Kosovës dhe i viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi me Republikën Socialiste të Shqipërisë dhe Republika Shqiptare përbrenda Jugosllavisë, zë fill një botëkuptim i ri, qoftë edhe befhëm, për Republikën e Kosovës. Kosova Republikë shfaqej si një formulë në përputhje me logjikën e ndarjes administrative aktuale, kështu duke përfshirë në kërkesën për Republikë vetëm territorin e Kosovës, pa territoret tjera shqiptare përbrenda Jugosllavisë *që binte në kundërshtim me "logjikën dhe ambicjet shekullore kombëtare"*. Ideja për Republikë të Kosovës u shfaq pas plenumit të Brionëve (1966), e posaçërisht pas demonstratave të 1968, u sforcuar fuqishëm nga demonstratat e vitin 1981 e tutje, kështu për t'u bërë ligjërimi politik dominant në Kosovë. Ndër shqiptarët ky ligjërim nyjëtonte rreth zgjidhjes së çështjes kombëtare dhe të ardhmes politike të popullit të Kosovës. Kosova Republikë shfaqej si një formulë në përputhje me logjikën e ndarjes administrative në ish-Jugosllavi, kështu duke përfshirë në kërkesën për Republikë vetëm territorin e Kosovës, pa territoret tjera shqiptare përbrenda Jugosllavisë *binte në kundërshtim me logjikën kombëtare dhe kontekstin gjeografik të artikuluar nga nacionalizmi shqiptarë*. Ide të tilla janë refleksion i real politikës, sepse mundësia e ndryshimit të kufijve qoftë për bashkëngjitjen e viseve shqiptare të Jugosllavisë me Shqipërinë, qoftë për krijimin e Republikës shqiptare përbrenda Jugosllavisë duke i ndryshuar kufijtë e brendshëm të Jugosllavisë interpretohej si shumë idealiste dhe pak e mundshme. Ideja për Republikën e Kosovës nënkuptonte vetëm avancim të statusit politik në kufijtë ekzistues, çka shihej si reale dhe shumë e mundshme. Mirëpo, pavarësisht mundësive, ideja e Republikës së Kosovës nënkupton tkurrjen e konceptit të territorialitetit dhe bie ndesh me parimin kryesorë të nacionalizmit të hershëm shqiptar. Kjo qasje nënkupton diferencimin nga idetë nacionaliste dhe ofronte zgjidhje të pjesshme dhe jo të tërësishme të çështjes shqiptare në Jugosllavi. Ide të tilla mund të jenë të frymëzuara nga lëvizjet dhe iniciativat nacionaliste, siç janë, Rilindja Kombëtare, Lidhja e Prizrenit e të tjera, mirëpo, ato i nënshtrohen real politikës dhe kalkulimeve strategjike të kohës.

Në fillim të viteve të 90-ta, me shpalljen e pavarësisë të disa shteteve nga Jugosllavia, ideja e Republikës së Kosovës fillimisht dhe më pas Pavarësia e Kosovës ngadhënjeu mbi të gjitha artikulimet politike. Kështu, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e udhëhequr nga Ibrahim

Rugova e cila dominonte artikulin politik në këtë periudhë dhe shumica e klasës politike shqiptare në Kosovë homogjenizuan qëndrimin për Pavarësinë e Kosovës si një njësi më vetë politike. Platforma e sajë kristalizoi fuqishëm idenë e pavarësisë së Kosovës, që i shpinte shqiptarët në një realitet tjetër politik e gjeopolitik. Kjo kulturë politike ishte gatuar në Kosovën e socializmit duke kaluar përmes institucioneve të saja, kryesisht përmes Universitetit të Prishtinës. Lidhja e Shkrimtarëve të Kosovës si lëvizje intelektuale e politike, e që më vonë do të shndërrohet në Lidhjen Demokratike të Kosovës, Republikën e Kosovës e shihte si fazë kalimtare drejt pavarësisë, mirëpo bashkimin e saj me Shqipërinë nuk e shihte si pjesë të diskursit të saj. Rrethanat politike, gjeopolitike dhe kulturore tashmë kishin krijuar një zbrazë të madhe në mes Shqipërisë dhe Kosovës paçka se aktivitet kulturore kishin vazhduar tek tuk edhe në kohën e socializmit. LDK-ja, Kosovën e parashikonte si subjekt të barabartë me shtetet tjera, gjegjësisht raporti i sajë me Shqipërinë do të jetë i ngjashëm si me atë të Serbisë, si dy shtete të njëjta rajonale ndaj të cilave do të ketë marrëdhënie të njëjta ndërshtetërore. Lidhja Demokratike e Kosovës me liderin e sajë Ibrahim Rugovën, mbeten të përkushtuan në zhvillimin kombëtarë shqiptarë, por jo për një njësinë politike të përbashkët shqiptare.

Një formë tjetër e zgjidhjes së çështjes së Kosovës, e cila paraqitej në këtë fazë ishte ideja e "*Bashkimit kombëtarë*". Fillimisht ndiqet nga intelektual të shquar si Ukshin Hoti e Rexhep Qosja dhe më pas nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) që artikulonin se Kosova e Pavarur dhe jo vetëm, duhet të bashkohen me Shqipërinë si shtet amë. Në këtë kontekst mund të themi UÇK-ja mbetet nacionaliste vetëm në aspektin programorë, sepse veprimtaria e sajë e kufizohet vetëm në hapësirën gjeografike të Kosovës dhe pranon të çarmatohet pa realizuar objektivin e sajë sublim.. Kështu, Rexhep Qosja dhe Ukshin Hoti artikulojnë në mënyrë të shkëlqyer aspektin teorikë të së drejtës së shqiptarëve për të jetuar së bashku në një njësi politike. Në aspektin konceptual dhe ideorë, ligjërimi politik i Ukshin Hotit mbetet ligjërim nacionalist më i avancuar, krahasuar me artikulet e tjera politike nga individ dhe lëvizjet politike të kohës. Hoti në çështjen e bashkimit, shtetin Shqiptarë e sheh si bartës të këtyre proceseve gjithashtu dhe si të paprekshëm sepse ai është boshti rreth të cilit duhet të sillemi. Parulla "një komb-një shtet" mbetet udhëheqësja kryesore në jetën politike të Ukshin Hotit. Martirizimi i tij, është i lidhur drejtpërdrejt me idetë e tija politike mbi çështjen

shqiptare, dhe mbi të gjitha ajo që i bënë edhe më legjitime qëndrimet e tija, është sakrificat e tij deri në vetëmohim, apo siç thoshte ai “Bëje ose Vdis për ta vrarë vdekjen”.

Pothuajse në një linjë të njëjtë ideore me Ukshin Hotin çështja e Kosovës dhe çështja shqiptare në përgjithësi artikullohet nga Lëvizja Vetëvendosje. Ajo fillimisht shfaqet si manifestim i pakënaqësisë së “establishmentit ndërkombëtar” dhe menaxhimit të tyre të dobët që bëhet me Kosovën si “protektorat”, dhe kështu duke u truallizuar teorikisht me ligjërimin nationalist shqiptarë. Në esencë të diskursit të sajë politik është ideja për krijimit kombit të bashkuar shqiptar si produkt i konceptit të vetëvendosjes. VV-ja, konceptin e vetëvendosjes e lidhë me vullnetin e popullit të Kosovës të mohuar ndër vite, për ta rishfaqur atë si refleksion që duhet të ndodhë gjithmonë në të tashmen. Lëvizja Vetëvendosje është vazhdimësi e ligjërimin nationalist e shfaqur gjatë periudhave të ndryshme historike, e posaçërisht gjatë periudhës 1945-1999. Ky ligjërim shpërfaqet dhe truallizohet në refleksion me realitetin e krijuar politik, gjegjësisht në kundërshtim me misionet ndërkombëtare në Kosovë, me idenë “kosovarizmit” dhe “kombit multi-etnik” pjesë të së cilave në mënyrë të vetëdijshme apo të pavetëdijshme janë edhe shumica e partive politike në Kosovë dhe një numër i madh i shoqërisë civile.

Shqyrtuar në përgjithësi ligjërimin nationalist shqiptarë në Kosovë gjatë periudhës 1945-1999 dhe më pas, u artikulua deri në fillimin e viteve të tetëdhjeta. Në formën e vetë parimore dhe doktrinare u artikulua nga fillimi i viteve dyzeta. Këto lëvizje si objekt kryesorë kishin projektin e nacionalizmit shqiptarë të periudhës së Rilindjes Kombëtare, gjegjësisht Bashkimin e Kosovës dhe të Viseve të Tjera Shqiptare në Jugosllavi me Republikën Socialiste të Shqipërisë, apo Republikën Shqiptare përbrenda Jugosllavisë. Tek lëvizje të tilla vetëdija për kombin dhe të jetuarit në bashkësi është mbi të gjitha kalkulimet dhe strategjitë e mundshme të real politikës. Gjatë kësaj periudhe kombi shqiptarë u përkufizua në terma *kulturorë dhe etnik* duke e theksuar prejardhjen me anë të gjakut. Kombi u përfytyruar *gjeografikisht* ashtu siç ishte përfytyruar nga rilindësit dhe nationalistët shqiptarë, ai përfshinte si objekt final domosdoshmërinë e bashkëngjitjes së të gjitha trojeve shqiptare në ish-Jugosllavi me shtetin amë Shqipërinë. Kufijtë e Shqipërisë për ta ishin të pa natyrshëm, të dhunshëm, dhe se bota është e ndarë në kombe dhe e drejtë e secilit komb është të zotëroj shtetin e tyre kombëtarë dhe *të drejtën për vetëvendosje*. Gjithashtu, misioni i këtyre lëvizjeve kishte karakter *mbrojtës*, e mbronin kombin shqiptarë

nga shpërngulja, copëtimi dhe asimilimi i popullsisë së sajë. Ato ishin të përkushtuara në ruajtjen e homogjenitetit dhe integritetit të popullsisë shqiptare që po përjetonte dhunën sistematike dhe shumë frontale nga pushtetet e atëhershme, mision ky që përshkon tërë krijimtarinë e rilindësve. Këto, lëvizje konsideronin *armike dhe të rrezikshëm* të gjitha ato nacionalitete, lëvizje dhe ideologji që pamundësonin idealin e kombit shqiptar. Armiqtë e tyre ishin sllavët dhe grekët, gjithashtu ideologjitë politike si komunizmi, kozmopolitizmi e të tjera që nuk e konsideronin kombin si njësi politike. Referuar periudhat e mbuluara në këtë punim, bazuar në secilën periudhë në fjalë ligjërimi nacionalist shqiptar në Kosovë gjithmonë vihet përball tjetrit, pra ka *natyrë dikotome*. Ndërtimi i këtij ligjërimi forcohet gjithmonë përball “tjetrit”, gjegjësisht represionit të tjetrit ndaj “neve”. Represioni, dhuna, shpërngulja e dhunshme, burgosjet politike ndaj popullsisë dhe lëvizjeve politike shqiptare vetëm sa e forconin ligjërimin nacionalist të kësaj periudhe. Për të ardhur deri tek qëllimi final, ky ligjërim kishte për qëllim bashkimin e Kosovës dhe trojeve të tjera shqiptare në ish-Jugosllavi me Shqipërinë, duke e shndërruar atë në një shtet kombëtar shqiptar. Pra, karakteri ligjërimor i këtyre lëvizjeve *nuk është ekspansionist*, sepse nuk synonte territoret joshqiptare, por ajo synonte bashkimi i tërësisë territoriale kombëtare në një shtet të përbashkët projekt ky i mbartur nga rilindja kombëtare shqiptare.

Pra, mund të themi se ligjërimi nacionalist shqiptar në Kosovë gjatë këtyre periudhave pësoi oscilime të shumta politike dhe ideore dhe se nuk arriti të ruaj koherencën ligjërimore me konceptin e shqiptarizms. Kështu, të braktisur nga shteti amë dhe nga faktori ndërkombëtarë, shqiptarët e Kosovës idenë e nacionalizmit shqiptarë e artikuluan të tkurrur dhe jo në gjithpërfshirshmërinë e sajë. Kjo trajektore dinamike dhe dialektike në vetvete përbën boshtin e një mendimi të ri politik, tani më i diferencuar qartë dhe bindshëm nga ai i rilindësve shqiptarë. Ky lloj diskursi nëse do të mund ta quanim, është shkarja dhe evoluimi, modeli dhe paradigma e nacionalizmit shqiptar si mendësi, politikbërje dhe praxis politik e reflektuar dhe aplikuar brenda një territori dhe realiteti të ri gjeografik brenda ish-Jugosllavisë. Thënë ndryshe, skica potenciale e mendimit politik Kosovar, është një sfond konceptual fillimisht dhe më pastaj si angazhim aktiv politik në formë të rezistencës paqësore dhe ushtarake me një qëllim kryesor në ndarjen e saj nga Republika Socialiste e Jugosllavisë dhe të drejtën e saj për vetëvendosje, por jo domosdoshmërisht bashkim me Shqipërinë. Vazhdimësia e mendimit politik Kosovar, do të jetë një ndërrmarje e re

intelektuale, angazhim dhe politikbërje; zhvillim i debatit politik dhe diskursiv në diferencimin e Kosovës si çështje e Shqipërisë, zhvendosje e autenticitetit së publike shqiptare dhe shqipërisë si realitet politik; si dhe, e që është më e rëndësishmja, sovraniteti i plotë politik dhe territorial i cili do të vazhdojë të zhvillohet në raport me Serbinë në një anë dhe nomenklaturën ndërkombëtare në Kosovë.

IX. Literatura

- Agani, Fehmi. (2002). Demokracia, Kombi dhe Vetëvendosja, Dukagjin, Pejë.
- Agani, Fehmi. (2002). Partitë dhe grupet politike në Shqipëri /1939-19457, Dukagjin, Pejë.
- Agani, Fehmi. (2002). Pavarësia gjasa dhe Shpresë, Dukagjin, Pejë.
- Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë Tiranë, Instituti i Historisë-Prishtinë, Përmbledhje Kumtesash. (2004). Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, Tiranë.
- Anderson, Benedict. (2013). Komunitete imagjinare, dy lindje & dy perëndime, Tiranë.
- Appiah, A. Kwame. (2008). My cosmopolitanism, IDK, Tiranë.
- Appiah, A. Kwame. (2006). Cosmopolitanism ethics in a world of strangers, W.W. North &Company, New York, London.
- Austin, C. Robert. (2011). Fan Noli dhe një revolucion i ikur, Koha.
- Autoktonia e shqiptarëve në studimet gjermane. (1990). Rilindja, Prishtinë.
- Bajram Kurti. (1997). Begzad Baliu, Gjaku i lirisë 1981-1995, III, Prishtinë.
- Baleta, Abdi. (1995). Shqiptarët përballë shovinizmit serbo-grek : përmbledhje e zgjeruar e përmbledhjeve dhe intervistave, Koha, Tiranë.
- Baleta, Abdi. (2005). Vetëm Nacionalizmi e shpëton kombin Shqiptar, Rimëkëmbja, Tirana.
- Baleta, Abdi. (2018). Udhëkryqet Politike Shqiptare, Vizioni M, Shkup.
- Basha, Këçmezi Sabile. (2003). Organizatat dhe grupet ilegale në Kosovë 1981-1989, Instituti i Historisë Prishtinë, Prishtinë.
- Basha, Këçmezi Sabile. (2009). Shtypi Ilegal Shqiptar në Kosovë (1945-1999), Shoqata e të Burgosurve Politik të Kosovës, Prishtinë.
- Basha, Këçmezi Sabile. (2009). Të Burgosurit Politikë Shqiptarë në Kosovë 1945-1990, Logos-A, Shkup.
- Basha, Këçmezi Sabile. (2013). Programet politike të lëvizjes kombëtare shqiptare 1878-1990, Instituti i Historisë Prishtinë, Prishtinë.

- Basha, Kijmezi Sabile. (2013). Veprimtaria atdhetare ilegale në Anamoravë 1945-1968, I, Instituti i Historisë Prishtinë.
- Bauman, Zygmunt. (2008). New frontiers and universal values, IDK, Tiranë.
- Beck, Ulrich. (2006). The Cosmopolitan Vision, Polity Press.
- Beck, Ulrich. (2008). Re-inventing Europe-A cosmopolitan vision, IDK, Tiranë.
- Buja, Ramë. (2006). Konferenca e Rambujesë, Vertigo Prizren, Prishtinë.
- Buxhovi, Jusuf. (2012). Kosova nga Konferenca e Londrës deri te pretektorati ndërkombëtar, Prishtinë: Faik Konica.
- Buxhovi, Jusuf. (2015). Kosova 1945-1999, Faik Konica.
- Buxhovi, Jusuf. (2015). Kosova Perandoria Osmane, Faik Konica, Prishtinë.
- Bytyqi, Enver. (2007). E drejta e vetëvendosjes: Rasti i Kosovës, Koha, Tiranë.
- Clayer, Nathalie. (2009). Në fillimet e nacionalizmit shqiptar, Botimet përprojekta, Tiranë.
- Çeku, Ethem. (2004). Shekulli i Ilegalës, Proceset gjyqësore kundër ilegales në Kosovë, Dokumente, Brezi '81, Prishtinë.
- Çeku, Ethem. (2006). Struktura politike e ilegales së Kosovës, Brezi '81, Prishtinë.
- Dani, Doan (2016). Shpikja e Mesjetës Vetja dhe Tjetri në medivistikën shqiptare, Pikapasipërfaqe, Tiranë.
- Delanty, Gerard. (2008). Peripheries and borders in a Post-Western Europe, IDK, Tiranë.
- Dupre, Ben. (2012). Pesdhjetë ide politike, Plejad, Tiranë.
- Elsie, Robert. (1997). Historia e letërsisë shqiptare, Pejë.
- Fanoni, Franc. (1984). Të mallkuarit e botës, Rilindja, Prishtinë.
- Feraj, Hysamedin, (2010). Skicë e mendimit politik shqiptar, Logos-A, Shkup.
- Feraj, Hysamedin. (1997). Pavarësia është e shenjtë, Koha, Tiranë.
- Feraj, Hysamedin. (2005). Pamundësia e Kozmopolitizmit Shqiptar, Rimëkëmbja, Tiranë.
- Fevziu, Blendi. (2008). Presidenti që u bë Mbret Ahmet Zogu, Uetpress, Tiranë.
- Fischer, Bernd. (2008). Diktatorët e Ballkanit, Instituti Shqiptar për studime ndërkombëtare, Tiranë.
- Fine, Robert. (2007). Cosmopolitanism, Routledge, London and New York.

- Frashëri, Kristo. (2012). Mbi historinë e Ballit Kombëtar, Botimet Dudaj, Tiranë.
- Frashëri, Sami (1987). Vepra 2, Shqipëria ç'ka qenë ç'është e ç'do të bëhet?, Rilindja, Prishtinë.
- Frashëri, Sami. (1978). Vepra 2, Rilindja, Prishtinë.
- Gashi, Shkëlzen. (2010). Adem Demaçi Biografi, Rrokullia, Prishtinë.
- Gellner, Ernest. Kombet dhe Nacionalizmi, , Rizoma, pvb.
- Gellner, Ernest. Nacionalizmi, , Botimet IDK, Tiranë.
- Greenfeld, Liah.(1992). Nationalism: five roads to modernity, Harvard University Press, London.
- Hasani, Enver, (2010). Vetëvendosja, integriteti territorial dhe stabiliteti ndërkombëtar: Rasti i Jugosllavisë, Buzuku, Prishtinë.
- Hasani, Enver,(2000). Shpërbërja e ish-Jugosllavisë dhe Kosova (Aspekte Politiko-Juridike), Instituti Shqiptar për Studime ndërkombëtare, Tiranë.
- Heywood, Andrew, (2008). Politika, Brezi '81, Prishtinë.
- Historia e Popullit Shqiptar, I. (2002). Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë.
- Historia e Popullit Shqiptar, II. (2002). Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Botimet Toena, Tiranë.
- Historia e Popullit Shqiptar, III. (2007). Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botimet Toena, Tiranë.
- Historia e Popullit Shqiptar, IV. (2007). Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Botimet Toena, Tiranë.
- Hobsbawm, E. J. (2002). Kombet dhe Nacionalizmi që nga 1780, Toena, Tiranë.
- Hoti, Ukshin dhe Kadare Ismail. (2000). Bisedë përmes hekurash, Onufri, Tiranë.
- Hoti, Ukshin. (1995). Filozofia Politike e Çështjes Shqiptare, Rozafa, Tiranë.
- Hoxha, Fadil. (1986). Jemi në shtëpinë tonë I, Rilindja, Prishtinë.
- Hoxha, Fadil. (1986). Jemi në shtëpinë tonë II, Rilindja, Prishtinë.
- Hoxha, Fadil. (1986). Jemi në shtëpinë tonë III, Rilindja, Prishtinë.
- Iain King dhe Whit Mason. (2007). Paqe me çdo kusht, si dështoi bota në Kosovë, Koha, Prishtinë.

- Iain Mc Lean. (2001). Fjalori Politik i Okxfordit, Shtëpia e librit dhe e komunikimit, Prishtinë.
- Ignatieff, Michael. (1993). Gjaku dhe Përkatësia Udhëtime në Nacionalizmin e Ri, Dituria. Tiranë.
- Imami, Petrit (2017). Serbët dhe Shqiptarët ndër shekuj, Vëllimi I, Samizdat B92, Beograd.
- Imami, Petrit. (2017). Serbët dhe Shqiptarët ndër shekuj Vëllimi II, Samizdat B92.
- Instituti i Historisë. (2002). Historia e Popullit Shqiptarë II. Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Toena. Tiranë.
- Intervista nga Shkëlzen Gashi. (2019). Kosova lufta dhe paqja (intervista), Drejtoria për Kulturë Komuna e Prishtinës, Prishtinë.
- J.Pettifer & M Vickers. (2007) Çështja shqiptare riformësimi i Ballkanit, Bota shqiptare & Edicioni Libri, Tiranë-New York.
- Kant, Imanuel. (2004). Drejt paqes së përhershme, Dritan, Tiranë.
- Kant, Imanuel. (2004). Ese ne filozofinë historike dhe politike, Fan Noli.
- Konferencë shkencore kushtuar 125 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, mbajtur më 9-10 Qershor 2003 Prizren. (2008). Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe vendi i sajë në histori, Instituti i historisë, Prishtinë.
- Kraja, Mehmet. (2019). Identiteti Kosovarë, Uetpress, Tiranë.
- Krasniqi, Milazim. (2015). E kujt është kjo kulturë, Logos-A, Shkup.
- Krasniqi, Milazim. (2017). Nacionalizmi Shqiptar, Logos-A, Shkup.
- Krasniqi, Milazim. (2017). Sekretet që nuk i mori me vete Ibrahim Rugova, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë.
- Krasniqi, Milazim. (2018). Krimet e vjetra dhe marrëzitë e reja, Vizioni M, Shkup.
- Kymlicka, Will, (2007). Multicultural Odysseys-Navigating the New International Politics of Diversity, Oxford Press.
- Lita, Qerim. (2011). KQ i NDSH-së dhe Azem Marana, Logos-A, Shkup.
- Lita, Qerim. (2014). Çështja shqiptare në RSFJ 1981-1990, Vatra, Shkup.
- Lita, Qerim. (2018). Problemi Shqiptar në RP(S) të Maqedonisë, Përmbledhje dokumentash Qëndresa Antikomuniste, Logos A, Shkup.
- Malcolm, Noel. (2001). Kosova një histori e shkurtër, Koha, Prishtinë.

- Maliqi, Shkëlzen. (1989). Nya e Kosovës As Vllasi As Millosheviqi, Prishtinë.
- Maliqi, Shkëlzen. (1994). Shqipëtarët dhe Evropa. Dukagjini, Pejë.
- Mazover, Mark. (2010). Ballkanin Një histori e shkurtër, Skenderbeg Books, Tiranë.
- Me shënim dhe parathënie të Veton Surroit. (2010). Fadil Hoxha në vetën e parë, Koha Prishtinë.
- Murtezai, Ekrem. (1978). Marksizmi, socializmi dhe vetëqeverisja, Bot. II, Qendra krahinore e arsimit marksist Prishtinë, Prishtinë.
- Muja, S. Hajredin. (2012). Lufta e Kosovës në shtypin Amerikan 22 shkurt 1998-10 qershor 1999, Logos-A, Shkup.
- Ndiriçim, Kulla. (2003). Antologji e Mendimit Shqiptar 1870-1945, Plejad, Tiranë.
- Novosella, Selatin. (2012). Demaçi Lëvizja për Bashkim, Shoqata e të Burgosurve Politik të Kosovës, Prishtinë.
- Novosella, Selatin. (2012). Kosova “64, Lëvizja për Bashkimin e Shqiptarëve, Logos-A, Shkup.
- Novosella, Selatin. (2012). Kosova “68, Demonstratat e gjashtëdhjetetës, Logos-A, Shkup.
- Novosella, Selatin. (2012). Kosova “75, Procesi politik i Prishtinës, Logos-A, Shkup.
- Nuray, Bozborra. (2002). Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane, Dituria. Tiranë.
- Ollomani, Shefki. (2008). Çështja Kombëtare Shqiptare, Shkupi, Shkup.
- Pajaziti, Ali. (2003). Ese Sociologjike, Logos-A, Shkup.
- Përzgjedhjen, përkthimin, redaktimin dhe parathënien Qerim Lita. (2015). Lidhja Kosovare në SHBA dhe Jusuf Azemi, Dokumente sekrete jugosllave (1971-1990), Vatra, Shkup.
- Pirraku, Muhamet. (2006). Për Kauzën e UÇK-së, Grafobeni, Prishtinë.
- Prishtina, Hasan. (2009). Nji shkurtim kujtimesh mbi kryengritjen shqiptare të vjetit 1912, PrintingPress, Prishtinë.
- Qosja, Rexhep. (1990). Populli i ndaluar, Mega Medium, Prishtinë.
- Qosja, Rexhep. (1990). Porosia e madhe, Rilindja, Prishtinë.
- Qosja, Rexhep. (1992). Strategjia e Bashkimit Shqiptar, Instituti Albanologji, Prishtinë.
- Rahimi, Shukri. (1986). Gjurmime historike të Rilindjes Kombëtare, Rilindja.

- Raifi, Mensur. (1995). Fan Noli dhe çështja e Kosovës, Shoqata e përkthyesve letrarë të Kosovës, Prishtinë.
- Rugova, Ibrahim. (1991). Pavarësia dhe demokracia, intervista dhe artikuj, Fjala, Prishtinë.
- Schevill, Ferdinand. (2002). Ballkani Historia dhe Qytetrimi, Eugen, Tiranë.
- Schmit, J. Oliver. (2012). Kosova Histori e shkurtër e një treve qendrore Ballkanike, Koha, Prishtinë.
- Schmit, J. Oliver. (2012). Shqiptarët Një histori midis Lindjes dhe Perëndimit, K&B, Tiranë.
- Skëndi, Stavro, Zgjimi Komëtar Shqiptar 1878-1912, Phoenix&Shtëpia e Komunikimit, Tiranë.
- Smith, Anthony. National Identity, Penguin Books.
- Smith, D. Anthony. (2008). Kombet dhe nacionalizmi në erën globale, Botimet Dudaj, Tiranë.
- Smith D. Anthony. (1987). The Ethnic Origins of Nations, Blackwell Publishing.
- Spahiu, Nexhmedin. (2017). Ngritja e Kombit Kosovar, Prishtinë.
- Sulstarova Enis. (2003). Ligjërimi Nacionalist në Shqipëri, Afërdita, Tiranë.
- Sulstarova, Enis. (2012). Jam Evropë!, Logos-A, Shkup.
- Sulstarova, Enis. (2015). Ligjërimi Nacionalist në Shqipëri dhe studime të tjera, Pika pa sipërfaqe, Tiranë.
- Shala, Blerim. (2000). Vitet e Kosovës 1998-1999, Gama, Prishtinë.
- Shehu, Shaban. (1978). Marksizmi dhe Humanizmi, Flaka e vëllazërimit, Shkup.
- Tahir Abdyl. (2003). Hasan Prishtina, GME, Prishtinë.
- Todorova, Maria, (2009). Imagining the Balkans, Oxford University press, New York.
- Vasa, Pashko (1989). Vepra, 3, E vërteta për Shqipërinë dhe Shqipëtarët, Rilindja, Prishtinë.
- Vasa, Pashko. (1989). Vepra 3, Rilindja, Prishtinë.
- Veprimtaria atdhetare e Hasan Prishtinës (dokumente), përzgjedhjen dhe redaktimin. (2012). Skender Asani, Mehmet Prishtina, Sefer Tahiri, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Shkup.

- Vickers, Miranda. (2004). Midis serbëve dhe shqiptarëve Një histori e Kosovës, Botimet Toena, Tiranë, 2004,
- Vlora, Bej Syreja. (2015). Shqipëria pas Osmane 1912-1920, Logos-A, Shkup.
- Zija Xholi. (1978). Sami Frashëri Monografi, Rilindja, Prishtinë.

Nga interneti

- Abetarja e pushtetit: Libërth mbi politikën, njerëzit dhe partitë në Kosovë, IKS, Prishtinë, 2011, pdf version: <http://iksweb.org/wp-content/uploads/2011/12/Abetarja-e-Pushtetit-Liberth-mbi-Politikën-Njerëzit-dhe-Pushtetin-ne-Kosove.pdf> , 10. 11. 2019.
- Adam D. Etinson, Cosmopolitanism: Cultural, Moral, and Political, f. 28, 29. Në dispozicion nga: https://www.researchgate.net/publication/299637593_Cosmopolitanism_Cultural_Moral_and_Political [accessed Jun 08 2018]. Data e qasjes në këtë artikull: 03. 06. 2018.
- Sennet, Polysemy, Philosophy of Language, Online Publication Date: Aug 2016: <https://www.oxfordhandbooks.com/view/10.1093/oxfordhb/9780199935314.001.001/oxfordhb-9780199935314-e-32>, 20, 08, 2020.
- Albin Kurti - Bashkimi kombëtar i shqiptarëve i domosdoshëm, video, Mar 30, 2012; <https://www.youtube.com/watch?v=97h5c0qEtKc> 12. 12. 2019.
- Albin Kurti Për bashkimin kombëtar, video; Apr 12, 2015; https://www.youtube.com/watch?v=_5OZVE029k 12.12.2019.
- Doja, Alber. Etniciteti, ndërtimi kombëtar dhe nacionalizmi në territorin etnik shqiptar: qasje antropologjike e konfliktit të marrëdhënieve ndëretnike: <http://discovery.ucl.ac.uk/19511/2/Ethnicity-alb.pdf> 9.06. 2018.
- Enis Sulstarova, Bashkimi Kombëtar nuk zëvendësohet nga integrimi evropian, Jun 4, 2017; <https://shenja.tv/enis-sulstarova-bashkimi-kombetar-nuk-zevendesohet-nga-integrimi-evropian/> 4. 12. 2019.
- Ethem Çeku, Kosova në vitet 1960-1970 dhe qëndrimi i Shqipërisë; https://aab-edu.net/assets/uploads/2016/11/02-2009-04_-_Ethem_Ceku.pdf 22.07.2019.

- Halil Matoshi: Kombi kosovar nuk ka lindur sot, i ka fillesat që nga lëvizja e vitit 1968, 23/11/2019, <https://gazetametro.net/halil-matoshi-kombi-kosovar-nuk-ka-lindur-sot-i-ka-fillesat-qe-nga-levizja-e-vitit-1968/> 3.12.2019.
- Hasan Prishtina (1873-1933), ideolog i çlirimit dhe i bashkimit kombëtar të shqiptarëve, intelektual e atdhetar..., 13/08/2019
<https://www.radiokosovaelire.com/hasan-prishtina-1873-1933-ideolog-clirimit-dhe-bashkimit-kombetar-te-shqiptareve-intelektual-e-atdhetar/>, 24.12. 2019.
- Kadri Veseli: Kosova dhe Shqipëria do të bashkohen, 27 Maj 2017;
<https://lajmi.net/kadri-veseli-kosova-dhe-shqiperia-do-te-bashkohen/> 2.12.2019.
- Latif Mustafa, Në frymën e shekullit radikal, Revista Shenja;
<http://shenja.mk/index.php/opinion-analize/17483-ne-frymen-e-shekullit-radikal.html> 14.12.2019.
- Lëvizja Vetëvendosje, Bashkim për bashkimin, 19 11 2012;
<https://www.vetevendosje.org/bashkim-per-bashkimin/> 13.12.2019.
- Mandati i UNMIK-ut; <https://unmik.unmissions.org/sq/mandati> 2. 02. 2020.
- Menifesti i Vetëvendosjes, Lëvizjes Vetëvendosje;
<https://www.vetevendosje.org/ep-content/uploads/2019/01/Manifesti-11494292623.pdf> .
- Muhamedin Kullashi, Konferencë ndërkombëtare, e mbajtur më 25 Gusht 2008 në Prishtinë, Kosova dhe Bota Arabe. 2009, Prishtinë; <http://kfos.org/ep-content/uploads/2012/08/bota-arabe-al.pdf> Data e qasjes: 10. 06. 2018.
- NATO's role in Kosovo; http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48818.htm 2. 02. 2020.
- Pirro Prifti, “Kombi Kosovar”, një projekt anti-kombëtarë; 25/10/2016,
<https://sot.com.al/opinion-editorial/“kombi-kosovar”-një-projekt-anti-kombëtar> , 2. 12 2019.
- Platforma e Grupit Negociator të Kosovës është Pavarësia;
<https://www.evropaelire.org/a/1010479.html>, 06 tetor, 2005.
- Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, shtator, 2017;
<https://www.min->

- rks.net/repository/docs/programi_i_qeverise_se_republikes_se_kosoves_2017_2021.pdf 14.12.2019.
- Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, shtator, 2017;
https://www.min-rks.net/repository/docs/programi_i_qeverise_se_republikes_se_kosoves_2017_2021.pdf 14.12.2019.
 - Rexhep Qosja: Dhunëtarët e histories, 5 Nëntor 2019,
<https://www.koha.net/arberi/192466/rexhep-qosja-dhunetaret-e-historise/>, 1. 11. 2019.
 - Rexhep Qosja: Shqipëria dhe Kosova do të bashkohen, 18, 02, 2020;
<https://www.gazetaexpress.com/rexhep-qosja-shqiperia-dhe-kosova-do-te-bashkohen/> 3. 4. 2020.
 - Switzerland Demographics:
http://www.indexmundi.com/sëitzerland/demographics_profile.html), July, 2016.
 - Shih më tepër: Strategjia Kombëtare për Integrimin Evropian “Kosova 2020”;
<https://www.president-ksgov.net/repository/docs/StrategjiaKombetareIntegrimEvropian.pdf> 2. 12. 2019.
 - Thaçi për “bashkim kombëtar”, Haradinaj për fqinjësi me Shqipërinë, 27 Maj 2019;
<https://www.gazetaexpress.com/thaci-per-bashkim-kombetar-haradinaj-per-fqinjesi-me-shqiperine/> 2.12.2019.
 - Valon Murati, Bashkimi Kombëtar si një process, 05.11.2012;
<https://levizjaperbashkim.org/informacion/press-release/bashkimi-kombetar-si-nje-proces> 14.12.2019.
 - Vjosa Osmani kundër Albin Kurtit për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë: Kosova, projekt i përhershëm; Publikuar me 13 Nëntor 2019; <https://ballkani.info/vjosa-osmani-kunder-albin-kurtit-per-bashkimin-e-kosoves-me-shqiperine-kosova-projekt-i-perhershem/> 2. 12. 2019.
 - János Kenyeres, Aspects of Canadian Multiculturalism: History, Policy, Theory and Impact, Central European Journal of Canadian Studies, Volume 09, 2014;
https://digilib.phil.muni.cz/bitstream/handle/11222.digilib/134378/2_CentralEuropeanJournalCanadian_9-2014-1_5.pdf?sequence=1, 08.07.2019.

Revistat dhe gazetat

- Ahmeti, Nuredin, “Xhemijeti” zë i artikuluar në mbrojtjen e shqiptarëve, Revista Shenja, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Nr. 105. Janar 2020.
- Basha, K. Sabile, Formimi dhe veprimtaria e organizatës Nacional Demokratike Shqiptare 1945-1948, Revista Kosova, Nr. 18/19, Instituti i Historisë, Prishtinë, 1996.
- Fera, Hysamedin, Irracionaliteti i “racionalitetit”, Revista Shenja, Nr, 32. Dhjetor, 2013.
- Hoxha, Elvis, Një popull është gjithnjë një universalitet, Publikja Shqiptare figurat e skandalit 2, Zenit, Tiranë.
- Lita, Qerim, Procesi i shpërnguljes së shqiptarëve nga trevat verilindore gjatë shekullit XX, Revista Shenja, E përmuajshme mbarëkombëtare politike, ekonomike dhe kulturore, nr 78, tetor 2018.
- Muhiq, Ferid, Gambit Kozmopolit – mbrojtje kombëtare, Revista Shenja, Nr.67. Nëntor 2016.
- Pajaziti, Ali, Shpërngulja e trurit si kancer social: Konteksti Ballkanik, Revista Shenja, Nr. 78, Tetor, 2017.
- Pajaziti, Ali. Filozofia politike shqiptare mes etnocentrizmave Ballkanikë dhe internacionalizmit, Revista Shenja, Nr.67. Nëntor 2016.
- Prishtina, Hasan, Sjellje e Serbisë Kundrejt Shqipnisë, Revista Shenja, Nr. 16, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, 2012, 21.
- Spahiu, Nexhmedin, Xhemijeti si pararendëse e LDK-së së Rugovës, Revista Shenja, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Nr. 105. Janar 2020.
- Sulstarova, Enis, Bashkëkohësia e Rilindjes, Publikja Shqiptare figurat e skandalit 2, Zenit, Tiranë.

Dokumente

- Deklarata për dhënien e pavarësisë vendeve dhe popujve të kolonizuar, Rezolutë e Asamblesë së Përgjithshme, numër 1514 (XV), me datën 14 dhjetor, 1960.

- Dokumenti "Standardet për Kosovën", Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Harri Holkeri ju dorëzoi autoriteteve kosovare dokumentin Standardet për Kosovën, Dhjetor 2003.
- Dokumenti i Rambujesë, Marrëveshja e përkohshme për Paqen dhe Vetëqeverisjen në Kosovë, Rambuje 23 shkurt 1999.
- Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 15 Maj, 2001.
- Kushtetuta e Kosovës
- Marrëveshja e Konçulit, Maj, 2001
- Marrëveshja Kornizë Ohrit, Gusht 2001.
- NATO's role in Kosovo, http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_48818.htm 2. 02. 2020.
- Në Kartën e Kombeve të Bashkuara (1845), Rezolutën 1514 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (1960), Konventën Ndërkombëtare për të Drejta Civile dhe Politike (1966), Rezolutën 2625 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së (1970), Akti Final I Helsinkit (1975).
<http://www.hrc.ucepeace.org/files/pages/Human%20rights%20instruments.pdf>
- Pakoja e Martti Ahtissarit për Kosovën, Shkurt 2007.
- Pakti Ndërkombëtar për të drejta civile dhe politike. Miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966. Pjesa e parë, Neni 1. Shih <http://www.hrrp.eu/alb/docs/CCPR-a.pdf>.
- Programi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës
- Programi i Lëvizjes Vetëvendosje
- Programi i Lidhjes Demokratike të Kosovës
- Programi i Partisë Demokratike të Kosovës
- Programi politik i Lëvizjes për Bashkim
- Rezoluta 1244 e Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 10 Qershor 1999.
- Rezolutën 1244 e Kombeve të Bashkuara për Kosovën, 10 Qershor, 1999.
- Statuti i Partisë Demokratike të Kosovës

